



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I LETËRSISË



*Tezë doktore*

# STUDIME LETRARE TË IBRAHIM RUGOVËS

UDHËHEQËS SHKENCORË:

Prof. Asoc. Dr. Kujtim SHALA  
Prof. Dr. Dhurata SHEHRI

PËRGATITI:

Albanë MEHMETAJ,  
*doktorante*

Tiranë, mars 2015

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**  
**Departamenti i letërsisë**

**TEZË DOKTORATURE**  
E paraqitur nga  
**ALBANË MEHMETAJ**  
Në kërkim të gradës shkencore  
**Doktor**

**Tema:**  
**STUDIME LETRARE TË IBRAHIM RUGOVËS**

**Udhëheqës shkencorë**  
**Prof. Asoc. Dr. Kujtim Shala**  
**Prof. dr. Dhurata Shehri**

**Mbrohet me datën** \_\_\_\_\_

**Komisioni i vlerësimit:**

1. \_\_\_\_\_ kryetar
2. \_\_\_\_\_ anëtar
3. \_\_\_\_\_ anëtar
4. \_\_\_\_\_ anëtar
5. \_\_\_\_\_ anëtar

## LËNDA

HYRJE, 5

**Pjesa e parë:**

**TEORIA LETRARE**

PARADIGMAT E TEORISË LETRARE, 11

*Kah teoria*, 11

Letërsia, 12

Metodologjia, 14

Estetika(t), 17

Semiologji, 21

FUNKSIONET E TEORISË LETRARE, 24

TEORIA E KRITIKËS LETRARE, 27

TEORIA E POEZISË SHQIPE, 33

Teoria e tipologjisë, 33

Artikulimi tipologjik, 36

**Pjesa e dytë:**

**ESETË**

STRATEGJIA E KUPTIMIT, 43

REFUZIMI ESTETIK, 46

**Pjesa e tretë:**

**KRITIKA LETRARE**

KRITIKA LETRARE, 51

I. KRITIKA LETRARE, 51

II. STRATEGJIA E KUPTIMIT, 52

- II. 1. Ironia poetike (Ali Podrimja), 54
- II. 2. Teksti simbolik (Rrahman Dedaj), 56
- II. 3. Abstraksioni poetik (Beqir Musliu), 57
- II. 4. Eidoritmia poetike (Eqrem Basha), 59
- II. 5. Vetëdije e ligjërimet poetik:  
Formalizmi poetik (Sabri Hamiti), 60
- II. 6. Ideja e tjetërsimit: Momenti poetik, 62
- III. REFUZIMI ESTETIK, 63
- III. 1. Poezia bashkëkohore, 64
- III. 2. Romani bashkëkohor shqiptar, 71

**Pjesa e katërt:**

**STUDIMET DHE LIBRAT MONOGRAFIKË**

DY STUDIME MONOGRAFIKE, 78

I. OPUSI I BEQIR MUSLIUT, 82

II. SISTEMI POETIK I SABRI HAMITIT, 82

BOGDANI *SIPAS* RUGOVËS, 90

Rugova dhe vepra e Bogdanit, 90

Gjenetika e veprës, 91

Analitika e veprës, 93

Semiologjia e Rugovës, 109

KAHE DHE PREMISA TË KRITIKËS

LETRARE SHQIPTARE 1504-1983, 115

Kahe dhe premisa, 115

Kontekstet socio-kulturore, 117

Kahe, 121

Premisa (rezultate), 125

Bibliografia, 135

PËRFUNDIM, 137

BIBLIOGRAFI, 140

LITERATURA, 157

Abstrakti, 163

Abstrackt, 164

## HYRJE

Interesimi për studimin e veprës teoriko-letrare të Ibrahim Rugovës është interesim për hulumtimin e një prej veprave më të mëdha të bashkëkohësisë kulturore dhe letrare shqiptare.<sup>1</sup> Teza e doktoraturës “Studime letrare të Ibrahim Rugovës” shënon përpjekjen për të hetuar dhe definuar disa nga problemet themelore të teorisë së letërsisë dhe të kritikës letrare moderne.

Rezultatet në këtë drejtim dalin si rezultat i punës së Ibrahim Rugovës, studiuës i formuar në frymën e teorive letrare moderne, të teorive të shekullit XX, duke filluar nga formalizmi rus, semiotika, strukturalizmi e postrukturalizmi. Rëndësia rritet kur shikojmë se të gjitha këto gjenden të artikuluar brenda fushës së pikëpamjeve të Rugovës, por edhe të provuara në veprën e tij në nivel metode dhe rezultatesh.<sup>2</sup>

Para se të kalohet te rezultatet, është e rëndësishme të theksohet se Rugova filloi jetën prej dijetari si interpretues i letërsisë, me librin *Prekje lirike*, të vitit 1971, vijoi si eseist, u bë teoricieni kryesor në kulturën letrare të Kosovës dhe, së fundmi, kaloi në interpretues të ideve kulturore dhe politike, sidomos te *Refuzimi estetik* (1987), që është vepra e tij e fundit.

Kështu, me emrin e Ibrahim Rugovës lidhet shumë zhvillimi i mendimit modern shqiptar për letërsinë dhe kulturën, kritika letrare moderne shqiptare dhe teoria letrare, por edhe jeta nacionale, meqë ai ishte dhe prijës i shqiptarëve të Kosovës në përpjekjet tyre për liri dhe pavarësi.

Por, cili ishte Ibrahim Rugova e cila vepra e tij, që e kemi objekt kërkimi në punim tonë doktoratë?

\*\*\*

---

<sup>1</sup> Deri më tani për veprën studimore të Ibrahim Rugovës kanë shkruar: Ali Aliu, Rexhep Ismjali, Sabri Hamiti, Xhemajl Mustafa, Ramadani Musliu, Gjergj Zheji, Shaban Sinani, Ymer Çiraku, Mark Marku, Agron Tufa, Kujtim M. Shala, Dhurata Shehri, Nysret Krasniqi etj. Shih *Bibliografinë* në fund të punimit. Në vitin 2012, Kujtim M. Shala, Dhurata Shehri, Munish Hyseni dhe Albanë Mehmetaj botuan antologjinë me studime për Rugovën, “Rugova i letërsisë”, Fondacioni “Ibrahim Rugova”, Prishtinë, në të cilën janë përfshirë tekstet themelore për Ibrahim Rugovën të botuara deri më tani.

<sup>2</sup> Krahaso me “20<sup>th</sup> Century Literary Criticism”, edited by David Lodge, Longman, London, 1972; Jonathan Culler: “Criticism after Structuralism”, Routledge & Kegan Paul, London and Melburn, 1983; “Critical Terms for Literary Study”, edited by Frank Lentricchio and Thomas McLoughlin, The University of Chicago Press, Chicago and London, 1995; “Literary Aesthetics” edited by Alan Singer and Allen Dunn, Blackwell Publishers, Oxford, 2000.

Ibrahim Rugova u lind më 1944, në Cërcë, Istog, të Kosovës. Mbaroi studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Studioi letërsi në Paris. U doktororua në Universitetin e Prishtinës, në vitin 1984. Më 1996, dr. Ibrahim Rugova u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Po në këtë vit ai u shpall Doktor nderi i Universitetit të Parisit VIII, në Paris. Në vitin 2004 u shpall Doktor nderi i Univesitetit të Tiranës.

Ibrahim Rugova punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës si hulumtues i letërsisë. Për një kohë ka qenë kryeredaktor i revistës "Gjurmime albanologjike" të Institutit Albanologjik. Ishte kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës.

Ibrahim Rugova për së gjalli botoi këto vepra: *Prekje lirike* (1971), *Kah teoria* (1978), *Kritika letrare* (1979), *Strategjia e kuptimit* (1982), *Vepra e Bogdanit 1675-1685* (1982), *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983* (1986) dhe *Refuzimi estetik* (1987), që të gjitha në Prishtinë. Në vitin 2009, në Prishtinë është botuar edhe libri me tekste të Rugovës, të botuara në gazeta e revista dhe me dorëshkrime, i titulluar *Kode të shkrimit letrar*.<sup>3</sup>

Vepra studimore e Ibrahim Rugovës fillon me *Prekje lirike*, me interpretime pothuajse poetike të teksteve letrare dhe vijon me *Kah teoria*, që e hap rrugën e Rugovës në kërkimet teorike-letrare, siç e tregon edhe vetë titulli i librit. Konkretisht problematika e trajtuar nën këtë titull kap probleme teorike të letërsisë dhe ka në qendër propozimin për tekstin artistik dhe artin e hapur dhe që do të thotë se Rugova asnjëherë, as këtu dhe as në veprat e mëvonshme, nuk synon drejt mbylljes së çështjeve. Në këtë kuptim, teoria e tij shkon drejt pikëpamjes për letërsinë si *differentia specifica*, si prodhim i veçantë artistik. Këtë koncept, përpos teorikisht, Rugova e zberthen edhe brenda letërsisë shqipe, duke synuar ta takojë me modelet e dijes botërore. Përpjekja e tillë ka objekt diferencimin e letërsisë si gjini e veçantë, si produkt intelektual, me synim kërkimin e qenësisë së letërsisë.

Eseistika, kritika dhe teoria letrare janë zhanret e veprës të radhës, të titulluar *Strategjia e kuptimit*. Në tekstet eseistike Rugova trajton dukuri të mëdha letrare, në tekstet kritike vlerëson vepra të caktuara, ndërsa te tekstet teorike ai përgjithëson rezultate të kërkimit të arritura në dy fushat e para. Edhe këtu interesimi i Rugovës lidhet me probleme dhe fenomene të veçanta për veprën letrare artistike. Në kapitullin e parë Rugova përmes esesë do të krijojë rrethanën për të sqaruar kërkimin e dy pjesëve të tjera. Kështu, ai nisat nga pikëpamja se strategjia duhet kuptuar si mekanizëm, rregullator i kuptimeve, i shfaqur në forma të ndryshme e të shumta. Shkurt, kërkohet strategjia si element prodhues e krijues në procesin e krijimit të veprës artistike.

Me këtë kusht, pra të strategjisë së kuptimit, Rugova fillon pjesën e dytë, *kritikën*, duke bërë një përzgjedhje të autorëve bashkëkohës, për të vështruar fenomene të krijimit letrar, të poezisë, dhe duke kërkuar strukturat, qasjen dhe

---

<sup>3</sup> Në vitin 2005, nga ana Shtëpia Botuese "Faik Konica" e Prishtinës, është botuar Kompletin e veprave të Ibrahim Rugovës, në tetë vëllime.

metodën e krijimit. Pra, objekt kërkimi janë disa autorë bashkëkohës, veprat poetike të tyre, për të cilët Rugova bën interpretimet e para.

Kështu, ngadalë Rugova kalon në pjesën e tretë, në studimin teorik të poezisë bashkëkohëse shqipe. Ai për këtë studim zgjedhë tipologjinë si metodën më të përshtatshme për të shqyrtuar praksisin e poezisë.

*Vepra e Bogdanit 1675-1685* është studimi më i njohur i Rugovës, në të cilën studiohet një autor, por edhe një epokë letrare. Rugova paraqet fillimisht veprën pastaj e analizon atë, kështu që rezultati rrjedh nga një hulumtim i gjatë dhe i sistemuar. Rugova edhe vetë zbulimin e veprës së Bogdanit e shënon si *moment*, si ngjarje madhështore në kulturën tonë, pasi që është vepër që nënkupton kërkime në një varg fushash, filozofike-shkencore, filozofike-teorike, kërkim në çështje të ndryshme të retorikës dhe disa aspekte të poetikës. Shkurtimisht, vepra e Bogdanit në studimin e Rugovës, e lidh kulturën shqiptare me kulturën evropiane të kohës. Vepra vlerësohet një *Komedi Hyjnore shqiptare* në planin e akseologjisë historiko-letrare e filozofike dhe një vepër bazë në humanistikën shqiptare.

Ndërsa, monografia e radhës, *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983* është enciklopedi dhe tipologji e kritikës letrare shqiptare. Rezultati përfundimtar i Rugovës është hetimi i elementeve kryesore mbi të cilat kritika shqiptare i ka ndërtuar kriteret e veta, pastaj në bazë të këtyre premisave janë kërkuar kahet dhe premisat. Në këtë studim dallohet përpjekja që problemi i kritikës të vështrohet në proces të kontinuitetit të ideve dhe përpjekja për hulumtimin dhe studimin e letërsisë (e cila ishte pjesërisht e njohur), pastaj klasifikimin sipas formës dhe metodës. Kjo është vepra më e njohur metakritike në historinë e letërsisë shqiptare deri më sot.

Në vitin 1987 Rugova e botoi veprën e tij të fundit, *Refuzimi estetik*, që i ngjan për nga struktura dhe metoda me *Strategjinë së kuptimit*.

Refuzimi këtu shpjegohet si kundërshtues i imponimit, rrugë kjo që çon në ndërtimin e demokracisë së jetës dhe lirisë krijuese. Duke e njohur raportin që ka letërsia me botën, me njeriun, Rugova refuzimin e shikon dhe e analizon në raport me letërsinë dhe politikën. Në këtë kontekst, refuzimin më të madh të saj e konsideron *refuzimin estetik*, që do të thotë refuzimim me qenie, me karakterin e saj. Kështu, *refuzimi estetik* ndikon edhe në rendin historik kulturor. Synimi përfundimtar i Rugovës është që përmes *refuzimit estetik* të ruhet baza, në mënyrë që letërsia të mbetet letërsi e mirëfilltë, duke ndikuar në pushtet e në shoqëri dhe jo anasjelltas.

\*\*\*

Duke i patur parasysh të gjitha këto probleme që i shqyrton Ibrahim Rugova dhe duke e ditur rëndësinë e tyre, në punimet si ky i yi është e nevojshme që të përcaktohet me kujdes rruga e kërkimit. Prandaj, si të arsyeshme e kemi parë që në punimin tonë të ndiqet një tipologji e brendshme e veprës studimore të Ibrahim

Rugovës, që ndjek interesimet e këtij autori, por edhe zhanret dhe fushat e studimit. Kështu, punimi do të strukturohet në katër tërësi të mëdha, të përcaktuara si:

- I. *Teoria letrare,*
- II. *Esetë,*
- III. *Kritika letrare dhe*
- IV. *Studimet dhe librat monografikë.*

Këto tërësi do të përcillem me karakterizime të përgjithshme të këtij autori, që do të përftojnë profilin e tij si kritik letrar dhe dijetar, që është edhe një qëllim i punimit tonë.

Pjesa e parë do të ketë objekt kryesor veprën e dytë Rugovës, të titulluar *Kah teoria*, që është vepra që përcaktoi rrugën e tij në studimet letrare. Që në fillim Rugova hap një numër problemesh teorike që janë edhe paradigmat e teorisë letrare të këtij autori. Teoria letrare është fusha e dashur e Rugovës, të cilës ai i është rikthyer përherë, për të bërë një tip kurore të kërkimeve të veta, sa herë që ka synuar të përgjithësojë rezultatet nga vepra të veçanta e grupe veprash në koncepte teorike.

Pjesa kërkimore që i kushtohet eseistikës do të gjurmojë shenjat e kësaj forme shkrimi në gjithë veprën diskursive të Ibrahim Rugovës, meqë natyra e tij prej dijetari liberal u përshtat më së shumti me esenë, formë që shtrihet kudo në tekstet e tij.

Rugova kritik letrar shkëlqen sidomos kur lexon autorët bashkëkohës, në leximet e para të veprave të posabotuara. Ai matet me këto vepra, paraqet dhe vlerëson, në rrugën e vështirë të vlerësimeve të para, që përherë janë më të vështirat. Veçantia e kritikut qëndron në faktin që ai shfaqet si një interpretues i fuqishëm i dijeve letrare e më gjerë, si një studiues që kërkon kuptimet e thella të letërsisë.

Rugova do të dëshmojë këtë pluralitet të dijeve letrare fuqishëm në dy librat monografikë, *Vepra e Bogdanit (1675-1685)* dhe *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*. Dija e këtij mendimtari do të marrë formë duke u shkrirë në tërësinë e këtyre dy monografive.

\*\*\*

Një punim i kësaj natyre, pra i fushës së metakritikës, prej vetiu është sistematik e sistematizues dhe synon të përshkruajë, të sistematizojë dhe të vlerësojë probleme, çështje e kategori që studion Ibrahim Rugova në veprën e tij të gjerë studimore.

Meqë dija letrare e Rugovës buron nga teoria letrare moderne, ne do të përdorim pikërisht diskurset që përshkruajnë këtë teori për të studiuar veprën e këtij autori.



Një studiues formalist dhe strukturalist si Rugova kërkon të gjurmohet metoda e analizës. Një semiolog si Rugova kërkon të hetohet leximi i tij i shenjave. Një dijetar poststrukturalist si Rugova do që të lexohet në parimin e vlerësisë, pra të shikohet se sa e re është vepra e tij sot, kur ka atributet e një vepre klasike të modernitetit.

Në këto pika metodologjike do të bëjmë kërkimet tona, për të hapur një vepër autentike studimmoire të kulturës letrare shqiptare, siç është vepra e Ibrahim Rugovës.

**Pjesa e parë**  
**TEORIA LETRARE**

## PARADIGMAT E TEORISË LETRARE

### *Kah teoria*

Vepra e Rugovës *Kah teoria* hap një numër problemesh teorike, që në të vërtetë janë paradigmat e teorisë letrare të këtij autori. Vetë titulli e bën të qartë qasjen teorike, siç e bën të qartë që nuk synohen përkufizime përfundimtare. Kah teoria, Rugova ndryshe do të thoshte: *drejt teorisë*. Natyra e teksteve që përbëjnë librin dhe formimi i autorit, e bëjnë më të qartë pretendimin e librit për të shkuar drejt teorisë.

Paradigmat themelore rugoviane të fushës së teorisë letrare janë: letërsia si e tillë, metodologjia e studimit letrar, çështje të estetikës dhe semiologjia letrare.

Teoria e Rugovës gjithnjë çon drejt pikëpamjes për letërsinë si *differentia specifica*, si prodhim i veçantë artistik. Këtë çështje, përpos teorikisht, Rugova e shqyrton brenda strukturës së letërsisë shqipe, në të cilën ndeshet me një letërsi të ideologjizuar e me funksion shoqëror. Për dallim nga letërsia me një natyrë të tillë, autori propozon tekstin artistik dhe artin e hapur. Duke e kërkuar letërsinë moderne,<sup>4</sup> ai flet për apertativitetin e artit, në të cilën vepra është e bazuar në *posiblen*, në të mundshmen.

Rugova, siç e thekson edhe vetë, këtu trajton edhe problemin e metodologjisë. Objekt trajtimi bën kritikën letrare, e cila vetë e ka për objekt letërsinë. Për Rugovën, të kritikosh do të thotë të vësh në krizë. Në këtë kuadër hyn edhe mendimi i tij se vepra është qenie e objektivuar dhe polisemantike, prandaj dhe kërkon interpretim të hapur. Ndërsa, interpretimi i artit, për të, më së miri del nga teoritë estetike dhe konkretisht nga estetika e objektivizmit ontologjik, prej nga buron edhe efekti estetik, efekt ky i dalë nga objekti estetik, i cili merr përmasa të larta me funksion metafizik. Dhe, me këtë rast, vepra, duke u kuptuar si *meta-fizis*, jeton në kohën kozmike.

*Kah teoria* karakterizohet me konceptin për letërsinë si *differentia specifica*, që ilustron te letërsia shqipe, me model dijen botërore, siç thotë vetë Rugova, për të ndihmuar takimin e drejtpërdrejtë me këtë dije.

---

<sup>4</sup> Matei Calinescu: “Pesë fytyrat e modernitetit”, Dituria, Tiranë, 2012.

Duhet të theksojmë se *Kah teoria* i përgjigjet konceptit të autori (ndërtuar mbi tezën e Bartit), se: “të shkatërrosh do të thotë të ndërtosh, e jo përfundimisht të shkatërrosh”.<sup>5</sup>

## Letërsia

Kahja teorike e Rugovës në këtë vepër buron nga *genus proximum*, që shpjegohet si dalje e letërsisë nga roli i gjinisë më të lartë, si hyrje në konceptimin e letërsisë si aktivitet i veçantë, i ndryshëm nga aktivitetet e tjera. Kahe që nis rrugëtimin e trajtimit të letërsisë si të tillë (të veçantë), duke filluar nga fenomeni letrar, letërsia si *differentia specifica*. Pra, Rugova problematizon teorikisht diferencimin e letërsisë, çështje kjo që kërkon vështrimin e gjendjes së superstrukturës dhe që del e kushtëzuar nga lëvizjet e strukturës nacionale, sociale e prodhuese, më parë dhe tash.

Pikëpmaja për letërsinë si *differentia specifica* shoqërohet nga përpjekja për hulumtim tërësor të letërsisë, për të parë funksionin përkatës të saj, rezultati i të cilës shkon drejt konsiderimit të letërsisë si aktivitet i veçantë funksional (artistik), me efekte estetike e strukturë autonome.

Në përpjekjen për diferencimin teorik të letërsisë, Rugova analizon funksionin e letërsisë, në strukturat e bashkësisë dhe të shoqërisë shqiptare. Në kërkim e sipër, Rugova e shikon letërsinë si shërbyese të idesë kombëtare, nacionale dhe të religjionit, përfundimisht letërsinë si shërbyese të ideologjisë. Kështu, në kuadrin e teorisë, Rugova, nxënës i Bartit, i dijeve botërore, i njohur thellë me metodat strukturaliste dhe me semiologjinë, propozon letërsinë si prodhim të veçantë artistik.. Rreth këtij kuptimi, pra të Isi prodhim i veçantë artistik, do të diskutohet diferencimi i letërsisë, rezultati i së cilës është prodhimi artistik. Dhe, në gjithë tekstin, do të shënohet përpjekja për letërsinë jo si ideologji, por si prodhim artistik. Këtë çështje Rugova e njuh së pari nga Hegeli: “se arti nuk paraqet më nevojën më të lartë të shpirtit, dhe se artin kanë zënë ta shtypin refleksioni dhe mendimi”. Autori këtu e vlerëson *fundin hegelian* jo si çështje të zhdukjes së artit, por si çështje e procesit të diferencimit. Vështrimin e Hegelit ndaj artit e quan *proces të diferencimit të dijës së përgjithshme* që filloi në shekullin nëntëmbëdhjetë e që u intensifikua në shekullin pasues.<sup>6</sup>

Në letërsinë shqipe në Kosovë, krahas asaj në Shqipëri, Rugova thekson se ekziston *vetëdija për autonomi të letërsisë*. Shënon një diferencim brenda vetë superstrukturës sonë, duke e parë letërsinë si një produkt intelektual, në mesin e produkteve të tjera të dijës. Ky diferencim, mendon Rugova, do të mund të nxjerrë funksionin e ri të letërsisë, duke e ndihmuar atë në kërkimin e qenësisë së vet.

<sup>5</sup> Ibrahim Rugova: “Kah teoria”, Faik Konica, Prishtinë, 2005, f. 8.

<sup>6</sup> “Aesthetics and the Philosophy of Art”, edited by Peter Lamarque and Sten Haugon, Blackwell Publishers, Oxford, 2004.

Rugova qartëson se kërkesa ndaj letërsisë për heterogjenitetin total superstruktural, duhet fshirë, duke u diferencuar të gjitha degët e ndryshme të shkencave ekzakte dhe të shkencave shoqërore. Kështu, ai vazhdimisht thekson që prej letërsisë si art mund të kërkohej vetëm që të jetë art i fjalës, se vetëm si produkt artistik do të mund t'i qëndrojë procesit të vazhdueshëm të diferencimeve.<sup>7</sup>

Më tutje Rugova thekson se, marrë në përgjithësi, edhe te ne po shfaqet një diferencim i përgjithshëm, një specializim i produksionit shpirtëror-mendor. Kështu, në kuadër të problemit të diferencimit, shtrohet edhe problemi tjetër: letërsia nuk e ka humbur funksionin e dikurshëm "të shenjtë", por është çështja e funksionit të ri të letërsisë. E, për pasojë, letërsia duhet të studiohet si model i botës dhe i shoqërisë dhe jo si objekt i disiplinave të tjera të dijes.

Rugova e definon letërsinë si *differentia specifica*, këmbëngul për studimin e saj si model me efekt estetik, duke e zhveshur nga roli mitik, nacional-social-mitik. Letërsia si produkt i veçantë, si studim dhe hulumtim sistemor, krijon efektin prodhues artistik. Funksioni i dikurshëm pasqyrues i letërsisë del si çështje e mbyllur.

Pikëpamjet e Rugovës në këtë aspekt përafrohen jo vetëm me ato të Hegelit, por edhe me ato të semiologut të njohur J. M. Lotman. Me teorinë e Lotmanit për artin si *informacion artistik*, Rugova e përforcon mendimin e tij për *procesin e diferencimit të artit*.

Kur e shtron çështjen e prodhimit të letërsisë, të artit, Rugova favorizon artin e hapur, artin që mundëson zgjedhjen e lirë. Konceptit *art i hapur* e njeh si autor estetin dhe semiologun e njohur italian, Umberto Eko.<sup>8</sup> Do të thotë, pikëpamjet e Rugovës përafrohen me Ekon, për artin bashkëkohor si art i hapur, për dallim nga arti klasik. Ndikimi i tij ndihet edhe në planin e terminologjisë, kur operon me terma *definitivitet* dhe *apertativitet*. Duke iu referuar Ekos, teoricieni ynë termin e parë e konsideron të vlefshëm për ato vepra të cilat kanë dhënë probleme të ndryshme të jetës dhe të çështjeve njerëzore në mënyrë definitive, përfundimtare, që nuk krijojnë mundësi të gjera të kuptimit dhe të interpretimit. Ndërsa, apertative është vepra e hapur, e bazuar në *posibilen*, në të mundshmen, do të thotë në zgjedhjen e lirë të atij që kontakton me të; t'i zgjedhë vetë aspektet që i interesojnë dhe që i shikon si të rëndësishme e të vlerëshme për problemet e tij jetësore apo shpirtërore, që autori i ka lënë të hapura, nuk ka dashur t'i mbyllë përmes zgjidhjes, meqë për ta është i interesuar edhe njeriu (lexuesi, marrësi) që me natyrën e tij intelektuale të inkuadrohet në dhënien kuptim veprës.

Rugova, duke mos e pranuar letërsinë e as teorinë e saj si dogmë, si (për)kufizim final, por gjithmonë si çështje të hapur, te debatueshme dhe të diskutueshme përherë, artikulon pikëpamjen për një bashkëpunim ndërmjet autorit dhe lexuesit, duke e mbrojtur teorinë se vepra është e shkruar për aktivizimin e lexuesit. Prandaj, mund të themi që në thelb të teorisë së Rugovës për artin e hapur

<sup>7</sup> Shih edhe Kujtim M. Shala: "Rugova meditant", AIKD, Prishtinë, 2008, ff. 52-53.

<sup>8</sup> Umberto Eco: "Otvoreno djelo", Veselin Masleša, Sarajevo, 1965.

është çështja e marrësit, që veprën e lexon në mënyrën e vet. Do të thotë, semiologu Rugova shprehet për dialogim të hapur ndërmjet veprës dhe lexuesit.

Në mbështetje të kësaj teorie, këtë lexim e quan *poetikë të papërcaktueshme aspektesh*, duke e njohur si karakteristikë të veprës moderne. Njëherësh këtë mënyrë të organizimit e shikon të vlefshme për krijimin e botërave autonome, të njerëzve të pavarur. Shkurt, Rugova është pro njeriut të pavarur e jo për njeriun e mbyllur brenda shoqërisë. Përndimisht, ai mbron mendimin se vlerat estetike të veprës së hapur, mund të njihen dhe të krijohen vetëm nga njeriu i pavarur, i cili është edhe vetë i hapur.

### Metodologjia

Rugova niset nga mendimi se në një shqyrtim nuk është i rëndësishëm vetëm rezultati, por edhe metoda, ndaj përherë duhet shqyrtuar metodologjinë e kërkimit dhe bazën teorike të saj. Termin *metodë* e përdor në kuptim të teorive poetologjike dhe estetike, duke menduar se i ndihmon të gjejë diçka të përbashkët në orientimet e ndryshme të kritikës, të studimit të shkencës mbi letërsinë. Për të shpënë më tej kërkimin, fillimisht zberthen termin *kritikë*, kritikën në kuptimin e përgjithshëm, që vjen nga greqishtja: *kribis*, që do të thotë shpëputje, shqyrtim, kontest, zënkë, dallim, vendim, sprovim, gjykim, madje bart edhe nënkuptimin gjyqësor: padi, e drejtë, gjykim, drejtësi, dënim. Emrit *kribis* i përgjigjet folja *krino*, që ka kuptim: të veçosh, konsiderosh etj. Kështu, rreth definimit dhe kuptimit semantik të kritikës (duke patur parasysh se në përdorimin e sotëm ka humbur kuptimin e sanksionit juridik), del mendimi se kritika përmban në vete një proces brenda të cilit realizohet konkretizimi i konceptit të saj, që lidhet me ndonjë sistem të vlerave. Në këtë këndvështrim, termi kritikë shtrihet në të gjitha sferat e veprimtarisë intelektuale dhe njerëzore.<sup>9</sup>

Në fakt, autorit tonë i intereson kritika letrare si disiplinë e studimit të letërsisë. Ai problematizon objektin e saj, duke parë që nuk hyn as në shkencën e letërsisë, as në artin letrar, por qëndron *ndërmjet*. Për ta bërë sa më të qartë konceptin, Rugova e shqyrton kritikën në raport me disiplinat e tjera të studimit të letërsisë: teorinë e letërsisë, historinë e letërsisë dhe estetikën. Kështu që, në këtë drejtim, e sheh të udhës t'i komentojë këto disiplina veç e veç. Teorinë e letërsisë, respektivisht poetikën, e koncepton si teknikë për të përcaktuar prosedeun e një vepre apo të një letërsie të tërë. Duke iu referuar shkollës gjermane, por edhe më tej, shkruan se kjo disiplinë quhet edhe shkencë e letërsisë. Historia e letërsisë veprat letrare dhe letërsinë në përgjithësi i shqyrton në kontekstin suksesiv dhe sintetizues të vlerave gjatë periodave të ndryshme të zhvillimit dhe të pasurimit të letërsisë. Ndërsa, estetikën e letërsisë e konkretizon raporti midis veprës dhe

---

<sup>9</sup> “Teori dhe kritikë moderne” (zgjodhi dhe përktheu Nysret Krasniqi), Rozafa, Prishtinë, 2008.

marrësit në procesin e përjetimit të saj, e cila zbulon qenësinë estetike që përmban letërsia.

Pas këtyre formulimeve, kthehemi prapë te çështja e kritikës letrare, të cilën Rugova e shikon midis disiplinave të tjera të studimit të letërsisë. Kështu, vijmë te përgjithësimi i tij teorik që: ajo qëndron midis *theorisisit dhe praksisit*, nuk hyn as në teorinë e letërsisë, as në historinë e letërsisë dhe as në estetikë. Prandaj, mund të theksojmë se problemi të cilin e hap Rugova me këto nënvizime nuk mbyllet, mbetet i hapur.

Rugova e vazhdon edhe më tej rrugën e diskutimit për kritikën, duke e ilustruar me një koment përfaqësues: “kritika nuk qëndron më në atë kuptimin klasik, si ‘urë’ midis lexuesit dhe veprës, por ajo është si një ndërmjetësues krijues në këtë relacion, krijon kuptimet e reja mbi veprën, hyn në një aktivitet kreativ”.<sup>10</sup> Në këtë kontekst, ai gjithsesi thekson edhe mendimin e Rolan Bartit, “se kritika nuk hyn as në shkencë, sepse shkenca i hulumton kuptimet, e kritika i prodhon ato”.<sup>11</sup>

Rugova e gjurmon kritikën letrare dhe metodat e saj edhe në zhvillimin e saj historik. I heton fillet e saj në Antikë, duke i konsideruar kritikë të parë konfrontimet e hershme midis poezisë mitologjike greke dhe filozofisë. Duke e kërkuar konceptin e kritikës, Rugova dallon çështje të problematizuara që i afrohen konceptimeve të dhëna që në *Poetikën* e Aristotelit, kur flitet për problemet e krijimit dhe mbi zgjidhjet që paraqiten në artin poetik. Ndërsa, duke nënvizuar Rene Uelekun shkruan se, shekulli njëzet është epoka e kritikës dhe se metodat e saj po zhvillohen në frymën e antipozitivizmit.<sup>12</sup> Rugova konkludon se kritika për ta realizuar qëllimin e saj mbështetet në metodat e ndonjë teorie filozofike apo estetike dhe gradualisht, mbi atë bazë e krijon qenësinë e vet. Gjithashtu, ai nënvizon disa metoda të kritikës që nga fillimet, duke parë rezultate të arritura, si: formalizmin rus, kritikën e re, kritikën psikanalitike, kritikën stilistike afektive, kritikën marksiste evropiane, kritikën ekzistencialiste, kritikën ontologjike, kritikën fenomenologjike, kritikën hermeneutike, kritikën e re franceze dhe që në radhë të parë bazohet te strukturalizmi, i zhvilluar fuqishëm me Rolan Bartin.

Duke patur në këtë kapitull objekt një konkluzë metodologjike, Rugova nxjerr dy baza orientuese të kërkimit letrar: 1. vepra letrare, letërsia të merret si produkt historik-shoqëror dhe 2. që vepra të konsiderohet si produkt absolut artistik. Natyrisht që nënkupton se në një tekst kritik nuk mund të zbatohen të gjitha metodat, por duhet të aplikohet një metodë e njohur mirë, që të japë një kritikë të specializuar dhe shkencore.

Kërkimi i Rugovës vazhdon në përgjithësimin e *mjetit* kritikë, *kategoria e kritikës*, që në kuptimin e sotëm do të thotë: sistem i kritikës, strukturë e kritikës, shenjë e kritikës, kod i kritikës dhe që i bie se kategoria ka një semantizim më të madh se kuptimi themelor. Kategoria, në këtë kuptim, del edhe si sistem elementesh

---

<sup>10</sup> Ibrahim Rugova, vep e cit., f. 42

<sup>11</sup> Po aty.

<sup>12</sup> Rene Velek, Ostin Voren: “Teoria e letërsisë”, Rilindja, Prishtinë, 1982.

kualitative, kuantitative e modale, por edhe si formë e njohjes, e qenësisë dhe e vlerësimit në planin shkencor dhe filozofik, teorik dhe analitik, prandaj Rugova e konsideron si një domosdoshmëri dallimin ndërmjet teorisë së kritikës dhe kritikës si disiplinë. Sipas tij, kritika si mjet është e pranishme në të gjitha shkencat dhe disiplinat, madje edhe në procesin e mendimit, ndërsa në fushën e studimit të letërsisë, një pjesë e mendimtarëve e konsiderojnë si disiplinë, sepse del e lidhur ngushtë me prozedurën e saj.

Sa i përket metodologjisë kërkimore, Rugova bën sqarim më adekuat, duke theksuar se: “kritika letrare si disiplinë, në qendër të vet ka kryesisht kategorinë e kritikës, por jo gjithë aspektin e saj, gjithë aparaturnë e saj”.<sup>13</sup> *Kategorinë kritikë* Rugova e merr si metakategori, siç është *estetikja* në estetikë, pasi që kategoria është e pranishme në të gjitha disiplinat e kritikës. “E morëm si metakategori, sepse kështu bën edhe rishqyrtimin e kategorisë së vet, apo si metakritikë kur bën kritikën e çështjeve të kritikës, u muar vesh, në praxisin teorik.”<sup>14</sup>

Rugova e konsideron kritikën (kategorinë) si esenë, duke e parë të realizuar në dy plane të mëdha: në planin teorik dhe në atë praktik-operues apo si metakategori në planin e praxisit teorik dhe praxisit empirik. Nga të gjitha shpjegimet që u dhanë më lart, mund të themi se kritika ka karakter gnoseologjik, akseologjik e vlerësues, mirëpo është e rëndësishme të theksojmë se kategoria e kritikës, e kuptuar këtu si metakritikë, varet nga lëvizjet në praxisin teorik dhe në praxisin krijues letrar. Ndërsa, vetë letërsia gjendet midis këtyre sferave. Pikëpamja bartiane e argumentimit të kësaj çështjeje në mënyrë figurative e racionale, sipas të cilës ekzistojnë dy “kontinente”: në njërin anë bota, një masë e tërë faktesh politike, shoqërore, ekonomike e ideologjike; në anën tjetër vepra, i përgjigjet fuqishëm mendimit rugovian, kur ai e vendos letërsinë në “kontinentin e dytë”.

Kërkimi i Rugovës për metodologjinë shkon edhe më tutje, duke vështuar raportin e *interpretimit* dhe të *veprës letrare*, që konsiderohet si çështje themelore e studimit të letërsisë. Problematika do të vështrohet fillimisht si shpjegim i dy termave. Rugova thekson se nuk ka pretendim për definim të relacioneve të përmendura. “Vepra letrare është një krijim artificial, një vepër shpirtërore-intelektuale e njeriut, si veprimtari specifike e tij, e që mund të pohohet kështu vështuar në aspektin e përbërjes dhe të formësimit.”<sup>15</sup> Kështu, vepra letrare interpretohet nga autori si model artistik që e objektivon botën. Brenda botës është njeriu me përpjekjen e tij për njohjen dhe pushtimin e vetes dhe të botës. Bota, jeta, njeriu, objektivohet nga vepra, e cila vetë është model teorik - kjo e përbën gjithë letërsinë si art.

---

<sup>13</sup> Ibrahim Rugova, po aty, f. 64.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Po aty, f. 74.



Si problem tjetër metodologjik, në këtë tekst, del interpretimi, problem i cili, sipas autorit, del nga hermeneutika.<sup>16</sup> Shkurtimisht vështruar, interpretimi këtu del si problem i përgjithshëm, me tendencë për disiplinë në vete. Në kuadër të hermeneutikës gjermane, teoricieni ynë thekson se interpretimi kuptohet si *mjeshtëri* dhe *akt* për kuptimin e drejtë të tekstit, i cili bazohet në disiplina të ndryshme, si: fenomenologjia, semiotika, metafizika etj. Këtu Rugova shton se duhet të zbatohen rezultatet e disiplinave të ndryshme në kuadër të një interpretimi, por jo në mënyrë sinkretike, pra kërkon punë analitike. Në këtë plan, termi interpretim gjason me termin kritikë letrare, siç e përdorim sot. Kështu, Rugova përgjithëson nocionin e interpretimit, duke e parë të shfaqur si nevojë për njohjen dhe kuptimin sa më të mirë të veprës letrare. Rezultat të madh në këtë teori e konsideron veprën e konceptuar si shumështrësore dhe shumëplanëshe, e cila, në vetëdijen e lexuesit, konstituohet si objekt estetik. Do të thotë, vepra është polisemike dhe për t'u analizuar duhet të interpretohet, duke pasur parasysh disiplinat e theksuara më lart.

Edhe në këtë aspekt Rugova gjykon sipas Bartit, se: “vepra është gjithmonë ambivalente ndaj faktografisë së përditshmërisë, meqë lejon, në të njëjtën kohë, shumë kuptime”.<sup>17</sup> Gjykim ky (po ashtu edhe koncepti për letërsinë si *differentia specifica*, letërsia si prodhim artistik, teksti i hapur ndaj lexuesit) që e shtyn drejt përfundimit të mendimit se duhet të ketë edhe më shumë interpretime, që teksti për lexuesin të bëhet më i fuqishëm dhe ta rrisë ndikimin. Do të thotë, Rugova propozon më shumë se një interpretim.

Është e rëndësishme që edhe një herë të theksohet mendimi i Rugovës se për interpretimin e veprës letrare duhet të nisemi nga një teori e caktuar, ndërsa teoria e aplikuar bëhet metodologji.

## Estetika(t)

Meqë e ka objekt trajtimi teorik letërsinë si *differentia specifica* dhe synim argumentimin e të gjitha teorive që e diferencojnë letërsinë, Rugova shqyrton metodën estetiko-teorike si pjesë përbërëse të këtij plani dhe si element kryesor të veprës artistike. Këtë problematikë e diskuton në raportin trihotomik: idealiteti-realiteti-arti, në të cilin zhvillohet teoria qendrore estetike, prej së cilës buron dhe interpretimi i artit.

Teorinë e problemeve estetike Rugova e shqyrton të lidhur me teoritë estetike-ideologjike dhe estetikën e objektivizmit ontologjik, të cilat kanë zënë fill në elementet e pikëpamjeve të Platonit dhe të Aristotelit lidhur me artin. Sipas kësaj konkluzë, del se estetika ideologjike ndërlidhet me filozofinë e Platonit, në problemet që ngre ai mbi funksionin e artit, teori kjo e angazhimit politik të artit dhe

<sup>16</sup> Martin Hajdegger: “Poetry, Language, Thought”, Hague & Row Publishers, New York, 1971; Hans-George Gadamer: “Historia e filozofisë”, Plejad, Tiranë, 2008.

<sup>17</sup> Ibrahim Rugova, po aty. f. 80.

e së mirës. Arti pasqyron të mirën, natyrën, kërkesat e shtetit etj. Teori e quajtur e *mimesis*, që ndryshe, të bartur në kohë, Rugova e quan metodë të realizmit socialist dhe vlerëson se vepra (letërsia) e cila e konsideron artin si produkt të ideologjisë, është vepër e dobët.<sup>18</sup>

Duke vlerësuar se estetika ideologjike nuk qëndron në themelin e duhur teoriko-estetik, Rugova pozicionohet nga estetika objektive ontologjike, pasardhëse e mendimit filozofik të Aristotelit, filozofi që e diferencoi të bukurën nga e mira. Në kërkimin teorik rreth çështjeve estetiko-teorike, Rugova koncentrohet tek *objektivimi artistik* dhe *akti estetik*, të cilat, sipas tij, i vërejtë më së miri filozofi në fjalë. Këtë çështje e sheh të trajtuar më gjerë nga Herbarti, Hartmani, Ingardeni e Fohti.<sup>19</sup>

Rugova mendon se në estetikën ontologjike raporti idealitet-realityt-art vendoset në aspektin estetik (e jo në aspektin gnoseologjik), ku idealja paraqet subjektin estetik, i cili objektivohet në realen (objektin estetik), në veprën letrare artistike, tek e cila realitet është vetë vepra, që del nga realiteti njohës-krijues. Duke u nisur nga mendimi se vepra është një *meta-fisis* (prodhim shpirtëror i njeriut) e jo *fisis*, për studimin e veprës, Rugova kërkon qasjen epistemologjike dhe jo atë gnoseologjike.

Kthehemi prapë te problemi i autorit (të kërkimit të elementit estetik në art dhe letërsi dhe të qenies së objektivuar artistike), duke konkretizuar konceptin e tij, bazuar te filozofët e përmendur më lart, se objekti estetik dhe akti estetik nxjerrin efektin estetik. Lidhur me këtë, Rugova i bën një vështrim multiplikues ontologjik veprës letrare artistike me objekt estetik, duke dalluar se ajo është polifonike, polivalente, shumështrësore, polisemike, polilogjike etj. Përkufizimet, të cilat aplikohen në teorinë e veprës dhe të tekstit, ai gjykon se rrjedhin nga filozofia fenomenologjike dhe nga orientimi strukturalist dhe semiologjik, duke menduar se edhe *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme* i Ferdinand de Sosyrit mund të jetë studim fenomenologjik i gjuhës. Rugova dijes botërore i bashkohet edhe nëpërmjet ngushtimit të kuptimit të gjerë të veprës, duke pranuar pikëvështrimin social, ideologjik, didaktik, poetik apo estetik kërkon që në analizë të veprës të përdoret vetëm njëra, vetëm një metodë.

Nga paraqitja e aspekteve të lartpërmendura, mund të shohim se multiplicitetit të veprës i kontribuon pikëvështrimi ontologjik. Prandaj, për Rugovën ky pikëvështrim, veprën letrare si botë të objektivuar, e merr si qenie me shumë shtresa strukturore e semantike.

Duke u artikuluar estetika ontologjike si estetikë që është në gjendje ta studiojë letërsinë në aspektin e drejtë estetik, Rugova zbërthen termin *ontologji*, i cili del me prejardhje antike greke: *to on* që do të thotë ajo që është, ajo që ekziston, kurse fjala tjetër *to onta* na jep të qenët, ekzistimin. Krejt kjo për Rugovën do të thotë se ajo që ekziston dhe që ka të qenët e vet është qenie. Është ky koncept me

<sup>18</sup> Teoria e raporteve të artit me shtetin fillon te “Shteti” i Platonit.

<sup>19</sup> Aristoteli: “Poetika”, Rilindja, Prishtinë, 1984.

të cilin ndërtohet teoria estetike e Rugovës dhe më konkretisht relacioni ontologjik qenia-qenësia-qenësimi. Ky orientim estetik, sipas Rugovës, bazohet te Platoni dhe Aristoteli e që është zhvilluar në mënyrë sistematike te Hegeli, Marksi, Huserli, Haidegeri, Hartmani e Ingardeni. Do të thotë, këta filozofë sollën një sistem të tjetër të vështrimit të artit, që njihet si estetikë ontologjike. Ndërkaq Rugova, duke qenë adhures i artit të hapur, vlerëson se qenia letrare artistike del nga dy relacionet: relacioni kreativ, krijuesi vepra dhe relacioni receptiv (marrësi), relacion që objektivon veprën çfarë është e pranuar në vetëdijen tonë. Tash ai pohon se akti kreativ kryhet në procesin e objektivimit, i cili përfaqëson kalimin e shpirtit në materie. Është pra objektivimi që i plotëson nevojat intelektuale dhe shpirtërore në gjykimin e Rugovës dhe të vetë Rugovës si dijetar.

Për të përforcuar mendimin sa i përket çështjes së objektivimit, Rugova i referohet filozofisë së Haidegerit, sipas të cilit: e vërteta e botës është një vetë-vendosje-e-të-vërtetës-në-vepër. Kategori kjo e estetikës që merr përmasa të botës. Ndërkaq, kjo e vërtetë e botës, për Rugovën hyn në vepër dhe bëhet e vërtetë artistike.

Në konceptimin e objektivimit Rugova shkon më tej, duke interpretuar Bahtinin, realitetin e njohjes si rezultat të të shprehurit. Respektivisht, sipas tij, ajo që ekziston, “ekziston sepse është thënë”. Në fakt, këndvështrimin ontologjik të Bahtinit Rugova e vendos në planin e teorisë së komunikimit dhe të polifonisë së veprës. Në planin e teorisë së komunikimit artistik, Rugova njeh edhe Lotmanin me teorinë e informatikës, me të cilën mendon se pasurohet teoria e poetikës bashkëkohëse dhe e semiologjisë. Në teorinë e objektivimit, shohim edhe pikëpamjet personale të Rugovës, kur thekson se *vepra* në konstituimin e vet del *objekt*, kurse në modalitetet del *qenie*.

Në leximin e Rugovës, qenia e objektivuar, mbasi i përmban të gjitha karakteristikat e qenies: qenësinë dhe qenësimin (*esencën* dhe *ekzistencën*), bëhet qenie artistike. Sipas Rugovës, ky këndvështrim interpretohet në *kuptimin kozmik*. Kuptim ky që do shpjegim. Takimi me qenien artistike i ngjan takimit me qenien njerëzore, që na është shfaqur dikur e që, mbas kushedi sa kohësh, na shfaqet përsëri (në kontemplacionin tonë shfaqet vazhdimisht). Do të thotë, qenia artistike ekziston në shfaqjen e saj në botën e marrësit, por në formë të kohës së padefinuar, ajo ekziston si qenie në vazhdimësi. Për të ilustruar, ai bën ontologjinë e personazhit, p.sh. Hamleti i Shekspirit, Don Kishoti i Servantesit, Raskolnikovi i Dostojevskit, Fausti i Gëtes, Ana Karenina e Tolstoit, Jozef K. i Kafkës, Mërsoja i Kamysë, Stefan Blum i Xhojsit, Gjenerali i Ushtrisë së vdekur i Kadaresë etj.

Rugova ynë niset nga mendimi i filozofisë ontologjike se në vepër objektivohet personaliteti (bota e brendshme), kurse në personalitetin objektivohet vepra. Kështu shpjegon vlerën e procesit të objektivimit artistik, duke ardhur te përfundimi se: qenia njerëzore që i krijon këto qenie artistike, shuhet apo nuk ekziston më (subjekti), por këto ekzistojnë si rezultat i kohëve të ndryshme dhe në kohë të ndryshme.

Pikëpamjet filozofike dhe estetike ontologjike të Rugovës konkretizohen me objektin estetik dhe funksionin metafizik. Pra, vepra, si qenie artistike letrare, duhet të ketë *objektin estetik*, që kushtëzon *efektin estetik* e metafizik. E kjo lë të kuptohet që *objekti estetik* është *funksion në vete*, pra nuk mund të identifikohet me veprën. Objekti estetik, si strukturë polifonike, është produkt i vetëdijes së marrësit të veprës letrare.

Objektin estetik si plan dhe shtresim të ndryshëm Rugova e shqyrton edhe duke u nisur nga pikëpamjet e Hartmanit, Ingardenit dhe të Fohtit. Në këtë aspekt, shtresimet e veprës letrare Rugova mendon se Hartmani i shihte në prapavijë të shtresave të tjera, Ingardeni i karakterizonte me kualitetet metafizike, ndërsa Fohtin e cilëson të jetë një hap përpara, kur e konstituon si plan në vetë planin shpirtëror-metafizik. Gjithashtu, konsideron se ky autor e pasuroi estetikën ontologjike me dimensionin historik dhe me atë teorik. Në fund, Rugova vlerëson se planet e veprës duhet të kërkohen përmes analizës së strukturës së organizuar poetike, duke menduar se zhduken kufizimet e pikëvështrimit ontologjik.

Plani metafizik, sipas Rugovës, nuk është shqyrtuar në interpretimet shqiptare. Kështu ai do t'i bëjë një vështrim të shkurtër planit shpirtëror metafizik. Esteti niset nga mendimi se qenia artistike, duke ekzistuar si *fizis*, si vepër, objekt më vete, përmban botën prej idesh dhe emocioneve, të cilat hyjnë në *meta-fizisin* e saj. Kështu, mendon se qenia bëhet e plotë. Do të thotë termi *metafizikja* këtu kuptohet si kualitet estetiko-metafizik që e përbën planin shpirtëror-metafizik. Kuptohet, ky kualitet u përket vetëm veprave të mira artistike.<sup>20</sup>

Duke patur parasysh mendimin e studiuesve botërorë, Rugova thekson se kualiteti metafizik i veprës funksionon si një *katarsis*, si spastrim nga përditshmëria, të cilën mundësi e japin vetëm veprat e mira artistike. Por, ndërhyr në këtë pretendim, duke konsideruar se kjo vlerë nuk duhet të mbetet vetëm në rrafshin e katarsisit ndjenjor dhe thekson se ky kualitet duhet të kuptohet edhe si vetëdijesim që zhvillohet në planin intelektual. Vepra shpirtërore metafizike duhet ta realizojë mundësinë e përealizueshme në botë, pra si qenie të kryejë funksionin ontologjik.

Rugova, pasi bën një diferencim dhe konkretizim të metodës estetiko-teorike, për ta prekur empirikisht problemin, konkretizon elementet estetiko-poetike, duke bërë hulumtimin dhe tematizimin e tipologjisë së letërsisë shqiptare të Kosovës. Këtu provohet se kjo letërsi nuk i është nënshtruar në mënyrë të posaçme kërkimeve

e s t e t i k o - p o e t i k e, kështu ai dallon një strukturë heteronome të saj, ndaj edhe vlera konsiderohet relative. Me termin *estetiko-poetik* shenjohej konkretizimi i letërsisë shqiptare që i ka këto vlera.

Rugova ilustron qenien letrare në letërsinë shqipe të Kosovës. Ai këtu koncepton qenien letrare në vështrim fenomenologjik dhe ontologjik të studimit të letërsisë. Fillimisht, qenia letrare trajtohet në pikëprerje me faktorët e jashtëm, si:

---

<sup>20</sup> Ibrahim Rugova, po aty. f. 62.

mendimi dogmatik mbi letërsisë, humanizmi iluzor, pragmatizmi politik, ngushtësia provinciale, që në përgjithësi bëjnë që edhe letërsia të zhvillohet në kushte të veçanta e specifike, ndikim ky që çon në studimin sociologjik të letërsisë. Por, sipas Rugovës, letërsia nuk u ndikua plotësisht nga faktorët e jashtëm, duke krijuar dhe formuar qenien e saj për realizimin shpirtëror e mendor të këtij njeriu.

Në vitet '30 të shekullit njëzet Rugova shikon një zhvillim të strukturave të genies letrare shqiptare dhe heton se letërsia shqipe e thyen njëtrajtshmërinë e saj. Ai dallon dy modele të reja: letërsinë sociale dhe letërsinë moderne. Ndërsa, në vështrim estetiko-poetik dallon një evoluim të përgjithshëm të letërsisë, sidomos në letërsinë moderne në Kosovë, e cila, sipas Rugovës, po afrohej me bashkëkohësinë evropiane.

Duke patur parasysh zhvillimin specifik të letërsisë shqipe dhe duke konsideruar që letërsia nuk u shqyrtua si fushë sinkretike, Rugova na jep një pamje të elementeve estetiko-poetike në poezi, prozë dhe dramë.

Element të parë të poezisë e konsideron entuziazmin, që shoqërohet nga *pasqyrimi* si proces. Brenda këtij nocioni përshkruan poezitë e dobëta, të frymës sociale e romantike, të përfshira nga entuziazmi për njeriun e çliruar pas Luftës së Dytë Botërore. Shkurt, pasqyrohet realiteti ndikuar nga faktorët e jashtëm.

Element i dytë i poezisë konsiderohet ai i lirizmit subjektiv, që përshkruhet si *përjetim* (trajtohet subjekti krijues, ndjeshmëria, bota e brendshme).

Elementi i tretë është ai i poezisë objektive, i emërtuar - *trajtim*. Kjo poezi hyn në rrymimin modern poetik dhe funksionon në sistemin estetik dhe poetik. Vlerësohet si poezi e cila zhvillon hapësirën ndjenjore, kuptimore dhe qeniesore.

Rugova, në kërkimin e elementeve estetiko-poetike në prozë dhe në dramë, gjatë prerjes diakronike dhe sinkronike, heton elemente të ngjashme si të poezisë, do të thotë elemente të entuziazmit, lirizmit dhe objektivizmit. Këto ngjashmëri i lidh me faktin se të tri strukturat i krijuan autorët që shkruan më parë poezinë, pastaj prozën dhe në fund dramën.

Duke vështruar strukturat e mendimit mbi letërsinë, Rugova dallon edhe elemente të theksuara estetiko-poetike dhe vëren se krijohej një poetikë e qëndrueshme.

Përfundimisht, Rugova e vlerëson letërsinë si objekt të mendimit kritik, duke parë këtë procedurë në letërsinë shqiptare dhe duke e konsideruar si qenie shumë aktive në frymën e bashkëkohësisë.

## Semiologji

Teksti që përmbyll librin *Kah teoria* të Ibrahim Rugovës është ndërtuar mbi teorinë e dijetarit dhe kritikut të njohur, Rolan Bart, për *semiologjinë artistike*, që do të thotë se kemi të bëjmë një përshkrim teorik dhe kjo paraqet interes të madh, duke ditur se autori ynë asnjëherë nuk ka bërë një teori semiotike të hapur, por

gjithnjë ka qenë semiolog praktik dhe mënyra e punës së tij i është paradigmave konturave të semiologjisë letrare. Do të thotë, rezultatet e kërkimeve të tij kanë ndjekur metodën e analizave semiotike, duke analizuar e interpretuar në principin semiotik. Thënë ndryshe, Rugova e ka njohur semiologjinë si *joker të dijes*, pikërisht ashtu si e përcakton Barti.

Teksti i Bartit, i paraqitur në këtë mënyrë, na shtyn të hetojmë pikëpamjet e përbashkëta të disiplinës semiologjike të dy autorët, Barti dhe Rugova. Jo rastësisht Rugova ka shqyrtuar çështjet teorike semiologjike të Bartit, për të paraqitur disi tërthorazi edhe një teori të veten. Autori ynë përshkruan duke u pozicionuar dhe duke i interpretuar pikëpamjet e tilla si të vetat, kryesisht rreth pretendimeve se gjuha është *semiosis* (shenjë) dhe jo *mathesis* (njohje) e as *mimesis* (imitim).

Fillimisht, veprat e Bartit Rugova i konsideron si një forcë të zhvendosjes së fuqishme, të deklasimit të gjërave e të ideve, të mbarë dijes së vendosur në fushën e semiologjisë deri më atëherë. “Zhvendosja e tij e fundit është ligjërrata inauguruese *Portreti i semiologut artist*, të cilën në fillim të vitit 1977 e mbajti me rastin e hyrjes së tij në njërin nga institucionet më të larta shkencore-arsimore parisienne, në College de France, në të cilin ku iu besua Katedra e Semiologjisë letrare. Kjo zhvendosje del nga përkufizimi i tij bërë kësaj discipline të re, semiologjisë letrare.”<sup>21</sup>

Për të përkufizuar këtë akt, Rugova konstaton se semiologu Barti është nisur nga tjetërsimi i gjuhës, prej nga e ndërton këtë disiplinë, duke vështruar dy komponentat e saj: *semiologjinë* dhe *letërsinë*, përkatësisht, shton Rugova, vetë artin. Kështu, duke ditur se gjuha është kod i semiologjisë, Barti strukturën e gjuhës e shikon si një implikuese të një relacioni të tjetërsimit fatal. Kjo çon drejt mendimit se gjuha në ne krijon *mjeshttrin* dhe *skllavin*, që do të thotë se për Bartin, në vështrimin rugovian, gjuha është e *alienuar* dhe, në këtë plan, thekson Rugova, alienimi i gjuhës përbëhet nga gjysmëthënia, nga lejimi i kushtëzuar dhe nga obligimi, kundër të cilave luftohet vazhdimisht dhe *kohorësisht*.

Produktin e paradigmës së propozuar - duke patur parasysh se gjuha është e alienuar - se: “shkrimtarit nuk i mbetet tjetër pos të mashtrohet me gjuhën dhe ta mashtrojë gjuhën”,<sup>22</sup> Barti e emërton letërsi, përkufizim që na e kujton teorinë e artit të hapur e që këtu përkthehet si liri e veprës, gjë që nuk varet nga personi civil, nga angazhimi politik i shkrimtarit, por nga aktiviteti zhvendosës që ushtron ai mbi gjuhën.

Përmes Bartit, Rugova sugjeron një *dije/shije* të shkrimit, teksteve, që do të thotë një qëndrim ndaj artit. Shija në këtë aspekt del nga dija. Do të thotë, shkrimi si lidhje e shkencës me artin dhe shija e dijes, janë koncepte kryesore për letërsinë, propozuar nga Barti dhe përqaftuar herët nga ana e Rugovës.

Duke patur parasysh edhe vetë titullin e tekstit, *Semiologjia artistike*, gjejmë se kjo analizë çon drejt përfundimit se semiologu, në fund, do të bëhet artist dhe,

---

<sup>21</sup> Po aty, f. 146.

<sup>22</sup> Po aty, f. 147.

kur dimë se gjuha është shenjë, artisti do të luajë me shenja, si magjistar i vetëdijsëm, duke patur objekt të dashurisë së tij tekstet imagjinare. Prandaj, *semiologjinë artistike* Rugova e paraqet mbi konceptin e dimensionit të ri, që i shtoi Barti, pra të dimensionit më të thellë artistik. Ai pohon se: “semiologji do të quhej rrjedha e operimeve përgjatë së cilës - të shpresojmë - është e mundshme të luhet me shenja si me ndonjë vel të pikturuar, apo edhe më: si me ndonjë fikcion”.<sup>23</sup>

Për të konkretizuar mendimin e Bartit se semiologjia është *joker i dijes* dhe përpjekjen për një *semiologji artistike*, Rugova thekson disa pikëpamje kryesore të këtij pretendimi: semiologjia është një aktivitet që zgjedh e nxjerr papastërtitë e gjuhës, fshehtësitë e lingistikës, korrupsionin e drejtpërdrejtë të mesazhit, dëshirat, frikësimet, butësitë, muzikën, nga të cilat përbëhet gjuha aktive. Dominon mendimi se letërsia dhe semiologjia duhet të bashkohen, me qëllim që të korrigjojnë njëra-tjetrën dhe që të refuzojnë mitin e krijimit të pastër.

Për Rugovën, eksplikimi i Bartit, ndërtuar mbi konceptin *shije/dije*, çon përfundimisht drejt rrugës për në *semiologjinë artistike*, e cila kufizohet me artin dhe me filozofinë.<sup>24</sup>

---

<sup>23</sup> Po aty, ff. 150-151.

<sup>24</sup> Rolan Bart: “Aventura semiologjike”, Rilindja, Prishtinë, 1986.

## FUNKSIONET E TEORISË LETRARE

Çështjet e shtruar në tekstin *Teoria në dy funksione*<sup>25</sup> janë disa aspekte dhe teza që Ibrahim Rugova i kishte hapur dhe diskutuar më parë në tekstet e tij teorike. Ndësa tani, për të kërkuar dhe argumentuar mbi teorinë e kritikës, Rugova vë në qendër të diskutimit veprën *Teoria e letërsisë*, të Rene Uelekut dhe Ostin Uorenit, që për nga konceptet dhe përfundimet në praktikën kritike dhe historike të letërsisë, e vlerëson klasike e fundamentale në literaturën e shkencës e të letërsisë bashkëkohore. Gjithashtu, konsideron se ky tekst, në formë të sistemuar, na jep bazat e shumë disiplinave të specializuara të sotme në vështrimin, analizën dhe përgjithësimet e ndryshme mbi letërsisë. Kësaj vepre, këtij *projekti klasifikues*, siç e quan, Rugova i qaset si një vepre bazë dhe një modeli mjaft efektiv në teorinë e studimit të letërsisë.

Në paraqitjen e veprës Rugova fillimisht ndalet te vlera e autorëve Uelek dhe Uoren, duke i vlerësuar si teoricienë, kritikë e historianë të letërsisë të njohur edhe jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë vazhdë, me të drejtë konsideron se ky studim karakterizohet nga gjerësia aktive dhe thellësia intensive për shkencën e letërsisë.

Rol të rëndësishëm Rugova i jep strukturimit të veprës në katër pjesë, duke e parë si një reproduktim aktiv të sistemit dhe të koncepteve të autorëve. Klasifikimin e tillë e konsideron të mirë metodologjikisht dhe që jep rezultate për problemet e realizuara në perspektivën e propozuar. Sa i përket klasifikimit të përkufizimeve, ai veçon pjesën e parë *Definicionet dhe distinkcionet*, ku vëren dallimin e studimit të letërsisë dhe të letërsisë si art, që përkufizohet në bazë të disiplinave që merren me këtë fushë. Interesimi i Rugovës në këtë aspekt rritet kur mendon se ky klasifikim disiplinor forcon vetëdijen mbi letërsinë në planin artistik.

Siç e kemi theksuar edhe më parë, në epiqendër të studimeve teorike Rugova e vendos letërsisë si prodhim artistik. Kështu, në këtë plan, ai vlerëson se vepra e Uelekut dhe Uorenit është shumë e rëndësishme. Në vazhdim ai ndalet te përpjekja e autorëve që disiplinat klasifikuese të jepen në kuadër të pikëpamjeve që jep objekti i studimit, pra letërsia të dalë si art i fjalëve, si *Wortkunst*. Tërë këtë Rugova e lexon si rezultat të vështrimit të letërsisë në planin e ligjërimit artistik. Këtu shqyrton

---

<sup>25</sup> Ibrahim Rugova: “Refuzimi estetik”, Faik Konica, Prishtinë, 2005, ff. 301-313.



edhe çështjen e shtruar nga Ueleku dhe Uoreni që ka të bëjë me hulumtimin e letërsisë, pra me veprën letrare, faktografinë dhe burimësinë e saj. Njëherësh, ai u jep të drejtë autorëve të cilët e vendosin veprën letrare në radhën e studimit të një aspekti të letërsisë, si parakusht për vështrimin e saj më të thelluar dhe më të konceptuar në planin metodologjik.

Qëllimi kryesor i përkufizimeve të autorëve në shqyrtimin e Rugovës është argumentimi se studimi apo shkencë e letërsisë, me të gjitha disiplinat e saj, duhet të konsiderohet si një shkencë humanitare.

Në kuadër të diskutimit të studimit të letërsisë si koncept kryesor i teoricienëve, Rugova ndalet te pjesa e tretë dhe e katërt e veprës, që titullohen *Qasja e jashtme e studimit të letërsisë* dhe *Studimi i brendshëm i letërsisë*. Këtu ai dallon tendencat jashtëdisiplinare dhe brendadisiplinare të studimit. Sipas analizës së Rugovës, tendencat brendadisiplinare janë ato që hyjnë në fushë të teorisë, të kritikës dhe të historisë, shkurtimisht që kanë objekt vetë letërsinë; ndërsa tendencat jashtëdisiplinare shpjegohen si interesime të disiplinave apo të shkencave të tjera që kanë për objekt të hulumtimit apo të argumentimit të pikëpamjeve të veta e marrin letërsinë apo që gjenden në “zona” në kufi me të, si *qasje* dhe jo si *studim*.

Në të vërtetë, Rugova e vëren kërkesën e teoricienëve dhe thekson se që të gjitha disiplinat që nuk merren me poetikën e veprës, të letërsisë, janë qasje e jashtme ndaj saj, që e pasurojnë totalitetin e saj, po që nuk janë, nuk mund të jenë dhe nuk duhet të jenë finalitet i interpretimit. Ai konstaton se këtu nuk përjashtohet vështrimi i letërsisë në raport me shoqërinë, me biografinë, me idetë, me psikologjinë dhe me artet e tjera, por mendon se kërkohet që këto pikëvështrime të këtyre disiplinave të jenë të matura dhe me kuptim, që mos e tjetërsojnë konceptin dhe botëkuptimin e artit letrar. Në këtë kontekst, Rugova sqaron se pikëpamjet e këtilla të këtyre autorëve janë keqkuptuar, duke mendur se ata pretendojnë që disiplinat e tjera nuk kanë çfarë të kërkojnë në studimin e letërsisë. Përfundimisht, Rugova thekson se qasja e jashtme, sipas këtyre autorëve, është kontribut dhe jo qëllim i studimit apo i vështrimit të letërsisë.

Pos çështjes së qasjes së jashtme, si koncept të rëndësishëm të teorisë të Uelekut dhe Uorenit Rugova e konsideron studimin e brendshëm të letërsisë, koncept për të cilin thotë se autorët e ngrenë mbi elementet e formalizmit gjerman, formalizmit rus, metodës frënge të interpretimit të teksteve, pikëpamjeve të Kritikës së Re Amerikane dhe rezultateve të Qerthullit Strukturalist të Pragës. Në bazë të mendimit të autorëve, shpjegon Rugova, në studimin e brendshëm hyn forma e ekzistimit të veprës, eufonia, ritmi dhe metri, stili: figura, metafora, simboli, miti; format e letërsisë, vlerësimi dhe historia e letërsisë. Do të thotë, elementet e brendshme janë forma konstitucionale, përmes të cilave realizohet vepra letrare. Rugova pas këtyre koncepteve sheh thelbin e mendimit, që arti letrar të jetë i dhënë nëpër kontekste të ndryshme, por gjithnjë me një dinamikë të brendshme, në planin e procesit dinamik të zhvillimit.

Në shqyrtimin e këtyre problemeve, pra të planit të jashtëm dhe të planit të brendshëm, Rugova vlerëson se është fjala për koncepte estetike dhe filozofike mbi artin dhe letërsinë. Ai thekson se flitet për autonominë dhe heteronominë e artit dhe se konkludohet që vepra është autonome dhe heteronome dhe që nuk duhet kërkuar farë ndarjesh të rrepta. Nga e gjithë kjo Rugova kalon tek mendimi vendimtar, duke theksuar se vepra është qenie-private dhe qenie për botën. Gjenezën e kësaj ndarjeje të Uelekut dhe Uorenit, ai e gjen në teorinë e poetikës strukturale të Lotmanit që strukturat e veprës letrare i ndanë në jashtëtekstore dhe brendatekstore. Veprën e Uelektu dhe Uorenit për nga klasifikimi e vlerëson si produktive edhe sot dhe si vetëdije të formuar në procesin e studimit të letërsisë. Me bindje të thellë, Rugova e çmon atë si një *organon* të metodave të studimit të letërsisë dhe të çështjeve të tjera mbi letërsisë. Gjithashtu, ai mendon që autorët e kanë pasuruar toerinë e tyre me informacion të veçantë e të përgjithshëm.

Në paraqitjen e pikëpamjeve të veta mbi teorinë e diskutuar, Rugova vlerëson se vepra përmban edhe një fakt tjetër të rëndësishëm: kërkesën që të riaktualizohen dhe të afirmohen disa pikëpamje të poetikës dhe të retorikës Antike, që përmes disiplinave të sotme të studimit dalin forma shpesh të shpërndërruara larg kuptimeve burimore. Çështje tjetër të rëndësishme e konsideron edhe kthimin në burimet e terminologjisë dhe të koncepteve, si një ndër çështjet qendrore të teorisë, të cilat kanë dhënë rezultate në fushën e retorikës dhe në teorinë e analizës.

Në përcaktimet e thëna për studimin e letërsisë, për problemet e paraqitura, Rugova thekson funksionin e dyfishtë të teorisë së letërsisë: i pari që lidhet drejtëpërdrejt me vështrimin e problematikës së studimit të letërsisë, në të cilin ndihet si faktor i rëndësishëm teoria e disiplinave të ndryshme, siç janë teoria e kritikës, e historisë, e vlerësimit; ndërsa funksioni i dytë është ai i vështrimit të vet letërsisë, i natyrës, i funksionit dhe i poetikës së saj. Rugova konsideron se këto pikëvështrime e pasurojnë praktikën dhe teorinë e letërsisë apo të vetë teorisë. Kështu, Rugova konkludon se duke folur për metodologjinë e shkencës së letërsisë, flitet edhe për vetë natyrën e letërsisë apo anasjelltas, që do të thotë se, duke folur për letërsinë, flitet edhe për studimin e saj. Vështruar problemin në tërësi, Rugova e gjen të vendosur në planin teorik e të historisë së teorisë, çështjet e studimit të letërsisë, duke konsideruar se Ueleku dhe Uoreni hapin rrugën më sistematike të vështrimit të problemeve të iniciuara.

Pos theksimit të aspekteve teorike në planin ndërkombëtar, Rugova flet edhe për inkuadrimin e kësaj teorie në studimin tonë, duke e vlerësuar përkthimin e këtij libri si shumë të rëndësishëm. Kjo dëshmon se ai insiston, krahas informacionit profesional, për një praktikë të informacionit publik, që të ambientohemi me interesimet dhe me rezultatet e teorisë së përgjithshme. Madje, veprën e Uelekut dhe Uorenit e konsideron te denjë për formimin e botëkuptimeve të qëndrueshme mbi metodat e studimit mbi letërsisë dhe mbi terminologjinë. Gjithashtu, e shquan si të vlefshme edhe për të interesuarit e disiplinave humanitare në përgjithësi.

## TEORIA E KRITIKËS LETRARE

Nga *teoria e teorisë*, Rugova kalon në diskutimin e përhershëm të tij, të kritikës dhe të problemeve të saj. Por, në tekstin *Kritika letrare dhe marksizimi*<sup>26</sup> ai çështjen do ta vështrijë më ndryshe, duke e vënë kritikën në raport me marksizmin, si ideologji të kohës. Gjithashtu, edhe diskutimi do të jetë i një niveli tjetër, pasi Rugova e shkruan tekstin atëherë kur mendon se të gjithë ata që interesohen për këto probleme janë të formuar mirë intelektualisht.

Ajo që e karakterizon gjykimin kritik të Rugovës, është vëzhgimi i çështjes në rrafsh teorik, siç thotë vetë, pa kurrfarë kompleksi socio-politik dhe pa kurrfarë ngurrimi letrar e estetik.

Paraprakisht, vështrimi do të realizohet duke pasur ndërmend mendimin e dijetarit bashkëkohës Roman Jakobson: “se mospajtimet në fushat e dijes, të shkencës, e mund të themi edhe në art, për dallim nga sferat politike, janë frytdhënëse se pajtimet provizore”.<sup>27</sup> Kështu, përpjekja e Rugovës fillimisht do të marrë drejtim shpjegues rreth vlerësisë së termit dhe praktikës së kritikës marksiste. “Termi *kritikë marksiste* në fushën e studimeve letrare e estetike inkuadrohet që me konstituimin e socializmit, i cili si mbështetje dhe ideologjitë veten e shpall marksizmin”.<sup>28</sup> Në këtë fazë konsideron se marksizmi, ashtu siç kërkohet i pranishëm në të gjitha sferat e jetës, kërkohet dhe në arte. Mbështetje kryesore të tij dhe burim i gjen shkrimet fragmentare të klasikëve marksistë, me rezultate metodologjike dhe politike. Por, Rugova këtu thekson se nuk dallon pikëpamje sistematike, estetike dhe letrare. Tekstet e nënvizuara ishin kryesisht të Marksit, Engelsit dhe të Leninit.

Duke e vështruar praktikën e kritikës letrare marksiste, me nuanca dhe karakteristika të traditave të regjioneve përkatëse letrare, teorike dhe estetike, Rugova shkruan për dy tipa të kësaj kritike: a. Kritikën tradicionale marksiste dhe b. Kritikën moderne marksiste.

Të parën e karakterizon si kritikë e cila bazohet në tekstet e reduktuara të klasikëve, në teorinë e socialistëve dhe të marksistëve. Term qendror të kësaj kritike e konsideron *pasqyrimin* e realitetit, të shoqërisë, në disfavor të artit duke e vënë në shërbim të ideologjisë. Për të konkretizuar çështjen, ai sjell edhe terma të tjerë të kritikës tradicionale marksiste, si: tipizimin, heroin pozitiv, luftën e klasave, konfliktin

---

<sup>26</sup> Po aty, ff. 314-326.

<sup>27</sup> Po aty, f. 314.

<sup>28</sup> Po aty.

etj. Duke mos vërejtur tendenca letrare, por tendenca ideologjike, mendon se ndryshe kjo kritikë mund të quhet edhe kritikë ideologjike. Në këtë vlerësim ka parasysh edhe dihotominë formë - përmbajtje, e cila bëhet antinomi e estetikës dhe e cila në mënyrë mekaniciste zgjidhet në favor të përmbajtjes së kufizuar me tematikën e caktuar. Në këtë kontekst, Rugova vlerëson se shembulli i kësaj kritike e dëmton artin.

Për dallim nga kjo, gjatë shqyrtimit të kritikës moderne marksiste, Rugova thekson se kjo kritikë, bazohet në marksizëm vetëm si filozofi dhe teori e hapur ndaj problemeve të kohë, që do të thotë se nuk i nënshtrohet marksizmit, por kërkon raporte dialektike midis kritikës dhe marksizmit. Këtë qëndrim e përfaqëson mirë mendimi estetik dhe kritik i fazës së fundit të zhvillimit të Gj. Lukaçit, kohë kur ai do t'u kthehet më shumë problemeve të artit, të letërsisë, në planin ontologjik, të autonomisë së arit, specifikës estetike. Por, Lukaçi, vë në pah Rugova, përpjekjet e veta për konstituimin e estetikës marksiste i vë përpara dilemës me konstatimin dhe bindjen se estetika marksiste ekziston dhe nuk ekziston.

Kritikën marksiste të botës frankofone e identifikon me Lysien Goldmanin, i cili çështjet e marksizmit i vendos dhe i zgjidh në kuadër të strukturalizmit të tij gjenetik, në bazë të parimit të materializimit dialektik-historik dhe në bazë të vetëdijes klasore. Ndërsa, në këndvështrimin gjerman, me një traditë të fuqishme filozofike dhe estetike, Rugova thotë se bëhen përpjekje për pasurimin e teorisë estetike me orientim marksist e me kërkesë që së pari arti, letërsia, të vështrohet në tërësinë e vet artistike e pastaj të vendosen në korrelacione me fushat e tjera të jetës dhe të filozofisë. Në regjionin anglo-amerikan e vlerëson si mjaft të rëndësishëm problemin që shtroi Frederik Xhejmsoni midis marksizmit dhe formës në fushën e teorive letrare, dialektike. Edhe regjionin sovjetik, pas viteve '60 të shekulli të kaluar, e konsideron në përpjekje të tejkaloi kritikën tradicionale marksiste, por vetëm në disa sektorë.

Në gjithë këtë vlerësim dhe këto rezultate të arritura në sfera të ndryshme, për problemin e kritikës marksiste moderne, përpjekjen më interesante Rugova e vlerëson atë të Lotmanit, mbi lidhjen e strukturalizmit letrar me marksizmin. "Pra ai, esencialisht, kërkon të lidhë *aspektin njohës* të letërsisë, që vjen nga marksizmi, me *sistemin e veprës letrare-artistike*, por me kërkesë dhe riformulim të gnoseologjisë me termin *modeli artistik*".<sup>29</sup> Për më tepër, Rugova vlerëson se termi kryesor i Lotmanit është ai *ideoestetik* që vjen nga kritika tradicionale marksiste dhe që merr një kuptim të ri, si përpjekje për të tejkaluar dihotominë formë - përmbajtje. Në këtë kënd vështrimi të përpjekjes për të tejkaluar marksizmin tradicional në atë modern, autori ynë afrohet në pikëpamje me ato të Lotmanin, me kërkesën e tij për të tejkaluar dihotominë formë - përmbajtje, për të kënaqur kërkesën njohëse e artistike, vetë artin. Tendencën e tij e gjen të realizuar mjaft bindshëm, me një mospajtim të mundshëm metodologjik.

---

<sup>29</sup> Po aty, f. 319.

Duke patur parasysh klasifikimin e traditës së kritikës marksiste në planin metodologjik, terminologjik dhe ideor, Rugova vlerëson se kjo kritikë çështjet kërkon t'i vendosë në vështrimin e formës letrare, duke u lidhur me praktikën analitike dhe metodologjike të Marksit, të zbatuar në veprën e tij *Kapitali*. Një gjë të tillë e vëren te strukturalistët e prej tyre thotë se e marrin edhe kritikët letrarë dhe esteticienët e tjerë. Kjo ndodhë për shkak se Marksit në analizën e tij niset nga forma e idesë së mallit, për të ndërtuar sistemin e tij filozofik-shkencor.

Sa i përket vështrimin të kritikës marksiste në tërësi, mund të themi se interesimi i Rugovës shkon drejt asaj moderne, e cila kërkon që kritika me eksplikim marksist të orientohet në artin modern. Përpyekjet e para të këtij drejtimi i dallon te Banjamini, Goldmani, Fisherit, Blohu dhe Garodi. Njëherësh thekson se kritikët dhe esteticienët francezë analizojnë dhe kërkojnë me mjaft argumente çështjen e alienacionit në letërsi, sidomos në letërsinë bashkëkohore. Këtu Rugova kryesisht përmend analizat e Goldmanit dhe të Bartit. Në kërkimin dhe konstatimin e rrjedhës së kritikës marksiste, thekson edhe analizat e kritikëve dhe të shkrimtarëve që kritika tradicionale marksiste i cilësonte si dekadentë, siç janë Kafka, Prusti, Xhojsi etj. Nga kjo rrjedhë del termi interesant i Garodisë *realizimi i paanë*, për ta zgjeruar konceptin e realizimit, si koncept qendror i kritikës tradicionale marksiste.

Përgjithësisht, sipas Rugovës, kritika moderne marksiste ka dhënë kontribut në zhvillimin e kritikës me orientime marksiste në përgjithësi. Terma qendrorë të marksizmit modern konsiderohen: alienacioni, gnoseologjia dhe ontologjia. Por, mbi të gjitha vlerëson termin e formës së analizës letrare, duke menduar që siguron autonominë, pavarësinë e artit dhe të letërsisë. Këtë edhe e mendon si problem kryesor me të cilin u thyen pikëpamjet e kritikës marksiste.

Pas kësaj paraqitjeje të pikëpamjeve të tij për kritikën marksiste moderne, Rugova konstaton se përpjekjet letrare dhe të kritikës letrare me orientim marksist modern janë përpjekje për zhvillimin e mëtejshëm të kritikës letrare e artistike dhe të estetikës dhe një kërkesë që kritika letrare të jetë në rrugën dialektike të zhvillimit të saj. Autori si rezultate të marksizmit krijues i konsideron edhe shumë disiplina të tjera: "si konteksti social (determinizmi) e klasor, alienacioni, vështrimi dialektik e materialist i historisë dhe i traditës dhe në gërshetim me disiplinat, siç janë linguistika moderne, teoria moderne letrare e artistike, semiologjia, strukturalizmi, teoria e filmit, teoria e komunikimit etj".<sup>30</sup>

Kritikën marksiste evropiane të zhvilluar në këtë mënyrë, Rugova e vë përballë letërsisë dhe artit të Kosovës. Ndikimin e saj e konstaton të paktë në kritikën tonë, duke thënë se ajo zhvillohet më shumë pas kësaj faze të kritikës evropiane. Këtu thekson se janë raportet sociale dhe artistike të letërsisë në shkrimet kritike që dallohen në kritikën shqiptare. Ndërsa, për kritikën më të re që zhvillohej ndër ne, konstaton se qëndron në raport me elementet e ndryshme të marksizmit, duke i zbatuar rezultatet sipas nevojës. Kështu që, vlerëson se kritika

---

<sup>30</sup> Po aty, f. 324.

jonë mund të qëndrojë në raport me marksizmin. Ai edhe njëherë thekson se kritika marksiste është një teori dhe kritikë e mundshme dhe kurrsesi metodë apo teori universale.

Sa i përket vështrimit të çështjeve të sotme teoriko-letrare, mund të themi se Rugova kishte gjithmonë interesim të madh, duke ndjekur hapin e kohës. Prandaj, titulli *Interesimet e sotme teoriko-letrare* ka parasysh kërkimin e veçantë, për të përkufizuar koncepte teoriko-letrare. Përpos vështrimeve dhe diskutimeve të ndryshme për këto probleme, kemi edhe një parashtrim në formë të përmbledhur dhe të sistemuar të klasifikimit të interesimeve të sotme teoriko-letrare. Synimi shkon drejt përgjithësisë të vlerave të mendimit teoriko-letrar. Përmbledhja, klasifikimi i përmendur, konkretizohet për mes pesë pikave kryesore, duke u ilustruar me autorë përkatës. Këtu dallohet edhe insistimi i autorit për përvetësimin e këtyre koncepteve. Janë pra probleme që i ka diskutuar pak a shumë edhe herë tjetër, duke i ngulitur në literaturën tonë:

1. Thekson vazhdimin e praktikës analitike në planin e semiologjisë, të semantikës, të teorisë së komunikimit, analizës tekstore, ligjëratës apo diskursit letrar.

2. Rritjen dhe aprovimin e vetëdijes për pluralitetin e leximit apo të vështrimit, krahas me ngritjen dhe formimin e vetëdijes për pluralitetin e (leximit të) veprës letrare.

3. Shquan interesimin për vështrimin kritik dhe historik të terminologjisë letrare dhe rishqyrtimin e vlerësisë së orientimeve të mëparshme kritike, që nga antika e këtej. Këtu i nënvizon përpjekjet e R. Bartit, të Zh. Zhenetit, të T. Todorovit, e më parë të M. Bahtinit dhe të N. Frajtit.<sup>31</sup> Për më shumë, autori ynë mendon se me këtë është shtuar interesimi për konceptin historik të problemeve teoriko-letrare, përmes historive teorike të kritikës e të studimit të letërsisë dhe përmes diskutimeve të veçanta.

4. Në pikën e katërt, Rugova dallon vetëdijen e formuar të ndërdisiplinartetit, krahas vetëdijes për pluralitetin, por tash në planin e rezultateve. Duhet përmendur se këto orientime i konsideron të kushtëzuara nga kritika frënge e viteve '60.

5. Ndërsa, në pikën e fundit ai thekson interesimet teoriko-letrare të orientuara drejt analizave konkrete, pra drejt praktikës analitike.

Në kuadër të kërkimit të problemeve teoriko-letrare, Rugova diskuton çështjen e leximit plural, të cilën e gjen të aplikuar nga autorë të ndryshëm, me orientime dhe disiplina të ndryshme. E ilustron me veprën e S/Z të R. Bartit, pra me analizën tekstore, me vështrim simbolik, hermeneutik, semantik etj. Në këtë kontekst përmend edhe Fransua Bartonë me leximin etik, struktural, subversiv, psikanalitik e fenomenologjik që i bën romanit *Tristani dhe Izolta*. Në këtë vijë shton

---

<sup>31</sup> Rolan Bart: "Aventura semiologjike", Rilindja, Prishtinë, 1986; Zherar Zhenet: "Figura", Rilindja, Prishtinë, 1985; Cvetan Todorov, Olivier Dykro: "Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjëritimit", Rilindja, Prishtinë, 1984; Northrop Fraj: "Anatomia e kritikës", Rilindja, Prishtinë, 1990.

edhe Fitçen, romanin *I Huaji* të Alber Kamysë dhe leximin e tij biografik, politik, sociologjik, ekzistencialist, ontologjik e psikanalitik. Veprat dhe autorët e përmendur i zgjedh jo rastësisht Rugova, meqë aty ai gjen bazën për ngritjen e vetëdijes letrare e të formuar, për pluralitetin teorik e analitik.

Nga ky këndvështrim i problemeve teoriko-letrare, te Rugova zë vend të rëndësishëm edhe shqyrtimi për sensibilitetin në letërsi. Në këtë pikë dalin në shesh problemet e biografisë, të tekstologjisë filologjike dhe të pozitivizmit, probleme këto të rëndësishme për autorin, duke i parë shpesh të dala si gjenetikë dhe poetikë e tekstit.

Duke i patur parasysh të gjitha këto interesime teoriko-letrare, Rugova vështron edhe situatën aktuale të kritikës dhe të studimeve letrare shqiptare. Në këtë kontekst na njofton se në studimet shqiptare kontakti me orientimet teoriko-letrare moderne ka filluar në hyrje të viteve '70, arritje kjo që përcillet me zhvillimin e inkuadrimeve të gjuhësisë strukturale, të semiologjisë, të analizës tekstore, të teorisë së leximit, psikokritikës etj. Sukses kryesor në këtë kontakt Rugova e konsideron formimin e vetëdijes shqiptare për veprën letrare si një fenomen plural.

Duke folur për mendimin tonë kritik, Rugova ndalet te tradita e kritikës shqiptare, duke e vlerësuar relativisht të pasur, që nga Barleti e këndeje. Është e rëndësishme të theksohet se në këtë pjesë të tekstit Rugova nuk i ka objekt kontaktet e kritikës bashkëkohore në raport me traditën, por kontaktet e saj në raport me kritikën bashkëkohore evropiane. Inkuadrimit e kritikës sonë në kontakt me idetë e kritikës së kohës së vet i gjen të shfaqura pas Rilindjes Kombëtare, në vitet '30 të shekullit njëzet. Në këtë paraqitje ai zberthen edhe termin *kritikë bashkëkohore*, duke e kuptuar kritikën pas Luftës së Dytë e këndeje. Kuptimi i tillë ka të bëjë edhe me kritikën shqiptare dhe atë evropiane. Në vështrimin e kritikës shqiptare, në plan të zhvillimit, konsiderohet se ajo ka patur arritje të dukshme gjatë dyzet viteve të fundit, rezultatin e të cilës e vlerëson sot si degë të rëndësishme të studimeve shqiptare. Kështu, Rugova konstaton se: “kjo sot ka një autonomitet të vetin në forcim e sipër, çfarë flet se është bërë e aftë të vështrojë letërsinë në rrafsh të konsiderueshëm kritik e teorik, dhe të komunikojë në planin e jashtëm”.<sup>32</sup> Në këtë rrjedhë të zhvillimit ai e shikon vazhdimisht të forcuar bazën e saj, duke i parë të stabilizuara edhe organet e shtypit, revistat letrare e shkencore; diferencimin e tipave dhe formave të mendimit brenda kulturës shqiptare e shikon gjithnjë në zhvillim; të rëndësishme e konsideron edhe përkthimin e studimeve dhe të artikujve, si dhe të librave në fushën teoriko-letrare dhe historiko-letrare, në fushën e estetikës.

Kështu, duke iu kthyer temës bosht, pra raportit midis kritikës së sotme shqiptare dhe asaj evropiane, Rugova para së gjithash shikon raportin në rrafsh të ideve, të rezultateve dhe të metodologjive, si dhe orientimeve të kritikës apo të teorisë. Duke marrë për bazë Northrop Frajin, Rugova raportin e ilustron në kuadër

---

<sup>32</sup> Po aty, f. 334.

të logjikës zhvillimore ose të një kronologjie, të cilën e konsideron si instrument letrar. Këtu shenjon kritikën shqiptare me ide socialiste, të ardhura nga teoria sociale letrare perëndimore. “Kështu, në një shkrim të E. Mekulit, në numrin e parë të ‘Jetës së re’ (1949), përkundër thirrjes për ngritjen e një letërsie dhe të punës letrare, kërkohej që letërsia të ketë formë kombëtare e përmbajtje socialiste”.<sup>33</sup>

Brenda viteve ‘60, Rugova gjen të bëhet fjalë edhe për tendenca të reja. Në Kosovë e konsideron si aktualitet *teorinë e angazhimit*, ndërsa në Shqipëri *teorinë e novatorizmit*. Fillimi i viteve ‘70 e paraqet kritikën shqiptare të afruar me idetë dhe me teoritë evropiane, dallohen kontaktet me teori të ndryshme letrare, estetike e filozofike. Kështu evidenton kontakte fillimisht me *Teorinë e Uelekut* e të Uorenit lidhur me *studimin e jashtëm e të brendshëm*, pastaj të fenomenologjisë letrare, kryesisht të Ingardenit; pastaj kontaktet me strukturalizmin, me idetë e formalizmit, Kritikës së Re amerikane. Dallon edhe ide e rezultate të analizës dhe të teorisë semiotike, të teorisë së tekstit, të koncepteve të Bartit e të Zhenetit, të Todorovit, si dhe të poetikës strukturale të Lotmanit. Nënvizon tek ne edhe aplikimin e elementeve të poetikës së riaktivizuar dhe e interesime për narratologjinë, të teorisë së rrëfimit. Në përgjithësi, në Evropë, në vitet ‘70, thotë se kërkohet një plan më i gjerë i komunikimit për një *kritikë dialogjike*. Këtu përmend teorinë e Todorovit dhe terminologjinë filozofike të Bahtinit. Në këtë kontekst të teorive më aktuale, përfshin edhe “rezultatet e fundit të N. Frajit për *kodin e madh letrar*, që në formë mjaft produktive e aplikoi në vështrimin e Biblës si kod i madh me shtrirje, po ashtu, të madhe në letërsisë perëndimore”.<sup>34</sup>

---

<sup>33</sup> Po aty, f. 335.

<sup>34</sup> Po aty, f. 338.



## TEORIA E POEZISË SHQIPE

### Teoria e tipologjisë

“Vetë titulli i studimit, *Teori e poezisë*, nënkupton një nivel më të lartë të abstragimi në shkrimin për letërsinë, që do të dallohet dukshëm nga shkrimet e përparshme të tij edhe në këtë libër”.<sup>35</sup> Gjithashtu, nga vetë titulli nënkuptohen metoda dhe objekti i tekstit: studimi teorik i poezisë shqipe, më konkretisht i poezisë bashkëkohore shqipe.

Edhe këtu Rugova nuk do t’i largohet frymës së teksteve të tjera teorike, sa i përket kërkesave, konceptimeve, pikëpamjeve, argumentimeve, krahasimeve me dijet në përgjithësi etj. Një përpjekje të tillë të teorizimit dhe klasifikimit të poezisë shqipe, e kemi parë edhe në studime të tjera të tij, gjë që flet për punën sistematike të autorit. Teoria e tij gjithmonë ecën në një vijë të përparuar të kërkimit që i përgjigjet kontekstit të kohës dhe teorisë botërore. Pikëpamja kryesore që i lidh tekstet e tij teorike është vëmendja e posaçme për format artistike/estetike letrare dhe për të gjitha elementet e tyre.

Teksti në fjalë, siç na bën të ditur në fillim autori, do të ndryshojë për nga optika e vështrimit të letërsisë. Do të thotë, Rugova problemit nuk do t’i qaset përmes historisë së letërsisë apo të letërsisë komparative, por, për studimin e poezisë do të përdorë një metodologji tjetër, e cilanga ai konsiderohet disiplinë e studimit të poezisë, që është *tipologjia*.

Rugova e zgjedh *tipologjinë* si *metodën* më të përshtatshme për të shqyrtuar praksisin e poezisë. Metoda konkretizohet përmes zbatimit dhe rezultateve që sjellin përgjithësimet tipologjike. Për mos t’i hyrë në hak dy disiplinave të tjera, historisë së letërsisë dhe letërsisë komparative, ai do t’i shpjegojë edhe arsyet pse nuk do t’i përdorë si metodë pune këtu. Shkurtimisht, disiplinën e parë e konsideron si disiplinë të periodizimit dhe si terminologji përkufizuese, ndërsa të dytën, duke iu referuar Uelekut, e konsideron një *metadisciplinë*, e cila është në gjendje ta vështrtojë letërsisë në rrafsh të ndryshme, por jo në planin metodologjik. Dhe, ashtu siç e do puna, Rugova do të argumentojë disiplinën e zgjedhur nga ai, tipologjinë, konkretisht konceptin e tipologjisë, si të denjë, duke shpjeguar etimologjinë, historikun e termit e të metodologjisë dhe aplikimin e saj. Me që fjala tip vjen nga greqishtja e vjetër

---

<sup>35</sup> Sabri Hamiti: “Memento për Rugovën”, f. 61.

*typos*, që do të thotë figurë, imazh, gjurmë, shenjë etj, del se tipologjia është dije mbi tipat. Kështu, si orientim për konkretizimin e çështjes së tipologjisë, Rugova do të ketë referencë autorë të ndryshëm, të njohur, si: Velfin, Shilerin, Ejhenbaumin, Zhenetin, Bartin, Hrapçenkon, Lotmanin. Pikëpamjet dhe konceptet për tipologjinë do t'i plotësojë nga studimet e tyre, për të thënë se tipologjia është sistem ndërveprues në procesin e konstituimit të *tipit*, e duke iu bashkuar mendimit se e gjithë kjo vjen nga sistematika e organizmave. Si rrugë gjenetike-historike të ardhjes së tipologjisë në letërsi, shembull të parë Rugova e konsideron studimin e artit nga ana e Velfinit, i cili çështjet e artit i klasifikon sipas tipave. Ndërsa, kur e shikon çështjen brenda vetë mendimit për letërsisë, merr shembull klasifikimin e Shilerit mbi poezinë. Tipologjinë mbi poezinë e sheh të zbatuar shpesh edhe te formalistët rusë, si te Ejhenbaumi.

Para se t'i hyjë studimit të tipologjisë, Rugova thekson se në teorinë mbi tipologjinë në letërsi ekzistojnë mendime të ndryshme rreth përkufizimit dhe zbatimit të saj. Në vlerësimet e përgjithshme të teorisë së tipologjisë, ai nisat nga studimet strukturale e semiologjike, duke parë interesim që metoda dhe metodologjia tipologjike të zbatohen edhe në historinë e letërsisë dhe në letërsinë komparative. Do të thotë, tipologjia konceptohet si reaksion ndaj çështjeve periodizuese, në të cilën kërkohet një sistemim dhe specifikim i letërsisë. Në këtë drejtim, si më të arrirë i konsideron teoricienët e kritikës së re frënge, Zhenetin dhe Bartin (edhe për faktin që të dy ishin të mendimit që një histori e re e letërsisë të shkruhet "pa emra" të autorëve, histori e veprave të tyre, pra një histori e formave letrare), të cilët, ndër të tjera, ishin të mendimit që "aspektin poetik e estetik në kuadër të kontekstit kulturo-historik, po vetëm në planin e korrespondimeve kontekstuale, një histori e letërsisë e jo një histori e kulturës së letërsisë, sepse vetëm kështu do t'i ndihmojë drejtpërdrejt dhe do ta paraqesin një sintezë historike vetë letërsisë".<sup>36</sup>

Duke u thelluar në çështjen e tipologjisë, Rugova ndalet edhe te studiuesit sovjetikë, nga të cilët veçon B. Hrapçenkon, që për përkufizimin se studimi tipologjik zbulon përgjithësimin letrar-estetik të fenomeneve artistike. Në këtë rast ai thekson se mohimi i tipologjisë letrare do të thotë dominim i empirizmit dhe largim nga studimi shkencor i proceseve të zhvillimit letrar. Hulumtimin tipologjik e cilëson në funksion të konstatimit dhe të klasifikimit të dukurive letrar të afërta për nga tipi. Këtu dallon edhe elementet tipologjike, si *unitetin* dhe *diferencimin*, procesi i të cilave prodhon tipat dhe na bën të ditur se dallon tipologjia në gjuhësi dhe në letërsi, por edhe në disiplinat e tjera.

Problemin e tipologjisë, konkretisht tipologjinë e kulturës, Rugova e ilustron më së miri me Lotmanin, i cili bazë ka mjetet semiotike dhe që "çështjen e tipologjisë si disiplinë nuk e interpreton më shkoqur, po përmes kundërvënies ndaj letërsisë

---

<sup>36</sup> Ibrahim Rugova: "Strategjia e kuptimit", Faik Konica, Prishtinë, f. 173.

tradicionale komparative, si disiplinë të veçantë me mundësi të mëdha shkencore, që vepron me mjetet tjera”.<sup>37</sup>

Studiuesi ynë mendon se çështja e tipologjisë nuk është përpunuar ende sa duhet, prandaj e shikon si çështje në zhvillim. Ai e vështron teorinë mbi tipologjinë të lidhur me njësinë e saj kryesore, *tipin*. Terma operues që funksionojnë në procesin e analizës tipologjike konsideron: përgjithësimin, ngjashmërinë, diferencimin, ndryshimin, koincidimin, jokoincidimin dhe saktëson lidhur me procedurën e funksionimit të tyre: “përgjithësimi e shquan tipin, i cili ndërtohet në bazë të ngjashmërisë, ndërsa elementet e ngjashme dalin gjatë procesit analitik të koincidimit dhe të jokoincidimit, gjatë zbatimit të diferencimit midis elementeve të objektit të shqyrtuar, të dukurive poetike e estetike”.<sup>38</sup> Kështu e mendon Rugova metodën, rrugën tipologjike në kuadër të së cilës konstituohen *tipat* si tërësi unike, dinamike dhe dialektike. Parë teorikisht, strukturat e *tipit* janë të ngjashme me elementet që e përbëjnë poezinë dhe *tipin* e vështrojnë në planin sinkronik, në bazë të klasifikimit, poetik dhe në planin diakronik, në bazë të kohës. Kështu, Rugova e teorizon *tipin* si rezultat të abstraksionit dhe e konsideron instrument-metodë me rëndësi në shkencat shoqërore-humanitare. Në planin e modelimit, Rugova dallon *tipologjinë shkencore* dhe *tipologjinë artistike* letrare. Ndërtimin e tipit të parë e ilustron më së miri me mendimin e Lotmanit, i cili konstaton se: “modeli shkencor, sipas rregullit, krijohet atëherë kur përmes analizës ndërtohet një ide mbi strukturën e objektit ose mbi elementet që e përbëjnë”,<sup>39</sup> ndërsa sa i përket tipit të dytë, artistik-letrar, Rugova mendon që ai krijohet përmes aktit analitik e jo përmes aktit paraqitës, objektives, nga del se akti analitik, për dallim nga ai i modelit shkencor, konkretizohet më shumë në aktin e sintezës. E gjithë kjo procedurë sjell sqarimin e një elementi shumë të rëndësishëm, dallimin midis *tipologjisë* dhe *klasifikimit*. Janë këto dy metoda që përzihen shpesh: “Për dallim nga klasifikimi, tipologjia hulumton lidhjet dhe veprimet në strukturën e objektit, kurse klasifikimi bën vetëm grupimin e gjërave duke mos i vështruar marrëdhëniet strukturore”.<sup>40</sup> Në këtë plan, studiuesi ynë e gjen të nevojshme të bëjë dallimin e letërsisë komparative dhe të tipologjisë, të cilat e përdorin krahasimin. Këtë ngjashmëri e sqaron duke e bërë dallimin në përdorim, derisa e para e përdor krahasimin për të shfaqur të veçantën, studimi i dytë e përdor për të shquar specifikën dhe të përgjithshmen në kuadër të funksionit të gjërave. “Pra tipologjia është një disiplinë në të cilën ka mundësi më të shumta për realizimin më të madh të shkencërisë, jo duke pasur për shembull ekzaktësinë e shkencave ekzakte, por si metodologji që jep kontribut për krijimin e ekzaktësisë specifike të shkencave humanitare.”<sup>41</sup> Për një konkretizimin edhe më të hollë,

---

<sup>37</sup> Po aty, f. 178.

<sup>38</sup> Po aty, f. 179.

<sup>39</sup> Po aty, f. 181.

<sup>40</sup> Po aty, f. 182.

<sup>41</sup> Po aty, f. 183.

Rugova shpjegon se tipologjia si disiplinë dhe metodologji i prek çështjet esenciale të historisë së letërsisë dhe të letërsisë komparative.

Duke e lexuar tekstin në përherë kemi parasysh që Rugova ka zgjedhur tipologjinë si metodë për studimin e poezisë shqipe bashkëkohore. Para se të kalojmë te artikulli tipologjik, do t'i sqarojmë edhe disa pikëpamje të Rugovës për këtë metodë, të cilat ai i mendon si më të përshtatshme për analiza tipologjike.

Analizën e poezisë Rugova e ndërton duke patur parasysh tipat e poezisë shqipe dhe korelacionet e komunikimit me letërsi të tjera. Tipat do t'i vështrojnë në lidhjen që kanë me traditën e vendit dhe ndikimet e poezisë së huaj. Çështja do të diskutohet më shumë rreth problemit të ndikimeve. Për këtë problem Rugova i referohet studiuesit strukturalist të Pragës, Jan Mukarzhovskit, që thekson se: “për t’u kryer procesi i ndikimit duhet të jetë e përgatitur tradita artistike e vendit, e cila do të kushtëzojë kahen dhe realizimin e ndikimit të një letërsie”.<sup>42</sup> Studiuesi ynë mendon se kjo çështje, më qartas dhe më bindshëm teorikisht, do të realizohet përmes parimit tipologjik, duke menduar se tipologjia nuk i jep përparësi apriori asnjë letërsie. Mendimin e Mukarzhovskit Rugova e sheh të dalë nga ky proces: Ekzistuesja - Brendaveprimi - Ndikimi - Tipi, pra nga procesi interaktiv. Si përfundim, mendon që do të dalë një element i ri, të cilin e quan *tip*, e i cili ndryshon nga ai që ekzistonte më parë. Do të thotë, *tipi* veçohet gjatë aktit të analizës që i bëhet objektit të analizuar, përmes artikullimit tipologjik. Rugova këtu edhe një herë thekson se *tipi* merret si njësi teorike unike që konstituohet në bazë të planit sinkronik dhe të atij diakronik. Duke patur parasysh se poezia është model i jetës, i botës, i ekzistimit, Rugova modelin tipologjik e sheh në sferën e njohjes epistemologjike, duke theksuar se tipi është model shkencor që ndërtohet në bazë të shkallës së lartë të abstraksionit, pra “model tipologjik do të thotë model që konstituohet brenda zbatimit të tipologjisë në modelin artistik”.<sup>43</sup> Ndërsa, duke patur referencë Bartin, Rugova e konsideron *tipin* “si proces kualitativ të elementeve formale dhe semantike, si konstrukcion model intensiv e jo ekstensiv, në ç’mënyrë tipologjia dhe tipi si njësi operuese e tij, merr karakter vlerësues në kuadër të tipologjisë së tekstit, sepse asnjë tekst nuk ekziston para se të klasohet simbas vlerësisë së tij”.<sup>44</sup> Rugova përcaktohet për modelin tipologjik, për të pasur mundësi më të madhe për vlerësimin e poezisë. “E dhënë me një emër më popullor, tipologjia e teorisë së Rugovës është Poetika”.<sup>45</sup>

## Artikulli tipologjik

---

<sup>42</sup> Po aty, f. 187.

<sup>43</sup> Po aty, f. 190.

<sup>44</sup> Po aty, f. 191.

<sup>45</sup> Kujtim M. Shala: “Rugova meditant”, f. 85.

Në vijim Rugova do të ketë në qendër të vëmendjes vështrimin tipologjik të poezisë shqipe në ish-Jugosllavi. Tipologjinë, sepse jep më shumë mundësi për vështrimin e praktikës analitike, për shkak të bazës së vet teorike dhe metodologjike. Ai nuk do ta ketë poezinë shqipe vetëm objekt të kritikës, por do ta vështrojë më gjerë e më gjatë. Kritika e tij do të depërtojë në praktikën poetike, gjë që, siç thekson ai, nuk është bërë më parë. Si një përjashtim dallon përpjekjen e Sabri Hamitit që poezinë ta vështrojë përmes zhvillimit të figurës poetike, në mënyrë sistematike. Në këtë kontekst, dallon edhe Mensur Raifin, për një përpjekje të caktuar të praktikës poetike moderne.

Për sqarim, Rugova kërkon një analizë më të detajuar të poezisë shqipe, duke kërkuar elemente më të hollësishme, prandaj mendon që përmes prerjes tipologjike, në rrafshin sinkronik të analizës, do të ketë mundësi të mira për vështrimin sistematik të elementeve kryesore të poezisë. Si elemente kryesore e që do t'i kërkojë praktikisht janë: elementet estetike e poetike, sistemi i figuracionit, rezultatet e realizimit poetik, forca e përgjithësimit të abstraksionit dhe raportet e paraqitjes poetike. Si rezultat të kësaj analize, përcakton tre tipa të poezisë shqipe: 1. Poezia afirmative, 2. Poezia subjektive dhe 3. Poezia objektive. Rugova, në *Kah teoria*, e kishte ndarë poezinë në tre tipa, duke shikuar aspektet poetike e estetike: 1. Poezia e entuziazmit me termin e pasqyrit; 2. Poezia e lirizmit me termin e përjetimit dhe 3. Poezia objektive me termin e formësimit. Ai thekson se këta tipa nuk do të dallojnë shume nga tipat e rinj dhe se, përkundër riformulimit, nuk do të gjendet larg kësaj tipologjie, të kërkimit të përbërësve estetikë e poetikë.

Në poezinë afirmative gjejmë paraqitjen e *objektit* në aspektin estetik dhe në atë poetik. Në aspektin e parë poezia realizohet në objektivin e entuziazmit dhe realiteti i ri social shfaqet në raporte të reja, përthihet nëpër elementin e entuziazmit poetik, që del si qëndrim poetik. Nga kjo del poezia afirmative, sepse gjendja e entuziazmit, rezultati i saj i vërtetë, është afirmacioni. Duke e parë që ky entuziazëm merret me elementin social, Rugova e quan entuziazmin social. Në aspektin poetik konsideron se poezia i kërkon gjenezat e veta në traditën e poezisë sociale ndërmjet dy luftërave botërore, në Ballkan dhe në Evropë. Kjo poezi njihet për autor kryesor Esad Mekulin.

Poezia subjektive ka në qendër *subjektin poetik*. Ky subjekt është realizues poetik i poezisë dhe filtrues i tematikës poetike, sepse veçori e kësaj poezie, siç thekson Rugova, është forcimi i subjektit në planin tematik, më parë se në atë artistik. Pra, i gjithë receptimi, strukturimi dhe mesazhi poetik realizohen nga subjekti poetik. Ky subjekt do vetëm atë që është poetike dhe lirike, ndërsa kategori kryesore e kësaj poezie është singeriteti.

Ky tip i poezisë karakterizohet edhe me formën e intimes, që do të thotë se poeti/subjekti tërhiqet në vete, duke shprehur revoltë. Madje, edhe shumë poezi të këtij tipi titullohen *intima*. Ndodh kështu, pasi koha e kësaj poezie ekziston vetëm si moment i përjetimit të drejtpërdrejtë apo të jetuar. Poezia e tillë niset nga parimi se çdo gjë që nuk mund të përjetohet, nuk është objekt i denjë për poezinë, nuk jep

rezultate poetike. Ndër kategoritë kryesore të intimes janë: pikëllimi, malli, vetmia, dëshira, shpresa, kujtimi etj. Poezia e tillë karakterizohet edhe me vetërrëfimin e subjektit poetik. Kjo distancë që krijohet midis subjektit dhe botës, paraqet një formë të hermetizmit. Me fenomenin e tillë Rugova nënkupton mbylljen e subjektit poetik, mosinteresimin e tij në relacionet me botën, përveç mesazhit që do t'i komunikojë botës. Këtë hermetizëm studiuesi ynë e konsideron si faktor të rëndësishëm në formimin e subjektit poetik, të poezisë sonë. Mbas hermetizmit të poetikës së Lasgush Poradecit, hermetizmin e poezisë subjektive moderne Rugova e njih si përpjekjen e parë në mënyrë më të thelluar.

Duke iu referuar Bomhofit se: “lirika nuk e ka objektin e caktuar të observacionit, po i komunikon lexuesit situatën e objektit, se lirika është modalitet i ekzistencës, të cilën gjë e pranon me rastin e observacionit”,<sup>46</sup> Rugova flet për refleksionin lirik të kësaj poezie, që e shpjegon jo si finalitet, por më shumë si mendime e reflekse në kuadër të kontekstit lirik brenda njësisë poetike. Madje, del që edhe figura është refleksion.

Formë të refleksionit lirik Rugova e konsideron *requiemim*. Ndër të tjera, Rugova thekson edhe hapësirën lirike të kësaj poetike dhe gjuhën deklarative të subjektit poetik si kuptim estetik. Si autorë kryesorë të poezisë subjektive numërohen: Azem Shkreli, Enver Gjerqeku, Rrahman Dedaj, Adem Gajtani, Fahredin Gunga, Din Mehmeti, Martin Camaj etj.

Poezia objektive realizohet me vendosjen e raportit midis *subjektit* dhe *objektit poetik*, që do të thotë subjekti poetik nuk mbyllet në vete, por i përgjithëson refleksionet e veta. Këtë proces poetik estetika e njih si akt kryesor të krijimit artistik. Pra, në kuadër të poezisë objektive, ndihet më shumë prania e objekteve, si rezultat i subjektivitetit poetik. Nga ky proces bartës del si rezultat vepra artistike. Relacionet e tilla realizohen përmes përdorimit dhe funksionalizimit të objekteve që bëhen objekte poetike dhe përmes mjeteve poetike, si figuracioni e figurabiliteti, me anë të simbolit, metaforës, ironisë poetike etj. Në këtë poezi, për dallim nga të tjerat, Rugova njih subjektin poetik si *koordinator krijues* midis kuptimeve objektive dhe atyre krijuese, që varen nga subjekti poetik. Në këto raporte poetike del edhe elementi i *distancës poetike* që nënkupton maturinë dhe stabilizimin e elementeve të veprës poetike.

Ironinë Rugova e konsideron kategori kryesore të poezisë objektive. Problemin e ironisë e të ironizimit, që del në këtë poezi, e quan *ironifikim*, e që e kupton tërë njësinë poetike, poezinë si tërësi të ironisë. Në këtë kontekst, Rugova i referohet Bahtinit, i cili mendon se: “ironia ka dalë në të gjitha gjuhët e kohës së re (sidomos në atë frënge), ka dalë në të gjitha fjalët dhe format (veçanërisht sintaksore); ironia për shembull, e ka shkatërruar periodicitetin e glomazitetit dhe të bombastikës së fjalëve”.<sup>47</sup> Duke menduar se ironia na ka bërë të vetëdijshëm për mundësinë e objektivitetit artistik, Rugova e favorizon këtë lloj poezie. Ai dallon disa

<sup>46</sup> Ibrahim Rugova, vep. e cit., f. 207.

<sup>47</sup> Po aty, f. 213.

modalitete të realizimit të ironisë dhe i klasifikon si vijon: *ironia fabulare* (objekt të ironisë ka huazimin e elementeve të fabulave, kafshëve, duke i zbërthyer semantikisht nëpër situata të reja poetike për qëllim pra të ironisë), *ironia figurative* (ideja ironike zhvillohet duke u bërë thyerja e figurës normale poetike, e duke u realizuar me surrealistet figurativ apo me ndonjë element fantastik), *ironia kuptimore* (bëhet fjalë për ironinë e kuptimeve, të ideve, ku poeti shpreh mospajtimin artistik) dhe *ironia konkrete* (konkretizohet nga metaforifikimi i objekteve dhe ideve ekzistuese). D.m.th. kemi zhvendosje të pranive dhe mungesave, përmes të cilave kërkohen prani të reja të shenjimit poetik, të cilat ilustrohen me autorët: Ali Podrimja, Rrahman Dedaj, Beqir Musliu, Sabri Hamiti etj.

Duke u nisur nga këto pikëpamje, shohim se Rugova e lartëson këtë tip të poezisë për pasurinë e mjeteve poetike. Po ashtu, këtë poezi e cilëson edhe për pasurimin dhe zgjerimin tematik, interesim i së cilët është fusha mitiko-historike e realizuar në poezi, të cilën e quan simbolizëm apo semantizëm të tematikës. Konkretisht, te poezia objektive Rugova veçon mitet antike kombëtare ilire, mitet e antikave të ndryshme të civilizimeve të hershme të popujve të ndryshëm, si dhe mitet popullore. Duke e vështruar kështu, poezinë objektive e konsideron si fazë të stabilitet artistik dhe poetik në poezinë shqipe.

Pikëpamjet e Rugovës për poezinë objektive shkojnë më tej, duke e veçuar si karakteristikë të saj mendimin poetik që del si formë e mesazhit në planin e poetikës dhe të refleksionit. Mendimi i tillë gjithashtu është i lidhur me figurën dhe tërësinë e saj kuptimore. Duke folur për këtë kategori, Rugova shpjegon se ajo nuk duhet të ngatërrohet me mendimin filozofik apo shkencor, sepse ky nuk imponohet, por buron nga fjalët, nga objektet dhe kuptimet poetike.

Duke u thelluar në çështjen e vlerësimit të poezisë objektive, shohim se Rugova i kushton shumë rëndësi edhe një elementi tjetër, të kësaj poezie: *resemantizimi intensiv poetik*, element të cilin në aspektin gjenetik e konsideron si një evoluim poetik, ndërsa në atë teorik dhe estetik si një shpërndërrim kuptimesh, prosedesh e koncepcionesh poetike, si një proces dhe dukuri intensive. Resemantizimi këtu njihet me karakter vlerësues, përmes cilësimit konkret të poetizmave të ndryshëm. Për ta ilustruar më mirë këtë element, merr shembullin në vijim: “gruri si një send, objekt i pranishëm në gjithë poezinë, nëpër tipat e konstituuar merr kuptime e domethënie të ndryshme: përderisa në tipin e poezisë afirmative ishte një objekt vetëm ekzistues e i parëndësishëm për interesimin e formësimit poetik, në tipin e poezisë subjektive bëhet element intim e frymëzues i botës poetike, shpreh intencën e identifikimit të brendshëm të subjektit poetik me të, elementi i një qëndresës kolektive, por edhe simbol i mendimit dhe kuptimit poetik, madje si mjet poetik”.<sup>48</sup>

Resemantizimi si proces poetik, sipas Rugovës, realizohet përmes figurës poetike, metaforës dhe simbolit. Shkurtimisht, fenomeni resemantizim poetik

---

<sup>48</sup> Po aty, f. 223.

cilësohet si pasurim i sferave kuptimore të poezisë e njëkohësisht edhe e sferave e kuptimeve dhe ndjenjave shpirtërore e intelektuale. Në këtë kontekst, Rugova do të bëjë një analizë dhe krahasim të tre tipave të poezive: Poezia afirmative ka kuptim elementar (*gjelbërim*), poezia subjektive ka kuptim intim, entuziast e meditativ lirik (*gjelbërimi*), ndërsa poezia objektive ka kuptim polivalent e negativ (*gjelbërimi i zi*).

Duke paraqitur këto pikëpamje, për këta tre tipa të poezisë, Rugova prek dhe shqyrton një çështje tjetër të rëndësishme, atë të *individualitetit poetik*. Do të thotë, vështrimi i bëhet krijuesit të poezisë, për të parë rezultatin e një poeti, i cili ka kontribuar për pasurimin e poezisë dhe që është bërë fakt poetik edhe në zhvillimin e saj. Njëherësh, kjo dukuri vlerësohet në planin diakronik, pra si është vlerësuar, dhe sinkronikisht, cila është vlera e tij. Për ta paraqitur orientimin tipologjik, ai i shqyrton karakteristikat kryesore të autorëve të zgjedhur dhe diferencimet e tyre individuale:

1. Poezia afirmative : E. Mekuli: *Asht ditë, Popollit tim*; E. Gjerqeku: *Agimi ynë, Fermës së mbyllun*.

2. Poezia subjektive - A. Shkreli: *Ç'është poezi*; E. Gjerqeku: *Dilema e këngës, Elegjia e gjelbërimit*; F. Gunga: *Pëshpëritje dashunije* (fragment); A. Gajtani: *Drandofilja*.

3. Poezia objektive - A. Podrimja: *Balada për njerinë që shëtiti lakuriq nëpër botë, Cung i vetëm në pyll*; B. Musliu: *Trëndafilja e drunjtë, Kuptimi i hinit*; Rr.Dedaj: *Një trekëndësh në jetën tonë*; A. Shkreli: *Dhjatë e re*; M. Ramadani: *Relacionet e relativitetit*; E. Basha: *Baladë e zezë e një dite të bardhë, Trashëgimi (V.)*; S. Hamiti: *Thika, Lulet në ballkon, Telefoni*.

Edhe ne jemi të mendimit se: “në tipologjinë e Rugovës, autorët përfaqësues e tekstet ilustruese provojnë se tipi është produkt i dominantave estetike/poetike e semantike dhe jo strukturë pastërtisht homogjene. Thënë më ndryshe, përbërës të një tipi mund të dalin edhe te tjetri, natyrisht të resemantizuara”.<sup>49</sup>

Pas paraqitjes së pikëpamjeve të veta, Rugova bën edhe vlerësimin e tyre, që e nxjerr si rezultat të koncepteve të zbatuara në tekst, me karakteristikat më esenciale të poezisë dhe të autorëve më me ndikim. Vlerësimin e strukturon në këtë mënyrë: jepet përgjithësimi, përcaktimi ndaj tipit të poezisë, pastaj elementet karakteristike për një vepër, aspekti tematik e prosedor i saj, rëndësia dhe, në fund, cilësimi vlerësues. Këto cilësime i merr nga terminologjia e kritikës procesuale, me këto kuptime:

- *Libër i dobët*, - që është nën nivelin e asaj që është shkruar apo shkruhet;
- *Libër i zakonshëm*, - që nuk vërehet mjaft në poezi, nuk sjell ndonjë element shquës, të nxisë diçka të re, po që inkuadrohet në situatën momentale;
- *Libër interesant*, - që përmban elemente të cilat heqin mendjen e kritikës dhe të praktikës poetike, po si tërësi nuk është i realizuar;

---

<sup>49</sup> Kujtim M. Shala: “Rugova meditant”, f. 88.



- *Libër i mirë*, - që ka mëvetësinë e vet artistike po nuk ndihet shumë në procesin poetik;
- *Libër i mirë e me ndikim*, - që me mëvetësinë e vet artistike dhe me elementet inovative ndikon në procesin poetik.

Rugova nisët nga mendimi se ky vlerësim do t'i shërbente dhe kontribuonte situatës së atëhershme të poezisë shqipe, se do t'i shërbente edhe individualisht personit që ka objekt poezinë dhe gjithë poezisë shqipe, fundja edhe vetëm si informacion që dëfton në tërësi mbi këtë poezi dhe mbi praktikën e saj krijuese.

**Pjesa e dytë**  
**ESETË**

## STRATEGJIA E KUPTIMIT

Në esenë e titulluar *Strategjia e kuptimit* Rugova bën një paraqitje të veçantë, duke shqyrtuar disa probleme gjithashtu të veçanta dhe thelbësore për veprën letrare artistike. Pika qendrore e trajtimit, siç shenjohe në titull, është *Strategjia e kuptimit*. Eseisti Rugova merret me shpjegimin, definimin e lidhshmërinë e strategjisë dhe të kuptimit.

Interesimi i autorit për këto fenomene është manifestuar në diskurs eseistik. Pra, Rugova bën përpjekje që, përmes leximit eseistik, të diskutojë problemet që kla objekt. Zgjedh këtë metodë dhe këtë diskurs për të qenë sa më i hapur në interpretimin e kategorive të zgjedhura. Eseja këtu del në formën më të përsosur, duke e ditur se autori i saj flet me vetëdijen e kritikut të madh. Po ashtu ajo pasurohet nga refleksionet e teorisë frënge dhe të teorive të tjera me ndikim, të cilat zotërohen nga autori. Kështu që, edhe një ese e shkurtër, e shkruar nga Ibrahim Rugova, na bën të ditur se ai është një autori sistematik, i cili tekstin e vështron dhe e diskuton duke e shqyrtuar nga çdo aspekt dhe duke u mbështetur në disa disiplina.

E theksuam se në thelb të esesë së Rugovës rri kërkesa për shqyrtimin e “strategjisë” dhe të “kuptimit” që lidhen si “strategji e kuptimit”. Në këtë vijë shpjegimi, shohim si pikënisje ta këtë studiuesin frëng, Pierrin, i cili thoshte se: “Kuptimi po vdes”!, se kuptimi po bie viktimë e ‘strategjisë’ së fshehur!<sup>50</sup> Për Rugovën, strategjia duhet kuptuar si mekanizëm, rregullator i kuptimit dhe i kuptimeve, i shfaqur në forma të ndryshme dhe të shumta. Ai strategjinë e shikon të lidhur ngushtë me kuptimin, për krijimin e kuptimeve të veçanta dhe të caktuara. Në këtë plan, Rugova flet për dy lloj strategjish: *strategjinë negative* dhe *strategjinë pozitive*.

Sa i përket strategjisë negative, Rugova pajtohet me Pierrin se ajo po bjen viktimë e sistemit qarkullues dinamik të shoqërisë bashkëkohore. Me strategji negative kuptohet ajo që ka domethënie sociale, të organizmit të fshehur e të hapur social, e cila bëhet me qëllim, krijohet nga trustet e ndryshme ideologjike dhe studiuesi ynë e quan tjetërsim i strategjisë, i marrëveshjes, i konvencës për të nxjerrë e fuqizuar veprimin. Për zbulimin dhe çlirimin nga kjo strategji, Rugova i konsideron si shpëtimtare linguistikën dhe semiologjinë, por edhe rezultatet e Marksit dhe psikanalizën e Frojdit. Kështu, “semiologjia dhe sociolinguistika vërejnë se në sferat e

---

<sup>50</sup> Ibrahim Rugova: “Strategjia e kuptimit”, Faik Konica, Prishtinë, 2005, f. 13.

fshehura të gjuhës, të komunikimit, ekzistojnë regjione ku vendoset strategjia negative, e cila përmbahet nga çdo ligjëratë, apo fjalim, që, siç vëren Jakobsoni, kanë për qëllim të pushtojnë, të bindin, të shtrojnë, të krijojnë ithtarë”.<sup>51</sup> Për të dalë nga ky rreth i negativitetit, Rugova thekson diskursat që kanë të bëjnë me të vërtetën e përgjithshme. Këtë procedurë e konsideron kthim drejt strategjisë pozitive, qëllim i së cilës është humanizmi dhe *vërtetësimi i kuptimit*.

Strategjia pozitive ruhet vetëm në art dhe në letërsi. Ajo i afrohet ritmit të natyrshmërisë së ekzistencës, sepse është e çliruar nga ndikimet ideologjike. Bartës kryesorë të saj në art Rugova e konsideron *poetikën aplikative*. Dhe, në këtë rast, strategjia (pozitive) del si element thelbësor i poetikës. “Kështu poetika interpretuese, gjithnjë tenton t’i afrohet, të zbulojë poetikën krijuese, apo së paku të jap kuptime të përafërta me të, të kërkojnë kuptimet e dhëna, kuptimet e krijuara në një vepër, që vështirë mund të jenë ekuivalente me to”.<sup>52</sup>

Pas zbërthimit të fenomenit të strategjisë, Rugova kalon në interpretimin e kategorisë tjetër, *kuptimit*. Kuptimin e vështron në raport me strategjinë, duke folur në mënyrë të hapur dhe duke e diskutuar, gjë që është brenda natyrës së esesë. Pikëtakime në këtë aspekt ka me Jungun, të cilit edhe i referohet parimisht në planin e interpretimit të kuptimit.

Marrë në këto logjikë, Jungu çështjen e kuptimit e shqyrton në planin gnoseologjik, do të thotë si çështje shkencore, për të cilën Rugova i jep të drejtë, sepse kuptimin e koncepton si kategori të njohjes. Ky i fundit, insiston edhe në vështrimin ontologjik të kuptimit. Këtu ka parasysh teorinë e tij për veprën artistike si qenie shpirtërore e produkt intelektual dhe gjithashtu kërkon që kuptimi të shqyrtohet në aspektin aksiologjik, për të parë vlerën e saj në procesin e ekzistimit.

Për të pasqyruar më mirë konceptin e kuptimit, Rugova sqaron se krijuesi nuk duhet të mendojë thjesht për kuptimin, sepse vetë ai proces është nisur nga njëfarë kuptimi që të prodhojë kuptime të tjera. Kështu, duke iu përmbajtur parimit që një vepër të jetë sa më shumë artistike, të menduarit deklarativisht mbi kuptimin e shihet si humbje të vlerës artistike. Ai kërkon që në procesin e krijimit, krijuesi të kujdeset për *strategjinë* dhe për vendosjen e punkteve poetike. Do të thotë, nga prodhimi i kuptimit del strategjia dhe punktet poetike dhe nga këto pasurohet ekzistenca. Shkurt, strategjia element si prodhues e krijues bëhet kusht për krijimin e veprës artistike. Vepra artistike krijohet nga kuptimi (në aspektin fenomenologjik), i cili del si qëllim i fundit i veprës artistike. Idetë pra duhet të interpretohen përmes kuptimit, i cili është objekt i semantikës. Shkencën e semantikës Rugova e shikon të lidhur ngushtë me semiologjinë, e cila procesin e kuptimit e shpjegon përmes shenjzimit, si proces i prodhimit.

Pas theksimit të këtyre veçorive vlerësuese të kuptimit (përmbajtjesor), që përmban vepra artistike, Rugova shton se ekziston edhe kuptimi atributiv. Kuptimi përmbajtjesor është prodhim i organizimit, strukturimit, strategjisë së veprës

---

<sup>51</sup> Po aty, f. 14.

<sup>52</sup> Po aty, f. 15.

artistike, ndërsa kuptimi atributiv është ai që i atribuohet veprës, që del si mundësi semantike. Gjithë këtë Rugova e shpjegon në bazë të teorisë së Greimasit, sipas të cilit: “një tablo pikturë, një poezi nuk janë tjetër pos pretekste, ato nuk kanë tjetër kuptim - pos atij që ne ua japim”.<sup>53</sup> I bie se të gjitha kuptimet janë të mundshme dhe, pavarësisht prej vendit se ku e vendosim, çështja e kuptimit mbetet e tërësishme.

Të zakonshme në këtë fushë Rugova e konsideron problemin e cilësimit të kuptimit, do të thotë kuptimit të implikuar dhe atij që i japim ne diskursit artistik. Kështu, kuptimin e karakterizon si interesim të kritikës tradicionale, pasi merret me pyetjen: “Çka thotë vepra?”. Ndërsa, kuptimin atributiv e konsideron si objekt të kritikës bashkëkohëse, pyetja e të cilës është: “Ç’mund të thotë vepra?”. Nga kjo kritikë sheh interesimin e probabilitetit kuptimor, të cilën edhe e konsideron më kreative dhe pasuruese.

Kuptimin e implikuar dhe të atribuuar, Rugova e ilustron edhe me konceptin e denotacionit (kuptimi i parë) dhe konotacionit (kuptimi i dytë), të shkrimit të veprës. Në këtë plan mendon se kritika duhet ta kërkojë kuptimin konotativ të veprës, përkundër asaj që është natyrore e elementare, pra kuptimit denotativ. Për më tej, mendon se çështja e strategjisë së kuptimit qëndron në konotacionin e shkrimit të veprës.

Një element tjetër të rëndësishëm për konstituimin e kuptimit Rugova e konsideron *strukturën e thellë*, të koncepteve të Çomskit, e cila realizon ndërmjetësimin midis *sintaksës* dhe *semantikës*, pra tekstit letrar dhe kuptimeve të tij. Brenda strukturës së thellë kuptimet janë ende të padefinuara dhe bashkëjetojnë si supozime. Janë hapësira të cilat lejojnë mundësi të përmbushjes kuptimore, sipas Ingardenit, fushë e ekzistimit të konotacionit, i cili varet nga supozimi i kritikut apo i interpretuesit. Përveç që *strukturën e thellë* e konsideron rezultat të organizimit të tekstit poetik dhe të strategjisë, Rugova e shikon si metafizikë të veprës, e cila në eksplikim duhet të definohet, sepse ajo është e panjohur në ekzistencë. Nga ky formulim del se autori përfundimisht kuptimin e konsideron si rezultat të relacionit të objekteve, fjalëve e shenjzimeve të veprës letrare artistike, e cila ka objekt semantikën e kritikës.

“Kuptimi po vdes!, megjithatë ai ekziston, po të forcojmë strategjinë krijuese, e cila shton produktivitetin e tij. Letërsia dhe arti janë fusha më të përshtatshme, ku kuptimi mund të ekzistojë, të ringjallet, po se po, apo mund të mos vdes!”<sup>54</sup>

---

<sup>53</sup> Po aty, f. 21.

<sup>54</sup> Po aty, f. 25.

## REFUZIMI ESTETIK

Objekt trajtimi i esesë së njohur *Refuzimi estetik* të Ibrahim Rugovës është kategoria qenësore estetike dhe ontologjike letrare e mendimit estetik rugovian: *refuzimi*.

Refuzimi estetik është objekti, *Refuzimi estetik* është titulli i esesë, *Refuzimi estetik* Rugova e titullon krejt librin, për më shumë *Refuzimi estetik* është edhe titulli librit të fundit të kritik të këtij autori, i cili në vete ngërthen më shumë probleme dhe pikëpamje të *interpretuara*. Ndodh kështu, meqë Rugova e zgjedh esenë si formën më të hapur për t'i shprehur pikëpamjet e veta (të cilat ndikohen nga shkollat dhe metodat kritike evropiane). Këtu ai i interpreton më së gjeri leximet e shumëfishta, duke i teorizuar sipas metodës së tij.

Konceptin *refuzimi estetik* Rugova e përkufizon parimisht, duke i analizuar veç refuzimin e veç estetikën. Ai thekson se refuzimi është mospranim i asaj që të imponohet dhe se kjo varet nga qëndrimi personal dhe ai i përgjithshëm. Në këtë logjikë, refuzimi realizohet në aporinë e pazgjidhshme të raportit trihotomik imponimi-pranimi-refuzimi. Përmes refuzimit, çlirohem nga presioni apo bëhemi viktima të tij. Rugova praktikisht i sheh dy zgjidhje: *po* ose *jo*, me rrugë të ndryshme te realizimit. Refuzimi, këtu shpjegohet si kundërshtues i imponimit.

Koncepcioni rugovian i imponimit zgjerohet kur theksohet se njeriu në jetën e tij, në jetën kolektive, gjendet midis përfaqësueses dhe ekzistueses. Imponimi bëhet më i ndërlikuar, kur gjendet në kuadër të përfaqësueses, sepse njeriut ekzistuesja i largohet për disa shkallë, mendon Rugova, rrugë kjo që çon në ndërtimin e demokracinë. Rugova e kërkon demokracinë në letërsi, ndërsa demokracia nënkupton jo imponimin, por ofrimin e përfaqësueses dhe ekzistueses, procese që ofrojnë lindjen e zgjidhjes së lirë, përcaktimin e individit në formë të lirë midis asaj që imponohet dhe të refuzimit, që, sipas Rugovës, arrihet përmes formës së *plebshitit* individual, *referendumit* individual dhe kolektiv. Idenë për plebshitin si formën më të përshtatshme, e ndërton mbi argumentin e Ciceronit, i cili thoshte se duhet dhënë argumente të arsyeshme për të bindur apo refuzuar kundërshtarin sipas ligjeve apo artit retorik. Mendon kështu pasi që e sheh mundësinë e zgjedhjes së lirë thujse gjithmonë të manipuluar, sepse interesat e ndryshme e mbysin zgjedhjen e lirë, individin, e pa individ nuk ka kolektivitet stabil e të drejtë, përforcon mendimin Rugova. Si zgjidhje të problemit e konsideron *consensusin*, formën më të përshtatshme për të arritur një baraspeshë të mendimit të lirë, si dhe mundësisë më

të madhe për largimin e manipulimit.

Pasi e teorizon kontekstin e refuzimit, realizimin e tij në apriorinë e pazgjydhshme të raportit trihotomik, pra si formë në të cilën është i mbërthyer vetë njeriu, Rugova e shqyrton këtë apriori në planin e artit dhe të letërsisë. Do të thotë, kalon tek esenca, te refuzimi i letërsisë dhe e paraqet refuzimin human si burim të refuzimit të letërsisë. Në këtë aspekt, duke iu referuar Bartit, letërsinë si fryt të realitetit, e shikon të vendosur në aporinë e imponimit-refuzimit.

Në raportin e letërsisë me botën dhe me njeriun, Rugova refuzimin e shikon dhe e analizon në raport me letërsinë dhe me politikën. Në këtë kontekst, refuzimin më të madh të saj e konsideron *refuzimin estetik*, që realizohet me mjetet e letërsisë: satira, sarkazmi, grotesku, ironia e angazhimit, që bëjnë që letërsia ta refuzojë imponimin. Kjo do të thotë se refuzimi estetik e kërkon letërsinë si vlerë dhe funksionin e saj si qenësi dhe jo si letërsi në funksion. Prandaj, mendon Rugova, letërsia pa mjete të shoqërisë, politikës, refuzon duke *ignoruar* dhe forcuar *dignitetin*, si kategori të përgjithshme. Duke u nisur nga ky parim, ai mendon që duhet bërë dallimi midis pushtetit dhe politikës në letërsi, që e quan politizim të saj. Këto dy kategori, pushtetin dhe politikën i dallon si kategori pasuruese për letërsinë. Në këtë kontekst i thekson tragjeditë antike dhe ato të Shekspirit, pastaj si letërsi të politizuar thekson vepra të socializmit tradicional dogmatik etj., por Rugova e kërkon qenësinë e letërsisë, qenësinë estetike dhe jo letërsinë e angazhuar, jo letërsinë në funksion, por funksionin estetik të saj, që del nga qenësia estetike. Rugova, gjithëherë në tekstet teorike, ka kërkuar elementin estetik në art dhe në letërsi, dhe të qenies së objektivuar artistike. Edhe vetë metodën estetike e ka diskutuar në raportin trihotomik: idealiteti-realiteti-arti, ashtu siç e ka diskutuar refuzimin në raportin trihotomik: imponimi-pranimi-refuzimi.

Duke e vlerësuar qenësinë e veprës letrare, Rugova e thekson problemin e estetikës dhe të politikës, për të parë konfliktet midis artit dhe pushtetit. Në fakt, këtë polemikë e vëren që nga vepra *Politeja* (Qyteti, Shteti) e Platonit. Duke e lexuar titullin e veprës së Platonit si diçka e përgjithshme, si “gjë” publike e hapur, mendon se u ndërtuan raportet e precizuara në teorinë estetike, si arti-politika, arti-ideologjia apo estetika-politika. Në të gjithë diskursin vërehet pikëpamja se arti nuk është i një, por i të gjitha shoqërive, sepse ngrihet përmes refuzimit dhe aprovimit estetik. Përgjithësisht Rugova mendon se një shoqëri e caktuar nuk mund ta ketë artin e vet, por mund ta ketë politikën e vet.

Në këtë logjikë, për krijimin dhe domosdoshmërisë e refuzimit estetik, Rugova shtron edhe problemin e vënies nën kontroll të prodhimit shpirtëror, të letërsisë, që e konsideron si fenomenin më të dëmshëm për lirinë e autorit. Kësaj forme të dëmshme ia gjen fillet në Antikw, duke vijuar në epokën moderne, me autocensurën e Sartrit, e më tej. Këtu për shpëtimin e krijimit letrar, ai shtron kërkesën për domosdoshmërinë e refuzimit estetik.

Diskutimin për qenësinë estetike Rugova e orienton edhe në raport me “shkrimtarët e oborrit”. Është pra një çështje tjetër, që autori e konsideron me

thellim të madh. Ai e vështron përgjithësisht qenësinë estetike, duke e parë se si kanë funksionuar shkrimtarët në oborre mbretërore. Në kontekstin e shkrimtarëve të oborrit, e dallon letërsinë si faktografi dhe letërsinë si letërsi. Faktikisht dallon letërsinë që e kanë prodhuar shkrimtarët e vërtetë, që edhe kanë punuar për oborrin mbretëror, me shkrimtarët që kanë punuar vetëm për këtë të fundit. Fenomenin e parë e konkretizon me Diogjenin, Gëten, Gojën etj. Ndërsa në historinë e kulturës shqiptare, duke ditur se nuk ka pasur oborrin e vet (prandaj as “shkrimtarët e oborrit”), e konkretizon me Gjergj Fishtën, i cili gjendej me formim në oborrin kishtar. Fishta, sipas tij, arriti të krijojë vepra me vlerë, që nuk përkojnë shumë me oborrin që i takonte. Në këtë vijë përmend edhe Naim Frashërin, i cili, edhe pse i përkiste sektit të bektashinjve, vepra letrare e bëri Poet kombëtar, të Rilindjes kombëtare. Me këtë vështrim Rugova e ngre konceptin e qenësisë estetike si mbizotëruese mbi veprën. Kur estetikja është në vepër, e bën autorin të dalë fitimtar edhe në rolin e prijësit të popullit, del kështu mendimi tjetër i Rugovës. Do të thotë, shkrimtarët e mëdhenj bëhen edhe prijës popullorë, por mbeten shkrimtarë të mëdhenj. Njëherësh ai vlerëson se në disa raste letërsia dhe politika mund dhe duhet të bashkëpunojnë. Në këtë rrjedhë ndjek edhe rrugën e Sartrit, për *shkrimtarin e angazhuar* dhe *letërsisë e angazhuar*. Thekson konceptin sartian për shkrimtarin e angazhuar në jetën e përditshme edhe si intelektual dhe të bëjë një letërsi të angazhuar në kuptim më shumë filozofik dhe shpirtëror, se sa praktik social.

Kujtojmë se Refuzimin estetik Rugova e kurorëzon me *qenësinë estetike*, rpra e vështron në plan të gjerë, me të gjithë faktorët që lidhen me artin dhe letërsinë, në të gjitha rrethanat që është zhvilluar, duke përfunduar se vendimtare është vepra dhe esenca e saj, qenësia estetike e saj. Vepra me qenësi estetike ka shtuar edhe jetëgjatësinë e shkrimtarëve, që e kanë krijuar. Do të thotë, këta shkrimtarë kanë qenë me ndikim më të madh, karshi atyre veprës së të cilëve u ka munguar qenësia estetike, madje edhe në raport me politikën-pushtetin, arti ka pasur ndikim më të madh. Përgjithësisht, me qenësi estetike kuptojmë frytin e karakterit të lirë e të gjerë të letërsisë. Në këtë kontekst, Rugova mendon se ndikimi i veprimit praktik të De Radës dhe Naim Frashërit është arritur nga qenësia e thellë estetike. Përfundimisht, Rugova konkludon se me anë të refuzimit estetik letërsia ndikon në vetëdijen kulturore të kohës, ndërsa kjo në vetëdijen dhe në veprimin politik.

Një çështje tjetër e rëndësishme në esenë e Rugovës, e shqyrtuar në vazhdimësi, është raporti arti-politika. Në bazë të vështrimit të rrjedhave dhe rezultateve që kanë prodhuar, shikuar sipas pikëpamjes së Rugovës, letërsia apo arti dhe politika janë dy kategori të kundërta, të ndara, të ndryshme në mjetet e formimit dhe të veprimit. Rugova shton se gjithmonë politikë apo pushtet më i mirë ka qenë ai pushtet që nuk e ka kufizuar dhe nuk i është mbivënë letërsisë. Është e rëndësishme të theksohet se letërsia për nga natyra e vet ka vlerë mbijetuese dhe politika vlerë aktuale.



Në mbyllje të tekstit, Rugova hap edhe një çështje praktike dhe teorike, duke thënë se aty ku rreziku politik nuk është i pranishëm apo i vogël, refuzimi estetik i letërsisë është më i madh, autonom dhe veprues. Sipas vlerësimit rugovian, sot është bërë legjitime vetëdija se imponimit të jashtëm që i bëhet artit dhe letërsisë, duhet kundërvënë me refuzimin estetik. Refuzimi estetik ndikon edhe në rendin historik kulturor, do të thotë vë dhe i ruan bazat që letërsia të mbetet letërsi e pastër, duke ndikuar në pushtet dhe në shoqëri. Kështu ndërtohet, rritet dhe shtrihet fenomeni i quajtur *refuzim estetik*.

**Pjesa e tretë**  
**KRITIKA LETRARE**

## KRITIKA LETRARE

### I. KRITIKA LETRARE

(Kërkimi, vlerësimi i kuptimeve dhe i qenësisë estetike)

Në këtë pjesë të punimit do të shqyrtojmë dy veprat e njohura të Ibrahim Rugovës, *Strategjia e kuptimit* dhe *Refuzimi estetik*, të cilat sipas ndërtimit formal janë të ngjashme dhe e dyta e vijon të parën. *Strategjia e kuptimit* ka këtë strukturë: Ese, Kritikë dhe Teori e poezisë shqipe në Jugosllavi, ndërsa *Refuzimi estetik*: Ese, Kritikë, Studime, vështrime dhe Teori e kritikës.

Vështrimi ynë përqendrohet në pjesën e dytë të librave, mbi *Kritikën*. Rugova këtu analizon vepra konkrete të autorëve shqiptarë bashkëkohorë (Ali Podrimja, Rrahman Dedja, Beqir Musliu, Eqrem Basha, Sabri Hamiti, Abdullah Konushevc, Agim Mala, Azem Shkreli, Fahredin Gunga, Musa Ramadanit, Teki Dërvishit, Jusuf Buxhovi, Mehmet Kraja, Ibrahim Kadriu, Qerim Arifi), heton fenomenet letrare, temat letrare të poezisë dhe prozës shqiptare bashkëkohore. Do të thotë, Rugova vlerëson autorë të ndryshëm, gjini letrare të ndryshme, por të një kohe.

Rugova, siç e thekson në parathënie, i shkruan këto tekste për të forcuar *vetëdijen letrare*, duke bërë vështrimin dhe vlerësimin e atyre autorëve që iu desh ta mbajnë letërsinë ndër ne. Ai insiston në krijimin e hapësirave të krijimit, duke e konsideruar krijimin si shkallën më të lartë të vetëdijës humane dhe kulturore të një ambienti krijues.

Rugova, duke qenë njohës i teorive moderne të letërsisë, nuk e praktikon vetëm një metodë të caktuar. Ndërsa, duke qenë ndër themeluesit dhe aplikuesit e strukturalizmit dhe të semiologjisë në dijen shqiptare (duke lexuar dhe mësuar metodat interpretuese të Rolan Bartit, Zherar Zhenentit, Ferdinand de Sosyriti etj.), përqendrohet në tekstin letrar, duke e quajtur fakt letrar. Në bazë të qasjes që u bën autorëve dhe veprave të tyre, Rugova ka vetëdijen se çdo vepër duhet vlerësuar si një tërësi e pavarur, duhet të zbulohet struktura e fenomenit të saj dhe ajo që një vepër e bën artistike.

Rugova është i mendimit se natyra e kritikës letrare është e hapur dhe, për më tepër, si eseist që është, pavarësisht formës që përdor, do lirinë e tekstit.

Rugova merret, siç e thekson vetë, jo me çështjet anësorë të veprës, por me ato çështje që e bëjnë krijimin letrar vepër në vete, me ato çështje që krijojnë qenësinë e veprës. Përqendrohet në metodat strategjike dhe refuzuese që përdorin

autorët, për të interpretuar kuptimet dhe efektet estetike që prodhojnë veprat e tyre. Pra, Rugova i interpreton kuptimet dhe qenësinë estetike përmes kategorive dhe njësive kritike.

Forma e kritikës letrare të Rugovës në këto dy vepra është kritika recensioniste, që karakterizohet me vlerësime dhe analiza të shkurta të veprave të sapobotuar dhe të pakomentuara më parë. Rugova bën një analizë tekstore, duke argumentuar, parashtruar dhe interpretuar probleme. Kritika e tij motivohet nga parimi se vepra duhet lexuar dhe njohur mirë, pastaj duhet vlerësuar. Kërkimi i tij është vlerësim i veprës letrare, të cilën ai e konsideron *qenie* që buron nga imagjinata e autorit. Kur kemi parasysh që kritiku ynë letërsinë e lexon si një *differentia specifica*, del se edhe veprat këtu i vështron si fenomen, që lexohet pavarësisht.

Krahas hetimit të kuptimeve dhe qenësisë estetike, pra kuptimit poetik dhe kuptimit të temave, që është kërkesë esenciale për Rugovën, ai kërkon edhe teknikat poetike, kompozicionin, figurat, domethëniet retorike, idetë dhe pikëpamjet, e autorëve si veçanti.

Kritika për Rugovën jep kuptime, kritika për të është lexim personal, andaj vlerësimi për veprat e autorëve të zgjedhur titullohen me kreativitet nga ai. Titulli i secilit shenjon elementin më të rëndësishëm që ka vlerësuar Rugova tek autorët e të cilat i konsideron të arritura në tërë letërsinë shqipe. Për ilustrim shohim titujt: te *Strategjia e kuptimit* kemi - *ironia poetike, teksti simbolik, abstraksioni poetik, eidoritmia poetike, vetëdija e ligjërit poetik, ironia konkrete-vdekja e metaforës, ideja e tjetërsimit, vetmia objektive*, ndërsa te *Refuzimi estetik* dalin - *poezia e efektit estetik, ashpërsia e të folurit poetik, sublimimi i thënies eugjenike, paradoksi heretik, imuniteti autokton, reminisencë psikohistorike, realizimi i vazhdimësisë, vizioni nokturian i botës, kuptimi i "rënies"*.

Mund të themi se kritika e Rugovës, e praktikuar këtu, ka ndërtuar një pamje kërkimi e vlerësimi. Pra, duke menduar se natyra e kritikës është e hapur dhe se metoda është dije dhe kërkim, Rugova vështron zhvillimin tematik, teorik dhe ideor të poezisë shqipe. Pavarësisht se në pjesët vlerësuese të librave Rugova bën një kritikë recensioniste, ai prapë bën një kritikë më të hapur, më dialoguese, kritikë e cila dallon nga kritikën e rëndomta recensioniste.

Rugova përherë i ka lënë çështjet të hapura, për të vërejtur jo vetëm ç'thotë vepra, por edhe ç'thotë dhe si e thotë kritiku.

## II. STRATEGJIA E KUPTIMIT

*Strategjia e kuptimit* e Ibrahim Rugovës strukturohet në tri pjesë: *Ese, Kritikë* dhe *Teori e poezisë shqipe*. Edhe në këtë rast do të flasim për pjesën e dytë të librit, në të cilën bëhen interpretime të veprave bashkëkohore shqipe.

Rugova ka bërë përzgjedhje të autorëve bashkëkohës, duke vështruar fenomene të krijimit letrar, të poezisë, duke kërkuar strukturat, qasjen dhe metodën e krijimit. Pra, objekt kërkimi janë autorët bashkëkohës, veprat poetike të tyre, që i dallojnë fenomenet e ndryshme, për të cilat Rugova bën interpretimet e para.

Rugova bën kritikë recensioniste për autorëve si: Ali Podrimja, Rrahman Dedja, Beqir Musliu, Eqrem Basha, Sabri Hamiti e në mënyrë përgjithësuese edhe për Abdullah Konushevcin, Agim Malën etj., duke i parë si vijues të të parëve, krahas talentit dhe origjinalitetit të ideve. Veprat e tyre, kritiku i karakterizon për nga *ironia poetike, teksti simbolik, abstraksioni poetik, eidoritmia poetike, vetëdija e ligjërimet poetik, ironia konkrete-vdekja e metaforës, ideja e tjetërsimit, vetmia objektive*. Më konkretisht, duke iu referuar edhe titullit *Strategjia e kuptimit*, shohim se Rugova, në veprat që përfaqësojnë autorët e lartpërmendur, analizon e përshkruan poezitë, për të nxjerrë kuptimin e tyre. Ai kërkon pjesëmarrje në kuptimin e tyre, duke ndjekur parimin që edhe ai të bëhet krijues mendimi mbi ato që zbulon brenda tekstit që lexon. Duke i lexuar poetët bashkëkohës, ai mendon se mund të prodhojë kuptime të vetat mbi tekstet e tyre poetike.

Rugova konsideron se teksti poetik i poezisë bashkëkohëse nuk mund të lexohet e të kuptohet si ai klasik. Ai i referohet disa teoricienëve dhe analistëve që e bëjnë këtë lloj klasifikimi: tekstet poetike (letrare) klasike i quajtën të *lexueshme* (nga frëngjishtja *lisible*) dhe ato moderne bashkëkohëse i quajtën të shkrueshme (po ashtu nga frëngjishtja *scriptible*).<sup>55</sup>

Mendon se veprohet kështu për arsye se në tekstet klasike udhëhiqemi nga autori (shkrimtari), do të thotë ne nuk mund të kuptojmë, edhe po deshëm, më shumë se ç'na thotë ai, ndërsa, në tekstet bashkëkohëse ndihemi të lirë, mund të nxjerrim kuptime të ndryshme nga i njëjti tekst. Me një fjalë, teksti klasik është i kuptueshëm, që do të thotë se lexuesi është pasiv, ndërsa teksti bashkëkohës është i shkrueshëm, sepse gjatë leximit na aktivizon.

Para se t'i vështrojmë pikëpamjet e Rugovës për poezinë e autorëve objekt, po i theksojmë shkurtimisht disa elemente bazë që studiuesi ynë i koncepton si arritje të mëdha për poezinë shqipe në përgjithësi.

Kështu, poezia e *Podrimjes* mendon se arrin të pasqyrojë traumatikën e botës në vazhdimësi dhe tjetërsimin saj si fenomen në kohën dhe inflacionit të vlerave të fjalës, të mendimit dhe të veprimit. Por, ndaj tyre poeti reagon edhe poetikisht, me mjaft egërsi.

Tekstin e poezisë se *Dedajt* vlerëson se e shquajnë simbolika dhe metaforika, të cilat, duke u gërshetuar ndërsjelltas, përbëjnë një sistem interesant poetik, i cili nuk është i imponuar, po i krijuar sipas logjikës së vetë gjërave dhe të fenomeneve të krijuara e të zgjedhura nga ana e poetit. Autorin e kësaj poetike e emërton si një nga poetët e rrallë të ne, që me botëkuptim e vet në perceptimin e fenomeneve poetike, arriti të krijojë tërësinë e vet të bindshme poetike.

---

<sup>55</sup> Shih "Teori dhe kritikë moderne".

Metafizika e ekzistencës që del nga e gjithë vepra poetike e *Musliut*, me një sinonim tjetër, synon të bëhet filozofi e historisë, e qenies sonë në kohë-e-në-zbrazëtirë. *Bukurija e zezë* t Rugova vlerëson se tij e konsideron si një ndër veprat më të mira të poezisë sonë, me të cilin mendon se krijohet një objektiv i ri në poezinë tonë. Këtu e shquan për abstraksionin e lartë poetik si forcë dhe mjet qendror i poezisë moderne e bashkëkohëse.

*Bashën* e vlerëson si poetin e rrallë, i cili nuk e imponon mendimin, qasjen e vet poetike, që me librin e tij ka vërtetuar praninë në poezinë tonë dhe njëherësh e ka vërtetuar artin e vet poetik, frymën e vet poetike në nivel të lartë.

*Hamitin* e karakterizon dhe e lartëson për mënyrën e re të shkrimit. Në përgjithësi elementet e tij të formësimit poetik i konsideron si pasuri të poezisë sonë, përveç të fushës së vet poetike. Poezinë e tij e vlerëson me përmbajtje të thellë semantike, në të cilën përzihen dhe përthyhen relacionet, në konceptin e njohur e të përhershëm: jeta është art dhe arti jetë.

Një këtë vështrim të poezisë bashkëkohëse, duke analizuar poetët kryesorë të kësaj poezie, duke u pozicionuar më hapur në vlerësimet e tij, një kapitull të shkurtër Rugova ua kushton poetëve më të rinj, poezia e të cilëve paralajmëron elemente të reja. Është fjala për Agim Malën, Shaip Beqirin dhe Abdullah Konushevcin.

Në vijim do të flasim në mënyrë të veçantë për pikëpamjet dhe praktikën kritike të Rugovës për autorët e përzgjedhur. Rugova titujt e poezive i bën shenja për ta lexuar dhe interpretuar tërë poezitë. Duke ditur se leximet e tij janë kritike dhe vlerësuese dhe duke ditur se autori kërkon kuptimet e reja, po ndjekim sistem e tij të vlerësimit.

## II. 1. Ironia poetike (Ali Podrimja)

*Torzon* e Ali Podrimjes Rugova do ta shqyrtojë si përkujtim, vepër që pas një distance kohore prej dhjetë vjetësh është bërë *fakt letrar* në kuadrin e poezisë së autorit dhe në kuadrin e poezisë shqipe bashkëkohore. Përveç kësaj, Rugova mendon se me këtë vepër, Podrimja arrin standardizimin e poezisë së tij, të tekstit të tij poetik.

Rugova analizën do ta zhvillojë në dy drejtime: në atë të strukturës së tekstit poetik dhe në atë semantik. Në planin drejtimin e parë, Rugova mendon se poezia e tij merr formën stabilile në vetë strukturën e dhe në kuptimin e saj. Vëren tendencën që çdo poezi e veprës të jetë një poezi në vete, një mikrobotë, që ekziston dhe flet vetë. Formësimin poetik të *Torzo* e sheh të afruar me fushën e arteve të Volumenit, skulpturës dhe të arkitekturës, do të thotë çdo poezi synon të qëndrojë si figura skulpturale në hapësirën e kuptimit. Ndërsa, sa i përket planit të dytë, Rugova thekson se semantika e figurës *torzo*, etimologjikisht dhe realisht, sjell kuptimin

burimor të figurës së dëmtuar, gjymtuar dhe të cinguar. Kështu, *torzon* e sheh të ngritur nga procesi i *torzionit*, i deformimit maksimal të figurës njerëzore. Pra, semantika e *torzos* ngrihet mbi konceptimin poetik që do të japë fotografinë e njeriu dhe të botës *torzo*. Rugova e vlerëson poetin që këtë figurë e percepton mjaft qartas artistikisht, si figurë të llojit *preptum mobile* nëpër kohë. Kur e shqyrton idenë e *torzos*, konkludon se ajo materializohet nga *torzioni* i botës së njeriut. Çelës për të lexuar *torzon* Rugova e konsideron *brengën*, e cila, sipas tij, për t'u realizuar, përdor ironinë. Ironia ngrihet nga revolta e njeriut.

Në gjithë këtë, Rugova si faktor të rëndësishëm në krijimtarinë poetike e shikon relacionin njeriu-bota. Këtu e gjen te realizuar qëllimin që të kërkohen elementet qenësore të qenies njerëzore në dy fusha: njeriu si ide, si mundësi, dhe njeriu si realizim, si produkt shoqëror dhe human. Kësisoj, ai thekson se këtu mbizotëron ideja mbi njeriun, kërkesa e tij që të realizohet plotësisht.

Vlerësimi i Rugovës shkon më tej, por ai fillimisht e shpjegon semantikën e fjalës *botë*, e cila korrespondon me shoqërinë, me bashkësinë njerëzore, duke e quajtur qenësi, realizimin e së cilës e bart qenia njerëzore, por që në poezi merr kuptimin shenjzues-simbolik dhe del si objekt-simbol. Semantiksht, njeh botën si fushë të realizimit të njeriut, ndërsa për regjistrin semantik të poezisë së Podrimjes mbi botën thekson: *botën* me sëmundje si fenomen, me dhimbje, e ndotur, bota me Kalin e Trojës, me macet e zeza, me Perëndi të tipave të ndryshëm etj. Kur shqyrton mesazhin e kësaj poezia, Rugova përcakton se ai është imazh me mesazh negativ, pra *torzoja* ka ngarkesë semantike negative.

Rugova çmon te Podrimja figurën ironike dhe tragjike, e cila mendon se është realizuar jo vetëm në poezinë e tij, por edhe në poezinë bashkëkohëse në përgjithësi. Rugova ka zgjedhur të ilustrojë me këto vargje të Podrimjes, për ta parë më afër figurën poetike:

*njoh një njeri  
lakuriq shëtit nëpër botë*

*në vend të kravatës  
gjarprin lidh për qafe*

Pra, është zëvendësimi apozicional i *kravatës* më *gjarprin* që kritiku e konsideron si figurën më të thellë ironike-tragjike, figurë të cilën e konsideron kuintesencë të kuptimit artistik. Në shqyrtimin e kësaj poezie, Rugova vlerëson nga një kënd më i hapur, duke parë njeriun në fushën e bardhë, lakuriq fizikisht dhe shpirtërisht, bars me shkretëtirën. Vlerëson më hapur, duke thënë së ngjyra e bardhë shenjon asnjësinë e njeriut, ku mundësia e realizimit të tij, sipas filozofit dhe kritikut francez Bart, do të gjendet në *shkallën zero të ekzistimit*, thekson Rugova.

Objekt vështrimi poetik të Podrimjes e konsideron gjysmëbotën, gjysmënjeriun që e sjell ai, kërkesë e cila përmbushet me mungesë të realizuara nga universalitete poetike, që dalin nga sfera të ndryshme të ekzistencës.

Edhe një herë po theksojmë se analizën e poezisë së Podrimjes autori do ta zhvillojë në dy drejtime, duke dhënë dy tipa vlerësimesh të idesë dhe të raportit të poezisë me realen/realitetin. Tipi i parë jep idenë e mosrealizimit të saj, që duket gjithmonë më interesante, dhe tipi i dytë jep realen që shpesh nuk kënaq dhe sjell zymtësi e brenga të tjera. Por, këto dy fenomene të *Torzo* Rugova nuk i gjen të ndara në pikënisje, por të kompletuara për nga *tendimi*, koncept ky që përfshin tërë mendimin bashkëkohës teorik mbi këto fenomene.

Në bazë të gjithë kësaj, autori përfundon se poeti, duke dhënë dhe duke analizuar poetikisht *torzon* e gjithëhershme të ekzistimit të botës dhe të njeriut, arrin në konstatime të hidhura, që i metaforikon me emërtimin *Torzo*.

## II. 2. Teksti simbolik (Rahman Dedaj)

Kërkimin kritik për Dedajn Rugova e fillon duke krahasuar tekstin klasik poetik dhe atë bashkëkohës. E theksuam më lart mendim e autorit se teksti poetik i poezisë bashkëkohëse nuk mund të lexohet dhe të kuptohet si ai klasik. Ky ndryshim nuk del nga vlera që kanë poezitë, por nga metoda e krijimit. Do të thotë, Rugova nuk e konteston vlerës e asnjërës, por i klasifikon ato, që të mund të hyjë më mirë në strukturat e skematizuara, që sjellin ato. Për të parë dallimin midis tyre dhe për të konkretizuar se si duket teksti simbolik, ai merr në shqyrtim dy autorë shqiptarë, me nga një dy poezi secilin: Rahman Dedaj me përmbledhjen *Balada e fshehur*, me poezinë *Fjala jonë*, si dhe *Luletë e Verësë* të Naim Frashërit, me poezinë *Gjuha jonë*. Si rezultat nxjerr se të dy vjershat i lidh një tematikë e përbashkët: *gjuha jonë*, por, me rëndësi në këtë kërkim është se poezitë dallojnë shumë për nga mënyra e thënies dhe për nga qëllimi. Kështu heton se poeti i Rilindjes flet mbi gjuhën si diçka kombëtare, të porealizuar në tërësi në jetën kombëtare, për kohën e atëhershme, pra kërkon që gjuha të vihet në komunikim aktiv, ndërsa poeti i sotëm arrin kuptim përmes simboleve, duke folur për gjuhën, për fjalën, jo në mënyrë deklarative, po në kuadër të një dialogu të hapur. Për të vërtetuar më mirë këtë dallim, kritikun thekson se poezia e Naimit është *kërkesë*, kurse ajo e Dedajt është një *aspekt filozofik dhe poetik mbi këtë fenomen* të realitetit njerëzor, pjesë e të cilit jemi edhe ne. Në këtë problematikë, Rugova më së shumti do ta theksojë se poezia e Naimit mund të merret nga të gjithë me po atë kuptim, kurse poezinë e Dedajt mund ta marrim në mënyra dhe kuptime të ndryshme, sepse poeti nuk e ka kufizuar thënien e vet poetike. Thekson qartas se në poezinë bashkëkohëse poeti nuk e kufizon thënien e vet poetike dhe ne kemi një liri dhe një angazhim më të madh, gjë që e kënaq lexuesin dhe e zhvillon mendimin dhe gjykimin e tij. Rugova e veçon tipologjikisht



poezinë bashkëkohëse për nga ndryshimi i proseedeve, të mënyrave të krijimit, lirinë e të menduarit. Ai edhe pikëpamjet teorike i ngre mbi letërsinë si *differenti specifica*, pra letërsinë si prodhim i veçantë, duke propozuar tekstin artistik dhe tekstin e hapur.

Për ta ilustruar tekstin simbolik Rugova ka zgjedhur tekstin poetik të Dedajt. Me tekst simbolik ai kupton poezinë e ndërtuar në sistemin e simbolikës, të kuptimit të objektivuar në shenja, të cilat shprehin konceptione të veçanta dhe marrin domethënie më të gjerë dhe më të zbatueshme. Këtë strukturë e sheh të realizuar në poezinë e poetit që shqyrton dhe thekson se pjesa më e madhe e poezisë së tij është e përbërë nga simbole të shumta, ku pushon të folurit e zgatur narrativ, ku merr forcë funksioni në kuadër të gjuhës poetike, fjalët shfaqen si objekte, si gjëra që marrin vlerën komunikuese dhe semantike brenda organizimit të tyre në varg dhe në poezi. Këtu autori ka parasysh se Dedaj simbolikën e vet e zhvillon edhe në kuadër të metaforikës së pasur, duke parë që simbolet marrin vlerë më të fuqishme në sistemin metaforik. Pos kësaj, shton se edhe metaforika e kësaj poezie del si rend i organizuar dhe jo vetëm i figurës poetike. Pra, sipas tij, metaforika gjendet në funksionin të cilin e mundëson gjuha poetike e jo vetëm figuracioni, siç e thotë teoria klasike e letërsisë.

Autori vështron dhe komenton disa simbole dhe fjalë-çelës që shfaqen rregullisht apo herë pas here në poezinë e Dedajt, siç janë: *rrashta, kafka, vasha, dashuria, dielli, drita, fëmijëria, era, hiri, shiu, buka, hëna sëmundja, epidemia* etj., pastaj lexon edhe metaforat: si: *guri i lashtësisë, unaza e verdhë, rëra e kujtimit* etj., për të shtuar se me këta shembuj mund t'i kuptojmë interesimet poetike të tij, që, në kuadër të tematikës, kanë funksionin e tyre adekuat, në pajtim me shprehjen dhe me kontekstin që na sugjeron teksti. Gjithashtu, thekson se kur analizohen simbolet e poezisë së Dedajt, flasim edhe për temat brenda të cilave ngrihen ato simbole.

### II. 3. Abstraksioni poetik (Beqir Musliu)

Në kritikën recensioniste, Rugova ka për objekt vështrimi edhe një poet tjetër dhe një poezi më ndryshe, është Beqir Musliu, me *Bukurija e zezë*, poezinë e të cilit kritiku do ta klasifikojë me elementin e abstraksionit kuptimor të të folurit poetik. Rugova mendon se ky element e ngre hapësirën poetike dhe e mposht elementin e hipertrofisë lirike dhe figurativitetin e drejtpërdrejtë, element i cili dominonte deri në shfaqjen e këtij poeti. Po ashtu, ky element poetik bën një lloj spastrimi ligjërimor të poezisë.

Që në krye të vlerësimit, Rugova sqaron se abstraksioni poetik në poezinë e Musliut është rezultat i imagjinatës së pasur dhe i operimit poetik në planin kuptimor. Abstraksionin poetik ai e shikon të realizuar në dy plane: përmes

inkuadrimit të disa termave abstraktë, të gjuhës abstrakte të emërtimeve poetike, dhe përmes një metafore abstrakte.

Autori shkon më tutje në karakterizimin dhe vlerësimin e poezisë së Musliut, duke e konsideruar titullin e librit si metaforë. Ai nisët nga koncepti estetik i të bukurës në art dhe në realitet dhe shton se poeti bën një përmbysje të kuptimit të saj, të së bukurës klasike, tradicionale. Do të thotë, me *Bukurinë e zezë* të Musliut afrohet koncepti modern mbi të bukurën, e cila shpesh merret si shenjë kobi, si element i tragjikes. Vazhdon mendimin duke thënë se çdo gjë i ka antipodet, se është bipolare, se mund të shpërnderrohet, të metamorfizohet. Ai e cilëson konceptin e së bukurës të kjo poezi si metaforë që përmban, përfaqëson dhe shpjegon kuptime e gjendje që kanë të bëjnë me referencën poetike. Kështu, ai thotë se metafora *bukuria e zezë*, metaforifikon situatën subjektive të subjektit poetik dhe atë të kontekstit objektiv të atij subjektiv. Lidhur me këtë, autori synon që të kuptohet edhe e kundërta e bukurisë, që nuk është e pavarur, e veçantë, po në thelb të saj. Çështjen e së bukurës në këtë vepër e sheh më shumë si vlerë etike, sesa estetike, mirëpo këto dy vlera Rugova gjithnjë i ka parë të funksionojnë së bashku, me forcë e me ndikim të barasvlershëm.

Duke folur për abstraksionin poetik të Musliut, Rugova e gjen atë të realizuar në planin e kohës dhe të hapësirës. Edhe vetë stukturimin e *librit* të Musliut e shikon të konceptuar në këtë mënyrë, do të thotë në dy pjesë. Në pjesën e parë kërkohen elementet e ekzistencës, ndërsa në pjesën e dytë ato kërkohen në planin e hapësirave e të kohës. Ajo që do të theksojë Musliu, sipas kritikut Rugova, është mungesa, zbrazëtia, që dimensionin e pestë të kohës e vëren vetëm si zbrazëti individuale dhe kolektive. Çiftin hapësira- zbrazëtia, autori vlerëson se në poezi merr formë mitike, por në librat e tjerë, heton se poeti prej kohës mitike kalon në disa probleme të kohës historike, të cilat do t'i kushtojnë më shumë kujdes rrëfimit deduktiv të gjërave dhe fenomeneve. Këtë prosede të Musliut Rugova e emërton *ritual poetik*. Argumenton mendimin duke thënë se raporti midis objektit poetik dhe subjektit poetik ngrihet në mënyrë induktive, si zberthim i formulave e konceptioneve poetike. Marrë në përgjithësi, *ritualin poetik* të kësaj poezie e koncepton si një model të kuptimit të origjinës së ekzistencës dhe të forcës së saj, disi të pashpjegueshme, dhe thekson se më vonë vetë poeti do ta quajë "magji", si proces brenda të cilit vepron forca e destinuar nga *natura naturans*. Shkurtimisht, *ritualin poetik* e konsideron si formë krijuese të këtij poeti, por mendon se brenda tij duhet të zbatohet ligji i seleksionimit, sidomos i atij poetik. Në këtë kontekst, Rugova vështron edhe një raport tjetër të *ritualit poetik*, që është ai i qëndrimit poetik ndaj poezisë, ndaj artit, e që e quan *metapoezi*.

Sa i përket poiesit të Beqir Muslit, Rugova përmbledh se në librin e tij vërehet përpjekja e zberthimit të kuptimeve në mënyrë lirike-simbolike, ndërsa sa i përket planit kuptimore, përmes *ritualit poetik* si prosede, e zbulon absurditetin historik, të historisë rikonstruksion, për të vendosur kontinuitetin mitik të ekzistencës.

#### II. 4. Eidoritmia poetike (Eqrem Basha)

Për Eqrem Bashën Rugova bën një vështrim të veçantë dhe më shumë ndalet te mënyra e zbatimit të ritmit poetik nga ana e tij. Rugova mendon se ritmi shndërrohet në kërkesë dhe realizim krijimi, karaktërsitikë që ai e emërton *ritmi* poetike. Konkretisht, autori flet për një dukuri interesante të kësaj poezie, pra ritmin poetik, nga i cili dalin imazhe, përfytyrime të shumta e të ndryshme. Pra, është kjo esenca që terminologjikisht e filozofikisht e përfaqëson *eidosi*. Prandaj, Rugova edhe e quan poezinë e Bashës *eidromi* poetike, që flet për aktivizimin e disa esencave, thelbësive të gjërave, të sendeve e imazheve të fshehura, që marrin formë ekzistence përmes ritmisë.

Në vështrimin e përmbledhjes poetike të Bashës *Polipët-ptikon*, Rugova mendon se planin kuptimor të poezisë e përfaqëson kërkimi i ekuivalencës midis *detit* dhe *botës* (si figura të gjera të ekszitencës), duke e konceptuar edhe si plan eidoritmik. Sa i përket çështjes artistike të poezisë, konstaton se një nga prosedetë qendrore dhe më efektive në këtë poezi është parodizimi i gjërave dhe i fenomeneve të botës. Parodinë, si element të satirës, këtu e nxjerr si rezultat të eidoritmisë së aktualizuar gjerësisht. Njëherësh parodinë e sheh të zbatuar nga autori jo në formë deklarative, por në planin eidetik, të rikrijimit të imazheve të reja, në bazë të atyre që tashmë janë lënë e që, përmes aktivizimit të tyre, tregohet se ato i kanë esencat dhe vlerat e veta. Ai e çmon parodinë në këtë poezi, duke e parë të dalë si kundërvënie dhe si mospajtim me njëfarë insistimi të paimponueshëm. Në këtë vijë të diskutimit, Rugova mendon se, pasi thuhet që ironia është një kundërvënie më e ashpër, për ndërrimet radikale, parodia është një insistim për të ndryshuar me arsye, nga një insistim në vepër.

Duke folur për këto probleme, Rugova, me të drejtë, e quan veprën e Bashës mesazh i paimponuar, pra autori nuk e imponon qasjen e vet poetike. Thekson se poeti krijon poezinë, i kërkon elementet që mund të hyjnë në *botën e poezisë*, të cilat në kontekstin poetik sjellin kuptimin e vet dhe marrin kuptime të ndërlidhjes së njësive. Vlerëson lart Bashën edhe për faktin që ai nuk insiston në ngritjen dhe funksionalizimin e elementeve poetike, por insiston në tërësinë poetike, në shpërndërrimin poetik të tyre. Faktikisht, ky krijim poetik thotë të duket sikur lojë, e që është lojë, ritëm, lëvizje kuptimore, zhvendosje e natyrshme e koncepteve, është *përqendrim* drejt *qendrës poetike*. Shquan pra Bashën për ritmin, të cilin e konsideron të rrallë në poezinë tonë bashkëkohëse, e shquan për botëkuptimin dhe aplikimin e ritmit që qëndron në bazë të *substancave të energjisë artistike e jetësore*, që shtyn lëvizjen e vazhdueshme të prirjes njerëzore për qarkullim, për veprim dhe për kuptim. Ky konstatim e shtyn drejt përfundimit se Eqrem Basha është *poet i lindur*, duke thënë që me natyrshmërinë e vet të krijimit poetik (pa imponim) krijon

fenomene poetike. Kështu që Rugova mendon se ajo që nuk imponohet dhe që nuk sforcohet, është më e fortë, më vepruese, më efektive dhe më e pranueshme.

## II. 5. Vetëdije e ligjërimit poetik: Formalizmi poetik (Sabri Hamiti)

Siç na e sugjeron edhe vetë titulli, kritiku Rugova këtu do të merret me veçorinë esenciale të poezisë së Hamitit, që është *formalizmi poetik*, veçori kjo që e përbën jo vetëm strukturën poetike, organizimin e ligjërimit, vargut, por edhe strukturën e gjerë të perceptimit dhe të kuptimit poetik. Këtë veçori Rugova e gjen të realizuar më së miri në *librin* poetik *Thikë harrimi*. Me inkuadrimin e këtij fenomeni, Rugova thekson se Hamiti, me dy-tre *librat* e tij të poezisë, ndikoi që poezia jonë, vetëdijshëm apo ndërvetëdijshëm, të bëhet e vetëdijshme për ligjërimin e vet: ta ngrisë, ta funksionalizojë dhe ta saktësojë gjuhën poetike. Me një fjalë, mendon se poezia e këtij poeti e vetëdijeson strukturën poetike shqipe. Rugova në përgjithësi mendon se pa *gjuhë poetike të kërkuar* nuk ka poezi. Kritiku ynë përgjason Hamitin me Lasgushin, i cili e ka formalizuar poezinë shqipe, tendencë të cilën e ringjalli Hamiti.<sup>56</sup>

Formalizmi poetik, siç u theksua, është më së miri i realizuar te *Thikë harrimi*. Strukturën ciklike të këtij libri Rugova e konsideron të fortë, duke e quajtur sintaksë dhe sistem të realizuar në mënyrë paradigmatisht. Vlerësuar edhe në bazë të sistemit të cikleve, Rugova nxjerr përgjithësime, duke theksuar se kuptimin dhe domethënien e plotë poezia e Hamitit e merr në kuadër të strukturës organizuese dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë rrëfimtare.

Duke u marrë me problemin e sistemit ciklik të librit të Hamitit, Rugova konstaton një problem qendror, që është fenomeni i ekzistencës individuale dhe kolektive. Mbi këtë fenomen jep mendim se kemi të bëjmë me botëkuptime ontologjike, sepse ai fenomen është tërësia jetësore, e qenies. Në radhë të parë poetit i intereson fenomeni i qenies dhe i ekzistencës së caktuar, në një ambient të caktuar vetëm poetikisht e jo realisht. Mandej, Rugova shton se ky fenomen nuk realizohet përmes induksionit, por përmes deduksionit, sepse ajo kërkohet në tërësinë e strukturave fenomenale. Po ashtu, kur e diskuton dhe e problemëson këtë fenomen, Rugova vë në pah se ai e përfaqëson jetën e njeriut, të njeriut tonë, mes dy skajeve, *Lindja* e *Vdekja*. Do të thotë, *Thika* si mjet poetik, si mjet dhe figurë e instrument i prerjes, nxjerr shtresat e fenomenit, sipas tij. Me bindje të thella dhe me argumentet që i jep, Rugova këtë poezi e velrëson të realizuar mjaft mirë dhe në të cilën kuptimi i parë i këtij mjeti transformohet aq bukur e mirë poetikisht, sa që edhe poezisë i jep forcë reale e që kufizon me artin e mirë. Këtë fenomen e sheh të

---

<sup>56</sup> Shih Kujtim M. Shala: “Prishtina letrare”, Albas, Tiranë, 2011.

pranishëm edhe në ciklet e tjera të Hamitit, të cilat mendon se paraqesin kategori të veçanta të jetës, të ekzistencës. Lidhur me këtë ai shton se këto poezi krijojnë bindjen se dalin nga ambient i caktuar ekzistencial, se ekzistenca është e pakufishme. Si përfundim, lidhur me këtë çështje, konstaton se është ekzistenca jonë, është ekzistenca njerëzore, të cilën poeti e nxjerr nga ajo e përgjithshme njerëzore. Me këto konstatime Rugova përfundon se koncepticionin i paraqitur sistematikisht në librin e Hamitit mund ta përafrojmë, për nga kompozicioni, me atë të romanit, i cili jep një fenomen të prerë, pra me romanin modern.

*Libri* tjetër poetik i Hamitit, *Trungu ilir*, e plotëson kërkesën poetike të Rugovës që shkrimtarët të hapen artistikisht ndaj jetës dhe problemeve të tjera. Në këtë drejtim Rugova mendon se letërsia dhe arti nuk duhet të ngurrojnë para gjërave “të mëdha” dhe “të vogla”, se duhet të kenë guxim artistik e krijues intelektual në zgjedhjen dhe trajtimin e problematikës.

Hamitin poet Rugova e vlerëson për faktin se ka hyrë me konceptione të caktuara në poezi, me *konceptione poetike*. Duke e lexuar sistematikisht veprën e tij, vëren rezultatet poetike, që kalojnë prej një formalizmi poetik e kuptimor të poezisë, e arrin te një konkretësi, te një *realitetësim* i botës semantike të poezisë. Do të thotë, formalizmin poetik të Hamitit e veçon si karakteristikë të parë të veprës së tij, krahas veçorive të tjera që ka vepra e tij poetike. Në këtë kontekst, thekson se ka shumë probleme që shtron poezia e këtij autori, po që në këtë tekst ka për qëllim të bëjë vetëm një vlerësim të përgjithshëm për inovacionin e saj në planin e prozedut dhe të ndërtimit të saj, gjithashtu edhe të semantikës. Është fjala për *librin* e tij *Trungu ilir*, në analizën e së cilës autori ynë dallon dy tipa shkrimi. Në pjesën e parë të librit, të titulluar *Trungu*, vëren një metaforikë të zbërthyer kuptimore me aluzione të subjektit poetik ndaj ekzistencës nacionale historike, gjithashtu flet edhe për një element tjetër të kësaj pjese e që është ironia tragjike, që buron nga përvoja e ekzistencës në relacionin subjekti-antikja e tashmja. Ndërsa, në pjesën e dytë, të titulluar *Koha*, duket një tip krejt i ri në poezinë e Sabri Hamitit që Rugova e quan *poezi e ironisë konkrete*.

Rugova thekson se te *Trungu ilir* kemi të bëjmë me *dy libra të pavarur* të poezisë, që në kontekstin e librit ndërlidhen mjaft ngusht. Përveç *dy libra*, shikon edhe *dy kohë* të realizuara aty: *Trungu* - koha ekzistenciale e metaforifikuar dhe *Koha* - momenti i kohës aktive të realitetësuar..

Sa i përket temës dhe idesë, Rugova mendon se në poezinë e Hamitit derdhet një tërësi temash e idesh, të gërshetuara me momentin e aktual të perceptimit. Në këtë aspekt, thekson se poezia e Hamitit të fut në botën e fiksionit poetik, që hapet dhe bëhet i pranishëm përmes metaforikës si riaktualizim dhe si ripërjetim objektiv brenda hapësirës së vetëdijes.

Në analizën e bërë në bazë të cikleve të tërësishme të Hamitit, Rugova nxjerr në vija të shkurtra një vlerësim për fushat semantike të tij. Para së gjithash thekson se të gjitha këto fusha që dalin nga poezia e tij janë rezultat i botës moderne dhe që kanë humbur kuptimet klasike. Vlen të përmendet se në këto fusha semantike gjen

të shfaqur kërkesën për hulumtimin e adekuatësisë midis gjërave, fjalëve dhe kuptimeve: kuptimi i raportit fjalë-objekt-ekzistencë.

## II. 6. Ideja e tjetërsimit: Momenti poetik

Çështje esenciale që shtrohet në këtë tekst është hetimi i elementeve të reja të poetëve të rinj, të talenteve të reja poetike, pas emrave të njohur të Eqrem Bashës dhe Sabri Hamitit, për të cilët autori mendon se kanë vërtetuar praninë e tyre në poezinë bashkëkohore shqipe. Në këtë kontekst, kritiku dallon Agim Malën, Shaip Beqirin dhe Abdullah Konushevcin. Para se të vlerësojë pikëpamjet poetike e këtyre poetëve, Rugova thekson se do të bëjë një punë që rrjedh nga kënaqësia e atij që merret dhe i përcjell dukuritë dhe momentet letrare të kohës. Rugova për nga natyra është shpjegues i thellë i fenomeneve dhe i problemeve që trajton, prandaj edhe në këtë tekst shpjegon se përkufizimin *krijues të rinj* nuk e merr në vështrim thjesht vlerësues, po në atë *shfaqjesor*, të fuqive të reja që flasin për vitalitetin dhe fuqinë e letërsisë në proces e sipër, prandaj arsyeton që edhe nuk ka emërtime të tjera.

Përmbledhjen *Pasqyrë dhe diell*, të Abdullah Konushevcit, Rugova e shikon si dëshmi për ide poetike të autorit të saj, për talent, ndjenjë e aftësi të përkushtimit krijues. Çmon këtë poet për përqendrimin poetik, përqendrimin në materien poetike dhe të formësisimit të saj. Në përmbledhjen e poezisë së tij vëren edhe elemente të ironisë poetike. Po ashtu, thekson ndërtimin e figurativitetit poetik të tij, të cilin e veçon për nga maturia precize, imagjinata dhe kërkesa për figurabilitet dhe jo figurë të zakonshme.

Duke vështruar praktikën poetike të Konushevcit, në vokabularin poetik heton elemente të modelit poetik të Ali Podrimjes dhe të Sabri Hamitit, por në materien dhe idetë e zgjedhura e vlerëson për origjinalitetin.

Po në këtë frymë, Rugova thekson elemente të rëndësishme të poetit tjetër, Agim Malës. E konsideron poet me talent, që di të zgjedhë lëndën poetike, të prekë çështjen më interes për momentin dhe kohën e vet. Në krijimtarinë poetike të Malës, vëren elemente të modelit poetik të Eqrem Bashës dhe të Ali Podrimjes, por nuk i duken aq të forta në krahasim me potencialin e ideve origjinale, të cilat beson se do t'i zgjerojë dhe thellojë në pajtim me pasurimin e prosedeut poetik. Përmbledhjen e poezive *Fjalë e vetmi* të Malës e konsideron libër të suksesshëm, për të cilin thotë se realizohet si ligjëratë poetike, pa komplikime të mëdha apo artificiale të komunikimit poetik, në kuptimin pozitiv të fjalës. Por, gjithashtu, për fund, uron që ky libër mos të jetë libri më i mirë i poetit.

\*\*\*

Nga kjo paraqitje e pikëpamjeve të Rugovës, shohim se autori ka bërë një definim të poezisë bashkëkohëse, duke e ilustruar me autorët përkatës, vepra e të

cilëve përmban çështje apo pikëpamje të ngjashme, që shtrojnë disa kërkesa dhe provojnë karakteristika të poezisë bashkëkohore. Nga analiza e Rugovës kuptojmë se veprat e analizuar janë të hapura dhe se duhet të kapen në kuptimin metaforik, të kuptohen me anë leximesh të simboleve dhe të elementeve të tjera poetike. Esencialisht, poezia e tyre dallonte shumë nga poezia e mëparshme. Në këtë aspekt Rugova së pari vështron autorët që janë bërë *fakte letrare* dhe e vijon kërkimin deri te poetët më të rinj.

### III. REFUZIMI ESTETIK

Do thënë që në fillim se po shqyrtojmë interpretimet, analizat dhe leximet e para të disa autorëve bashkëkohorë që ka përzgjedhur Rugova në kritikën e tij. Gjithashtu, do sqaruar se kemi në shqyrtim pjesën e dytë të *Refuzimit estetik*, duke e ditur se ai përbëhet nga katër pjesë: Ese, Kritikë, Studime -Vështrime dhe Teoria e Kritikës. Në pjesën e dytë, Rugova bën kritikë recensioniste për autorë, si: Azem Shkreli, Fahredin Gunga, Musa Ramadani, Abdullah Konushevci, Teki Dërvishi, Jusuf Buxhovin, Fahredi Gunga, Ibrahim Kadriu, Qerim Arifi.

Diskutimi i bërë këtu ka në qendër të vëmendjes hetimin e vlerave që kanë prodhuar veprat e këtyre autorëve dhe të cilët përcaktojnë vlerat e përgjithshme të letërsisë shqipe të kohës në Kosovë. Kështu, Rugova shqyrton veprat e veçanta të autorëve dhe për të qenë më afër tyre, pothuajse secilës vepër poetike i zbërthen titullin etimologjikisht, gjenetikisht e poetikisht. Pra, analizon që nga rrënjët fenomenet që karakterizojnë autorët, për të ndjerë sa më afër *refuzimin estetik*. “Refuzim do të thotë të mos pranosh, të mos pranosh atë që të imponohet, e kjo varet nga qëndrimi personal dhe ai i përgjithshëm”,<sup>57</sup> definon Rugova në pjesën e parë të librit. Sipas tij, refuzimi realizohet në aporinë e pazgjidhshme të raportit triotomik: imponimi - pranimi - refuzimi.

Për të vështruar refuzimin praktikisht, Rugova zgjedh autorët që e kanë shkruar *letrarisht* refuzimin, duke parë efektin estetik të tyre, prandaj vështrimi i tij bëhet estetiko-kritik. Rugova, tek autorët që ka zgjedhur, praktikon teorinë e tij, duke kërkuar elementin e kryesor të saj, *qenësinë e letërsisë, qenësinë estetike*, duke i ikur letërsisë në funksion. Letërsinë e zhvilluar në këtë mënyrë, Rugova e vëren tek autorët e lartshënuar, duke i vlerësuar si vijon:

Te poezia e Azem Shkrelit thekson rëndësinë tematike e artistike që shtyn mendimin deri te përfundimi se *Kënga e hutinit* është ndër veprat më të mira të shkrimtarit. Heton shqetësimin intelektual, që realizohet në bazë të refuzimit estetik e artistik, ndaj fenomeneve që konstaton dhe refuzon.

---

<sup>57</sup> Ibrahim Rugova: “Refuzimi estetik”, f. 11.

Te Fahredin Gunga thekson dhe dinamizon ashpërsinë e të folurit poetik, ekspresionin poetik e estetik. Rugova mendon se revolta lirike e tij kufizohet me ironinë e tragjikes me vetëdije për humbjen njerëzore.

Te Musa Ramadani, Rugova do të vlerësojë më së shumti të folurit eugjenik, sublim, dhënë përmes dëshpërimit të subjektit poetik me karakter përmirësues, shërues të së keqes. Vlerëson tematikën e poezisë, të cilën e shquan për nga struktura e thellë.

Te poezia e Abdullah Konushevcit flet për kuptimin e rënies si dekadencë shpirtërore e jetësore. Konstaton një imazh poetik mbi çështjen e rënies.

Shohim se refuzimi estetik këtu realizohet me mjetet e letërsisë: satira, sarkazmi, grotesku, ironia, që bëjnë që letërsia ta refuzojë imponimin. Rugova kërkon refuzimin edhe në romanin shqiptar bashkëkohor. Vështron metodën artistike romaneske të romanet: *Herezia e Dërvish Mallutës* të Teki Dërvishit, *Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit* të Jusuf Buxhovit dhe *Moti i Madh* i Mehmet Krajës. Kritiku thekson se duke i vështruar në një interval kohor të botimit, këto tri romane, ka qëllim që t'i theksojë dhe shqyrtojë vlerat e përgjithshme të tyre. Ai ndalet më shumë te mënyra e shkrimit të tyre, që i konsideron me elemente origjinale. Sa i përket problemeve të formësuar brenda tyre, vëren edhe një lloj koincidence: merren me çështjen e intelektualit në kohë të ndryshme, konkretisht, te Dërvishi paradoksi i intelektualit të ri në rrjedhën e krijimit; te Buxhovi tipi i intelektualit dijetar dhe te Kraja tipin e intelektualit poet. Pra, është tematika e tyre që vlerëson Rugova, të cilën këta tre autorë e realizojnë në dimensione të ndryshme kohore e romaneske.

Përgjithësisht, Rugova arrin të bëjë një konkretizim mjaft të mirë rreth temave dhe ideve të autorëve të shenjuar. Shohim se poetët dhe romancierët e diskutuar, kanë realizuar përmes imazhit poetik e romanesk një fushë të pasur tematike të ideve të ndryshme filozofike, letrare dhe artistike.

Hetim i rëndësishëm i Rugovës, përveç interpretimeve esenciale, është se ai dallon te disa autorë inkuadrimit të një idiomatike të pasur të traditës sonë më të mirë poetike, si të: Nolit, Lasgushit, Migjenit, Fishtës etj. Po ashtu dallon edhe fenomene që janë trashëguar që nga tradita arbëreshe dhe nga letërsia e vjetër shqiptare.

Paraprakisht, para vlerësimit të veprave objekt, Rugova sqaron se në këtë interpretim të kritikës aktuale, nuk do të merret me çështje anësore të një vepre, por me ato që veprën e bëjnë *vepër në vete* e që vlen për autorët që me veprën e tyre kanë siguruar ekzistencën e vet.

### III. 1. Poezia bashkëkohore

Autori i parë që analizohet në këtë kontekst, pra në kontekstin e veprës si genësi e jo si hyrje në shërbim pragmatik dhe politik, është Azem Shkreli, me *Kënga*



e *hutinit*. Rugova konstaton *punktet* më të rëndësishme poetike dhe tematike të Shkrelit, si: shqetësimi intelektual i subjektit poetik, tema historike, sociopatia e elementeve jetësore dhe estetikën negative me funksionalizimin e idiomatikës autoktone.

Tek Azem Shkreli, Rugova që nga libri i parë i tij *Bulzat* e deri te *Bibla e heshtjes*, sheh të realizuara dy fahe, fahun e lirikës subjektive dhe fahun e peizazhit natyror e shpirtëror të ambientit shqiptar. Ndërsa, te vepra më e ri e poetit, Rugova heton një ndryshim të optikës vrojtuese të shkrimit poetik, duke e parë librin si sintezë poetike të këtyre dy faheve.

Në bazë të vrojtimit të përgjithshëm, Rugova vëren se te *Kënga e hutinit* realizohet një shqetësim intelektual, që lidhet me zhgënjimin, me paqartësinë jetësore, çrregullimin e vlerave dhe pikëpamjeve të deklaruara. Rugova mendon se këtë shqetësim e shenjon edhe vetë titulli *Kënga e hutinit*. Gjithashtu, duke e vijuar studimin sistematik të poezisë, Rugova heton një refuzim estetik e poetik që del në formë të një injorimi total, në emër të vazhdimësisë së jetës, të së mirës.

Shqetësimin intelektual e gjen të shtrirë në formë të rrëfimit poetik, i cili mendon se thellohet në ciklin *Nga ditari i së premtës dhe Shënime natën*, vargje të cilat janë të ndërlidhura poetikisht dhe kuptimisht. Autori vëren se të gjitha këto shenjojnë një gjendje e cila cilësohet me zbrazëti, me shurdhim, me gjëmim dhe me vetëtimë. Këto konsiderohen nga ai si elemente të një perceptimi original të botës dhe të fenomeneve, i cili konstaton, po njëherësh edhe refuzon.

Sa i përket temës historike, të trajtuar nga Shkreli, te kjo vepër Rugova heton një zgjerim të temës, vëren se poeti e realizon këtë temë pa sforcime, po duke kërkuar një traditë, një identitet të shenjuar si diçka “në pergamenën tonë”, që e preokupon ligjëratën e tij poetike. Me një fjalë, Rugova mendon se vazhdimësisë meditative poeti ia shton edhe vazhdimësinë konkrete historike, e cila përbën qenësinë e qenies.

Rugova në ligjëratën poetike të Shkrelit e analizon termin mendim, që në kuptimin e zakonshëm ka të bëjë me mençurinë, idenë etj., por te Shkreli heton insistimin për ndërtimin e një filozofie të vet me bazë të fortë në idiomatikën e qytetërimit tonë, sidomos në atë gojore. Konkretisht, mendimin te kjo poezi e koncepton si kategori politike, kërkesë për vetëdijësim dhe insistim për filozofim. Në këtë kontekst, Rugova thekson edhe një element tjetër të poezisë së Shkrelit, siç është ai i idiomatikës autoktone. Te ky poet vëren se në mënyrë kreative pushon kufiri midis idiomës kolektive dhe asaj individuale. Këtë fenomen Rugova e ka parë edhe te Naimi, Lasgushi, e Fishta. Poezia e Shkrelit, sipas tij, del vazhduese e poezisë paraprake. Më tej, heton se Shkreli e ka pasuruar këtë raport, duke e inkuadruar urtinë e popullit, përmes mediumit më të sigurt, gjuhës, të ngritur mbi filozofinë empirike të tij. Kështu që, nëpërmjet analizës konkrete të idiomatikës së tij, Rugova konstaton se, duke e aplikuar këtë idiomatikë popullore, poeti nuk e mbyll atë, po e përgjithëson në plan komunikimi, e funksionalizon me mjete të reja poetike përmes

konotimit të fuqishëm poetik. Për më shumë, shton se Shkrel e modernizon këtë idiomatikë, i jep kuptim të ri në kontekstin e çdo vjershe.

Duke e interpretuar poezinë e Shkrelit, Rugova vëren edhe një element tjetër të konceptin estetik e poetik: në planin e poetikës, poezia e tij del e përkryer, me një metrikë të veçantë dhe me një ritmikë kuptimore të parimit të tejbartjes së vargut dhe të fjalës në kuadër të sintaksës poetike. Për Rugovën, estetikja, ideologjia poetike e poetit, ndërtohet mbi të *bukurën*. Këtu kritiku vlerëson se Shkreli edhe të keqen e refuzon përmes kësaj kategorie, që e quan *estetikë negative*. Në këtë drejtim, Rugova gjen të bashkuar mendimin e poetit tonë me mendimin e Valerisë se poezia është akt solemn i intelektit, e bashkë më Shkrelin mendon se është akt solemn i sensibilitetit. Këtë kategori estetike të Shkrelit, Rugova e konsideron si mjetin më të fortë poetik, si koncept, si pikëpamje krijuese, ashtu edhe si realitet të poezisë. Kështu, në kuadër të *estetikës negative*, Rugova çmon te ky poet edhe qëndrimin eufemist ndaj gjërave, për ta mbrojtur e realizuar të bukurën në vepër, për të cilin Rugova mendon se e forcon idealin e tij poetik.

Në fund të tekstit vlerësues për Shkrelin, është interesant edhe mendimi përfundimtar i Rugovës lidhur me këtë poet, kur thekson se është ndalur dhe mendon se duhet ndalur, në çështjet esenciale të veprës, duke menduar se po ngeli tek ato anësore, çfarë e bën kritiku i dobët, klasifikimet dhe interpretimet bëhen jonatyreshëm.

\*\*\*

Në vijim Rugova e heton veprën poetike të Fahredin Gungës, duke filluar nga vepra e tij e dytë, *Mallkimet e fjetura*, për të dalë te vepra më e re, *Mallkimet e zgjuara*.

Analizës së poezisë së Gungës Rugova do t'i qaset duke e parë strukturën e saj, për të thënë se ajo përbëhet nga pesë cikle, të ndërlidhura me nga një poezi, që autori e quan "meslojë". Pra, na jep të kuptojmë se vjershat ndërlidhen ndërmjetvete me strofa, sipas kurorës sonetike, duke evidentuar që vjersha pasërendëse fillon me strofën e vjershës pararendëse. Jo pa dashje e theksuam këtë formësim të strukturës, të nënvizuar nga ana e Rugovës, për të shtuar se poeti insistonte të bënte një poemë. Rugova thekson se, edhe pse vepra del si një poemë, është ruajtur dukshëm njësia e pavarur, vjersha.

Për të arsyetuar konstatimin, thotë se libri është një akt insistues i të folurit poetik, që formësohet brenda një ligjërate të ashpër. Kështu, në rend të parë ai shqyrton leksikun e reduktuar, të poetit me qëllim konotimi në planin e sensibilitetit. Pastaj, analizon idetë e tij, të cilat thotë se dalin të realizuara nga një shqetësim në kufi të dëshprimit e që i konsideron forma e mallkimit, në plan më të gjerë.

Te Gunga, Rugova thekson dinamizimin dhe ashpërsinë e të folurit poetik, ekspresionin poetik dhe estetik. Kështu, ai përqendrohet te ligjërimi poetik, duke e parë të ngritur në raportin juktapozicional filozofik, i cili duket si vijon: Subjekti

poetik - Polemi - Zgalemi - Fati. Këtë raport, Rugova e shpjegon: “poeti, duke dashur që këto koncepte të jenë sa më të qëndrueshme dhe me vlerë të përgjithshme, nga leksiku i vjetër shqiptar merr termin Polem, që do të thotë populli, njerëzia, bota e vegjëlisë, pastaj një emërtim të rrallë Zgalemin, zog paralajmërues i stuhisë, i shqetësimit si dhe sinonimiken shqiptare të fatit: Risku, Shorti dhe Morti, si përmbaresh të ekzistencës”.<sup>58</sup>

Në bazë të gjithë kësaj, Rugova konstaton se Gunga merret me filozofinë e fatit si reklamacion, por me bindjen se fati zhvillohet brenda raportit të gjërave dhe të situatave, e që nuk është diçka e dhënë që kufizon sociologjinë e fatit. Lidhur me këtë vepër poetike dhe veprat e tjera të poetit, Rugova mendon se revolta lirike e tij kufizohet me ironinë e tragjikës me vetëdije për humbjen njerëzore. Kur i shqyrton gjithë këto veçori, do të thotë veçoritë e brendshme, të një psikologjie dinamike, thotë se kodifikon se çdo gjë matet me *rrisk polemi*. Rugova gjithashtu shqyrton edhe ekspresionin poetik, duke thënë që poeti në kuadër të tij aplikon ndërlihdjen ndërmjet poezive, që është *përsëritje e qëllimuar*. Ndërsa, sa i përket funksionit të dinamikës së tekstit, heton në masë të dukshme rimat foljore me karakter të ndryshëm semantik, me të cilat shquan situatat e dhimbjes, të butësisë, ashpërsisë etj.

Te poezia e Gungës, Rugova po ashtu vëren të aplikuar edhe poetikën noline, pasi që në poezinë e tij heton rima foljore, që mendon se shenjojnë një gjendje të papërfunduar mbas një dramaciteti që ndihet dhe realizohet në tekstin poetik të këtij libri. Pra, mendon që Gunga inkuadron një idiomatikë të pasur të traditës sonë më të mirë poetike, si nga Noli, Lasgushi, Migjeni etj., pastaj edhe nga tradita arbëreshe dhe nga letërsia e vjetër shqiptare. Shpjegon p.sh. se termin Polem e gjejmë që nga Pjetër Bogdani e këndeje.

Me inkuadrimin e perceptimit të ri tematik e poetik, Rugova mendon se Gunga gjendet në vazhden e shkrimit aktiv të poezisë. Me inkuadrimin e konceptit poetik të përfaqësuar nëpërmjet Zgalemit, mendon se poeti e pasuron poetikën shqiptare, ashtu siç veproi Lasgushi me inkuadrimin e Nositit. Po në rend të parë mendon se pasurohet poezia e tij.

Rugova, duke pranuar që po bën një vështrim kritik dhe analizues të poezisë së Gungës, e konsideron të arsyeshme t'i shprehë edhe disa mendime në formë vërejtjesh të përgjithshme. Mendon se poeti duke u koncentruar tek të folurit poetik, më shumë i ka kushtuar kujdes situatës së imagjinuar dhe kërkesës që ka të bëjë në mënyrë sa më efektive të komunikimit, duke bërë që të ngushtohet realizimi poetik. Vlerësuar kështu, kritiku ynë mendon se sikur poeti të kërkonte një autonomi më të madhe të vjershës si njësi, ndërlihdja poetike në kuadër të konceptit të poemës, do të dilte më e natyrshme. Pavarësisht kësaj, me të gjitha elementet që solli Gunga, Rugova mendon se kemi në dorë një ndër librat më të mirë të autorit

---

<sup>58</sup> Po aty, f. 78.

dhe ndër librat me të rëndësishëm në shkallën e zhvillimit të atëhershëm të poezisë shqiptare në përgjithësi.

\*\*\*

Në këtë radhë të vështrimit Rugova shqyrton veprën poetike *Eugjenika e tri deteve* të Musa Ramadanit, duke e shquar si një botë në vete. E karakterizon dhe e vlerëson për nga struktura, kodi dhe shenjzimi i veçantë, që bën që tekstin kritik për të ta titullojë *Sublimimi i thënies Eugjenike*. Koncentrohet shumë te titulli, duke menduar se poezia Ramadanit e krijon botën e saj, përmes një thënie poetike eugjenike, të lartë, sublimuese.

Fillimisht Rugova do të ndalet në vlerësimin e fjalës titulluese *Eugjenika*, për të cilën me të drejtë konstaton se përveç një nominacioni të rëndomtë njerëzor apo mitologjik, pra me Eugjenikën, ka të bëjë me diçka më të thellë dhe më serioze. Për të shpjeguar emërtimin Eugjenikë, Rugova përmend librat profesionalë, të cilët për këtë çështja na njoftojnë se emërtimi Eugjenikë vjen nga greqishtja e vjetër, që do të thotë *fis i lartë*. Shpjegimi shkon më tutje, në kuptim të zanafillës së etimologjisë së fjalës, eugjenika është dije, shkencë mbi metodat e përsosjes së vetive trupore dhe shpirtërore. Është dije për riprodhimin dhe përsosjen e racës njerëzore, që lidhet deri diku me kuptimin bashkëkohor për gjenetikën si shkencë. Shkurtimisht, nënvizon Rugova, ajo merret me mënjanimin e së keqes njerëzore. I veçuar të gjitha këto kuptime të Eugjenikës, pasi që Rugova mendon se të gjitha i gjejmë në veprën e Ramadanit në forma të ndryshme.

Te Ramadani, Rugova do të vlerësojë më së shumti të folurit eugjenik, të lartë, të dhënë përmes dëshpërimit të subjektit poetik me karakter përmisues, shërues të së keqes. Por, për të vështruar më mirë semantikisht veprën poetike të Ramadanit, Rugova jep edhe një sugjerim të kuptimit të titullit, duke e menduar kështu: *Eugjenika e tri deteve* është sublimacion i trashëguar i qytetërimit të tri deteve, të atij fisi të lartë dhe e lidh me lokucionet e ngjashme të krijimtarisë gojore shqiptare: tri dete, tri maja e të tjera apo edhe, *përmes një asociacioni të largët*, me të bukurat, hyrijat e detit të prozës gojore shqiptare.

*Të folurit eugjenik*, Rugova e gjen si leitmotiv në të gjitha veprat e Musa Ramadanit, prandaj edhe e emërton *ide të ndërlydhur*, duke thënë se nëpër to e keqja njerëzore formësohet dhe konstatohet poetikisht me insistim. Kjo ide nisët që nga libri i tij i parë *Mëkatet e Adamit* (1969), te libri i dytë *Thirravaje* (1971), pastaj *Neurosis* (1973), pastaj *Alfabeti i neurozave* (1982) e deri te më i riu, *Eugjenika e tri deteve* (1986). Këtë ide-leitmotiv të veprës së Ramadanit, Rugova vetëm e konstaton, duke thënë vepra është shumë më e gjerë së një konstatim me interes vështrimi.

Te ky autor Rugova do të ndalet sidomos tek organizimi i librit, të cilin e cilëson si mjaft të mirë. Organizim sipas të cilit imponon një rrjedhë të leximit, apo duke iu referuar Iserit, një fenomenologji të leximit.

Po e sjellim këtu si një evidencë këtë fenomenologji të leximit, parë nga Rugova dhe të emëruar: Mitologjia - Autoktonja - Historia. Rugova analizon poezitë e Ramadanit që nga e para e që është *Miqtë e mi memecë*, në të cilën heton se Ramadani e hap librin, duke na sugjeruar tematikën e veprës, duke na futur në botën e veprës. Kjo poezi hapet si përjetim i momenteve të perceptimit poetik, pastaj si një moto ëndrre, për ta vazhduar me ciklet *Libri i vdekur* dhe *Libri i gjallë*, të cilat i konsideron si paratekste e që mbyllen me vjershën *Miqtë dhe hijet e tyre*. Rugova e interpreton poezinë e parë, duke e kuptuar si paralajmërim të perceptimit të brendshëm të së shkuarës në shpirtin dhe në mendjen krijuese, në vizionin e subjektit poetik. Kështu që kjo poezi shenjon një ëndërr të kufizuar në kohë të subjektit poetik, dukë kërkuar mitologjinë e vet.

Rugova vëren se cikli i parë, i titulluar *Libri i vdekur*, i kushtohet mitologjisë, komplekseve e fytyrave të njohura mitologjike, duke filluar nga antikiteti greko-iliro-romak, e pastaj asaj biblike, hinduse, islamike, asirase, egjiptase e kështu me radhë. Kështu, nëpërmjet analizës konkrete, konstaton se këtë mitologji autori e shfrytëzon në formë produktive. Vëren se çdo figure apo topoi mitologjik ia kushton nga një vjershë, për ta bërë objekt të saj, pastaj shton se me çdo mit lidh nga një ide, virtyt, gjest apo moment të kohës, duke konsideruar të bëjë një riaktualizim të mitit. Rugova, duke analizuar në sistem veprën poetike të Ramadanit, vëren një remitologjizim të ky autor, kur mitet antike ndërlidhen, aktualizohen me mitologjinë moderne. Këtë fenomen të vjershës së Ramadanit Rugova e gjen të dalë si mbindërtim të elementeve të mbijetesës, të survivalit mitologjik, gjithnjë duke mos tradhtuar kuptimin qendror të çdo miti. Në vijimësi konstaton edhe një dialog të gjallë me idetë që përmban miti, duke inkarnuar në të idenë dhe përvojën e vet në raport me kohën. Gjithashtu, Rugova vëren se poeti krijon mitologjinë e vet poetike, të bazuar në atë antike, duke theksuar se poeti nuk kërkon t'i maskojë idetë e veta prapa mitit apo me të, por ato të mitit t'i vërë në kontekste të caktuara të ekzistencës.

Në ciklin e dytë, *Libri i gjallë*, Rugova heton vazhdimin e thënies së mëparshme poetike, por e cila ka për objekt historinë. Këtu vëren se poeti përmes vjershave me përkushtime disa figurave të njohura iliro-shqiptare, që nga Teuta, Genci, Pirro, Skënderbeu, Pjetër Bogdani, Nora e Kelmendit, Ali Pashë Tepelena, Abdyl Frashëri, Mic Sokoli, Zef Serembe, Naim Frshëri, Bajram Curri, Isa Boletini, Hasan Prishtina e deri te ato të ditëve tona, realizon lëndën e vet poetike, me qëllim sintetizimi të karakterit të këtyre figurave në planin nacional dhe në atë të përgjithshëm. Rugova thekson se poeti, duke hetuar vlerën e tyre, duke i ngritur në simbole të vazhdimësisë të ekzistencës, arrin të nxjerrë esencialitetin e tyre njerëzor dhe praktik e kulturor që dhanë për popullin dhe rrënjën e vet.

Duke e krahasur me ciklin e parë, në të cilin autori krijon një *mitologji poetike*, këtu konstaton se na jep një *histori poetike*, për të cilën thotë se përmbys nyjat kryesore të saj, qoftë si përjetim apo edhe racionalizim poetik në masë të konsiderueshme. Duke i parë së bashku këto dy cikle, që i pari ka për objekt

mitologjinë dhe i dyti historinë, Rugova vëren edhe një element tjetër që shenjon Ramadani, lidhjen me konceptin se *mitologjia* dhe *historia* janë dy vazhdimësi. Ndërsa, sa i përket problemit të vjetruar se mitologjia nuk është histori, Rugova vëren se Ramadani i kundërvihet konceptit, duke afirmuar se *mitologjia është historia e parë e përvojës njerëzore*, se *mitografia* është edhe *historiografi* në kuptimin modern të fjalës, se *histografia* nuk përfshin gjithmonë historinë e as *mitografia* mitologjinë, esenca këto të ekzistencës njerëzore.

Në fund të tekstit për poezinë e Musa Ramadani, Rugova sjell përgjithësime lidhur me veprën e fundit të tij, duke e parë si mjaft komunikative, duke e theksuar stilin e paimponueshëm, i cili komunikon me esencat e lëndës poetike. Po ashtu, vëren se autori ka shkruar “pa pardon”, çlirshëm e bindshëm, pa mistifikimin që mund të imponojnë momentet e caktuara. Përmend edhe njëherë tematikën, të cilën e shquan për nga struktura e thellë, që përmes *thënies eugjenike*, e konsideron një sublimim, i cili realizohet në kundërshtim që sjell dëshpërimi poetik si mospajtim. Përfundimisht, jep mendimin e tij, duke e konsideruar këtë vepër si formë të re të shkrimit poetik, që e pasuron poezinë tonë bashkëkohore, duke dalë si një ndër veprat më të mira të saj.

\*\*\*

Një tjetër poet që Rugova konsideron se duhet analizuar është Abdullah Konushevc, poet që me librin e tij të dytë, *Rënia e mollës*, vërteton ekzistencën e vet poetike.

Kur e heton këtë poezi, Rugova konstaton një imazh poetik mbi çështjen e rënies, të cilin e lidh me idenë e teorisë së Njutonit mbi gravitacionin tokësor, që e shpjegon me kushtëzimin filozofik dhe etik të rënies njerëzore në rrjedhat e jetës, pra flet për kuptimin e rënies si dekadencë shpirtërore dhe jetësore. Njëherit, Rugova vlerëson se përmes këtij imazhi poetik, poeti ka realizuar një fushë të pasur tematike të ideve të ndryshme filozofike, shkencore, letrare e artistike. Gjithashtu, në interpretimin e tij, përveç ideve të dijës, Rugova vëren edhe tematizimin e ideve artistike e jetësore, si dhe tematizimin e ideve teologjike-biblike.

Në interpretimin e idesë së gravitacionit, Rugova thekson edhe një herë se kemi problematizimin e njohjes, ide që del si ndër më të rëndësishmet dhe më interesantet në planin mbinatyror dhe në atë socio-ekzistencial, e cila del si forcë bashkuese. Gjithashtu, Rugova vëren se Konushevc e ka realizuar mjaft mirë poetikisht një komplementim të njohjes: përmes intelektualitetit dhe realitetit të ekzistimit.

Në vlerësimin e përgjithshëm për Konushevcin, Rugova përfundon se poeti ka një gjuhë të formuar poetike, duke përdorur me mjeshtëri narracionin gojor shqiptar. Për me tepër, konstaton edhe një metaforifikim të pastër të poezisë dhe elementin e tematikës së ideve, që bën këtë libër poetizim të ideve mbi dijen, mbi jetën dhe mbi artin.

## II. 2. Romani bashkëkohor shqiptar

Rugova, duke e shquar Teki Dërvishin si një ndër shkrimtarët tanë më të mirë bashkëkohorë, që vepron e krijon në fusha të ndryshme të krijimtarisë, kësaj radhe merr dhe analizon korpusin romanësor të tij, duke u përqendruar kryesisht te romani i fundit.

Rugova nis kërkimin te ky autor që nga romani i parë i tij, *Pirgu i lartë*, tek i cili vëren elemente të rëndësishme tipike për tërë prozën e tij. Ndër tjerash, në romanin e parë vëren elementin të cilin e konsideron tejet të rëndësishëm, realizimin e funksionin e poezisë në roman. Këtë rrugë konsideron se Dërvishi e ndjek edhe në romanin tjetër, *Padrona*, ndërsa romanin *Skedarët* e sheh të larguar nga kjo rrugë.

Romani i ri i Dërvishit, *Herezia e Dërvish Mallutës* (1981), sipas mendimit të Rugovës paraqet një përgjithësim të përvojës së tij në fushën e romanit, një thellim dhe zgjerim tematik dhe artistik. Rugova e përplotëson mendimin duke thënë se Dërvishi ka një aftësi tejet të domosdoshme për shkrimtarin, aftësinë e vrojtimit artistik. Këtë fenomen të vrojtimit artistik autori e favorizon shumë duke theksuar se Dërvishi na jep gjëra e fenomene më të thella e më interesante për veprën artistike, që i ikin vrojtimit të rëndomtë.

Leximi nis që nga titulli i romanit: *Herezia e Dërvish Mallutës*, nëpër etimologjinë dhe semantikën që Rugova e njeh mirë në planin gjenetik dhe historik gjenetik: “herezia është një doktrinë (teori), që u shfaq në gjiun e kishës katolike, që ka të bëjë me gjykimin e asaj që korrupton (prish) dogmat. Vështruar historikisht kuptimin e këtij termi që u bë fenomen në fusha të ndryshme të veprimit shoqëror e shpirtëror e intelektual të njeriut dhe të grupeve shoqërore na dalin disa herezi qendrore: adamizmi, arianizmi, manikenizmi, socializmi etj. Kështu, me kohë, herezia mori kuptimin e përjashtimit të pikëpamjeve dhe të gjesteve, që nuk përkojnë me një gjë të shpallur, me dogmën. Zhvillimi historik e ka demantuar herezinë, po ajo gjithnjë është fryt i së tashmes, i atyre momenteve kur nuk merret parasysh perspektiva”.<sup>59</sup>

Duke iu atribuar veprës së Dërvishit, Rugova kalon prej etimologjisë terminologjike në etimologjinë letrare, romaneske. Në këtë rrugë fenomenin e herezisë e sheh të nxjerrë nga empiria e një grupi social, që jeton në bazë të asaj teorie, që është sekt dërvishësh. Këtë sekt autori e përdor vetëm për të nxjerrë qëllimin. E në këtë kontekst Rugova vëren se qëllimi i tij është të tregohet, të vërtetohet paradoksi i herezisë, e cila vjen e kthehet në paradoks heretik, e që njëherësh del edhe si paradoks jetësor. Në qendër të herezisë dhe të hermetizmit qëndron paradoksi, kundërthënia, me shkakun dhe pasojën e vet. Ndërsa, sa i përket

---

<sup>59</sup> Po aty, f. 98.

intelektualit të ri, apo dervishit të ri, Rugova vëren se ai, përmes tjetërsimit personal dhe tjetërsimin jetësor, kërkon një riambientim të personit dhe të personalitetit të vet. Pikëpamja esenciale që ngre romani në këtë aspekt dhe që e heton Rugova është se ky dervish i ri nga tjetërsimi shkon në mesin që ka zënë e shpall herezi, në mesin heretik, në mesin e eksoduar. Mirëpo, edhe në atë mes heton se ekziston shkalla tjetër e herezisë, brendaherezia, e cila vepron në bazë të sistemit të hierarkisë, hereziarku dhe heretikët e hermetizuar. Dhe, personazhi që bën udhëtimin e vet nëpër vargun e heretikëve e që vjen nga vetëtjetërsimi, kthehet përsëri në mesin e parë, i cili më në fund arrin të thyejë herezinë. Prandaj, Rugova konstaton se autori na jep atë paradoksin e parë se fenomeni i hermetizimit zë fill në gjirin e familjes, midis prindit e fëmijës, ku vetëdija e birërisë e thyen atë të herezisë së jetës, të ligjeve të ekzistimit. Konkretisht, Rugova vëren se kërkesa e intelektualit të ri, që është figurë për vetë autorin, për nënshtrimin e vetes, është kërkesë për të pushtuar jetën. Mirëpo, ky akt i njohjes dhe i vetënjohjes, duhet të zhvillohet në një pikë të lartë, që autori na e jep figurativisht me masë reale, në Sukë, në majën e ngritur. Me këtë bashkon mendimin, sikur edhe sugjeron autori, se për ta nënshtruar veten është problemi më i madh.

Do të thotë, Rugova vë në qendër të romanit të Dervishit aktin e nënshtrimit, i cili duhet të realizohet diku poshtë e që në këtë roman kritikun ynë vëren, se ky akt zhvillohet në një vend të ngritur - në Sukën e Cërmjanit. Në këtë kuptim, akti i nënshtrimit, që Rugova e quan *akti i spastrimit*, realizohet nëpër procedurën e organizuar të askezës aktive konkrete: të vetëmundjes, të vetëpushimit dhe të vetëpërbalimit të kushteve dhe të instrumenteve që parashihen me atë doktrinë të sektit. Rugova, duke e kuptuar thellësisht aktin e spastrimit, thotë se për të pranuar idenë e imponuar apo të vetëkërkuar, që gjithnjë vjen si e imponuar, duhet pranuar aktin. Prandaj mendon se herezia duhet të kryhet mbi vetveten, një ide dhe akt i fuqisë së brendshme të njeriut.

Duke e njohur këtë ideologji, Rugova konstaton se spastrimi shpirtëror zhvillohet përmes shuarjes fizike të trupit. Në këtë roman, ky akt i herezisë shpallet nga hereziarku Dervish Malluta. Spastrimin e sheh të realizuar këtu në dy plane: në atë të brendshëm, kur është fjala për vetë personazhin, dhe në atë të jashtëm, që përsëri lidhet me personazhin që kërkon drejtpeshimin e vetes në jetë, kërkon harmoninë e brendshme dhe atë të jashtme, por që e lë të hapur, sepse nuk e arrin dot.

Kërkimi i Rugovës në këtë roman shkon drejt një mendimi më të thelluar dhe domethënës, kur shtjellon dilemën se kush është kryepersonazhi dhe arrin të përgjigja se ai është dervishi, intelektual i ri, i cili nuk arrin të spastron përmes situatave reale jetësore, por që tash do ta bëjë këtë përmes spastrimit asketik. Duke e konsideruar këtë personazh të Dervishit si personazh të vetin, thekson se ai është një karakter i intelektualit-krijues, që kërkon realizimin e vet edhe përmes akteve më të vështira, krijues i pathyeshëm, që në plan të parë e ka veprën, atë fuqi që mban në vete dhe që e sprovon në jetë.



Rugova e nxjerr në plan të parë kryepersonazhin e këtij romani, me qëllim që të theksojë vetëdijen e tij nëpër situata të ndryshme të jetës e të dogmës. Prandaj, mendon se kjo paraqitje romaneske, është roman mbi vetëdijen, siç e vërejtë edhe një kritik (Ramadan Musliu), duke shtuar se është roman mbi vetëdijësimin, pra i vetëdijësimit të kryepersonazhit.

Në fund të kritikës për romanin e Teki Dërvishit, Rugova thekson edhe një herë veçantitë e romanit, duke nënvizuar se poetika e tij është vetëdijësim artistik edhe për korpusin tonë romanesk. Thekson edhe njëherë se vlera më e madhe e romanit qëndron në paradoksin e herezisë, të cilin edhe e ka shtjelluar në gjithë tekstin, por duke theksuar që romani është i pasur edhe me mjaft tema të tjera interesante, i pasur në planin figurativ dhe asociativ, që në vete përmban “metaforën” e domethënies universale të tematikës së realizuar. Përfundon duke e konsideruar romanin dhe autorin e saj në radhën e më të mirëve të letërsisë sonë bashkëkohore.

\*\*\*

Në tekstin tjetër kritik, Rugova shpalos pikëpamjet për romanin më të ri të Jusuf Buxhovit, *Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit*. Autori i bën një analizë të thellë romanit, duke e përshkruar dhe interpretuar detajisht, për t’i evindetur vlerat e tij. Fillimisht e konsideron si roman të një situatë, gjendjeje. Edhe vetë kritikën për këtë roman e titullon *Gjendja epidemike*, duke menduar se motivacioni i saj kryesor është situata epidemike që shkaktohet nga depërtimi i sëmundjes së murtajës. Dhe, këtë mendon se e forcon më shumë e dhëna se epideminë e bën në formë të imponuar pushteti i Perandorisë osmane, me qëllim të thyerjes së një ambienti, konkretisht të një qyteti (Gjakova). Atmosfera e kushtëzuar nga ky *imponim* zhvillohet në bazë të sistemit të kundërvënies: përhapja sekrete e murtajës, me qëllime të qarta, dhe organizimi kundër saj. Rugova vëren se kjo bazë motivore bëhet e rëndësishme nga lideja që shenjon kjo situatë.

Rugova vëren se një roman të tillë dhe një atmosferë të tillë në letërsinë botërore e kemi te romani *Murtaja* të Kamysë, por heton se qëllimet janë të ndryshme. Përderisa te romani i Kamysë ky tip i epidemisë del i vetvetishëm, te Buxhovi është i imponuar. Rugova sheh se dy shkrimtarët merret me absurdin e situatave të tilla në historinë e ekzistencës, por duke e parë në rastin tonë këtë absurd më të vështirë, sepse mendon se dallon absurdi si biologji dhe absurdi si histori.

Po e konkretizojmë edhe një herë: ngjarja e rrëfyer ka të bëjë me sëmundjen e murtajës, të cilën e kanë sjellë turqit në mënyrë të fshehtë. Në gjithë këtë ngjarja vëmendja e Rugovës përqendrohet te personazhi kryesor i romanit, që është një intelektual, një personazh historik, Gjon Nikollë Kazazi. Më saktësisht, kritiku ynë fokusohet te plani praktik që ka zgjedhur ai për organizim kundër epidemisë. Në këtë drejtim e vlerëson edhe Buxhovin që ka e zgjedhur këtë personazh, duke konsideruar

se ky personalitet intelektual real thekson rolin dhe funksionin e intelektualit në shoqëri, në mesin ku jeton dhe vepron. Ky intelektual, që ka funksionin e narratorit, sipas Rugovës shpalos gjithë fytyrën në këtë situatë të vështirë, me gjithë personalitetin e tij, në tërësi.

Figurën e këtij personazhi, Rugova mendon se e përforëcon paraqitja e dy poetëve, Padër Coli dhe Selami Tarku. I pari afrohet me Kazazin në aspektin e bashkëpunimit intelektual, ndërsa i dyti bashkohet me idenë e tij. Përderisa të dytë i lidh gjendja dhe ideja e revoltës jetësore dhe artistike, që del baras me kundërvënien, Kazazi karakterizohet edhe si dijetar në funksion të ideologjisë së vet dhe idesë së bashkëqëndresës autoktone. Kjo do të thotë se rreth personazhit kryesor zhvillohet e gjithë çështja e organizimit dhe e qëndresës, që inicohet dhe realizohet nga vetë ai.

Si përfundim, lidhur më këtë çështje, pra të hulumtimit për forcimin e kundërvënies dhe gjetjes së mjeteve kundërepidemike, Rugova e vlerëson objektivin e Buxhovit në një fushë tjetër, në fushën e diturisë popullore. Në këtë drejtim, ai e gjen një metodë e cila kishte dalë si rezultat i imunitetit autokton, që ka qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me sëmundjen. Kështu, thekson se gjetja e dijes popullore nga ana e intelektualit e përforcon edhe më shumë rolin e tij në jetën e popullit. Më këtë njëherësh thekson edhe faktorin e përvojës së brendshme, e cila në brendaveprim vjen e bëhet element imuniteti në vazhdimësinë e perit të ekzistencës. "Dhe përfundimi artistik i këtij romani se në kontakt, po me elementin imanent të përvojës ekzistenciale, formohet dhe në vazhdimësi vepron fuqia e imunitetit, që siguron atë vazhdimësi, e që konsiderohet si rezultat i përvojës së vendit".<sup>60</sup>

Përfundimish, del se Rugova veçanësinë e këtij rrëfimi romanesk e gjem të dalë nga *dokumenti* dhe arrin të realizohet si *fakt artistik*. Rugova mendon se romani është një analitikë e përvojës dhe vijës së përfaqësuar nga dokumenti i shkruar dhe nga ai gojor apo rrëfimor. Pra, Rugova, kur e shpjegon metodën artistike romaneske të Buxhovit, mendon se rëndësia qëndron në ndërlidhjen dokumentare të romanit në raport me lëndën e tij. Vetë romanin e konsideron dokument artistik, i cili mbështetet dhe realizohet në bazën e dokumentaritetit, i cili kërkon bazën e vet dokumentuese. Këtë e gjen të realizuar më së miri edhe nga personazhi kryesor i tij, Kazazi, i cili është personalitet i dokumentit, i realitetit. Do të thotë, për Rugovën, Buxhovi ka arritur të universalizojë artistikisht faktin e dokumentit dhe për të ai është romancier i sprovuar e me përvojë në fushën e prozës në përgjithësi dhe e dallon edhe si tregimtar.

\*\*\*

---

<sup>60</sup> Po aty, f. 112.

Është radha e romanit *Moti i madh* të Mehmet Krajës. Në paraqitjen e tij, Rugova e vlerëson autorin për teknikën që përdor, teknikën e reminishencës, që konsideron se hyn në atë të retrospeksionit dhe të introspeksionit (prapavështrimi dhe brendavështrimi). Vlerëson se fuqia e rrëfimit reminishent brenda romanit, falë mjeshtërisë, sillet e përthyeret nëpër kohë e hapësirë. Rrëfimin e romanit e sheh të bartur nga personazhi kryesor i Krajës, Zef Serembe. Para se të hulumtojë më tutje romanin e autorit objekt, shkurtimisht Rugova bën edhe një paraqitje të shkurtër të ndodhive biografike të Serembes si njeri e autor i Rilindjes sonë.

Lidhur me këtë roman, kritiku konsideron si problem kryesor është raporti midis Epokës dhe Individit. Një element tjetër të rëndësishëm Rugova e konsideron relativizmin e kohës që ka bërë autori, me të cilin thotë se duket se kohërat lëvizin e njerëzit dhe fatet e tyre mbesin të palëvizshme. Këtij koncepti kohor i përgjigjet Serembe me imagjinatën e tij poetike, i cili e provon konkretisht me shtegtime. Ky relativizimi i kohës, që nis me dimensionet iliro-romake në planin historik, deri në dimensionet evro-amerikane, zhvillohet në parimin e identitetit historik dhe të ironisë historike. Përveç këtij elementi, Rugova shkon më tutje, duke nënvizuar se nëpër këtë lundrim të hapësirave kohore e vendore, personazhi kërkon identitetin e vet kohor e shpirtëror, ambientin e vet poetik dhe historik dhe se është ky personazh që vetëm e konstaton identitetin e vet dhe kurrë nuk e realizon, sepse është rezultat i lëvizjeve të rrafshëve të ndryshme kohore, që fillojnë dhe gjenden në bazën e tij gjenetike.

Gjatë vështrimit të romanit në këtë dimension, Rugova ka përshtypjen se këtij relativizmi kohor i përgjigjet plotësisht relativizmi shpirtëror i personazhit, Serembes, që në roman del si fryt i perceptcionit poetik dhe intelektual të botës. Kraja, sipas Rugovës, bën psikobiografinë e Serembes, duke e vendosur midis fakteve reale që bëhen fakte të bindshme artistike. Kritiku ynë vëren se romancieri është i përkushtuar ta paraqesë fatin e intelektualit që kërkon realizimin që vazhdimisht gjendet midis ekzistencës dhe aktit të krijimit.

Kështu, Rugova, duke ilustruar pikëpamjet e veta mbi romanin *Moti i madh*, vëren se në gjithë romanin ngrihet një masë e madhe e ironisë, përmes rrëfimitarit, si rezultat i revoltës psikobiografike të personazhit. Ndërsa, sa i përket punës së Krajës në përgjithësi, thotë se me këtë roman ka treguar aftësi të sprovuara të shkrimit romanesk.

Rugova do të ketë në vëmendje edhe autorin Ibrahim Kadriu, me romanin e tij *Kroi i ilaçit*. Konkretisht, pikëpamjet e veta do t'i shtrojë në raportin: Legjendami-realja, në të cilin mendon se do të kuptohet i gjithë romani. Këto tri komponente ndërthehen ndërmjetvete sa të gjitha veprojnë përnjëherësh në vetëdijen e mesit dhe në atë të vepruesve brenda tij.

Në analizën e veprës, Rugova heton linjat rrëfimore të romanit, për të cilat thotë se sjellin materiale jetësore të kësaj kohe, çrregullimet që ndodhin në tradicionale, do të thotë me mitin dhe historinë, arrijtjet e njerëzve të rinj të

arsimuar, emigrimet e detyruara, konfliktet midis tyre dhe njerëzve që duan të vazhdojnë me tradicionale, konflikti i pushtetit me brezin e ri etj.

**Pjesa e katërt**  
**STUDIMET DHE LIBRAT**  
**MONOGRAFIKË**

## DY STUDIME MONOGRAFIKE

### I. OPUSI I BEQIR MUSLIUT

Në studimin për opusin e Beqir Musliut,<sup>61</sup> Rugova do të përqendrohet te konceptet e Musliut për artin dhe botën e dhënë në letërsi. Vështrimi i kritikut do të motivohet nga pikëpamja e poetit për letërsinë, poezinë, nga insistimi krijues i tij, që, për kohën kur u shfaq, në poezinë tonë, vitet 60', ishte jo i rëndomtë.

Puna serioze e insistuese e Musliut nënkupton edhe lexim kritik shumë serioz dhe të përqendruar. Për të arritur hetimin e veçantive të poezisë së Musliut, Rugova do të ndalet te vështrimi i çështjeve konkrete të opusit poetik të tij, për të analizuar dhe interpretuar strukturën e tij poetike, figurat letrare, kuptimet semantike etj., do të thotë gjitha ato elemente dhe fenomene që me dalin së pari te ky autor dhe e pasurojnë letërsinë tonë e që në disa raste shfaqen edhe për herë të parë.

Sipas Rugovës, që në fillim të krijimtarisë së Musliut, vërehet një refleksivitet poetik dhe një regjistër vrojtimesh më i ndërlikuar. Përgjithësisht nga kritika jonë tema e poezisë së Musliut karakterizoheshin si vrojtim tepër i ngrysur, thekson Rugova. Por, kritiku ynë ndryshon mendim duke thënë se tematika e tij ishte e re për kritikën e kohës, prandaj edhe paraqiste shqetësim për të. Risinë e heton sidomos në planin e koncepteve poetike, që i “çrregullon” edhe disa pikëpamje të tematikës. Kjo për Rugovën kuptonte njëfarë “enfant terrible”, që dilte si shpirt i pavarur për poezinë e atëhershme.

Sipas Rugovës, kritika e atëhershme fliste për errësi në pikëpamjet e Musliut, kështu që edhe habitej duke konsideruar diskutin e saj si të njëfarë “pesimizmi” të tepruar për moshën e re të autorit. Vlerësimi i Rugovës merr kahje tjetër, duke analizuar nga pozita e dijetarit modern, drejt konstatimit, se kështu duken shfaqjet e para më insistuese në letërsi.

Në vijim, Rugova vëren se autori i tij do t’i demantojë të gjitha kritikën dhe konstatimet që janë bërë për të, duke u perfeksionuar në ato pikëpamje, pra të vrojtimit poetik, dhe të zgjedhjes së temave. Tani Rugova do të diskutojë për shtatë veprat e Musliut, duke i quajtur opusi poetik i Beqir Musliut. Opusin e merr në kuptimin e termit teoriko-letrar, si një përkufizim të një tërësie të pasur zhvillimore të tematikës dhe të ideve, pra opus si vepër, si tërësi e realizuar në disa plane.

---

<sup>61</sup> Ibrahim Rugova: “Refuzimi estetik”, f. 206.

Rugova do t'i vështrojë librat e Musliu veç e veç, duke u ndalur më shumë në elemente esenciale të çdo libri, që konsideron se përbëjnë konturat e opusit poetik.

Natyrisht, kritikën letrare për Musliun e fillon që me veprën e parë, *Rima të shqetësuar*, vepër që për Rugovën shenjon shqetësimin poetik që kufizon me revoltën dhe konceptin për poezinë. Pikëpamjet që ka Rugova për këtë libër, p'adyshim, i japin të drejtë rititullimit të tij: *ambienti i brendshëm*, e sidomos kur te Musliu dallon insistimin për të dhënë pasurinë shpirtërore dhe filozofinë e ekzistimit, të njësuar në dy plane: individualen dhe kolektiven, në një vështrim dhe ekzistencë epike. Marrë në përgjithësi, në tërë veprën ai vëren një depërtim të thekshëm poetik, spontan e të bindshëm në gjërat dhe fenomenet e atij ambienti dhe një pjesëmarrje të shquar të subjektit poetik si formësues i tij.

Si gjithnjë, Rugova fokusohet në planin estetik të veprave objekt, dhe konkretisht këto poezi i koncepton të dalin nga një pasuri e madhe e imagjinatës. Imagjinatë, që për të, arrin t'i thyejë kufijtë e vrojtimit, duke të të bërë që të vrojtosh bashkë me poetin. Një vend të rëndësishëm konsideron edhe hetimin e lokucioneve poetike, për të cilat mendon se dalin të qëlluara, dhe të cilat lidhen me vokabularin tonë figurativ gojor, si: *na blerohen gishtat si bari, hijerandë varë lotin në rrem të synit*. Në këtë drejtim, Rugova konsideron se për herë të parë në poezinë shqiptare bashkëkohore ndeshim një vokabular abstrakt poetik që nuk praktikohet më parë dhe Rugova e ilustron me: *zbrazëtitë e kohës, pamundësia, përjetësia e gjërave të thjeshta, arkivolet e zeza të luleve, engjëjt e zez, korridoret e zbrazëtimeve* etj. Më tutje, analizon konceptet abstrakte poetike duke vërejtur që, te ky poet, pajtohen mirë me idiomatikën gojore. Këto elemente dhe të tjera, do t'i shohë më të arrira në librat e tij të mëvonshëm.

Në veprën *Lulkuqet e gjakut* Rugova përsëri vështron problemin e kuptimit dhe të krijimit. Konceptit të Musliut se komunikimi u shfaq midis njerëzve, me njeriun dhe kohën, Rugova e kupton si rezultat të nevojës së marrëveshjes dhe kuptimit njerëzor. Përderisa këtë koncept në veprën e parë e lidh me aktin e krijimit, me imagjinimin e tij, në veprën e dytë mendon se ndërlidhet me shembuj konkretë të krijimit, të modelit poetik. Për konkretizim, duke kërkuar të vërtetën, thekson se poeti merr Khajamin, veprën, jetën dhe fatin e tij. Praninë e Khajamit e ndërlidh me botimin e përkthimit të *Rubairave* nga Noli, përkthim të cilin e konsideron si shembull krijues në një kohë kur letërsia botërore ishte pak e pranishme në kulturën shqiptare.

Duke marrë për bazë se Rugova gjithherë në shkrimet e tij ka pasur kërkesë të veçantë semantikën e tekstit, duke konsideruar se jepte mundësi më të mëdha të analizës dhe interpretimit të fenomeneve të saj, vepra *Lulëkuqet e gjakut* për të paraqet një koncentrim të madh një problematikë kryesore, duke përfaqësuar një semantikë të dyfishuar. Në këtë pikëpamje të tij, gjaku bëhet simbol dhe metaforë që përfaqëson një dendësi referenciale si jetë, si frymëzim, si pasion dhe si veprim. Në këtë kontekst, Rugova veçon vjershën *Epshtet e gjakut*, ku objektivohet gjakimi, pasioni i madh për veprimin dhe krijimin në përgjithësi. Rugova e shikon me

përqendrim këtë imazh midis krijimit dhe vdekjes, duke e parë poetin të dalë në anën e krijimit, të fitores mbi të keqen përmes këtij akti të fuqishëm në vetë qenien e njeriut. Kështu që, me të drejtë Rugova e titullon pjesën e tekstit që i kushtohet kësaj vepre *Vetëdija krijuese*.

Librin *Bukuria e zezë* Rugova e ka vlerësuar edhe më herët si më të realizuarin e Musliut, duke e konsideruar konceptin poetik si më të thelluarin. Sintagmën *Bukuri e zezë* e konsideron si realizim i gjithë asaj që shtronte poeti në dy veprat e mëparshme, si çështje krijimi. Në radhë të parë, këtë sintagmë Rugova e emërton “metaforë estetike”, duke konsideruar që në vete përmban konceptin modern për krijimin si tragjikë, si vuajtje. Këtu bën dallimin e konceptit të së bukurës që ka shtuar poeti në këtë vepër dhe në të mëparshmet, duke vlerësuar se tash koncepti i së bukurës del në formë të *dialogut poetik*, si problem i zgjidhjes së brendshme të bindjes artistike. Konkretisht, konceptin e së bukurës më herët të ky poet Rugova e ka vlerësuar më shumë në planin e jashtëm. Kur jemi te vlerësimi i kësaj vepre, krahas dy veprave të tjera, duhet theksuar se këtu Rugova heton edhe shumë çështje tjera më të profilizuara, e kryesisht një regjistër jo më lirik-refleksiv, por refleksiv të pastër, në kuadër të një filozofie poetike.

Specifiken e kësaj metafore estetike, në formë të thelluar dhe të konceptuar, Rugova e konsideron në kurorën sonetike *Fylli dhe hiri*. Prej këtu konsideron se metafora estetike bëhet temë qendrore e veprës. Në analizën e poezisë thekson si bazë të saj *aktin e krijimit*, aktin e veprës dhe të kuptimit e të realizimit të së pamundshmes. Pos këtyre çështjeve, Rugova vëren se poeti inkuadron kuptimin e legjendës shqiptare për murimin në urë dhe në kështjellë, venerim që shtyn mendimin në konstatimin e një materializimi total të tematikës popullore. Vetë titujt e soneteve vlerëson se flasin për intensitetin e lartë të semantikës abstrakte.

Pos elementeve të tjera lidhur me poezinë e Musliut, Rugova dallon edhe ironinë eliminuese, çfarë e gjen në poezinë më të re shqiptare. Çështje tjetër të rëndësishme, sidomos në pjesën e dytë të veprës, *Balada dhe legjenda*, konsideron elementet nga epika edhe epiko-lirika jonë. Këtu heton një transponim ndërzharror, duke vlerësuar se poeti konvencat e lirikës dhe të epikës i sjell në një version të ri të vështrimit poetik individual. Konkretisht, poetikën kolektive gojore e vëren të kthyer në poetikë individuale, duke mos humbur semantikën e përgjithshme. Në disa raste dallon të krijuar edhe semantikë të re.

Në këtë mënyrë, duke hetuar këtë elemente të risisë së Musliut, Rugova krijon mendim se ambienti shpirtëror i dalë nga libri i parë, *Rima të shqetësuara*, tani del në një krijim që përmban esencat historike të tij. Vlerëson, se në ndërtimin e këtyre poemave, Musliu i merr episodet qendrore të epikës dhe bën një reinterpretim.

Veprën tjetër të Musliut *Kurorë sonetesh* që del me titull paralel-alternues *Skënderbeu ose shqiptarja e maleve* Rugova e emërton “personazhi historik”, duke konsideruar se poema nuk i kushtohet Skënderbeut, por është “materializim” i personazhit përmes sistemit metaforik. Në kontekstin e përgjithshëm të vlerësimit



një nga pikëpamjet qendrore të Rugovës, del mendimi se ky libër është kurora e parë e soneteve në letërsisë tonë në përgjithësi.

Në veprën *Sezamet* të Musliut Rugova heton elemente të reja poetike në opusin e tij. Vëren që metaforika e pasur që shfaqet te *Bukuria* pasurohet me imagjinaretin si element të *prosedeut poetik*. Planin tematik tani e gjen më të realizuar.

Rugova, duke analizuar veprën poetike të Musliut, vëren që poeti identitetin personal artistik e kërkon te poeti më personal arbëresh, Zef Serembe, duke u identifikuar me fatin dhe veprën e tij. Derisa në veprën e dytë konstaton identifikimin e poetit me Khajamin, tani e sheh të realizuar me një poet të rëndësishëm, Seremben.

Një element tjetër me rëndësi që e vëren te ky poet është edhe *konceptualiteti poetik*. Më konkretisht, Rugova, duke e analizuar çdo varg të poetit, heton se ai inkuadron figura tropologjike. Vëren se inkuadron koncepte teoriko-literare në lëndën e vet poetike si mjete të lëndës së vet, duke i konsideruar bartëse të kuptimeve nga disiplinat përkatëse shpirtërore dhe njerëzore. Këtë formë të krijimit Rugova e quan formë tropologjike të shkrimit poetik, kur vetë figurat poetike dhe konceptet e tjera bëhen mjete të lëndës poetike.

Përgjithësisht, kur vlerëson opusin poetik të Musliut, këtë vepër e vlerëson si të rëndësishme brenda opusit, për nga tërësia e ideve dhe prosedeve të vrojttimeve të tij “imagjinare”. Këtë më së miri e heton në poezinë *Lojë e pakryer*.

Të kësaj natyre, duke e vazhduar konceptualitetin poetik, nga *Sezamet*, Rugova konsideron edhe *Parabolën*. Këtu vëren një parabolizëm të çështjeve e të problemeve, me një domethënie universale. Këtë kërkesë e sheh të realizuar nga poeti me marrjen e disa momenteve e situatave që tashmë në historinë e njerëzimit janë bërë vetë simbole.

Rugova analizon veç e veç ciklet e librit dhe një parabolizëm të absurditetit e vëren më së miri te cikli *Parti shohu*. Vëren se poeti e cilëson zhvillimin historik dhe aktual si një lojë që emërtimet i ka nga historia dhe nag aktualiteti njerëzor. Kështu që, duke e kuptuar së brendshmi poezinë e Musliut, mendon se poeti na jep një semiotikë të absurdit që nis nga akseologjia historike. Në këtë drejtim, Rugova, kur lexon semiotikisht, duke e analizuar “lojën e shahut” dhe përbërësit e saj shenjues, vëren se poeti nxjerr lidhshmërinë misi konceptit se njerëzit edhe historinë e konceptojnë si lojë. E vazhdon mendimin duke thënë se: “sikur konstatohet poetikisht se çdo gjë zhvillohet si në këtë lojë, çfarë është një përgjithësim i koncepteve të mëparshme të poetit për jetën dhe historinë, pra zbulon anën socio-historike të veprimit njerëzor, të asaj loje të menduar nga të mëdhenjtë, që për fat të keq, me dashje e pa dashje, e luajnë edhe të vegjlit, e luajmë të gjithë në histori dhenë bashkëkohësi”,<sup>62</sup> prandaj Rugova edhe e emv\ërton vepër të absurdit.

---

<sup>62</sup> Po aty, f. 229.

Në veprën e fundit, *Darka e magjisë*, Rugova vëren një semantikë poetike të një fenomeni apo forme të veprimit të përgjithshëm mitologjik, jo të një figure. Për dallim nga *Parabola*, tek e cila bëhej universalizmi përmes figurës poetike, tash heton universalizimin përmes një fenomeni veprues. Më konkretisht, këtu vëren se poeti bën *remitologjizmin* e një miti thënë simbas Meletinskit, të magjisë, që njëherësh është edhe ritual i ekzistencës.

Në këtë vepër kritiku ynë vëren të inkuadruar edhe një konceptualitet tjetër, anatemën, të cilin e konsideron të dalë si akt të përjashtimit në komunikimin njerëzor, kundër atij komunikimi që e prish rendin komunikues të deklaruar, prandaj mendon se autori gjithë këtë akt e quan tërësi anatemash, apo libër anatemash.

Në këtë vështrim, shohim se qëllimi kryesor i Rugovës ishte ta shenjojë poetikën e poezisë së Musliut, duke e parë të pasuruar prej veprës në vepër. Duke i bërë një analizë të përgjithshme opusit poetik të Beqir Muslit, konstaton shtresime idesh e prosedesh, një regjistër të pasur tematik, që konsideron se e bëjnë opusin më të qëndrueshëm e më funksional.

Vlerësimi i Rugovës për Musliun theksohet te plani tematik, kur konstaton se bota e tij lirike nis me inkuadrimin e historisë dhe të traditës gojore, mitologjisë, të magjisë, metafizikës dhe anatemës. Gjithashtu, ai vlerëson konceptualitetin poetik që realizohet si prosede i veçantë, e që fillon si një poezi lirike-refleksive.

## II. SISTEMI POETIK I SABRI HAMITIT

Në këtë studimin monografik *Sistemi poetik i Sabri Hamitit*, Rugova zgjedh për të interpretuar më hollësisht Hamitin poet, të cilin ai me plot fjalën e quan *poet modern*. E konsideron të tillë kur heton format e shfaqjes së poezisë së tij, shenjat poetike të tij. E quan poet modern, kur heton kërkesën e sistematikës së Librit poetik të tij; komunikimin e librave dhe të cikleve, për të bërë një libër të vetëm; titujt metaforikë e poezinë alegorike-simbolike; shkrimin e dhimbjes jetësore të realizuar me subjektin poetik, të dalë me theks revolte e ironie. Rugova zgjedh të analizojë veprën poetike të një poeti me pikëpamje të reja në letërsinë shqipe.

Studimi *Sistemi poetik i Sabri Hamitit* është një vështrim monografik i elementeve qenësore të veprës poetike të poetit. Në këtë rast, kritiku dallon kuptimin e termit *monografik* nga *libri monografik*, duke sqaruar se kësaj radhe nuk do të flasë për prozën dhe kritikën e këtij autori, çfarë do të bëhej në një vështrim më të gjerë monografik. Prandaj, vështrimi është më i veçantë, duke u shqyrtuar vetëm *sistemi poetik* i Hamitit, ideja e këtij sistemi poetik, përbërësit më të rëndësishëm të poezisë së tij etj.

Para se të shohim se çka vëren Rugova kur analizon sistemin poetik të Hamitit, hetojmë edhe një fenomen tjetër që ka theksuar kritiku ynë, ndërlihdjen e kritikës më poezinë e këtij autori. Sabri Hamiti gjithëherë e ka pasur vendin aty ku Rugova ka diskutuar kritikën më të mirë të letërsisë shqipe. Njëherësh mund të

themi se nuk ka studiues bashkëkohor shqiptar që nuk ka lexuar dhe mësuar nga studimet kritike të Hamitit. Prandaj edhe në këtë vështrim monografik të poezisë së tij, Rugova e shquan për aftësinë e depërtimit në letërsie bashkëkohore shqiptare, për shqyrtimin e thellë të tekstit letrar, për aftësinë e nxjerrjeve të përfundimeve e fenomeneve letrare etj.

Rugova jo rastësisht e nënvizon kritikën e Hamitit, por për të theksuar raportin përplotësues të këtyre dy zhanreve, kritikës dhe të poezisë. Prandaj, veçantia dhe rëndësia qëndron në mënyrën e ndërtimit të tekstit të Rugovës gjatë leximit të Hamitit kritik dhe Hamitit poet. Në këtë kontekst, thekson se fusha e kritikës i ka ndihmuar Hamitit t'i vërejë disa fenomene, që ndoshta si poet nuk do të kishte mundur t'i vërente. Kështu, në shqyrtimin e çështjes ose të faktit se poetët nuk janë kritikë, Rugova mendon ndryshe, duke hetuar se poezia e Hamitit në praktikën kritike i ka forcuar vetëdijen dhe përgjegjësinë kritike për vlerësinë e veprës letrare. Jo vetëm që pranon bashkëpunim e këtyre dy fushave, por edhe e konsideron si shumë të rëndësishme. Në këtë pikë, Hamitin, e sheh të perfeksionuar. Përfundimisht, Rugova bashkëpunimin e këtyre dy fushave njih si rezultat me mundësi refleksioni më të gjerë e më imagjinatave. Hamiti, për Rugovën, është njëri ndër poetët e rëndësishëm në letërsinë tonë që merret me poezi dhe me kritikë. E vlerëson si kritik në kritikë e si poet në poezi, duke gjykuar se kritikët janë poetët më të mirë.

Vetë titulli i kësaj monografie shenjon pikëvështrimin e Rugovës dhe autorin objekt, por në hyrje të tekstit Rugova jep informacione për njohjen e poetit nga kritika, si është pritur dhe vlerësuar. Duke nisur kërkimet që nga fillimet, poetin e sheh të formuar brenda një dhjetëvjeçari, me një sistem të mbajtur në formë kreative. Mendon se është mirëpritur nga kritika, krahas disa rezervave se mos ishte insistim i tepërt në shembullin krijues të L. Poradecit. Nënvizon mendimin e Mensur Raifit për Sabri Hamitin, kur vlerëson veprën si orientim i ri, se lihej tipi migjenian i poezisë e fillonte ai lasgushian. Më saktësisht këtë ndryshim e kuptonte si vlerë historike në gjithë poezinë tonë.

Në përgjithësi, për shkak të risisë që solli Hamiti, si të ligjërit personal, gjuha poetike, përqendrimi te figura e strukturimi i librave, Rugova vëren një keqkuptim ndaj poezisë së tij. Në këtë kuptim Rugova do të bëjë një rrugëtim nëpër veprën e tij, me synim që t'i hetojë të gjitha këto fenomene, që për të paraqesin vlerë.

Në këtë ecje sheh si kërkesë kryesore të tij ngulmimin për një sistem poetik në planin konceptual dhe organizues të poezisë. Në këtë aspekt e konsideron model të tij Poradecin, pra gjetjen e një sistemi poetik në traditën poetike shqiptare, si *zhvillimësi* apo *vazhdimësi*. Po ashtu vëren se ka referencë edhe sistemet e ndryshme poetike evropiane.

Rugova shpalos *sistemin poetik* të Hamitit duke e parë të konsistojë në tre faktorë qendrorë: në konceptimin e librit, në konceptimin e ciklit dhe në

konceptcionin e realizimit të subjektit poetik. Njëherit këto edhe i shenjon si kontura të opusit të tij poetik.

Duke analizuar veprën poetike të Sabri Hamitit, heton idenë e librit si tërësi e organizuar, duke e quajtur një *sui generis* e shpirtit dhe mendjes njerëzore. Këtë koncept e njeh që nga Antika, ndërsa formën e kërkimit të këtij poeti e vëren si kërkësë dhe realizim, të marrë që nga Mesjeta dhe Renesansa. Në esencë, Rugova arrin të zbulojë se vepra e Pjetër Bogdanit, Poradecit e Sharl Bodlerit etj. qëndrojnë si shtylla të forta në poezinë e Hamitit.

Sa i përket elementeve kompozicionale të poezisë së Hamitit, në radhë të parë të ciklit poetik, Rugova gjen njësinë e realizuar poetike, vjershën. Vjersha mund të qëndrojë edhe jashtë kontekstit ciklor, në planin absolut të vështrimit të poezisë, po në planin e ndërkuptimit merr nuanca të caktuara çfarë i janë dhënë nga poeti. Rugova qartëson çështjen duke bërë një parabolizëm, duke e konsideruar vjershën në raport me ciklin, si njeriu, individi, në raport me bashkësinë njerëzore të caktuar, apo me kolektivitetin. Prandaj, Rugova vëren dhe kupton kërkësën e Hamitit që vëmendja kryesore t'i kushtohet vjershës si realizim poetik, e cila pastaj mund të inkuadrohet në kategori të ndryshme.

Faktor tjetër të rëndësishëm në poezinë e Hamitit konsideron subjektin poetik, që ndryshe këtë faktor e njeh si uni poetik, personazhi lirik, apo edhe heroi lirik, kur i referohet Bahtinit. Kjo kategori poetike-estetike, sipas tij, përbën kompozicionin e veprës, që do të thotë subjekti poetik del në çdo poezi. Ky subjekti poetik, që si kategori përfaqëson poetin, bën ndërlidhjen midis cikleve dhe librave të poezisë. Subjekti poetik hetohet si regjistër që përmbledh në vetë botën poetike të veprës, duke e përfaqësuar nëpër situata të ndryshme poetike brenda saj.

Prandaj, për të parë më mirë realizimin e subjektit poetik dhe për të parë rrugën e zhvillimit dhe pasurimit të kësaj poezie, Rugova u bën një vështrim të veçantë librave poetikë të Sabri Hamitit, vështrim që kushtëzohet nga sistematika e tyre, që përmban në regjistrin tematik dhe të titujve dhe që shprehin ide të caktuara brenda lëndës poetike.

Rugova ndjek kronologjinë e veprave poetike të Hamitit për të hetuar fenomenet dhe për të interpretuar vlerat e tyre. Në këtë vështrim niset që nga titulli i parë i Hamitit, *Njeriu vdes i ri*, duke hetuar theksin e revoltës që vë në lëvizje subjektin poetik dhe kërkësën për të ruajtur fuqinë ekzistenciale të njeriut. Në këtë drejtim vëren që titulli përmban dy koncepte: *njeriun* dhe *vdekjen*, ku heton se poeti mohon vdekjen e formave të ndryshme të njeriut duke pohuar se njeriu mbetet vazhdimisht i ri. Titullin e kësaj vepre e vlerëson si koncept esencial poetik, duke e parë të lidhur me konceptin biblik, antik, e humanist, përpjeke kjo që e konsideron për të ruajtur pastërtinë e njeriut në jetë dhe vepër. Kërkësën e poetit që *njeriu të vdesë i ri* në kuptimin që të mbetet i pastër dhe i qëndrueshëm për humanizmin e tij, e heton të përmbysura në ciklin e fundit *Revolta*, ku jeta kuptohet nga ky subjekt si Lojë, Mashtrim, Mërzitje, Vrasje e Revolt. Konstaton një revolt të subjektit poetik ndaj fenomeneve të jetës. Në anën tjetër, kur analizon ciklin *Vrasje*, ndesh një

revoltë tjetër, që e konsideron kërkesë për riafirmim. Vjershën e lexon si të folur aktiv revoltues për veprën dhe fatin e poetit të njohur Lasgush Poradecit. Ndryshe nga interpretimi i kritikës që i është bërë poetit lidhur me Lasgushin, Rugova e konsideron si element përbërës të poezisë së Hamitit. Vjershën e lexon si një zbërthim të veprës së Lasgushit dhe jo si një kushtim i rëndomtë. Do të thotë, kjo lidhje është krejt ndryshe. Konkretisht, Rugova e lexon si revoltë artistike për artin, prandaj edhe e vlerëson si ciklin qendror të librit edhe në planin tematik dhe artistik. Njëherit në këtë cikël vëren edhe fuqinë e Hamitit që e vë poezinë në funksion të kritikës për poezinë. Fuqi kjo që i provon vetëdijen poetiko-historike të poetit.

Librat e Sabri Hamitit janë të lidhur me njëri-tjetrin, duke bërë kështu që të kuptohen më mirë, kur lexohen me rend. Kështu libri i dytë *Faqe e fund* titullohet njëjtë me vjershën që përmbyll librin e parë. Këtë bashkëpunim të librave, Rugova e lexon si një ndërlidhje tematike, artistike, strukturuese dhe formësore. Do të thotë, vjersha që bartet nga vepra e parë në këtë vepër për merr funksionin e hapjes së një problemësie vazhduese, një kontinuitet logjik poetik. Ndërsa, libri në vete përmban segmentin jetësor të subjektit poetik midis këtyre dy kategorive fundamentale të ekzistencës.

Ironia dhe revolta janë shenja të përhershme të poezisë së Hamitit. Në veprën *Faqe e fund*, Rugova analizon ironinë si një prosede i vazhdueshëm i poetit. Revolta mjaft e theksuar në dy librat për të artikulon rritjen e ironisë. Duke u përqendruar tek ironia, Rugova heton një gjendje të brendshme ironie kur analizon detajisht ciklet e librit, vjershat veç e veç. Ironia sipas tij del e lidhur me njohjen dhe vetënjohjen.

Rugova studion sistematikisht ndërlidhjen sistematike të librave të Hamitit. Kështu veprën e tretë *Thikë harrimi* e sheh të hapet me poezinë përmbyllëse të librit të mëparshëm *Thika*, i cili mbyllet me poezinë *Harrimi*. Për dallim nga vepra e mëparshme, tek e cila kërkimi del si esencë, këtu vëren më shumë veprimin midis kategorive: thikës, që në poezi bëhet simbol-kategori, dhe harrimin, si element të ekzistencës shpirtërore e mendore të njeriut.

Veçanti tjetër të kësaj vepre Rugova e thekson mënyrën e organizimit. Analizon ciklet dhe nënciklet e saj, duke hetuar një kuptim të qëndrueshëm të tyre, si cikle jetësore që fillojnë nga lindja e tutje. Idenë e këtyre cikleve, Rugova e vëren të shtrohet që nga libri i parë.

Të gjitha ciklet e veprës, që përçojnë idenë e cikleve të jetës, Rugova i heton të lidhura me vdekjen e të realizuara në jetë përmes subjektit poetik. Pra, si esencë e poezisë së Hamitit del mendimi se vdekja gjendet në çdo cikël të jetës. Në këtë rrugë, Rugova vëren që është subjekti poetik, i cili vendoset në një objektivitet, për të thelluar fillimin dhe fundin e njeriut. Këtë specifikë të poetit e konsideron të realizuar përmes gjuhës poetike dhe përmes teknikës së përshkrimit të subjektit poetik.

Mbi këtë çështje, Rugova mendon se Hamiti me këtë cikël përmbyll një cikël të poezisë së tij, ku subjekti poetik realizohet në tri situata të mëdha ekzistenciale, të

realizuara në veprat e analizuara. Por, heton që vjersha e fundit *Harrimi* paralajmëron hapjen e një cikli tjetër të poezisë me situata të tjera.

Pikëpamja e Hamitit në librin *Thikë harrimi* është në njëfarë mënyre edhe vetë pikëpamja e Rugovës, që *harrimi është thikë*, se koha është ajo që e kundërshton këtë fenomen njerëzor e kozmik, përkundër thënies së zakonshme se “harrimi e shëron”. Duke çmuar idenë e Hamitit se harrimi është një mungesë, i referohet termit të Setosë, për ta quajtur *absentia individualis*.

Ndërkaq, duke e ditur që vepra e Hamitit zotëron një sistematikë të cikleve, në vjershën *Harrimi*, Rugova heton një paralajmërim të ciklit të ri të interesimeve me vargun “çile një lule në gurë harrimi”, duke e menduar të korrespondojë semantikisht me vargun e vjershës *Trung ilir*.

Ndërkaq, *Trungu ilir* Rugova e konsideron një vazhdimësi të ideve poetike nga librat e mëparshëm. Vëllimi i ndarë në dy libra *Trungu* dhe *Koha*, për kritikun tonë paraqesin dy kontekste të mëdha kohore të ekzistimit të qenies në hapësirat historike dhe në hapësirat bashkëkohore. Duke e pasur parasysh ndërlidhjen e librave, Rugova zbërthen të dy librat e vëllimit, për t’i nxjerrë esencat. Kështu, në librin e parë vëren një thyerje të harrimit individual-historik, kryesisht të historisë së ekzistencës ilire, çfarë edhe i sinjifikon titulli sintagmatik, pra dallon një ambient të ri të subjektit poetik. Në këtë rrugë, Rugova heton kërkimin e qenësisë e të qenies në procesin kohor, shenjzimin e esencave historike, që në poezi konsideron të bëhen esenca poetike. Vëren edhe zbërthimin e disa shenjave të errëta antike, për krijimin e shenjave poetike. Në gjithë këtë kërkim të Hamitit, duket qartë kënaqësia e Rugovës, që poeti i tij nuk ka kërkuar të bëjë histori apo historiografi, po ka ndjekur parimin modern të perceptimit të së kaluarës si pjesë të qenies.

Rugova analizon nga rrënjët veprën e Hamitit, duke e parë të ngritur metaforikisht nocionin ontologjik *Trungu*. Ky nocion sipas tij del nga konteksti i kohës bashkëkohore, si një alinacion historik dhe bashkëkohës. Heton këtu një parabolë ekzistenciale midis këtyre dy skajeve, të historisë dhe bashkëkohësisë. Parabola e ndihmon të lidhet me konceptin e thënë të filozofisë së ekzistencës, se midis bashkëkohësisë dhe Antikës problemet njerëzore janë identike. Këto probleme, mendon Rugova, fare pak kanë ndryshuar në kontekste të ndryshme kohore, që është koncept universal për Antikën e bashkëkohësisë, të cilën te Hamiti e sheh në shembullin e antikës shqiptare, ilire, si njëra nga antikatat qendrore evropiane. Në këtë kalim të subjektit poetik në kohën antike, Rugova konsideron se ky subjektivon maksimalisht për të vendosur lidhjen kohore ekzistenciale, nga pozita e kohës së vet që i sinjifikon libri i dytë i vëllimit *Koha*. Koha merret me esencat e kohës moderne, që del si kohë triviale, konkrete. Ndërsa, këto dy kontekste kohore, Rugova vëren që i ironizon subjekti poetik, duke krijuar një ironi historike dhe një ironi konkrete. Do të thotë, për Rugovën, pjesa e parë librit përshkohet nga hidhësia epike e ekzistimit, ndërsa pjesa e dytë nga një hidhësi konkrete aktualiteti.

Rugova evidenton se *Trungu ilir* ndahet në dy libra, i pari titullohet *Trungu*, i cili ka gjashtë cikle, dhe fillon me vjershën *Gjuha*, që Rugova e lexon si simbol të

dëshirës për komunikim, dhe të mbaron më vjershën *Katarza*, tek e cila ku heton një çlirim komunikues; ndërsa, Libri i dytë, *Koha*, i cili ka shtatë cikle, fillon me vjershën *Epitaf*, dhe mbaron me vjershën *Dhjata*, ku Rugova vëren të frymojë një kohë, një botë moderne.

Në këtë vështrim monografik shohim se kritikut tonë i ngjall interesim të madh niveli tematik i gjithë poezisë së Hamitit. Duke e vlerësuar këtë aspekt dhe kuptuar plotësisht Rugova, ndryshe nga çdo vështrim dhe hulumtim tjetër, bën një katalog të disa fenomeneve poetike, që janë pra elemente tematike të poezisë së Hamitit. Pra, bën klasematikën e tyre, duke konsideruar se këto tregojnë pasuri poetike. Po ashtu, duke bërë klasematikën e tyre, mendon se këto fenomene dalin si vlera absolute, vendimtare në poezi. Rugova, tash do të vështrojë ato fenomene që përfaqësojnë ide e probleme poetike në zhvillim e sipër.

Element më të rëndësishëm në sistemin poetik të Hamitit e konsideron dukurinë e *restrukturacionit*. Heton pra që poeti së pari e strukturon një fenomen, pastaj atë e ristrukturon, duke e vë në kontekste të reja të interesimeve. Këtë shndërrim në përgjithësi e quan *folologji poetike*, sipas një termi filozofik të Derridasë.

Elementin e dytë të rëndësishëm për raportin Lindje-Vdekje-Jetë e konsideron *konceptin e Nënës, Nanës*. Pra Nëna, në poezinë e Hamitit, del si një koncept bioekzistencial, si origjinë të qenies njerëzore. Kultin e nënës e vëren të ngritur në të gjitha librat e Hamitit, duke e parë të bëhet një mit veprues.

*Kujtimi* është elementi tjetër i hetuar nga Rugova, që këtu merr formën e një kategori njohëse, vlerësuese, për mbajtjen e kujtesës, të memories. Hamiti insiston në këtë kategori, sipas Rugovës, për plotësinë e vënies, duke u lidhur me mendimin njohur se e kaluara kontrollon të tashmen, dhe se kujtimi është aktiv dhe veprues në aktet e gjalla të ekzistencës.

Rugova vazhdon të nënvizojë fenomene, duke e dalluar kuptimin si koncept të insistimit, të subjektit poetik për një komunikim të plotë brenda qenies dhe jashtë saj, kuptimin pra si bartës të asaj që themi. Sipas tij, për Hamitin zotëron mendimi se pas kuptimit nuk ndihen gjërat dhe fenomenet, madje as Vetja, por nga poezia e tij vëren se kuptimet kanë humbur fuqinë e tyre, përmbajtjen humane si pikë e parë e komunikimit.

Në ciklin *Trungu ilir* Rugova heton një element që realizohet më së miri në këtë libër *sublimacionin antik*. E konsideron këtë fenomen si *tendim* të fuqishëm për zënien e elementeve qenësore të memories ekzistenciale antike. Heton që autori aplikon zbërthimin poetik të problemit kryesisht në planin të brendshëm shpirtëror e intelektual. Konkretisht, vëren një spastrim të objektit poetik, nga të gjitha elementet e jashtme, i cili kërkon ngritje për vlerat e antikës ilire.

*Dielli i zi i ligjërit* është koncepti tjetër që Rugova e konsideron si frekuencë e të folurit poetik, pra koncepti i diellit në gjithë poezinë e Hamitit, sipas tij del si simbol, apo përbërës kuptimor.

Gjatë vështrimit të veprës poetike të Hamitit, Rugova vëren një strukturë të

pastër ligjërimore të logjicitetit popullor. Në këtë kontekst heton edhe mjaft formula poetike të mendimit popullor që në shkencën e letërsisë njihen si *topoi*. Do të thotë, *Topitë e ligjërimet popullor* është elementi tjetër që Rugova do ta nënvizojë në veprën poetike të këtij poeti. E konsideron vlerë këta *topoi*, si dhe inkuadrimin e figurave mitologjike, pasi mendon se ia shtojnë vlerën semantike e autentike poezisë, si element krijues dhe jo dekorativ.

Në poezinë e Hamitit, Rugova ndër tjerash vëren edhe shumë vargje të cilat konsideron se mund të qëndrojnë si *Formulacine poetike*. Do të thotë, heton vargje që mund të qëndrojnë të pavarura, si momente të realizmit maksimal midis pajtimësisë së idesë, objektit dhe thënies.

Duke hetuar dhe interpretuar elementet tematike të sistemit poetik të Hamitit, Rugova fokusohet në vështrimin e vlerave prozodike dhe metrike. E konsideron si kualitet çështjen prozodike të poezisë së këtij poeti, pasi mendon se imazhi tingullor i saj është shumështrësor e funksional dhe në pajtim me vlerën semantike të ligjërimet poetik.

Vështron shkurtimisht pasurinë metrike të poezisë së Hamitit, duke menduar se kjo çështje do vështrim tjetër, më të veçantë. Kështu, heton që poeti përdor me funksion rimën si kategori tingullore e semantike, e cila ngrit fuqinë e ritmit. Prandaj, mendon se bëhet fjalë për një ritmikë të rrallë në gjithë poezinë bashkëkohore shqiptare.

Në këtë drejtim vlerëson edhe ndërtimin sintaksor të vargut, duke hetuar që Hamiti bën një varg të spastruar nga shtesat e ndryshme gjuhësore, që e ngarkojnë vargun. Mendon se e arrin këtë qëllim duke e fuqizuar semantikisht vetë fjalën e pastaj duke e inkuadruar atë si element përbërës të vargut, herë-herë në formë autonome.

Pra, në rrafshin e analizës se planit sintaksor, prozodik e metrik, Hamitin e mendon si ndër poetët tanë të rrallë të poezisë bashkëkohore. Ky aspekt i ri, pra i prozodisë, konsideron se i jepi vlerë jo vetëm e poezisë së tij, por edhe e asaj bashkëkohore shqipe marrë në tërësi.

Rugova zgjedh Hamitin për interpretim ndër tjerash edhe për të parë kërkesën për një pajtimësi adekuate midis klasicitetit-esencave të artit klasik dhe modernitetit-esencave të artit të sistemeve moderne nga simbolizmi e këndeje. Pra, kur shikon opusin poetik të tij, vëren klasicitetin në idenë dhe praktikën e formëimit të poezisë, dhe në insistimin që imazhi poetik të jetë sa më i fortë, më i qëndrueshëm dhe i bindshëm. Te ky autor edhe idenë e sistemit e vlerëson si esencë klasike, duke menduar se strukturohen ndërlidhshëm idetë dhe problemet.

Pas analizës së detajuar tekstuale, duke hulumtuar çdo fenomen, në çdo varg të Hamitit, Rugova përfundimisht e konsideron poezinë e tij, moderne. “Me modernitet në këtë poezi kuptojmë tendencën e autorit, që të jetë në frymën e problemeve artistike e tematike të kohës, që poezia të jetë edhe ashpërsi e shpirtit



dhe e intelektit, çfarë përfaqësohet nga tipat e shumta të ironisë duke filluar nga revolta e deri te tragjiciteti i shkrimit dhe i formulimit”.<sup>63</sup>

Përfundimisht, këtë tendencë të autorit e sheh të aplikuar te shumë poet të njohur bashkëkohorë të letërsive të shquara, duke konsideruar kështu që në poezinë tonë është ndër shembujt më të mirë dhe më të realizuar.

---

<sup>63</sup> Ibrahim Rugova, vep e cit., f. 287.

## BOGDANI SIPAS RUGOVËS

### Rugova dhe vepra e Bogdanit

*Vepra e Bogdanit (1675-1685)*<sup>64</sup> e Ibrahim Rugovës është rezultat i një hulumtimi të gjatë dhe sistematik. Rugova, kur po bënte një hulumtim të materialeve të filleve të kritikës shqiptare, „takoi“ Bogdanin dhe veprën e tij, vepër ndër më të mëdhatë e letërsisë shqipe. Ky zbulim për Rugovën shënon *moment*, shënon ngjarje madhështore në kulturën tonë, sepse është vepër që nënkupton kërkime filozofike-shkencore, filozofike-teorike, kërkim në çështje të ndryshme: metaforat, tropologjitë, figurat e ndryshme të retorikës dhe disa aspekte të poetikës.

*Çeta e Profetëve*, që është vepra e parë autoriale e shkruar shqip, studiuësit tonë i ngjall emocione deri në fascinim, i sjell entuziazëm, të cilin e krahason me entuziazmin e ngjallur të Lasgushit dekada më parë. Por, Rugova e kshite menduar si entuziazëm rasti nga ana e Lasgushit, gjersa tash zbulon se vepra do të mbetet përherë entuziazmuese për lexuesin e ri, për nga vlera dhe problemet e trajtuara. Dhe, drejt kësaj rruge, drejt hetimit dhe zbërthimit të kuptimit sot të veprës së Bogdanit, Rugova paraqet studiuësin më të rëndësishëm. Teksti i Bogdanit shkrihet në tekstin e Rugovës. Të gjitha këto veçori të studimit të Rugovës do t'i trajtojmë në vazhdim, ndërsa tash i kthehemi kontekstit në të cilin e zbulon ai këtë vepër dhe synimin që ka për afirmimin e saj në Pishtinën e viteve '80 të shekullit njëzet.

Akti i njohjes së Rugovës me veprën e Bogdanit lind si rezultat i një procesi sensitivo-semantik, ndërsa motivimi si magjepsje pas leximit të veprës. Magjepsjen e arsyeton racionaliteti, e arsyeton vepra e kompleksiteti i saj. Pra, Rugova në komunikimin me Bogdanin ndjek rrugën prej idesë-intuicionit, deri te kritika për veprën, pra që subjektiviteti të marrë formën e objektivitetit. Kur dijetari Rugova magjepset me këtë vepër, s'do mend se kemi përpara një vepër madhështore.

Mbi këtë ide jemi nisur të studiojmë veprën e madhe të Rugovës, me objekt studimi veprën e madhe të Bogdanit. Të gjitha fenomenet e zbuluara hapen në rendin metodologjik struktural të Rugovës. Kështu, Rugova e studion të plotë veprën, e hulumton gjenetikën e saj, për të interpretuar analitikën. Do të thotë, vështrimi i tij për *Cuneusin*, njëherë do të jetë paraqitës, pastaj do të jetë analitik, duke u ndalur më shumë te kjo pjesë. Hetimi i gjenetikës Rugovës i krijon mundësi

---

<sup>64</sup> Deri më tani për këtë vepër kanë shkruar: Anton Nikë Berisha, Sabri Hamiti, Shaban Sinani, Kujtim M. Shala etj. Shih *Literaturën (Korpusi studimor)* në fund të punimit.

më të madhe për analizimin e poetikës ose analitikës. Gjenetika këtu përdoret si mekanizëm i poetikës.

Studimit të Rugovës i prin si referenca *Letërsia evropiane dhe Mesjeta latine* të Robert Kurtiusit (referencë që më shumë realizohet në pjesën e parë të librit, duke e ditur që edhe kërkimi ka karakter më shumë filologjik), vepra *Sade, Fourier, Loyola* e Bartit (të cilit i referohet në pjesën e dytë të tekstit, kur e analizon si libër struktural letrar) dhe *Poetika e letërsisë së vjetër ruse*, e Lihaçovit. Autori thekson më konkretisht se merr si bazë metodologjike autorët e përmendur, për të përforcuar dhënien e informacionit për veprën, duke dashur ta vendosë në kontekste teorike të kohës dhe të rezultateve të sotme teoriko-letrare.

Pasi synimi fillestar i *Veprës së Bogdanit* të Rugovës, ishte afirmimi i librit në Prishtinën e viteve '80, meqë vepra njihej pak në opinion, autori ndjek si parim metodologjik që problematika e veprës të mos mbetet e lidhur vetëm me kontekstin e saj historik. Pra, ka për qëllim planin paraqitës të veprës, plan ky qenësor i thelluar, i cili argumentohet përmes analizës së brendshme. Themelore për Rugovën është aktualizimi i ideve dhe problemeve të Bogdanit, në kontekst bashkëkohës. Zgjedh si rrugë modernizimin terminologjik e disiplinuar, që idetë dhe problemet e veprës së Bogdanit të mos humbin esencialitetin e vet.

Rugova, duke e ndjerë thellë veprën e Bogdanit, "momentet", pikat e saj themelore i shqyrton nga këndi kritik dhe teoriko-letrar. Duke kërkuar përfundimisht çdo shenjë të tekstit të Bogdanit, para se të hyjë fuqishëm në analizë e interpretim, na ambienton me llojin e hulumtimit, me gjuhë e stilin e vjetër të shkrimit shqip.

### Gjenetika e veprës

Para se t'i vështrojë më nga afër çështjet e *Cuneusit*, Rugova jep një pamje të përgjithshme të letërsisë së vjetër shqipe. Aktualizon kontekstin prej nga ka dalë objekti i tij i studimit, vepra e Bogdanit. Vështrimi i takon llojit të informacionit historiografik, ku dominon ideja që veprat e krijuara në këtë letërsi të bëhen objekt i interesimeve në kulturën bashkëkohore. Autori insiston që letërsia e vjetër shqiptare të bëhet objekt studimi jo vetëm i historisë së letërsisë, por edhe i kritikës dhe teorisë së letërsisë. Në kuadër të këtij insistimi, Rugova bën një studim më të thelluar të letërsisë së vjetër, më analitik e historik. Synimi ka si esencë ndriçimin e idesë se letërsia e vjetër ishte një letërsi aktive, me idetë, me artin e vet, e jo pasive, si një dokument formal i ekzistencës kulturore. Me këtë kërkesë, pjesën e parë të librit Rugova e ndërton mbi këto shtylla tekstore: I. *Letërsia e vjetër: Ide dhe probleme*, II. *Autori*, III. *Figura intelektuale*, IV. *Vepra*, V. *Informacione historiografike*.

Njëherësh, termin *letërsi e vjetër* Rugova e përkufizon edhe si letërsi mesjetare. E përkthen kështu që ta përafrojë me letërsinë evropiane të asaj kohe, sepse shekujt

X

V

I

-

-XIX për të përmbajnë në vete problematikën e Mesjetës së vonshme. Në kërkimin të letërsisë së vjetër shqiptare qëllim tjetër i autorit është ta konkretizojë këtë letërsi në kohën kur ndihet ndikimi i Humanizmit dhe i Renesansës në art e në letërsi, fillimet e konstituimit të racionalizmit, empirio-sensualizmit dhe fillimet e iluminizmit në filozofi. Do të thotë, e vështron letërsinë shqipe nga konteksti kulturo-historik dhe ai socio-historik.

Nga ky kënd i vështrimit, pika kryesore të letërsisë sonë të vjetër i konsideron Barletin, Buzukun dhe Bogdanin. Këta do jenë theksuar si tri shkallë të zhvillimit dhe të pasurimit të letërsisë sonë. Me shfaqjen e veprave të tre autorëve të përmendur, Rugova dallon shenjat e para të dëshmisë së kohëve të reja, pas Renesansës. Në bazë të vështrimit të tillë, në radhë të parë duke kërkuar elementet e para të mendimit për letërsinë dhe kulturën shqiptare, Rugova veprën e Bogdanit e konsideron librin e parë me probleme filozofike, shkencore dhe teologjike të kohës së vet. Mendimin e Bogdanit e inkuadron te mendimi i përgjithshëm i Renesancës në filozofi e të reformës në planin teologjik.

Këtu ndalet shkurtimisht në vështrimin e zhanrit dhe të formës së veprës së Bogdanit, Barletit e të Buzukut. Derisa te Barleti dallon biografinë e romanësuar, fragmentet poetike e filozofike të gjuhës te Buzuku, te Bogdani i dallon format e përziera: së pari trajtesën shkencore filozofike, biografinë e romanësuar, të cilat dalin si forma letrare, si dhe thekson zhanret që dalin te teksti i Bogdanit si proza e poezia.

Rugova heton vlerat e letërsisë së vjetër shqipe, duke e parë të dalë nga një traditë e quajtur "hasjane" - nga kjo traditë del Barleti, Beçikemi, Frangu, Bardhi etj. - me tendenca për një pavarësi në planin kulturor e teologjik. Qëllimi është të theksojë se nga kjo traditë del vepra e parë origjinale *Çeta e Profetëve* e Pjetër Bogdanit. Pra, heton në këtë rrugë, rrënjët e Bogdanit, për të dhënë dëshminë se vepra është historikisht rezultat i përpjekjeve mëse dyzetvjeçare, dhe gur themeli për brezat e ardhshëm.

Gradualisht Rugova e ndërton figurën e Bogdanit, figurën e intelektualit. Shenjon jetën e tij që nga lindja, ballafaqimet e tij në raport me dijen e kulturën, jetën vepruese të tij, duke e paraqitur intelektualin që kishte qëllim pasurimin e kulturës përmes kontaktit me dijen evropiane të kohës.

Problem tjetër esencial që parashtron Rugova është konceptioni dhe orientimi filozofik i Bogdanit, që thekson se "feja pa dije nuk mund të qëndrojë".<sup>65</sup> Në bazë të vërtetimit, Rugova nxjerr si konstatim se tendenca e tillë e dijes, përcillet që nga *Meshari* i Buzukut, por që të autori i tij - Bogdani, vërehet më e shprehur e më drejtpërdrejtë. Pra, nga këto përfundime shohim se Rugova gjithmonë vlerat e Bogdanit i nxjerr si trashëguese të një tradite të mëhershme, pra të letërsisë së vjetër, duke argumentuar çdo herë që kjo letërsi nuk është vetëm dokument, por përfaqëson një kulturë mesjetare.

---

<sup>65</sup> Ibrahim Rugova: "Vepra e Bogdanit (1675-1685)", Faik Konica, Prishtinë, 2005, f.45.

Pikëshikimi për motivin e shkrimit të veprës së Bogdanit është një tjetër vështrim me natyrë biografike i Rugovës. Duke e kuptuar se ky motiv buron nga dy anë, nëpër një vijë ngritëse, do të thotë motivi subjektiv ngrihet e bëhet ide, por edhe si motiv i jashtëm. Njëherit, duke e konsultuar parathënien e veprës së Bogdanit, heton se ai këtë ide dhe motiv e ka mbajtur në vete, duke e ndjerë si nevojë ta shkruante. Ky motiv, parë kështu, del i kultivuar sipas teorisë mesjetare për shkrimin si kult dhe idenë për librin absolut. Nga ana tjetër, duke vështruar krijuesin në aspekt psikologjik, mendon se Bogdani, duke u nisur nga ideja e librit si finalitet, e mbajti gjatë në vete motivin e shkrimit dhe ky motiv u kushtëzua nga motivi i jashtëm. Fuqia e tij krijuese, sipas Rugovës, shpërthen atëherë kur motivin e fuqishëm të brendshëm të shkrimit e thyen motivi i jashtëm.

Mjaft interesant në vijën e këtyre diskutimeve është vlerësimi i Rugovës mbi personalitetin e Bogdanit në letërsinë shqipe, si shtytës i thyerjes së mitit të anonimisë dhe i modestisë së autorit, karakteristikë që mendon se praktikohej në Mesjetën e hershme. Sipas tij, është autori i parë në kulturën shqiptare që la fakte për jetën, për veprën dhe kohën në të cilën veproi. Mbi këtë fakt e sheh të inkuadruar në pikëpamjet e kohëve të reja, pra mbi aprovimin e personalitetit të autorit-njeriut.

Rugova, duke u njohur edhe me shkrimet për Bogdanin, vëren se vlerësimet kanë mbetur në nivel përgjithësues historiografik dhe historik, duke hetuar që pak është bërë në analizën konkrete të veprës. Kështu që, në këtë rrugë, duke konstatuar se pjesa më e madhe e punimeve është marrë me çështje dokumentuese e biografike, i rreket një pune krejt ndryshe, për të analizuar veprën dhe për ta aktualizuar atë në Prishtinën e viteve 80-të.

### **Analitika e veprës**

Pjesa e dytë e librit, *Analitika e veprës*, e zë pjesën më të madhe të librit. Te kjo pjesë Rugova interpreton çdo shenjë të veprës së Bogdanit, duke e ilustruar sipas pikëpamjes së tij. Do të thotë, është pjesa më analitike në të cilën zberthehen probleme të ndryshme teoriko-letrare e filozofike-estetike.

Në vijën e interesimeve tona, ndër kryesoret është takimi i mendimeve të këtyre dy autorëve mbi disa aspekte. Rugova ka në qendër të interesimeve zbulimin e dijes së Bogdanit, metodat e aplikuara, ndërsa pikëvështrimi yni është të vihet në dukje qasja e Rugovës ndaj kësaj vepre. Dhe, në bazë të rezultatit të vështrimit, mund të konkludojmë se objekti ynë i vështrimit (Rugova) dhe objekti i vështrimit të Rugovës (Bogdani) bashkohet në shumë aspekte, i bashkon dija, diskursi, formimi, referencat etj. Prandaj, në mjaft pika duke e lexuar njërin, ne e lexojmë edhe autorin tjetër.

Kështu, për t'i vështruar në mënyrë sa më të drejtë çështjet e preokupimeve të autorit tonë, duhet theksuar dhe ndjekur çdo gjykim të tijin, çdo kapitull, titull e nëntitull, nga ku dalin përgjithësime të mëdha. Duke proceduar në këtë mënyrë,

evidentojmë se pjesa e dytë e studimit të Rugovës përbëhet nga këta kapituj: *I. Praktika filozofike, II. Koha dhe hapësira, III. Praktika teoriko-letrare, IV. Stili dhe tipet e ligjëratës, V. Të përgjithshme, VI. Tema e arti i Mesjetës në letërsinë e mëvonshme, VII. Përfundime*. Të gjithë kapitujt e kësaj pjese janë të ndarë sipas principit tematik e problemor. Në kapitullin e parë të pjesës së dytë të studimit, në *Praktikën filozofike*, shtrohen dhe analizohen problemet kyçe të interesimeve të Rugovës. Që këtu vërehet kërkesa e autorit për të riaktualizuar fenomene në studimet e sotme. Rugova mendon kështu, pasi që praktikën filozofike të Bogdanit e lidh me filozofinë e Mesjetës, duke i menduar si probleme që duhet aktualizuar.

Me këtë kërkesë lidhet edhe zgjedhja e autorit për ta hetuar veprën që nga struktura e saj, në aspektin ontologjik e gnoseologjik, pastaj në temat e astrologjisë, analogjik dhe semantik.

Për të realizuar dhe ngritur sa më shumë praktikën poetike, ai e analizon fillimisht planin kompozicional të veprës, duke njohur si projekt ideor të këtij plani konceptin organizativ të *Biblës*, me dy pjesë kryesore, *Dhjatën e Vjetër* dhe *Dhjatën e Re*, që te Bogdani del: *Cuneus prophetarum* dhe *De vita Iesu Christi slavatore mundi*, ndërlidhje e cila shfaq idenë e librit sipas Rugovës. Pra, si në *Bibël*, pjesa e parë është e hapur, ndërsa pjesa e dytë, që merret kryesisht me jetën dhe vdekjen e Krishtit, është më e mbyllur. Duke ndjekur konceptin e përgjithshëm të *Biblës* - gjenezën e botës, interpretimin e fenomeneve të saj, shfaqjen e njeriut, paralajmërimin e profetëve për ardhjen e shpëtimtarit të botës - Rugova kupton se Bogdani ka dashur të ruajë natyrshmërinë e ardhjes së qenieve, të ardhjes së Krishtit, duke dashur të krijojë një shqyrtim të thellë e të gjithanshëm filozofik, teologjik e shkencor.

Ndërsa heton strukturat në radhë të parë, te vepra e Bogdanit, Rugova vëren një traktat filozofik e shkencor në kuadër të teologjisë dhe me sistem të fortë të organizimit. Këtë sistem të klasifikimit dhe të strukturimit të materies, Rugova me të drejtë e quan sistematikë bogdaniane, duke e konceptuar si një logjikë shumë-sistimore, prej të cilës del sistematika e Idesë. Pra, në këtë vijë analitike për më shumë heton në gjithë veprën harmoninë e plotë të Idesë-Strukturës-Mendimit. Madje, si një semiolog i orëve të para kërkon idetë nëpër ide, përmes procesit të shenjzimit-sinjifikacionit.

Me një fjalë, vepra e Bogdanit për Rugovën është një praktikë filozofike, një filozofim i pasur dhe i thelluar me argumente mbi krijimin, jetën dhe përvojën njerëzore. Këtë praktikë filozofike e lidh me teorinë e Mesjetës, të cilën e afirmon dhe plotëson më tej Hegeli, në kuptimin e plotësimit të një filozofie skolastike. E, sipas tij, në esencë kjo teori është teologji, me synim qendror afirmimin e religjionit të ri, kristianizmit.

Duke pasur në mendje raportin e kësaj epoke me epokën e Renesansës, si diskontinuitet brenda kontinuitetit, dhe mbi sfidimin e të dytës, mbi këtë filozofi nënkategorinë e negativitetit të kuptimit të teologjisë dhe të skolastikës, Rugova zgjedh historianin dhe teoricienin frëng (me prejardhje ruse) Aleksandër Koire, për të hetuar problematikën e Bogdanit dhe raportin e saj me *filozofinë e Mesjetës*.

Vështruar kështu, thekson se *filozofia skolastike* dhe *skolastikët* janë ata që përmes punës së tyre i lejuan Perëndimit të vendosë kontakt me veprën filozofike të Antikës. Në përgjithësi, për nga problemet që shtrohen dhe shqyrtohen lidhur me filozofinë e Mesjetës, Rugova e konsideron si finalitet dhe kauzalitet të saj final filozofinë e Zotit, arsyetimin e ekzistencës së Zotit dhe eksplikimin e tij. Në të vërtetë, në këtë filozofi konsideron dominate dy rrymat që vijnë nga Platoni (mbi nocionin e *shpirtit*) dhe Aristoteli (mbi nocionin e *natyrës*), të cilat lidhen te filozofia e Shën Augustinit dhe e Shën Toma Aquinit.

Përpjekja e Rugovës për definimin e veprës së Bogdanit sillet brenda interesimeve për filozofinë e Mesjetës, për pararendësit dhe pasrendësit e saj. Duku u nisur nga kjo përvojë, konstaton se burimet filozofike të veprës së Bogdanit bazohen esencialisht në filozofinë mesjetare, por heton edhe elemente të reja që ishin plotësuar në kohën e tij. Kështu, në konceptin e tij Zoti del si Formë, Qenie e amshueshme, Qenie absolute, qenie në vete dhe për veten. Por, Rugova në brendi të kësaj Qenieje, heton të selitur parimin e lëvizjes së quajtur *krue i gjallë*. Sipas tij, kjo shpjegohet në parimin e dialektikës, ku çdo gjë rrjedh, qëndron, lëkundet e mbahet. Ndërsa, në kuptim metaforik, mendon se jep forcën e brendshme dialektike të Zotit. Në këtë kuptim, Zoti është përfaqësimi i të Mirës, i Mendjes, i Dritës dhe i Krijimit. Sipas Rugovës, Bogdani atij ia mvesh të gjitha atributet pozitive si kushte dhe parakushte për të bërë *veprën e mirë*, në kuptimin filozofik. Duke vështruar praktikën filozofike të Bogdanit, Rugova kalon në esencën e ligjëratës së librit, që është ligjërata e parë, e cila titullohet *Qenia e pavarur (Ente Indepedente): Zoti*.

Rugova do t'i kushtojë vëmendje edhe historisë së ekzistencës së Zotit të Bogdanit, që e kërkon për ta zbuluar Esencën e ekzistencës. Kërkimin e nis që nga mitologjia e historia, d.m.th. nga refleksioni i parë njerëzor, duke kaluar në filozofinë antike të Platonit, për të dhënë arsyen e ekzistimit të gjërave si arsye të mjaftueshme të të qenmit të vet. Për Bogdanin ekzistenca e kësaj Esence njihet përmes dritës së besimit. Tërë këtë e arsyeton me teorinë teologjike, që te Bogdani merr rezon filozofik.

Si bazë teologjike të veprës së Bogdanit Rugova e merr *Imanencën: Trinitetin*. Së pari niset nga koncepti se Zoti është një Formë, që në vete prodhon forma të tjera. E gjithë kjo ndërtohet mbi bazën e Trinitetit: së pari brenda Zotit lind Ati e prej tij Biri e prej të dyve lind Shpirti i Shenjtë, që është një lidhje bashkuese midis tyre, por secili prej tyre është Zoti. Sipas Bogdanit qenia është e lidhur, pra brenda Qenies së tij totale, të cilën, për ta njohur, duhet drita e religjionit. D.m.th. ai flet për një singularitet të Zotit (një në natyrë) dhe pluralitet të brendshëm të tij (tre në vete). Dhe në këtë kontekst, Rugova shkruan se Bogdani e ilustron me trinitetin e numrit të Pitagorës, pastaj me Aristotelin, Timegjistin e në fund me Platonin, pastaj vëren një strofë që Bogdani e merr nga Ekloga IV e Virgjilit.

Teorinë për trinitetin e Zotit të Bogdanit Rugova e gjykon të konkretizuar e të mbështetur në iluzionin pasqyrues. Së pari, termi pasqyrë te ky autor përdoret si mjet ilustrues për shpjegimin e abstraktes në raport me realen. Termi pasqyrë, nga

latinishtja *speculum* - pasqyrë, që në filozofi dhe në disa fusha të tjera ka dhënë termin *spekuloj*, përdoret për filozofinë e sferave abstrakte, por edhe në kuptim të drejtë. Nga kjo u krijua teoria e *reflektimit* apo e pasqyrimit. E parë kështu, te Bogdani kjo teori e merr trajtën: Zoti është Një, posi tri drita që paraqesin Një reflektim. Pasqyra përdoret si mjet për të dhënë koncept teologjik e filozofik.

Duke folur për Zotin, për fuqinë e brendshme riprodhuese të tij, Bogdani, sipas Rugovës, thekson krijimin e jashtëm të tij, në kohë e në hapësirë. Thekson fuqinë e krijimit, që e cilëson me krijimin e botës: kozmosit, tokës, natyrës dhe të njeriut. Vepra e tij, pra e *krijuara*, vepron jashtë tij, po gjithnjë me forcë të tij, sepse ai është krijuesi i saj.

Filozofia e natyrës është pretendimi tjetër i Rugovës për ta parë te ky autor. Këtu dalin në shesh mendimet për *Rruzullimin (Universi)*. *Planetet, Pushtetin e yjeve, Diellin, Tokën (Dheun)*, fenomene këto natyrore, të cilat Rugova konstaton se shpjegohen mbi baza shkencore të epokës, ashtu si shpjegohen sot në meteorologji e në gjeografi. Gjithashtu, vëren se pikëpamja e Bogdanit mbi zënien e diellit e të hënës është gjeocentrike, afër konceptit heliocentrik. Kështu pra Bogdani i tij, argumenton çdo fenomen shkencërisht, duke rrënuar besëtytnitë e paragjykimet e ngritura mbi këto elemente e fenomene natyrore.

Filozofinë e natyrës së Bogdanit Rugova e konstaton të ndërtuar nga këto pika: 1. *Druri i Dijes. Druri i jetës*, 2. *Stoicizmi*, 3. *Trupi-shpirti*, 4. *Natura naturans-Mimesisi*, 5. *Njeriu qenie*, 6. *Mendja-vetënjohja*. Pra, në këtë kontekst, del mendimi i dyfishtë se, për krijimin e njeriut, Zoti e mori në pajtimësi më vete, sepse, sipas versionit teologjik, ajo është krijesa më e përkryer dhe vepra më e madhe, më e mirë dhe më e bukur e Zotit. Po ashtu, Rugova nënvizon edhe në këtë vijë drurin e jetës, drurin e dijes. E thekson për të përmendur drurin që u ishte premtuar Evës dhe Adamit, duke e përdorur si term metaforik, duke menduar se përdoret edhe në filozofi, shkenca dhe në teoritë e tjera, si *teoria e drurit të njohjes*.

Në kontekst të filozofizë njerëzore, Rugova e vëren të trajtuar tek autori i vet edhe çështjen e stoicizmit, si rrymë filozofike që njihet nga antika greke, jo në kuptimin negativ, po përmes mohimit të teprimit në gjëra dhe në kërkesa.

Njëherësh, Rugova bën edhe vështrimin e raportit *trupi-shpirti*, koncept ky ndër kryesorët te Bogdani. Këtu shquhet shpirti si esencë kryesore e trupit të njeriut, që e mban dhe e udhëheq njeriun, e ngjashme plotësisht me Zotin, sepse shpirti vjen nga ai, e trupi nga e krijuara e tij - dheu.

*Shpirti është një jetë e pas sosuni ndepër të pomendunitë, mendtë e volendetnë, më shembelltyret Tinësot, prej Sinëzot asnjiseni krijuem, qi mundet ma bām vepra të mira e me fyhem; e qi mundet me pasë pagetyrenë t'mirave e të keqiavet; i lirë ndë mend, me viryete, me vese e me të dashun mbukuruem. Aqa i madh, sa ma*



*mundet me pas të amëshuem; aqa ma i drejtë, sa mundet me pas e me desheruem të miretë; aqa ma i mirë është shpirti, sa ma pjesë ka Sinëzot.*<sup>66</sup>

Në këtë përshkrim përkufizues të shpirtit të njeriut nga ana e Bogdanit, Rugova mendon se më parë mund të flasim për një identifikim, sesa për ngjashmëri. Pastaj, vëren se Bogdani kërkon harmoninë midis shqisave dhe mendjes, duke e bërë ndarjen në planin gnoseologjik, shqisat: për njohjen e natyrës, kurse mendja për njohjen e Zotit. Në këtë vështrim vëren se autori i tij nuk e pranon teorinë e Pitagorës për teorinë e mendjes.

Në vlerësimin e çështjes së krijimit, autori ndeshet edhe me konceptin *Natura naturans*, si formë e lartë filozofike përmes terminologjisë së saj, term ky që në shqip del si Natyra e Natyrës, ose Natyra krijuese që krijon. Këtë term e sheh të përdorur më parë nga Bruno, i cili natyrën e Zotit i quan natyrë krijuese. Përmend po ashtu edhe Spinozën, i cili Zotin në gjëra e merr si *natura naturans*.

Për çështjen e ngjashmërisë midis Zotit e njeriut, Rugova vëren se Bogdani inkadron problemin e Imitimit (Imitatio), term i njohur si *Mimesis*. Shkurtimisht heton se Imitimin Bogdani e lidh me Natyrën e Aristotelit dhe me Idenë e Platonit. Sipas Rugovës, ai ecën rrugës së filozofëve të vjetër të njohur me parimin se njeriu ekziston në natyrë e natyra është vepër e Zotit. Ndërsa, mendja e njeriut mahnitet para natyrës dhe para Zotit.

Po ashtu, në këtë rrjedhë të diskutimit mund të konstatojmë, sipas vlerësimeve të Rugovës, se njeriu i Bogdanit është qenie tokësore, intelektive dhe shpirtërore.

Kështu, deri tash, brenda klasematikës që e zbaton Bogdani, njeriu merret si kreatyrë, krijesë mbi krijesat e tjera në natyrë. Del pra se njeriu është qenie intelektive dhe shpirtërore, njeriu i Bogdanit është qenie me pavarësi autopersonale. Proces ky që kryhet me mendjen-vetënjohjen. Dhe, për ta theksuar më shumë rolin e njohjes, Rugova heton çështjen e njohjes intelektive, që i lidh tri fusha të njohjes, tre tipa: njohja hyjnore apo kozmike, njohja e botës (natyrë - shoqëri) dhe me vetënjohjen. Do të thotë, sipas gjithë kësaj del që njeriu e ka aftësinë më të lartë dhe më të vështirë-vetënjohjen e që realizohet në raport me idenë dhe me vetveten. Po ashtu, me këtë gjest, konstaton Rugova, se Bogdani afirmon aftësinë e njohjes njerëzore që është rezultati i gjithë qenies së njeriut.

Rugova kur shpjegon fenomenet e Bogdanit, thekson se ai duke qenë mjaft i lirë në parimin analogjik, ai shpesh bën identifikimin e anëtarëve të analogjsë, dhe kështu jep mendime e koncepte më të lira. Kështu, në një kapitull tjetër, interpretimin e raportit Zoti-Njeriu e mbështet në sistemin analogjik, *analogia entis*, që ka të bëjë me ngjashmërinë midis qenieve. Në këtë raport të qenieve, Rugova shtron problemin e marrëdhënieve ontike. Dhe, në ndërlidhjen e këtij raporti heton dy terma: shembëlltyra dhe gasa - gjasimi, ngjashmëria - rolin e të cilave Bogdani e dallon, duke vërejtur se shembëlltyra përdoret për termin figurë e në shumë raste

---

<sup>66</sup> Po aty, f. 114.

përdoret për metaforën. Rugova thekson se termi shembëlltyra përdoret për të nënkuptuar përfytyrimin që vjen nga Zoti.

Autori ynë thekson edhe një herë se gjithë koncepti i analogjisë merr kuptim kur kemi parasysh se për nga forma, natyra, njeriu është si Zoti, por që lodhet me këtë jetë. Pra, Njeriu është imazhi, ideja e Zotit në këtë botë. Ndërsa, termin *gasë*, e sheh si kualitet që mban në vete njeriun si qenie. “Gasa realizohet në raportin e imitimit të qenies në raport me qenien e lartë”, citohet Pol Rikeri, nga *La métaphore vive* (Paris, 1975). Përderisa, shembëlltyra ekziston në këtë botë, mendon Rugova, gjasa, ngjashmëria duhet të kultivohet, sepse pa këtë proces ajo do të zhdukej. Pra, gjasimi si rezultat i kontekstit midis qenieve.

Për formimin e qenies, si pikë esenciale e zhvilluar këtu, Rugova shqyrton edhe një herë *teorinë e uniteteve*, por tash si përkujtim. Pos elementeve të theksuara më heret, të këtij formimi, Rugova heton dhe e kërkon konceptin e unitetit të Bogdanit, dhe si parim esencial teorinë e neoplatonizmit, në të cilën mbështetet filozofia mesjetare e Zotit. Në të gjitha diskutimet e mëhershme të Rugovës, rruga e formimit të brendshëm - imanenca - e Zotit mesjetar del trinore, e cila ngrihet në një shpërndërrim të brendshëm, por së pari me qenien e dhënë. Kështu, sipas tij, del se te Platoni filozofia e tij lidhet me filozofinë e Njëshit, mendim të cilin e thekson edhe te Bogdani: Zoti është Nja. Në këtë vetëdije thekson se nxënësi i tij Porfyri, boton nëntë esetë me titull *Absoluti* apo *Njëshi*. Filozofia e tij e Qenies është ngjashmëri - simulacrum - e ideve në ide - imazheve - përmes emanacionit - *tolma* - dhe kthimit të Njëshit Hyjnor. Pra, në gjithë këtë filozofi dominon ideja se Zoti është Njëshi, është Qenia, edhe e Mira, edhe e Bukura. Faktikisht, duke folur për këtë filozofi, Rugova thekson se Plotini është ai që e formalizoi përmes shpërndërrimit të trinitetit të Platonit në Një-shin universal, prej nga e mori filozofia mesjetare, e u bë filozofi drejtuese në botë. Pra, sipas tij, del që triniteti antik iu atribuua më shumë shpirtit të njeriut, që në këtë hierarki filozofike lidhet me trinitetin e Zotit, të cilën Bogdani e shpjegon duke e krahasuar me trinitetin e shpirtit të njeriut.

Rugova pra konstaton se te Bogdani njeriu vihet midis unitetit të Zotit dhe të botës, pikëpamje kjo mesjetare. Për ta ilustruar këtë konstatim, zbërthen unitetin e njohjes, pra rrugën e njohjes së Zotit, që del gjithnjë i drejtuar drejt imazhit të Zotit. Pra, duhet kuptuar edhe unitetet kundërshtare, që ekzistojnë në botë e që zhvillohen në kuadër të së *krijuarës* nga Zoti (botës). Unitetet kundërshtare i vështron të ngritura në parimin e së Mirës dhe së Keqes. Për të ilustruar më tej këtë paraqitje Rugova përmend Uimset dhe Bruks, në shpjegimet e të cilëve për filozofinë mesjetare, për qëllime të estetikës, heton një diagram mjaft interesant për të, të nxjerrë nga romani i Xhojsit, *Portret i artistit të ri*, i cili në planin filozofik mbështetet në filozofinë mesjetare. Diagrami i përmendur del nga dy boshte dhe jep rrugën e njohjes - boshti vertikal (njohja shpirtërore-mendore, formë që vjen nga Plotini), ndërsa boshti horizontal - njohja sensuale-shqisore, formë që vjen nga Toma Akuini.

Rugova i kthehet çështjes së tij, filozofisë bogdaniene, duke e hetuar këtë teori,  
t e k e c i l a p ë r f s h i h e n S h q i s a -

-Mendja, e para për njohjen e natyrës, e dyta për atë të Zotit. Pastaj, heton edhe unitetin, të cilin ai e quan mistik, të dalë kështu në filozofinë e tij sipas boshtit vertikal:

*Zoti-Njeriu*  
*Qielli-Toka*  
*Parajsa-Ferri*  
*Engjëlli-Djalli*  
*Forma-Kaosi*

Në këtë unitet Rugova kupton se elementet e shtyllës së parë paraqesin unitetin harmonik, kurse shtylla e dytë unitetin e çrregulluar, në të cilin gjendet njeriu, që vazhdimisht duhet të aspirojë drejt unitetit harmonik. Pra, konsideron se Bogdani e quan unitet mistik që i kundërvihet unitetit të djallit, në planin ideologjik e etik.

Teoria estetike, në të cilën hynë *E bukura, Etikja dhe estetikja, Claritas, Vepra në këndin estetik* dhe elemente të tjera estetike, janë kapitujt që përcaktojnë një rrugë tjetër të njohjes së Zotit të Bogdanit, e Rugova kërkon idenë e të bukurës. Gjëra dhe fenomene të ndryshme dallon te ky autor, vështruar përmes idesë të së bukurës dhe mbi të bukurën. Në bazë të këtij vështrimi, konstaton se edhe e bukura del në kuadër të filozofisë dhe të estetikës së Mesjetës. Më pastaj, e bukura realizohet në planin ontologjik si esencë, si qenie e qenies më të lartë, Zotit, dhe si inkarnim i tij në qeniet dhe fenomenet e tjera në natyrë.

Pikëpamjet e Bogdanit për të bukurën, sipas Rugovës, ilustrohen me dy shembuj: për të bukurën kozmike dhe për të bukurën e njeriut, për të na bindur për fuqinë gjithëkrijuese të Zotit. E shohim në atë sistem Zotin si qenie të bukur, prandaj pikërisht me këtë soditje të së bukurës hyjnore, sipas Rugovës, shfaqet e ngrihet kuptimi i së bukurës, kuptimi estetik në vështrim elementar të *aisthesisit*, të ndjenjës dhe të kuptimit që vjen përmes shqisës së të pamurit.

Në këtë pikë Rugova sheh një përqendrim të kërkimit të mendjes, arsyes, ndërhyrje kjo që mundëson kuptimin e të bukurës. Do të thotë, Zoti nuk mund të njihet vetëm sipas përjetimit estetik. Që këtu konstatohet e bukura rationale që qëndron mbi një racionalitet të plotë. E bukura kozmike shenjohet si vepër e Zotit, e cila inkarnohet atje, në pasqyrën e qiellit. Këtu Rugova i drejtohet një fragmenti të Bogdanit, në të cilin ai e merr si shembull pallatin e Pashtrikut, si të bukur, dhe me këtë vërteton se duhet të dallohet e bukura hyjnore dhe e bukura njerëzore. Shkurtime, e bën të qartë se pallati konsiderohet si ndërtim i bukur e jo si krijim.

Në këtë vijë, Rugova flet edhe për të bukurën e jashtme të konceptuar nga Bogdani, duke e parë të ilustruar me Shën Mërinë. Që të japë efektin e të bukurës, konstaton se autori e arrin atë përmes teknikës të përshkrimit, duke e dhënë kështu Shën Mërinë si krijesën më të dashur dhe më të çmuar të Zotit. Shën Mëria vlerësohet sipas konceptit të së bukurës, pra sipas shijes dhe dijes estetike. Në përshkrimin e së bukurës, Rugova dallon elementin që del më së shpeshti në idetë

estetike të Bogdanit, *njimendunit*, të cilën e zbërthen si masë e të gjitha vlerave të së bukurës së krijimit. Pastaj, heton se bëhet një përshkrim në gjuhën shqipe me intensitet dhe entropinë e përshkrimit gjuhësor, që del si rezultat i imazhit autokton, kolektiv e popullor mbi të bukurën e femrës në përgjithësi. Kështu, për nga saktësia përshkruese e bukurisë së Shën Mërisë, Bogdani Rugovës ia kujton Tanushën e Këngëve kreshnike.

Pos bukurisë fizike, Rugova dallon përpjekjen e Bogdanit për ta inkuadruar edhe bukurinë metafizike, të bukurën shpirtërore që ekziston në qenien njerëzore. Për Rugovën, bukuria metafizike qëndron si përfaqësim i botës së brendshme, i shpirtit të njeriut, që e përshkon atë. E bukura e brendshme tek autori i tij del si shpirtorësim i shpirtit të qenies. Ndërsa, raportin midis të bukurës fizike dhe asaj shpirtërore, metafizike, e shpjegon të lidhur me të bukurën si stoli dhe si thellësi, që kështu e japin plotninë e saj. E para shihet, e dyta duhet të njihet në raportin e sensitives dhe intelektives, apo, shton Rugova, si asthetikos dhe neotikos - ndjenjë dhe njohje - që, sipas Bogdanit, del shqisë dhe njohje. Në këtë rend, sensitivja duhet të kalojë nëpër intelektiven, si masë dhe rregullator i perceptimit të idesë të së bukurës. Pra, dominon ideja që Zoti del si formë që krijon forma të tjera, siç është e bukura, prandaj për të njohur formën e bukur të tij duhet njohur vetë formën e tij, që është inkarnim i të bukurës vetë.

Kategori tjetër filozofike e Bogdanit, e diskutuar nga ana e Rugovës, është etikja. Kështu, Rugova do të vështrojë raportin midis etikës dhe estetikës te ky autor. Mbi këtë vështrim konstaton se kategorinë e etikës, ashtu si atë të estetikës, Bogdani e ilustron me Shën Mërinë. Por, tash mbi etikën vëren paraqitjen e bukurisë morale: "*Shën Mëria kalon një jetë të mbyllur dhe të izoluar për të ruajtur nderin e atribuar dhe vashërinë e ve*".<sup>67</sup> Prandaj, gjykon një korrespondim midis etikës dhe estetikës, deri në masën sa mendon se etikja i shtrohet estetikës. Më tej, vëren një domosdoshmëri për ruajtjen dhe konservimin e të bukurës, për të marrë e bukura forcën dhe intensitetin e vet. Në këtë mënyrë konstaton një vështrim teoontologjik, të bukurën-në-vete dhe për-vete, ashtu siç është vetë Zoti qenie në vete. Kualitetin moral Bogdani, sipas Rugovës, e gjen te Shën Mëria, të cilën e përgjithëson dhe e konkretizon si finalitet. Dhe, si përfundim, del se e bukura, e ndershëmja, moralja, shkojnë dhe duhet të shkojnë bashkë. Do të thotë, vërejmë se mbi të gjitha në këtë aspekt luan rol dëlirësia e shpirtit dhe në bazë të dëlirësisë së shpirtit të Shën Mërisë, Bogdani i vlerëson më konkretisht problemet.

Në shqyrtimin estetik, Rugova i bën një vështrim edhe fenomenit *claritas*, që del si emërtim konceptual i dritës, në shqyrtimet estetike të Bogdanit. Si shqyrtim filozofik shpjegon se *claritas* del si fuqi e rendit të vendosjes midis elementeve kundërshtarë, ndërsa në aspektin estetik element i shenjimit të idesë, të së bukurës, qartësisë dhe unitetit të kuptimit të vështrimit të fenomeneve të tjera, duke përfshirë edhe vetë Zotitn. Burim kryesor i saj është Dielli, që ka Dritën, e cila del si

---

<sup>67</sup> Po aty, f. 131.

rezultat i harmonisë dhe i organizimit brenda tërësisë, siç janë Zoti, kozmosi, njeriu e të tjera. Si element etik në këtë botë për të *ndrituni e mbukuruem* jetën, po si element suprem është sinonim i Parajsës dhe i Gjithëkrijuesit. Rrënjët e këtij fenomeni Rugova i gjen në filozofinë antike greke, tek Akuini, etj, që del si shkëlqim i Zotit, në planin makrokozmiq.

Po në këtë frymë, të kategorive estetike, Rugova nënvizon edhe elemente të tjera, si *shija*, që te Bogdani del me karakter psikofiziologjik. Shohim se Bogdani edhe këtë element e ilustron me të zgjedhurin e Zotit:

*Kanë me ndiem një shije të pa masë, a ma tepër ata qi kan hjekunë kaq hunit e hetit (etjes, urisë) për nder të Jesu Krishtit*<sup>68</sup>

Sipas Rugovës, Bogdani e ngre konceptin abstrakt të shijes, mbi këtë karakter psiko-fiziologjik. Shija është e pakufishme në jetën tjetër, ku mund të shijohet bukuria e amshueshme e veprave të Zotit dhe shkëlqimi i dritës së përjetshme.

Në radhën e vështrimeve, Filozofia e gjuhës (*Verbum dei*) konsiderohet si çështje e rëndësishme e traktatit filozofik të Bogdanit. Kështu, *Verbum dei* e konsideron si problem teologjik e filozofik, që tregohet në kundërimazhin e fjalës njerëzore, në unitetin e Zotit-Atit dhe Zotit-Birit. Në këtë vështrim, gjuha shihet e konceptuar dhe e pranuar brenda trinisë, përmes procesit të inkarnacionit, të mishërimit të saj me Idenë dhe me forcën e brendshme. Kjo lidhje, sipas Rugovës, shpreh raportin midis ligjërit, të folurit dhe mendimit. Në të vërtetë, thekson ai se vetë ekzistenca dhe shpjegimi i saj brenda unitetit hyjnor, paraqet procesin e mendimit dhe komunikimit përmes mesazhit të saj. Kur kujton Bartin, Rugova thekson se këtu, në plan më të ngushtë filozofik të gjuhës, Fjala përfaqëson vetë Gjuhën si koncept të brendshëm aktiv dhe medium në procesin e riprodhimit të saj, në raport me të vërtetën universale. Po ashtu, sipas mendimit të Rugovës, Fjala paraqitet si *Logos grek* apo si *Rotio latine*, që prodhon në vete dhe që prodhohet nga qenia e pavarur.

Rugova e shikon më drejt këtë problem, duke e dhënë procesin e kuptimit të Fjalës hyjnore si trup, te Bogdani, që lidhet me qenien e Krishtit, duke e ilustruar kështu me hyrjen e Ungjillit sipas Gjonit: *Në fillim ishte Fjala*. Po ashtu, heton se procesi i trinitetit të brendshëm të Zotit zhvillohet kryesisht brenda procesit të mendimit dhe të imagjinimit, ndërsa procesi i jashtëm përmes shpalljes së krijimit, komunikimit të saj. Në këtë mënyrë konstaton se procesi midis mendimit dhe komunikimit të Mendjes, shpallet përmes fjalës.

Fjalën te Bogdani Rugova e sheh të dalë në shfaqjen e të folurit njerëzor me mesazh të përmbushur për përmirësimin e njerëzve, përmes të cilëve bëhet multiplicitet fjalësh, që përmbajnë në vetë Fjalën. Këtë e sinjifikon fjala latine *Verbum*, që më vonë në koncept dha folje. Kjo fjalë gjithashtu qëndron në zë (*vox*), sepse u dëgjua nga Hyji, sqaron Rugova.

---

<sup>68</sup> Po aty, f. 135.

Probleme tjera me rëndësi që shtrohen dhe theksohen në studimin e Rugovës për *Cuneusin* e Bogdanit janë Koha dhe Hapësira, si dy probleme të mëdha të filozofisë. Ky është kapitulli i dytë i madh që mbart pas vetes edhe kapituj tjerë: 1. Koha dhe hapësira universale, 2. Koha esenciale dhe koha ekzistenciale, 3. Hapësira, 4. Koha e veprës. Në shqyrtimin e çështjes problemin e kohës dhe përdorimin e saj në *Cuneus*, organizimin dhe strukturimin e materies së veprës e vlerëson të realizuar në konceptin themelor filozofik të Bogdanit mbi Qenien dhe Ekzistencën e Zotit, që përkon me njohuritë më fundamentale për kohën, në traditën filozofike mesjetare dhe në atë antike. Faktikisht autori thekson se Bogdani nuk flet në mënyrë të veçantë për kohën dhe konceptimin e saj teorik, nuk e shqyrton pra si problem teorik (p.sh. si Shën Augustini kur flet për ekzistimin e tri kohëve, të cilat nuk do të ishin pa njëra tjetrën), por këtë e bën dhe me konceptin e konceptimin e përgjithshëm të veprës.

Koha ekzistenciale, sipas tij, në vepër konsiderohet kohë subjektive, që përmbushet me përjetime dhe me kuptimet tona, që i kundërvihet kohës objektive në ekzistimin e universit dhe kohës së numëruar. Këtë së pari Rugova e heton në Ligjëratën e katërt të Shkallë së katërt të pjesës së dytë të *Cuneusit*, kur flet për Ditën e Gjqit dhe për ardhjen e sërishme të Krishtit. Njëherësh konsaton se kohë kryesore në këtë filozofi është e tashmja që lidhet drejtpërdrejt me qenien e Zotit, sepse ai duke qenë Qenie universale, e gjithëshme dhe e gjithëpranishme, vetëm është dhe nuk mund të ketë qenë apo do të jetë, sepse është esencë. Po ashtu, merr për bazë edhe Bogdanin, duke e vlerësuar narracionin dhe filozofimin e tij në të tashmen, si kohë dhe formë më e përshtatshme për procesin e njohje së Zotit, për të vendosur kështu kontakt me mendjen tonë. Në këtë mendim të përmendur, vlerëson dy kohët esenciale dhe ekzistenciale, e para realizohet në planin e njohjes me anë të mendjes në planin subjektiv, kurse ekzistencialja njohjen e vet e mbështet në planin e njohjes, po ashtu subjektive. Prandaj, konkretizon se koha esenciale qëndron vetëm në të tashmen, e ajo ekzistenciale, apo njerëzore, është e vendosur në tri format e kohës, sepse ka të bëjë me qeniet që ishin, janë dhe nuk do të jenë. Duke e shpjeguar këtë çështje, ai shpjegon edhe teknikën e narracionit të Bogdanit, të cilat krijojnë iluzionin e kohës së përjetshme, e cila, po ashtu, si Zoti, është gjithmonë e tashme.

Ndërsa konceptin e hapësirës Rugova e gjen të gërshetuar me atë të kohës, duke e parë përfundimisht si fenomen që realizohet në plan esencial dhe ekzistencial. Në këtë vazhdë konstaton se hapësira në veprën e Bogdanit është e fiksuar nga *Bibla* dhe Shkrimet e Shenjta, atëherë kur edhe u shfaq fjala e Zotit. Pra, hapësira është e caktuar, po vetë lidhja me hapësirën eternale, i siguron asaj një kuptim ku lindin dhe shfaqen gjërat eternale, që autori e konsideron si njëfarë kuptimi të eternalizuar e jo eternal. Më tutje, konstaton se eternalizimi i kësaj hapësire është aq i madh sa arrin shkallën e simbolit, që ngrihet mbi shenjat e para të eternalitetit që janë shfaqur aty. Sot, kjo kohë, sipas Rugovës, quhet kohë dhe hapësirë biblike, duke kuptuar kështu eternalizimin dhe simbolikën e tyre maksimale.

Sipas rrjedhës së tekstit, vërehet se Bogdani inkuadron edhe kohën e kufizuar biblike, që zhvillohet jashtë përfshirjes së saj. Por, Rugova vëren se në imazhin e tij filozofik, kjo është kohë primare dhe hapësirë primare, të inkuadruara për qëllime të caktuara të tij.

Konstatimet e tij për hapësirën lidhen edhe me kohën konkrete të veprës së Bogdanit. Koha në veprën e Bogdanit, për Rugovën, është subjektive, por shpesh varet dhe i shtrohet kohës objektive që ia imponojnë gjerësia dhe problematika e ngjarjeve që merr në trajtim. Këtë e vëren më së miri në bazë të narracionit të veprës, për të cilën përfundon se koha narrative i nënshtrohet problemit të konceptimit të çështjeve. Gjykon se në pjesën e parë, ku dominon ligjërata shkencore-filozofike e teologjike, kemi një narracion të këputur praktikisht, ndërsa në pjesën e dytë të librit, ku paraqitet jeta e një personazhi, heton narracionin kohor të rrjedhshëm, çfarë e imponon ngjarja, që më shumë qëndron në raportin fizik shkak-pasojë.

Në rrjedhën e këtyre koncepteve, sipas Rugovës, koha e veprës mbështetet në tempon narrative, ndërsa në *Cuneus* ajo thuhet se shkon paralel me kohën e paraqitur. Në këtë pikëpamje, ai shton se kjo mund të jetë edhe "iluzion" të cilin e nxjerrim nga gjerësia dhe infinitiviteti i kohës së paraqitur. Përfundimisht, gjykon se në veprën e Bogdanit, marrë në prizmin e kontekstit socio-historik, gjejmë elemente të logjikës popullore në perceptim dhe të narracionit të përrallës.

Në universitasin dominues të veprës së Bogdanit, Rugova ka parë të inkuadruar edhe të veçantën e kohës dhe të hapësirës konkrete. Këto dy elemente të etosit dhe të etnosit, Bogdani i merr si konkretizim të ideve universale mbi këto dy kategori themelore të ekzistencës. Dhe, Rugova konsideron se në këtë mënyrë, autori ia shton vlerën veprës për kohën e vet, duke e bërë të lexueshme edhe për kohën tonë. Definimin e hapësirës konkrete, Rugova e lexon edhe si një nga kërkesat kryesore të Bogdanit, duke e parë të shënuar në fillim të parathënies së librit. Mbi këtë bazë mendon se ai veprën e shkroi për këtë hapësirë të veten origjinare, duke kërkuar të tejkalohet gjendja fizike dhe metafizike e tij. Mirëpo, për realizimin e vendit, të ngritjes së tij shpirtërore, konstaton se autori i tij konsideron gjuhën si shenjim nacional e ekzistencial, si element të parë dhe më të rëndësishëm të një bashkësie nacionale, të bashkësisë dhe të kolektivitetit të vet. Shohim pra se gjuha merret si medium për realizimin e dijes dhe të urtisë, si mjet komunikimi midis reales dhe idesë së përgjithshme, shpirtërores dhe intelektuales, që përfaqësohej në filozofinë e kohës: teologjinë. Pra, gjuha si entitet dhe reprezentitet dhe si interkomunikim me ekstrakomunikim, vlerëson më së miri Rugova. Marrë në përgjithësi, heton se gjuha në të gjitha Shkallët e veprës së Bogdanit del si mundësi, problem dhe qenësi. Mbi këtë koncept qëndron mendimi se përmes saj pasurohemi shpirtërisht dhe intelektualisht. Këtë problem Rugova e sheh si temë-obsesion të veprës, që vazhdimisht do ta realizojë, të bëjë temë aksion, vetëdijshëm e ndërvetëdijshëm, po me insistim dhe rezultat.

Në këtë kontekst ai e vëren të trajtuar edhe elementin e Vendit, që te Bogdani në të gjitha rastet lidhet me ilustrimin e ideve dhe të problemeve që i shqyrton ai. Më shkurt, mendon se topografia paraqet një *lieu commun* të ekzistencës reale. Në këtë topografi lexon shpjegim shkencor për: Drinin, Vardarin, Vjosën, Danubin, Bunën, Sitnicën, Malet e Arbënit, Lubotenin, e mbi të gjitha një vend të veçantë konsideron të zënë Mali i Pashtrikut, duke e parë të dalë te Bogdani si Olimp antik ose si Mali Sion. Njëkohësisht, Rugova thekson edhe problemin e kohës te Bogdani, duke e parë një kronologji të këaj kohe prej krijimit të Adamit e Evës, te shfaqja e Krishtit, pra deri në epokën e re. Ai vëren që në këtë kronologji universale të botës jepen edhe disa pika të kohës historike dhe personaliteteve historike që kanë ndikuar në to.

Te *Praktika teorike-letrare*, Rugova tekstin e Bogdanit e lexon si teori që interpreton e analizon Shkrimin. Pra, këtu Bogdani, ushtron një praktikë teorike mbi Shkrimin e Shenjtë. Derisa në Shkallën I shqyrtonte dhe vështronte *Librin e Natyrës* përmes *Librit të Shkrimit*, në Shkallën II merret me shpjegimin e fenomeneve të shkrimit të Shenjtë. Për të kaluar te problemet që i shqyrton Rugova në këtë pjesë, po i theksojmë kapitujt e këtij trajtimi: 1. Raporti estetik, 2. Poetikë, 3. Retorikë, 4. Semiotikë, 5. Semantikë.

Praktika teoriko-letrare, që te Bogdani është teori e shkrimit, i referohet Shkrimit të Shenjtë, pranon si njohje të parë të shkrimit të përshpirtshëm njohjen sensuale, shqisore, që shtrohet edhe te çështja e njohjes filozofike të Natyrës në Shkallën I të veprës. Kështu, mbi këtë raport bazë të Shkallës I në kontakt me objektet dhe fenomenet, vijnë elementet e tjera, si asociacioni dhe elementet e mendjes (intelekti, racio), gjykon Rugova. Ky tip i njohjes sipas Kujtim M. Shalës, bëhet për eksplikimin racional të shkrimit. Principi i tillë, gjykon ai, vlen për të gjitha fushat e njohjes, ndaj njohjes racionale përherë i prin njohja estetike/sensuale.<sup>69</sup>

Pas raportit estetik, kalohet te poetika, duke u kapur problemi qenësor i saj, çështja e klasifikimit të shkrimit, të disiplinave. Pra, poetikës së Aristotelit, Bogdani i Rugovës, si dijetarët e Mesjetës, e përkthen në gjuhë nacionale të Shkrimit të Shenjtë. Ai e barazon poezinë me historinë, duke e vënë në krye të këtij klasifikimi shkrimin e përshpirtshëm, mbështetur në poetikën dhe në retorikën e Mesjetës. Por, shkrimit ia jep atotribute që Aristoteli ia jepte poezisë. Në klasifikimin praktik të Bogdanit, shohim se në fillim është shkrimi i përshpirtshëm, pastaj shkrimi letrar.

Në praktikën poetike, Rugova dallon fokusim më të madh në çështje të retorikës, pra fokusim te kuptimi figurativ i Shkrimit të Shenjtë. Në radhë të parë, në këtë plan heton barazimin e metaforës e profecisë. Pra, principi i tij bazohet në thënien se Zoti flet me metafora. Metafora mbretëreshë e tropeve, konsideruar nga Aristoteli, del edhe në retorikën e Bogdanit, koncept që e ka pranuar edhe retorika kristiane. Më shkurt, metafora është ngjashmëri e qenies, që i përgjigjet krijimit të njeriut nga Zoti, dominon në praktikën e Bogdanit, bazuar në konceptin antik. Marrë në përgjithësi,

---

<sup>69</sup> Shih Kujtim M. Shala: “Rugova meditants”.



në filozofinë mesjetare, metafora tregohet më e përshtatshme në interpretimin e toposeve të *Biblës*.

Konkretisht mbi këtë problem Rugova mendon se konceptin e vet Bogdani e mbështet në teorinë dhe filozofinë e Toma Akuinit, i cili figurave retorike të Shkrimit të Shenjtë u jep kuptim të katërfishtë. Fillimisht thekson se te ky autor Shkrimi i Shenjtë është shpirti i historisë së letërsisë. Pastaj vazhdon duke theksuar tri shkallët në të cilat mbështeten figurat retorike, ose saktësisht si i quan ai, shkallët figurative (duke menduar që nuk janë vetëm figura): si kuptimi tropologjik, kuptimi alegorik dhe kuptimi analogjik. Alegoria paraqet besimin, duke pasur vlerë figurative, Tropologjia veprimin, duke pasur vlerë semantike të teorisë së figurës, dhe Anagogjia tendimin, duke dalë si tendim për ngritje, si sublim me gjërat më të rëndësishme të Shkrimit të Shenjtë e të shkrimit në përgjithësi.

Duke e analizuar më tej praktikën poetike të Bogdanit, Rugova sqaron se këto tri shkallë ndërlidhen mes vete, duke e paraqitur: përmes Alegorisë besohet, përmes tropologjisë veprohet, vetëveprohet dhe përmes Anagogjisë tentohet kuptimi final i figurativitetit. Këto pikëpamje teorike dalin të ilustruara kështu: në kuptimin tropologjik - Jerusalemi shëmbëlltë e shpirtit të mirë, në kuptim alegorik - shëmbëlltë e Kishës, në kuptim analogjik - Jerusalemi shëmbëlltë e shpirtit në atë jetë.

Teorinë e Bogdanit Rugova e sheh të lidhur edhe me teorinë e shenjave. Kështu çështja tjetër që e heton është semiotika, çështja e shenjzimit. Zoti në filozofinë e Bogdanit është Krijuesi i çdo gjëje, dhe Zoti është krijues i shenjave, sinjifikon, shenjon. Shenjat janë të shpërndara kudo nëpër botë, prandaj ato duhet zbuluar. Nga këtu del raporti vepra-fjala, që janë bars me shenjën, sepse ato janë të fshehura, kështu që duhet të zbulohen. Më pastaj, Rugova zbërthen se shenja dhe vepra sipas pikëpamjes së Bogdanit, motivohen duke dhënë efektin teologjik-gnoseologjik. Pra, shenjat janë fjalët e veprat. Shenjat janë kudo të shpërndara nëpër tekstin e *Biblës*, prandaj edhe ato duhet zbuluar. Pra, përfundimisht, Rugova gjykon se Bogdani kërkon një dije për zbulimin dhe për kuptimin e shenjave, duke e parë të denjë për këtë shkencën e teologjisë. Këtu ka parasysh se shenjat për të janë abstrakte dhe reale, ndërsa shenjat e shkrimit janë të mbyllura, që kuptohen përmes leximit, receptimit dhe perceptimit.

Ligjëratën e fundit të Shkallës IV, Rugova e emëron semantikë, pra e dallon të trajtuar vlerën polisemike të kuptimit, kuptimin e dyfishtë ose dykuptimësinë e kuptimit. Është ky term nga italishtja *doppio senso* e te Bogdani *dy fije veshteriisë*, dhe që në shumë raste përdoret si vështrim, dije dhe shqisë. Rugova e vëren të inkuadruar drejtpërdrejt në semantikë, kur bën një klasifikim midis domethënies, shenjimit të figurave dhe çështjes së kuptimit. Gjithashtu vëren aftësinë e të interpretuarit në hermeneutikë.

Në këtë vështrim semantik të figurativitetit dhe shenjzimit, Rugova heton të trajtuar edhe problemin denotativ dhe konotativ të kuptimit. Përgjithësisht këtë praktikë të shumëkuptimësisë e gjen si rezultat të figurativitetit të Shkrimit të

Shenjtë dhe shenjzimit të tij në planin tekstual e kontekstual. Vëren që tekstit biblik, pos kuptimit të dyfishtë dhe të katërfishtë, Bogdani ia shton edhe metaforikën, figurativitetin dhe shumëkuptimësinë e disa njësive të tij.

Sipas rendit që ka vënë Rugova, në radhë për t'u shqyrtuar është Kapitulli IV i studimit të tij, *Praktika poetike*, e cila përbëhet nga nënkapitujt: 1. Kozmogonia, 2. Sibilat - akti i një jete e vepra, 3. Semantika e prozodisë, 4. Figuracioni, 5. Gjuha poetike. Rugova vlerëson se vepra e Bogdanit është e pasur me poezi, në funksion të ilustrimit, argumentimit të ideve dhe pikëpamjeve të ndryshme të veprës, por që si medium janë të pavarura në formësimin e materies dhe të lëndës. Këtë praktikë e vështron si poetikë të pavarur artistikisht, po në funksion konceptualisht, sepse ajo se lidhet me materien dhe idetë e veprës. Këtu ka parasysh edhe funksionin e dytë të poezisë të Bogdanit, e cila trajton temë të caktuar, duke ditur se poezinë e merr si fushë të veçantë për argumentimin e ideve filozofike dhe shkencore. Konkretisht, Rugova analizon tematikën, strukturën, gjuhën poetike, figuracionin, rimën e ritmin.

*Kozmogonia*, e titullon kështu, sepse Ligjëratën IV të Shkallës I e konsideron të lidhur tematikisht me problemet e krijimit të kozmosit, yjeve dhe të planeve, kështu që, në frymë të terminologjisë së tij, e emërton *Krijimi i rruzullit*. Duke analizuar tematikisht e strukturalist, Rugova heton katër elementet kryesore të poezisë, që janë *Qielli e Dheu* dhe *Deti dhe Zjarmi*. Do të thotë, mbi këto elemente ndërtohet tërë poezia e tij, prej të cilave Rugova nxjerr kuptimin e domethënies. Nënvizon këtu edhe ritmin kozmik, mesazhin e formulës universale. Pra, mesazh të gjithë *Cuneusit*, përmes eksplikimit filozofik e shkencor, nxjerr mesazhin poetik. Rugova shqyrton edhe planin metrik, duke vërejtur strofën e stancës (ottava rima), e cila përbëhet nga tetë vargje, me njëmbëdhjetërokësh jambik, me renditje rimore *abababcc*.

Në këtë analizë dhe interpretim të praktikës poetike, Rugova diskuton edhe për një cikël tjetër të rëndësishëm të poezisë së Bogdanit, *Jeta e dhejetë Sibilave e kanketë e tyne*. Rugova i emërton *akt të një jete e vepra*, duke i parë si vazhdimësi e profecive të profetëve, por nga një këndvështrim tjetër. Shkurtimisht, sipas tij, kemi të bëjmë me prefigurim të Sibilave mbi disa elemente të jetës dhe veprave të Krishtit.

Rëndësia e këtyre poezive, ndër tjerash, për Rugovën qëndron te fakti se Bogdani Sibilat i vendos në një ambient të vendit të vet, me mendim se ato nuk i përkisnin asnjë vendi e kohe. Poezinë e Bogdanit në përgjithësi Rugova e vlerëson të një fryme e konceptimi të shkrimit klasik. Por, edhe më me rëndësi e konsideron faktin se ato janë në shqip dhe sinjalizimi i Bogdanit për lëndën, tematikën, vetëm e përforcon artin poetik që del në këto poezi.

Ky cikël poezish vlerësohet për nga rrëfimi, kallëzimi i jetës së Krishtit prej lindjes deri në vdekje, e cila realizohet përmes prefigurimit.

Përfundimisht, Rugova i konsiderohen vjersha origjinale të Bogdanit, si tërësi poetike, tematike dhe të cilat e sjellin aktin e një jete të përmbushur me rënie e

ngritje, të përmbushur me idenë për të mirën, të vërtetën dhe për të drejtën. Këtë parim të zbatuar këtu, Rugova e konsideron edhe qendër të kësaj filozofie.

Në këtë diskutim, gjejmë edhe vështrimin semantik të prozodisë së poezive të Bogdanit. Sipas Rugovës, semantikën e tyre e forcon ideja qendrore e këtij cikli, që ta paraqesë jetën e personazhit në të gjitha nuancat e saj. Në këtë koncept konsideron se poezia nuk vihet në shërbim të idesë, po ideja e mishëruar edhe përmes prozodisë bëhet më e fuqishme në poezi. Dhe, këtë ide që autori i tij e konsideron përmes medimeve të tjera, fiozofisë, teologjisë, prozës, Rugova e sheh të trajtuar edhe përmes poezisë, duke e konsideruar si *ars divina* (art të hyjnueshëm).

Duke iu referuar Shën Augustinit, Bogdani mendonte se poezia e thotë të vërtetën në figura. Prandaj, Rugova vlerëson një gjuhë të formuar poetike dhe figurativitetet në këto poezi.

Po këtë gjuhë të formuar poetike, e po këtë liri kreative, Rugova e vëren edhe te përkthimet që bën Bogdani, si pjesët dhe strofat për poezinë e Homerit, Virgjilit, Juvenalit dhe Plinit.

Më tutje, siç e paralajmëruam në fillim, Rugova për të thëlluar studimin e hulumton edhe stilin e veprës së Bogdanit. Faktikisht pra është pjesa e V. *Stili dhe Tipet e Ligjëratës*, tek e cila ky autor dallon dy tipa stili: stilin shkencor dhe stilin artistik. Duke e konsideruar stilin si rezultat të gjuhës, këta dy tipa stili i quan edhe gjuhë shkencore dhe artistike, ose më mirë Ligjëratë shkencore (proza shkencore) dhe Ligjëratë artistike (proza artistike).

Rugova thekson se pjesa e parë e veprës realizohet përmes ligjëratës shkencore, ndërsa pjesa e dytë përmes ligjëratës artistike. Do të thotë, në të parën kemi probleme të ndryshme filozofike, shkencore e teoriko-letrare, kurse në të dytën, ku jepet *jeta e Jesus Krishtit*, kemi të bëjmë me prozë artistike. Prandaj, edhe e vlerëson veprën si një biografi të romanësuar, të shkruar në gjuhën tonë, me kontura mjaft të forta të romanit tonë. Duke e konsideruar argumentin veti kryesore të tërë veprës së Bogdanit, Rugova edhe vetë e argumenton ligjëratën artistike të tij. E quan artistike, për faktin se realizohet përmes rrëfimit artistik, në veta të ndryshme të ligjëratës, duke e parë të ngritur figurën e personazhit kryesor dhe të personazheve të tjera, evoluimin e situatave, përshkrimin si teknikë artistike. Gjuhën artistike të Bogdanit Rugova e konsideron gjuhë krijuese.

Pikëpamjet e Rugovës për stilin e veprës së Bogdanit shkojnë drejt përfundimit për një stil klasik të saj. Më konkretisht, stili i kësaj vepre përfaqëson stilin klasik të shqipes. Në këtë kontekst, Rugova dallon ndikime të stilit klasik latin dhe stilin klasik biblik, por vëren shpesh të inkuadruar edhe stilin popullor

Rugova anën metodike e metodologjike të *Cuneusit* e gjen si shumë sistematike, të përmbushur në një sistem: së pari autori e paraqet mendimin e vet, tezën e vet, të cilën e zhvillon, pastaj e merr citatin ose anasjelltas, së pari e merr citatin e pastaj e jep zhvillimin e mendimit të vet, ose e jep komentin. Citati këtu del si ndërhyrje - insistim - përforcues e ilustrues dhe dallohet sidomos në pjesën e parë të librit, për trajtimin e çështjeve filozofike, teologjike e shkencore. Mendon se autori e përdor

për të theksuar bazën e vet metodologjike e filozofike, me qëllim forcimin e argumentimit. Me përdorimin e citateve konsideron se Bogdani ka forcuar bazën metodologjike.

Gjithë këtë proces Rugova e vlerëson si pararelizëm metodologjik, që d.m.th. se problemet shqyrtohen nga ana teologjike dhe nga ajo filozofike.

Në kuadër të Kapitullit VI hyn dhe Nënkapitulli *Polemika*. Duke u nisur nga mendimi se Bogdani e kishte të fortë kultin e dijes, Rugova në ligjëratën e tij heton polemikë në planin ideologjik dhe në atë filozofik-shkencor. Kritikën e tij e konsideron ideologjike, kundrejt koncepteve dhe botëkuptimeve të islamizmit, kundër turqve dhe ebrejve. Arsye kryesore të Bogdanit për ta thyer fenë dhe filozofinë turke, Rugova e konsideron mendimin e se popullata ishte shkatërruar dhe poshtëruar. Këtë polemikë e sheh me argumente ideologjike e filozofike, kështu që konstaton temperamentin e Bogdanit si polemist. Sistemi polemik i tij, sipas Rugovës, duket kështu: së pari e shtron tezën e kundërshtuar si argument e pastaj e jep kundërgargumentin, antitezën, me të gjitha elementet e komentimit dhe të shpjegimit. Mbi këtë bazë përfundon se Bogdani ishte mjeshtër i polemikës së argumentuar.

Për nga problemet që shtron dhe analizon në këtë kapitull, një interesim zgjon edhe shqyrtimi terminologjik i Bogdanit, parë nga Rugova, sipas të cilit, Bogdani jo vetëm që ka aplikuar dhe formuar terminologjinë e veprës, por ka dhënë edhe shqyrtime rreth shumë termave fundamentalë. Ka shqyrtuar teorikisht terma të veçantë, duke i krijuar mundësi Rugovës të hetojë edhe mënyrën e ndërtimit të termave. Mbi shqyrtimin teorik të termave, Rugova e vlerëson më të sqaruar dhe më të zhvilluar interpretimin e tij filozofik. Duke parë që Bogdani themelon një pjesë të rëndësishme të termave fundamentalë të filozofisë dhe të dijes në gjuhën shqipe, ndërsa Rugova e çmon për aftësinë e përpunimit terminologjik.

Po ashtu, Rugova insiston se puna e Bogdanit me terminologjinë, me përdorimin dhe me saktësimin e aftësimin e saj, aftësoi shumë gjuhën shqipe dhe i rriti mundësitë e saj shprehëse, paraqitëse e formulative. Punën e sheh të realizuar me shqyrtimet filozofike dhe teologjike, por thekson se ai ka formuar terma disiplinuar, terma në jurisprudencë, në ekonomi, në pedagogji-psikologji, në gjeografi, në meteorologji, mitologji, matematikë, mjekësi etj.

Interesimin e vet kritik Rugova e vë edhe mbi dukurinë e metaforifikimit të koncepteve. Vëmendjen do ta përqendrojë kryesisht rreth komentimit të konceptit të Librit. Duke e zbërthyer semantikisht, thekson se termi biblik i librit nënkupton librin si burim të dijes. Kështu, konstaton se mbi këtë semantikë burimore Bogdani krijon një metaforikë për Librin e vet, i cili është “ta keshe një Qirī ndezunë ndorë, për të ndrituni atë të vobek dhë”.<sup>70</sup> Mbi këtë ilustrim dhe mbi konceptin qendror të këtij libri, Bogdani, përmes metaforikës së dritës, jep formën reale të këtij koncepti dhe formën më të lartë të përmbajtjes së tij, që përfaqësohet me formën e ekzistencës.

---

<sup>70</sup> Ibrahim Rugova, vep. e cit., f. 236.

Parë kështu, libri del si një univers, një botë, ku objekte dhe fenomenet dalin brenda universit. Rugova vëren se sipas Bogdanit universi për njeriun është si *libër i çelë*, i hapur para syrit dhe mendjes së tij, që do të thotë: libri është dritë për mendjen.

Marrë në përgjithësi, duke analizuar në hollësi praktikën filozofike të Bogdanit dhe veprën e konceptet e tij, Rugova e konsideron Bogdanin racionalist, humanist e panteist. E quan racionalist, për shkak se për njohjen e përgjithshme të Zotit, të botës e të njeriut e merr Mendjen, Arsyen (Intellectus, Intelletto dhe Ratio, Ratione). Në këtë mënyrë mendon se njeriu e posedon dijen. E quan panteist për shkak të botëkuptimit të tij mbi botën, që, pos parimit të Zotit, e lidh edhe me parimin e Natyrës. Është humanist, sipas Rugovës, sepse në qendër të veprës ka njeriun.

Në këtë vështrim, Rugova e shqyrton përfundimisht planin filozofik të veprës së Bogdanit, duke e parë të bazuar në platonizmin dhe aristotelizmin mesjetar. Si parim kryesor filozofik konstaton Zotin dhe çështjet e filozofisë së natyrës. Ndërsa, sa i përket filozofisë skolastike, referenca kryesore i konsideron Shën Augustinin dhe Toma Akuinin. Dhe, si çelës për zgjedhjen e problemeve filozofike njeh Zotin si parim kryesor filozofik.

Rugova tashmë, nga hetimet praktike filozofike, teorike, poetike, problemet e thella të filozofisë, teologjisë, të shkencës, të teorisë së letërsisë, të poezisë, estetikës dhe të prozës ecën drejt mendimit se vepra e Bogdanit është një kryevepër e kulturës sonë. Për më tej, Rugova vlerëson se edhe po të mos ishte problematika e veprës ashtu siç është, vetëm për stilin e saj, është e denjë për këtë atribut historiko-letrar.

*Cuneusin* Rugova e konsideron vepër të parë në të cilën shihet sprovimi i mendimit në praktikën gjuhësore e mendore, një problematikë kjo shumë e vështirë filozofike. Thekson këtu çështjen e Zotit dhe Trinitetit, që ishte ndër problemet më të mëdha filozofike të klasikës sonë.

Përfundimisht, veprën e Bogdanit Rugova e përcakton si vepër e cila lidh drejtpërdrejt mendimin dhe kulturën tonë me mendimin dhe kulturën evropiane të kohës së vet. Ai konstaton edhe vlerëson se kjo vepër është një *Komedi Hyjnore shqiptare* në planin e akseologjisë historiko-letrare e filozofike dhe një vepër bazë në humanistikën shqiptare.

### **Semiologjia e Rugovës**

Rugova e analizon semiotikisht tekstin e Bogdanit, duke iu qasur në mënyrë të drejtpërdrejtë, për të lexuar tërësinë e kuptimit, temën dhe nivelin e organizimit, strukturën e brendshme dhe të jashtme të saj, sistemin konceptual e terminologjik, konceptet e kodet e veprës.

Rugova veprën e Bogdanit e konsideron *praktikë filozofike*, ndërsa vetë bën një *praktikë semiotike*, duke synuar kuptueshmërinë dhe dallueshmërinë e objekteve të tekstit.

Nga ky këndvështrim e konceptojmë leximin rugovian të veprës së Bogdanit, si një vepër e kohës së studiuesit, metodë kjo me rrënjë në semiologji. Rugova analizon që nga rrënjët, analizon në mënyrë të detajuar, duke bredhur nëpër çdo kapitull, në *aventurën semiologjike*<sup>71</sup> të tij, për të ngjallur dhe për të aktualizuar veprën. Rugova, kur e lexon tekstin e Bogdanit, “dialogun e bën të gjallë, duke e ringjallur tekstin e Bogdanit në secilën shenjë”.<sup>72</sup> Semiologu ynë e lexon veprën e parë të shkruar shqip *Çeta e Profetëve*, nga këndvështimi i tashëm, për të nxjerrë nivelin e sotëm të komunikimit, vlerën dhe domethënien esaj sot.

Librin e Bogdanit, analiza semiotike e Rugovës e koncepton si një tërësi shenjuese, të strukturuar në pjesë tematike. *Cuneusi* për semiologun Rugova është një Univers, me formë harmonike dhe të përsosur. Ja se si e ilustron Rugova udhëtimin nëpër universin bogdanian:

*Së pari Ideja-Zoti, Hyji, Natyra, Bota, Njeriu, Zoti-Njeriu, Natyra-Njeriu, pastaj shtegtimi nëpër Aktin e krijimit, nëpër Konceptet e mendjes njerëzore: nëpër mitologjinë e hershme babilonase, asiriane, indase, më pastaj nëpër filozofinë antike greke e heleniste, nëpër dije, nëpër shkrimin e shenjtë, nëpër profetin e shëmbëlltyra profetike, nëpër metaforikën e shkrimit dhe të mendimit, nëpër metaforikën e poezisë.*<sup>73</sup>

Ky ilustrim e përmbyll vetëm një pjesë të Universit, pastaj Rugova e përshkruan pjesën tjetër, të lidhur me kuptimin e Idesë dhe me mesazhin e fuqishëm të saj. Motiv i cili e fut edhe vetë Rugovën brenda këtij universi, duke e nxitur edhe lexuesin.

Kështu, në një plan të përgjithshëm, analiza tekstore e Rugovës e koncepton veprën si një *metaforë solare*, ku çdo gjë, çdo fenomen e gjykim kërkohet dhe vendoset brenda refleksit të dritës, sinonimit të Arsyes së pastër.

Në këtë sistem, Rugova e analizon Librin si Qenie, ndërsa çështjet e filozofisë së saj i shikon ndryshe, disi më konkretisht. Në këtë këndvështrim referencë ka Derridanë, i cili filozofinë evropiane e cilëson si një metaforë. Ai thotë se është metaforë fundamentale, jo vetëm për faktin se është *metaforë fotologjike*, e në këtë këndvështrim edhe e gjithë historia e filozofisë sonë është një fotologji, jo e dhënë në histori apo në trajtë të dritës, por si metaforë: metaforë në përgjithësi, kalim të një të *qenmi* në një tjetër, apo të një të shenjuari në tjetrin të autorizuar nga *nënshtrimi* nismëtar dhe zhvendosja *analogjike e qenies* nën të *qenmit*. Ngjashëm,

<sup>71</sup> Shi Rolan Bart: “Aventura semiologjike”.

<sup>72</sup> Kujtim m. Shala: “Rugova meditans”, f. 91.

<sup>73</sup> Ibrahim Rugova, vep. e cit., f. 256.

Rugova kërkon shenjat e esencialitetit historik të historisë si shpërndërrim e jo të historisë si përshkrim, pra të një procesi cilësor.

Konstatimi i Derridasë ka të bëjë me shpërndërrimin e qenies në ekzistenca të tjera, të problemeve në probleme të tjera, dhe duke ecur nëpër këto shenja Rugova, atë që Mesjeta e quante Zot, e quan Fuqi të Natyrës, Fuqi natyrore e kozmike në kuadër të cilës vepron njeriu në Natyrë, pra si qenie.

Pra, Ibrahim Rugova *Çetën e Profetëve* nuk e lexon si ideologji, sepse mendon se gjendet jashtë kontekstit tonë ideologjik, por si esencë, duke hetuar probleme të shumta që mund të relativizohen, probleme që vijnë pa forcën e veprimit të ideologjisë, e të cilat Rugova i aktivizon në mënyrë imanente në përfaqësimin e universalitetit të problematikës dhe të përvojës që reflekton brenda dhe jashtë vetes. Dhe, në bazë të estetikës e të filozofisë ontologjike të artit, Rugova mendon se vepra e Bogdanit ka formuar qenien e saj, me artin dhe me sistemimin e problematikës së vet.

Prandaj, universin e veprës së Bogdanit e vlerëson modern. Vepër me kuptim e konceptim modern, në të cilën gjen të hartuara probleme ekzistenciale të mendimit e të filozofimit mbi gjëra e fenomene. Kështu, Rugova sot, si klasikën botërore, veprën e Bogdanit e shikon në planin e modernitetit, të mbushur me probleme universale. Veprën e Bogdanit sot Rugova e lexon ashtu siç e lexon sot Platonin, Aristotelin, Shën Augustinin e Toma Akuinin. Rugova, përveç zgjedhjes së Bogdanit, vlerëson - siç vlerëson historia e mendimit - shtytjet (stimulanset) e veprës. Dhe, nga ky plan i vështrimit, kërkon vlerësimin e veprës nga të gjithë ne, duke menduar se kështu na çmojnë të tjerët, sepse Rugova përfundimisht veprën e Bogdanit e konsideron si fundament të modernitetit tonë intelektual e ekzistencial, e më tej.

Rugova e gjen modernitetin në veprën e Bogdanit jo vetëm në problemet fundamentale filozofike e shkencore, por edhe te problemet teoriko-letrare, krijimin artistik (poezinë), stilin (plot metaforikë, ironi, simbolikë) i analizon në plan modern.

Duke e jetësuar veprën sot, Rugova e lartëson edhe të shkruarit e saj, për Rugovën Bogdani shkruan bukur, e duke iu referuar Leopardit mendon se të shkruash bukur do të thotë filozofi. Dhe, duke e kuptuar veprën si filozofi e shkruar bukur me probleme universale, mendon se sa herë të hapësh gjen diçka të re, vepër që të bën ta mbash hapur dosjen e studimit, e ta ndiesh kënaqësinë e leximit. Kjo njëherësh është edhe logjika e gjallë e saj, mendon Rugova. Kështu pra, studimi i Rugovës mund të konsiderohet risemantizim i ideve filozofike, teorike e poetike i veprës së Bogdanit, ose *fotologji* - sipas Derridasë<sup>74</sup> - dhe problemeve. Pra, Rugova bën riaktualizimin e çështjeve, duke mos e ndjekur metodën projektuese të problemeve, por të afirmimit të tyre.

Shikuar në këtë plan, Rugova e afirmon metaforifikimin e koncepteve të Bogdanit. Fillimisht e vështron *semantikimin* e konceptit *Libër* - si burim i dijes, i fjalës së Zotit, *Bibël* do të thotë libër: Libri pra si univers që flet me figura. Kështu leximi semiotik i

---

<sup>74</sup> Jacques Derrida: "Of Grammatology", The John Hopkins University Prese, Baltimore and London, 1997.

Rugovës vështron funksionin e veprës së Bogdanit si vështrim semantik të figurativitetit dhe të shenjzimit. Në bazë të teorisë së semantikës dhe të semiotikës moderne, Rugova e vështron problemin e *denotacionit* dhe të *konotacionit* të kuptimit, shumëkuptueshmërinë e shikon si rezultat të figurativitetit të Shkrimit të Shenjtë dhe të shenjzimit, duke konkluduar se janë figurativiteti biblik e emanticiteti i shenjave reale dhe irreale që pasurohen.

Çështjen e shenjzimit, që hyn në fushën e teorisë së shenjave, të semiotikës, Rugova e heton edhe kur Bogdani e vë Zotin në qendër të filozofisë së vet, në kuptimin dhe domethënien e të shembëllyeshmit: Zoti Krijues i shenjave, që sinjifikon, që shenjon, kështu që në terminologjinë e tij dallon (i, të) *shenjuem* (Libri shenjuem) dhe formën foljore *shenjue* (ashtë shenjue), që i inkuadron në klasifikimet e sotme semiotike, si *shenjuesi* dhe *i shenjuari*. Kësisoj teorinë e shenjave të veprës e gjykon të motivuar dhe me efekt teologjik e gnoseologjik. Teorinë e shenjave të Bogdanit e vlerëson të inkuadruar mbi teorinë mesjetare mbi shenjën, ku konsiderohej se shenjat janë të shpërndara në botë, prandaj ato duhet të zbulohen. Për më tej, konsiderohej se shenjat janë të shpërndara kudo në *Bibël*, prandaj ato duhet të zbulohen. Kështu, Rugova edhe kur e vlerëson stilin shkencor dhe artistik të Bogdanit, nisat në bazë të koncepteve të sotme, që stilin e konceptojnë si rezultat të gjuhës, në plan të gjuhësisë strukturale e stilistike, edhe të semiologjisë, në të cilat gjuha merret si koncept bazë për përkufizimin e tipave konceptualë terminologjikë.

Leximi semiotik i Rugovës, këndvështrimi i sotëm i tij, nxjerr në shesh edhe imazhin estetik të veprës, kur vështrohen kategoritë dhe elementet estetike në përgjithësi, duke vlerësuar se i kontribujnë stilit metaforik të shkrimtarit. Në këtë mënyrë Rugova veprën e vështron nga këndi estetik, me strukturë harmonike e imazh estetik. Thellësinë e të bukurës e vështron në raportin e *asthetikos* dhe *netikos* - ndjenjë dhe njohje. Gjithë këtë e krahason me harmoninë e Zotit, kosmosit dhe njeriut, si dhe me natyrën që krijon Bogdani te vepra e tij.

Aktualitetin e veprës, si kategori e përherhme e vlerësisë së një shkrimi a teksti, Rugova mendon se përveç tjerash, Bogdani ia shton edhe kur inkuadron elementet e etosit dhe të etnosit, si konkretizim i ideve universale. Mendim të njëjtë ka edhe kur Bogdani e konsideron gjuhën element të parë dhe të rëndësishëm të një bashkësie nacionale, të bashkësisë dhe të kolektivitetit të vet, pra gjuhën si qenësi.

Duhet të theksojmë se Rugova vëren një sistem analogjik të interpretimit të Bogdani. Në këtë kontekst tërheq vërejtjen se termin *ars* Bogdani nuk e përdor në kuptim të *artit*, po në kuptim të veprimit, të aftësisë, shkathtësisë, siç kuptohej në filozofinë mesjetare. Kurse, shikuar në planin e praktikës poetike bogdaniane, konkretisht kur flet për kozmosin dhe shikon elementet e jetës, ekzistimit dhe të shfaqjes, dallon *leitmotivet*, elemente të përhapura në poezinë moderne.

Dhe, në këtë rrugë, Rugova, kur e vështron ligjëratën artistike të Bogdanit, në konceptet e sotme mbi klasifikimin e zhanreve, këtë pjesë të veprës mendon se mund ta quajmë *biografi e romanësuar* apo *roman*.



Rugova vëren se Bogdani në shumë elemente është themelues i terminologjisë shqipe të disa fushave. Lëndën e gjerë të veprës, dijen dhe njohuritë e shumta të tij, Rugova, sipas klasifikimit të sotëm të shkencave, e vlerëson me impakt në formësimin e termave të jurisprudencës, ekonomisë, pedagogji-pikologjisë, gjeografisë, meteorologji-astronomisë, mitologjisë, matematikës, mjekësisë etj.

Marrë në përgjithësi, Rugova i vështron disiplinat e Bogdanit në kuptimin e sotëm, ashtu si veprohet në shkencë sot, duke vlerësuar se lënda, materia, objekti i disiplinave ekziston te Bogdani, po që nuk është i përkufizuar terminologjikisht e konceptualisht.

Pasi që veprën e Rugovës për veprën e Bogdanit e cilësuam si analizë semiotike, hulumtim bartian, me sensibilitet derridian relativizues të problemeve.

Ndërsa, para se të themi se stili i Rugovës është i veçantë, i qenësishëm, me figuracion të pasur, që i jep kështu veprës edhe një vlerë letrare, po kthehem edhe një herë te përkufizimi që i bën ai tekstit, kur e ndan në dy pjesë: *Gjenetika e veprës* dhe *Analitika e veprës*. Përderisa në përkufizimin e parë ai nisat drejt gjuhës së informacionit historiografik, biografik, filologjik e kulturor, stili i tij çon drejt paraqitjes së problemeve të përgjithshme. Në këtë tekst, me pretendim të shqyrtimit origjinal të problemeve informuese, ai do të japë vështrime të rëndësishme, ku dallohet qartazi një tekst me bazë të mirë informuese faktografike.

Në pjesën e dytë diskursi i Rugovës është më analitik, më interpretues dhe argumentues. Këtu Rugova e analizon dhe e interpreton sistemin filozofik e teologjik të Bogdanit, duke vështruar kështu shumë pikëpamje që kanë vlerësi, duke u zhvilluar edhe më tej. Pra, në këtë pjesë, diskursi i Rugovës është më konceptual, duke hulumtuar probleme universale, probleme që mbeten gjallë edhe sot.

Stili rugovian përben një ecje drejt teknikave të ndryshme, si stil i hapur i esesë, por shumë i saktë. Gjuha e tij është e aftë të shprehë mendime të mëdha, thellësi të kuptimit përmes artistikes, estetikës e figurës të mendimit në paraqitjen e praktikës filozofike, teorike e praktike. Në këtë vijë, stili i Rugovës kalon nga retorika tek estetika.

Rugova e diskuton dhe e problemëson veprën dhe autorin si qenësi, duke menduar se disa punkte të veprës në të ardhmen duhet të bëhen objekt i shumë studimeve speciale. Duke u motivuar në parimin e Bogdanit se Zoti është një *krue i gjallë*, konkretizon me mendimin se vepra është një krue i gjallë, “ku mendja dhe shpirti ynë do të gjejnë kënaqësi dhe shqetësim intelektual, ku shumëkush mund të marrë ujë, e s’do të shterret lehtë, çfarë është cilësi dhe vlerësi e veprave të mëdha e komplete që bëjnë jetë në kohë, që qëndrojnë fort me tematikën dhe poetikën e vet”<sup>75</sup>.

Përfundimisht, Libri dhe Stili i Rugovës e kanë dhënë profilin intelektual të Bogdanit, duke e përmbledhur në profil intelektual të shkencëtarit dhe të shkrimtarit në kuptimin e sotëm të termit. “Kështu Bogdani del shkrimtar, jo vetëm në kuptimin

---

<sup>75</sup> Ibrahim Rugova, vep e cit., f. 254.

operues, siç ishte në Mesjetë, po edhe në kuptimin formulues të ideve, problemeve dhe formulimeve artistike, e të krijimit siç e kemi sot.”<sup>76</sup>

---

<sup>76</sup> Po aty, f. 244.

## KAHE DHE PREMISA TË KRITIKËS LETRARE SHQIPTARE 1504-1983

### Kahe dhe premisa

*Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983* është libri i dytë monografik i Ibrahim Rugovës, i cili ngërthen probleme të kritikës letrare dhe ndërlihdjes së saj me historinë e letërsisë dhe me teorinë e letërsisë shqipe. Qëllimi për ta definuar kritikën shqiptare që nga fillimet e deri në kohën e autorit, me të gjitha problemet, kushtet e rrethanat, e ka motivuar autorin për ta titulluar rrugëtimin e tij *kahe dhe premisa*. Me *kahe* nënkuptohen orientimet dhe interesimet e autorëve drejt metodave kritike, ndërsa me *premissa* nënkuptohen bazat teorike dhe rezultatet e kritikës në planin historik dhe në atë aktual. Në esencë, titulli arsyeton konceptimin e kritikës si problem teorik dhe historik dhe përcakton kërkimin e Rugovës që në planin historik të hetohen disa *kahe* dhe *premissa* të kritikës shqiptare, pastaj të shqyrtohen dhe të diferencohen.<sup>77</sup>

Trajtimi i problematikës së cilës i ka hyrë Rugova, pra klasifikimi i kaheve dhe i premisave, si në planin teorik, po ashtu në atë historik, përkon edhe me trajtimet e ngjashme evropiane. Saktësisht, vetë autori problematikën e tillë e pasuron me pikëpamje të ndryshme nëpër regjione. Për të qenë më afër me pikëvështrimin e dijes botërore, e sidomos me kritikën bashkëkohore, ai e shqyrton edhe klasifikimin e çështjeve, tipave të kritikës në epokën bashkëkohore. Kështu, Rugova mbi këtë vështrim krijon një kuptim kontekstor të problemit të vështrimit, duke konstatuar se, pavarësisht pluralitetit të klasifikimeve dhe të përkufizimeve të kritikës, klasifikimi në epokën bashkëkohore bëhet në bazë të metodologjive të ndryshme që përdoren për kritikën letrare. Në këtë pikëpamje, Rugova është i mendimit se ky pluralitet metodologjik bashkëkohor flet për interdisiplinartitet, që vendos njëfarë bashkëpunimi midis tipave të kritikës, duke u parë si komunikim në rrafsh të rezultateve e jo të metodologjive. Këtë tip kritike e sheh të aplikuar më shumë te Zheneti dhe Todorovi, e sidomos ushtrimin e komplementaritetit të tyre, shpërndërrimet midis kritikës dhe poetikës, si edhe kritikën dialogjike.

Ndërsa kur flet për teorifikimin e letërsisë, shpjegon më së miri me teorinë e Uelekut e Uorenit, nga edhe mendon se del definimi bashkëkohor për këto disiplina,

---

<sup>77</sup> Kujtim M. Shala: "Prishtina letrare".

“përmes të cilave vështrohet zhvillimi i mendimit kritik në rendin historik dhe nxjerrja e përgjithësimeve teorike në plan të vështrimit historik dhe në plan të zhvillimit aktual të kritikës.”<sup>78</sup>

Kështu, në kuadër të këtyre mendimve, duke vlerësuar teorifikimin e Uelekut e Uorenit dhe interdisiplinaritetin e Zhenetit dhe kritikën dialogjike të Todorovit, Rugova prek problemin e bazës teorike të kritikës letrare shqiptare dhe problemin e kahjes së tyre, të metodave të diferencuara, pra ai anon drejt hetimit të metodës në kritikën letrare. Prandaj, Rugova për të hulumtuar kritikën letrare shqiptare, kërkon kahet dhe premisat duke i provuar në dy pjesët e librit, të cilat i ndanë në dy tërësi të mëdha: *fillimet e mendimit kritik* dhe *kritikën bashkëkohore*. Konkretisht, zhvillimin e mendimit tonë kritik në përgjithësi e kërkon në kuadër të një periodizim historik, për të parë evolucionin e tyre në periudha të ndryshme të kritikës, si në: Kritikën e Rilindjes Kombëtare, në Kritikën e periudhës 1912-1944, pastaj në Kritikën bashkëkohore, të cilën e ndan në Kritikën në Shqipëri, Kritikën shqiptare në Kosovë dhe Kritikën e arbëreshëve. Te secila periudhë kohore, përveç që kërkon metodat dhe bazat teorike, shpjegon edhe kontaktet sociokulturore të cilat e kanë determinuar rrjedhën e kritikës letrare shqiptare.

Rezultati përfundimtar i Rugovës është hetimi i elementeve kryesore mbi të cilat kritika i ka ndërtuar kriteret e veta, pastaj në bazë të këtyre premisave janë kërkuar kahet dhe orientimet. Rruga që ka ndjekur Rugova për ta arritur këtë rezultat është vështrimi analizues, karakterizues e vlerësues i librave të kritikës dhe problemeve të kritikës. Rëndësia e punës së tillë shtohet në rradhë të parë kur dihet që nuk është bërë asnjëherë hulumtimi i kritikës letrare brenda kësaj periudhe kaq të gjatë kohore. Kështu, në pjesën e parë të studimit shenjohehet dhe vërehet qartë përpjekja që problemi i kritikës të vështrohet në proces të kontinuitetit të ideve, ndërsa në pjesën e dytë shenjohehet përpjekja për hulumtimin dhe studimin e letërsisë (e cila ishte pjesërisht e njohur), pastaj klasifikimin sipas formës e metodës. Por, Rugova në parathënie të librit thekson se “kritikën do ta marrë në vështrim të gjerë duke e kuptuar edhe si studim të letërsisë në planin historik e aktual.”<sup>79</sup>

Interesi qendror i Rugovës kur klasifikon periudhat nuk është kalsifikimi me karakter tipologjik, por klasifikimi në plan kronologjik të orientimit. Në këtë mënyrë qëndrimin e tij kritik e mbështet në paraqitjen sistematike te premisave, duke parapëlqyer kështu diakroninë e gjatë të Bartit.

Është e rëndësishme të theksohet se Rugova ka vështruar të gjithë kritikët që kanë kontribuar në zhvillimin e kritikës sonë, pa marrë parasysh kriterin ideologjizues, që mund t’i eliminonte ata. Ai fton që kahet dhe premisat të kuptohen në kontekst të kohës e jo nga pikëpamjet e sotme të diskutimit për kritikën. Për çdo moskuptim shkruan qartë se “po qe se nisemi nga ideologji e shqyrtimeve të sotme

<sup>78</sup> Ibrahim Rugova: “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, Faik Konica, Prishtinë, 2005, f. 19.

<sup>79</sup> Po aty, f. 16.

në vlerësimin dhe orientimin e traditës me një qëndrim të tillë negativ, atëherë biem në mohim të asaj mbi të cilat qëndrojmë.”<sup>80</sup>

### Kontekstet socio-kulturore

Siç edhe e theksuam, kërkimin e tij Rugova e parashtrroi në radhë të parë duke kërkuar kontekstet socio-kulturore të secilës periudhë veç e veç. Konteksti i tillë, studiohet fillimisht në letërsinë e vjetër shqipe, që për autorin nënkupton fillimet e mendimit shqiptar. Kështu që, në këtë drejtim, të zbulimeve dhe vlerësimeve, Rugova konsideron se mendimi shqiptar fillon me veprat e para të humanistëve dhe të shkrimtarëve të parë shqiptarë, të cilët jetuan dhe vepruan në Itali, nga fundi i shekullit pesëmbëdhjetë dhe gjatë shekullit gjashtëmbëdhjetë. Këtë konstatim e mbështet nga aspekti i ideve dhe orientimeve të këtyre autorëve, të cilët i konsideron humanistë të vërtetë, pasi që në veprat e tyre merreshin me problemin e njeriut, të jetës njerëzore në frymën e filozofisë dhe të kulturës antike. Do të thotë, Rugova, duke vështruar idetë dhe ideologjitë e tyre, gjen elementet e para të mendimit për letërsinë dhe kulturën dhe gjithashtu flet për një kulturë humaniste në kuadër të Renesancës evropiane.

Këtë kontekst kulturor, studiuesi e shenjon me veprën e Barletit, me temë Shkodrën dhe Skënderbeun, me lëndë shqiptare e njerëzore, tipike humaniste. Në këtë drejtim të veprimit e shquan edhe Biçikemin.

Sa i përket zgjedhjes së humanistëve shqiptarë, mendon se prin Gjin Gazulli, i njohur në fushën e astronomisë, pastaj përmend arkitektin dhe skulptorin Aleks Durrësakun. Në këtë vijë të humanizimi njih edhe poetin dhe filozofin Mikel Maruli, pastaj Leonik Tomeun, etj. Prandaj, Rugova, duke i pasur në mendje këto informacione, gjykon se mendimi ynë kritik lindi nga humanistët shqiptarë, të cilët u shkolluan në Itali, duke e zhvilluar veprimtarinë e vet në latinisht, e cila ishte gjuhë e artit dhe e kulturës. Interesimin kryesisht e vë mbi çështje të poetikës dhe të retorikës e filozofisë humaniste e teologjike. Kritikët më aktivë të kësaj kohe konsiderohen përfundimisht Barleti, Bogdani e Budi.

Më pas, Rugova heton kontekstin sociokulturor të Rilindjes kombëtare, të cilën ai e quan kritikë romantike. Sa i përket këtij vështrimi dallohet zhvillimi i mendimit historik, estetik dhe kritik për letërsinë. Kurse, në plan të përgjithshëm kombëtar, nënvizon zhvillimin shoqëror dhe kulturor. Kështu, hapat e parë të kësaj veprimtarie rilindëse i vëren të zhvilluara nëpër qendra e koloni jashtë vendit. Mendon se në këtë mënyrë krijohet një interkomunikim më i fortë kulturor e letrar i pikëpamjeve të ndryshme. Gjithashtu, këtu i sheh hapat e parë të një orientimi të unitetit të përgjithshëm.

---

<sup>80</sup> Po aty, f. 19.

Këtë periudhë kulturore Rugova e lexon si një ideologji kolektive të rilindësve, të cilët kishin platformë të përbashkët konstituimin kombëtar, çlirimin dhe forcimin e unitetit shqiptar, formimin e shoqërisë së pavaruar dhe të organizuar shqiptare brenda një shteti si formë të ekzistimit dhe veprimit të organizuar shqiptar. Ky konstatim bëhet bazë për të vazhduar më tutje rreth kontekstit sociokulturor të kësaj periudhe, duke e dalluar si periudhë e konstituimit të një kulture të përbashkët. Duke e parë si pikënisje të parë këtë ide, dallon edhe përpjekjet për formimin e shoqërive të ndryshme jashtë vendit nëpër qendra të ndryshme dhe në koloni, për të kryer një aktivitet më të organizuar në fushën e arsimit, të botimit dhe të nxjerrjes së publikimeve. Esencialisht thekson angazhimin e rilindësve për botim dhe shtyp, si dhe kategorinë e tyre themelore themelimin e kombit, nën hulumtimin e historisë dhe të kulturës.

Ky karakterizim i jep autorit të drejtë të gjykojë se në librat e botuara do të rrahen probleme kombëtare të fushave të ndryshme. Kështu, e konsideron të nevojshme të përmend se në fazat e vonshme të Rilindjes, do të botohen më se 40 gazeta dhe revista të ndryshme, kryesisht jashtë vendit në qendra të ndryshme, si të arbëreshët, si më të njohurat konsideron: “Fiamuri Arbërit”, i De Radës, “Drita” e Stambollit (1884), “La nazione albanese” (1897), “Albania” (1896).

Nga kjo paraqitje e autorit mund të theksojmë se në këtë periudhë të zhvillimit kulturor në përgjithësi, Rugova e konsideron të rëndësishëm unitetin e orientimeve të përgjithshme; ideologjinë kombëtare; përpjekjen për aktivitetet e organizuara në fushën e arsimit, të botimit dhe nxjerrjeve të publikimeve, e gjithashtu të rëndësishme e konsideron edhe kujdesin për mendimin kritik.

Në këtë vijë diskutimi, Rugova shqyrton edhe kontekstin sociokulturor të kritikës së periudhës 1912-1944. Në këtë vështrim analizohet nevojat e kërkesat e reja, të realitetit kulturor e shoqëror për dallim nga ato të Rilindjes. Do të thotë, theksohen vitet kulturore pas Pavarësisë dhe fomimit të shtetit shqiptar, duke u shqyrtuar idetë e qendrave të ndryshme kulturore dhe ideve të reja, pas realizimit të idealeve të kërkuara të Rilindjes.

Në përgjithësi, në këtë periudhë Rugova shënon një aktivitet më të zhvilluar kulturor, andaj edhe kërkimi është më i detajuar. Duke menduar se kombi funksiononte si një shoqëri në kuadër të vetëorganizimit edhe kulturën e shihte ta ndante këtë fat të kombit. Ndër qëllimet e tij është të theksojë se në këto vite shtypi, si njëri nga mediumet më aktive të kulturës përjeton njëfarë zhvillimi. Kështu, përmend vazhdimin e daljes së revistës “Dielli” në Boston, pastaj “Lirija-Diturija”, “La nazione albaneses”, “Përlindja shqiptare”, pastaj daljen e “Hylli i Dritës”, 1914, “Koha” e Gramenos, “Djalëria” e Vjenës, “Shqipëria e re” e Konstancës, “Leka” në Shkodër e të tjera. Sipas këtij vështrimi dhe hulumtimi të revistave kulturore, Rugova vitet ’30 i quan vite të konstituimit dhe të konsolidimit të shtypit shqiptar në vend.

Në vështrimin dhe vlerësimin e shtypit shqiptar si kontekst kulturor i mendimin mbarëshqiptar, Rugova vazhdon shpalimin edhe të disa revista që botoheshin në

Tiranë, duke zgjedhur të përmend “Minvera”, “Illyria”, “Rilindja”, “Bota e re”, “Përpjekja shqiptare”, “Drita” etj.

Pra, në vështrim sociokulturor, kjo periudhë e kritikës, pra periudha pas vitit 1912, njihet nga Rugova si epokë e veprimtarisë shoqërore, kulturore e letrare, me zhvillim të hovshëm të shtypit dhe të arsimit. Kësaj periudhe kulturore i njeh si faktor edhe përkthimin letrar, duke e parë me shtim të vazhdueshëm. Vëren që pos përkthimeve të Nolit, përktheheshin edhe vepra nga letërsitë e popujve të ndryshëm dhe botoheshin fragmente të shkrimtarëve të të gjitha epokave dhe stileve. Pra, këtë rrjedhë të zhvillimit kulturor e sheh si fenomen të veçantë, andaj mendon se ky kontekst i hap këndvështrime të reja edhe vetë letërsisë.

Se Rugova mendon që revistat letrare dhe publikimet e botuara në periudha të caktuara ndikojnë fuqishëm në zhvillimin e letërsisë dhe të mendimit kritik, e shohim kur hulumton kontekstin socio-kulturor të *Kritikës në Shqipëri*. Kështu, në vështrim të përgjithshëm, kritika letrare në Shqipëri pas luftës, shikohet nga studiuesi si zhvillim i dukshëm kulturor, arsimor e shkencor, në dallim me epokat e tjera. Vlerëson se ndryshimi i raporteve shoqërore ndikon në ndryshimin e raporteve kulturore. Mendon se këto zhvillime kanë pasur ndikime në formimin e institucioneve të para shkollore, universitare e shkencore, që u aktivizuan në vitet '50. Përveç kësaj, e konsideron si të rëndësishme formimin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Nga ana tjetër, siç e theksuam, zhvillim të dukshëm sheh te shtypi dhe publikimet e ndryshme kulturore dhe shkencore. Revstat letrare më të njohura të kësaj periudhe, që kanë krijuar themelet e mendimit kritik e letrar shqiptar, dalin këto: “Bota e re” (1945), që pastaj shëndrrohet në revistën “Literatura jonë” dhe “Nëntori”, në fund të viteve '50 nënvizon edhe daljen e gazetës letrare “Drita”, pastaj me rol të veçantë e konsideron edhe revistën “Buletini i shkencave shoqërore”, në Shkodër përmend revistën me karakter shoqërore e kulturor shkencor “Shkodra”, si dhe “Buletini” i Institutit Pedagogjik.

Në vështrimin e kësaj periudhe kulturore shqiptare, Rugova shënon të ngjet edhe një fenomen i ri kulturor, duke e parë se në këtë kohë aktivizohen studimet albanologjike me formimin e institucioneve përkatëse shkencore të fushave të ndryshme. Megjithatë, konsideron se puna më e madhe bëhet në histori, në gjuhësi dhe në historiografinë letrare. Dallojmë pra se sipas pikëpamjeve të tij këto zhvillime kanë pasur ndikime në zhvillimin e kritikës letrare dhe në studimin e letërsisë, të cilat më së shumti i ka dalluar në revistat dhe publikimet “Nëntori” dhe “Drita”.

Në këtë aspekt, pra të vështimit socio-kulturor të kritikës, do të analizohet edhe *Kritika Shqiptare në Kosovë*, gjegjësisht konteksti i saj. Kjo kritikë mendon Rugova se fillon vetëm në periudhën pas luftës e këndeje. Moszhvillimin e kritikës dhe letërsisë në periudhën mes dy luftërave në Kosovë e shikon në kontekstin e rrethanave të vendosuar në Jugosllavinë e vjetër, ku kombësisë shqiptare, i mohohej, pos ekzistencës historike e kulturore, edhe ajo fizike, pra ishte i ndaluar shkrimi i gjuhës shqipe në çdo fushë të jetës.

Gjersa Rugova kërkon fillet e mendimit kritik dhe letërisë shqipe në këtë periudhë, i gjen vetëm pas luftës, me themelimin dhe funksionimin e shtypit dhe të institucioneve të para në gjuhën shqipe. Kështu, përpjekjet e para të organizimit të letërsisë dhe kritikës do t'i konsiderojë të shfaqura në gazetën "Rilindja", që botohet nga viti 1944, pastaj të "Zani i rinis shqiptare" e të "Përparimi". Ndërsa, në revistën letrare "Jeta e re" (1949), që në numrat e parë të saj, do të gjejë artikuj dhe vështrime për letërsinë. Në numrat e parë të saj, vëren se botohen disa artikuj me theks teorik për karakterin e letërisë dhe për funksionin e saj në shoqërinë e re. Ndërkaq, më pas vëren të botohen artikuj për shkrimtarë të njohur të letërisë botërore, për klasikën, realizmin dhe romantizmin.

Duke e konsideruar revistën "Jeta e re" si faktor të rëndësishëm të zhvillimit kritik, mendon se me të filloi edhe të funksionojë kritika, e të intensifikohet për veprat bashkëkohore. Autorët që do të nisin veprimtarinë e vet kritike në këtë kohë, konsideron Vehap Shitën, Hasan Mekuli, Ramiz Kelmendin, Hilmi Aganin e të tjerë.

Në këtë diskutim të hulumtimit të kritikës në Kosovë, Rugova gjykon se kritika është marrë më shumë me veprat e letërisë shqiptare të Jugosllavisë dhe me pak me letërsinë e traditës, por vëren të zhvillohen edhe vështrime të shkurtra për çështje të ndryshme teorike të letërsisë, po në kuadër të orientimit shkollor, të cilën dhe e quan kritikë stimulative.

Natyrisht që mendimi kritik në këtë periudhë vazhdon të zhvillohet dhe kështu në fundin e viteve '60 kritikën letrare Rugova e vëren të intensifikohet, duke parë që shtohet edhe një hapsirë e re, revista "Fjala".

Shohim, dhe del qartë kërkesa kryesore e Rugovës për të kuptuar kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të letërsisë në përgjithësi dhe të mendimit kritik në veçanti. Deri sa diskuton për periudhën e kritikës shqiptare në Kosovë, ai vëren një zhvillim të hovshëm dhe të kompletuar të kritikës. Gjithashtu, thekson një vetëdijësim të saj më të madh në planin teorik, interpretues dhe analitik. Prandaj, duke e shikuar tërë periudhën si proces zhvillimi, gjykon se në këtë kohë kritika zgjeron fushën e interesimeve të veta, duke u marrë në mënyrë të çliruar me gjithë traditën shqiptare, pra me letërsinë e këtushme dhe me letërsinë bashkëkohore të Shqipërisë. Në vazhdën e këtyre diskutimeve mendon se kjo situatë e lirë dhe kreative u krijua pas vitit 1966.

Ajo që e konstituon dhe që i jep peshë Rugova është mendimi se forcohen edhe institucionet e reja kulturore, arsimore e shkencore, gjë që bën të forcohen kuadrot në fushën e kritikës dhe të studimit të letërsisë.

Kështu është me rëndësi të përmendet se Rugova duke analizuar dhe informuar-klasifikuar vlerat e kësaj periudhe, konstaton se brenda viteve '70 formohet një vetëdije më e plotë për gjithë ekzistencën kombëtare e sociale dhe për realitetin e saj historik e aktual në planin e historisë dhe të kulturës. Prandaj, edhe gjykon se Prishtina zë të bëhet qendër kulturore, letrare e shkencore, me funksion të organizuar.



Çështjen e studion nga afër, duke hetuar në këtë kohë edhe përmbledhjet e para monografike për autorë të veçantë të traditës, të letërsisë bashkëkohëse për problemete të veçanta letrare. Në këtë mënyrë, duke e përcaktuar këtë periudhë si mjaft të bujshme të botimit të veprave, komenteve të ndryshme, sidomos për romanin dhe poezinë, e vlerëson edhe si periudhë të njohur të stimulimit të kritikës.

Vlerësimi i Rugovës për kontesktin socio-kulturor, sado shpejt, do të ndalet edhe te *Kritika e arbëreshëve të Italisë* dhe do të shqyrtojë pak kontekstin e situatës se re pas Luftës së Dytë ( e cila vazhdon me emrat e shquar të cilët i ka përmendur më lartë, si Dorsa, De Rada, Stratikoi, Markinoi, Petrotta etj.), duke menduar se dinamizimi rritet më shumë gjatë komunikimit dhe bashkëpunimit me Shqipërinë dhe Kosovën. Dhe, në këtë mënyrë, mendon se ata po inkuadrohen në rrjedhat e kulturës shqiptere, duke dhënë kontribut në këtë plan.

Në vitet '70 jetën kulturore arbëreshe Rugova do ta vërejë më të organizuar. Pos Katedrës së Gjuhës në Palermo dhe të Kozencës, thekson se fillon nxjerrja e botimeve të veçanta në fushën e studimit të letërsisë. Përmend revistën "Zjarri", revistën letrare "Vija", pataj "Zëri i Arbëreshëve", "Zgjimi", "Katundi ynë" etj. Dominuese në këto revista sheh folklorin dhe kritikën e viseve të ndryshme. Përfundimisht, duke shikuar kontekstin e zhvillimeve të tyre socio-kulturore, i konsideron si shumë të rëndësishme kontaktet e drejtpërdrejta të arbëreshëve me Shqipërinë, e sidomos vlerëson pjesëmarrjen e tyre në Seminarin e Gjuhës dhe Kulturës Shqiptare që organizohet në Prishtinë.

Pas këtij vështrimi të shkurtër për secilën periudhë që e ka studiuar Rugova, e shohim se rëndësia e gjithë kësaj qëndron në hetimin e rrethanave kulturore e sociale që krijojnë kontekstin e kësaj letërsie dhe ndikojnë në orientimet dhe bazat e saj teorike.

## Kahe

Pas përshkrimit të kontekstit socio-kulturor të secilës periudhë, dhënies së informacione të sakta të rrjedhës së ngjarjeve dhe të situatave, analizës dhe vlerësimeve, Rugova hap rrugë për t'u marrë më detajisht me interesimet e tyre autoëve të këtyre periudhave. Ai në secilën periudhë do të analizojë kahet, orientimet e zhvillimit të kritikës, për të parë metodat dhe format e kritikës më pas.

Te pjesa e parë e shqyrtimit të tillë, *Fillimet e mendimit kritik*, ka parasysh fillimet e kritikës së traditës. Kështu, analiza e tij sqaron format e para të krijimit të mendimit të përgjithshëm shqiptar. Në këtë vijë, si krijim të parë e evidenton formën e parathënies, me veprën e Buzukut, *Meshari*. Në përgjithësi për këtë epokë autori ka parasysh rrethanat që ë determinojnë kritikën letrare. Në këtë kuptim vëren nje gjendje të rëndë të intelektualëve që kishin mbetur në vend, duke i parë të formuar në kuadër të institucionit të kishës, për ta vazhduar veprimtarinë e tyre kulturore dhe letrare. Nga ky vështrim vëren një përpjkeje për mëkëmbjen e

ideologjisë së kohës, religjionit dhe të ekzistencës kombëtare. Në përgjithësi, parathëniet i konsideron forma që shërbenin për të ngritur popullin. Këtë veti e dallon edhe te Budi me *Fjalorin* e tij. Synimet e autorëve tanë të vjetër i thekson si interesime të para kulturore, si filllet e mendimit e si forma të para të mendimit tonë kulturor. Idenë e ndritjes së popullit e vëren edhe si traditë të përcjellur të Pjetër Bogdani, me veprën e parë origjinale në shqip, *Cuneus Prophetarum*. Si tekst i tërësishëm, *Cuneusi* i Bogdanit trajton çështje të shumta e të ndryshme, përveç atyre teologjike, edhe probleme të ndryshme filozofike, të shkences, të retorikës e poetikës. Te vepra e Bogdanit Rugova shikon trajtesën e parë të problemeve letrare në gjuhën shqipe. Ndërsa, e rëndësishme të theksohet është se këtu veçohet mendimi letrar nga mendimi i përgjithshëm shqiptar.

Interesime kulturore të shkrimtarëve tanë i konsideron edhe përkthimet e Matrangës (1592) dhe veprat e Varibobës në shekullin shtatëmbëdhjetë.

Duke i kërkuar format e para të mendimit shqiptar, Rugova flet edhe për letërsinë e bejtexhinjve, duke konstatuar më shumë ide teoriko-letrare në veprat e tyre poetike, që i konsideron reflekse të poetikës orientale. Këto elementë i vërente në formën e shkrimit të poezisë si te Ibrahim Nezimi, H. Z. Kamberi, S. Naibi, M. Çami etj.

Prej gjithë kësaj del se për Rugovën nga letërsia e vjetër fillon mendimi ynë kritik, mendimi për letërsinë dhe kulturën, pasi që letërsia dhe fushat tjera kulturore ende nuk ishin diferencuar.

Përveç letërsisë së vjetër, drejtimi tjetër të cilin do ta shqyrtojë Rugova duke kërkuar kahet është *Kritika romantike*. Pra, kritikën e Rilindjes e quan kritikë romantike, duke e parë si veprimtari të nisur nga premiset romantike. Orientimet e kësaj kritike i shikon të ndikuara nga premiset dhe orientimet e romantizmit evropian, të kërkimit të traditës. Kështu, te rilindësit tanë në letërsi dhe në kritikë, sipas tij, orientoheshin në aktivizimin e traditës sociologjike për kombin dhe për aktivizimin e bashkëkohësisë për çlirim. Pastaj, heton edhe kërkimin për folklorin në raportin letërsia e shkruar - letërsia gojore dhe konsideron se te rilindësit letërsia e shkruar merrej si vazhdim i letërsisë gojore.

Si bazë të letërsisë së shkruar të romantikëve, Rugova e konsideron letërsinë gojore dhe traditat popullore, duke i parë të nisura nga De Rada. Do të thotë, interesimet për letërsinë e traditës, të lidhur me atë gojore, dalin në qendër të kritikës romantike. Kjo ilustron fillimisht me veprën e Vinçenç Dorsës, *Su gli albanesi - Recherche e penisieri* (1847). Vërehen të inkuadruara problemet e letërsisë gojore në planin krahasimtar, kur Dorsa flet për disa autorë të vjetër dhe për ata të kohës, De Radën dhe Santorin. Interesimi i Rugovës mbi këtë autor ndalet edhe tek mendimi i autorit në fjalë, i cili thoshte se këngët gojore shqiptare në pikëpamje estetike nuk mbeten prapa poezisë së ndonjë populli. Po ashtu, thekson se nga ky autor mitologjia shqiptare krahasohet me atë të veprave të Homerit. Thekson këtu edhe shquarja që i bën ai anës figurative të poezisë gojore dhe çështjeve të metrikës.

Duke i hulumtuar këto orientime të kritikës së Rilindjes, pra të afirmimit të letërsisë gojore, Rugova përmend edhe Dora D'Istrian dhe veprën e saj për kombësinë shqiptare. Pastaj vëren Jani Vreton dhe kërkesën e tij për ribotimin e shkrimtarëve të vjetër si: Budi, Bogdani, H. Z. Kamberi. Në këtë radhë përmend edhe Zef Jubanin, i cili e vlerëson letërsinë gojore dhe historinë shqiptare me theks në letërsinë e traditës.

Hulumtimi shkon përtej kur Rugova vëren se gjatë kërkimit të letërsisë gojore dhe vlerësimit të saj, disa shkrimtarë të Rilindjes mendojnë se ekziston edhe epepeja në letërsinë gojore. Këtë përpjekje e vëren kryesisht të Dorsa, pastaj te De Rada. Përgjithësisht, pra hulumtimi i Rugovës përqendrohet rreth orientimit të shkrimtarëve rilindës, duke i parë si zbulues të veprave të letërsisë së vjetër shqipe, për të cilat mendon se janë vepra themele të letërsisë shqiptare në përgjithësi. Duke parë që mendimet e tyre donin ta arsyetonin lashtësinë e popullit, mendon se ata kërkonin ta dëshmonin idenë e një tërësie në formë epepeje të letërsisë gojore, siç janë veprat e Homerit.

Përveç këtyre kahjeve, Rugova për këta autorë flet edhe për interesimet e tyre historiko-letrare. Në këtë drejtim përmend Dorsën dhe veprën e tij në përgjithësi, ndërsa në plan të mendimit teorik dhe estetik konsideron me vlerë veprën e De Radës *Parime të estetikës* (1861), një interesim estetik dhe romantik në përgjithësi.<sup>81</sup>

Duke e kuptuar se mendimi kritik romantik po kalonte në faza të ndryshme, Rugova thekson se kritika letrare si disiplinë aktivizohet me shkrimet e Konicës. Konkretisht thotë se shtypi i Rilindjes do të paraqitet me kritikën publicistike si zhanër i kritikës dhe informimi për librin. Momente të rëndësishme Rugova i konsideron edhe mendimin kritik të veprave të Markinoit dhe të Gurakuqit, në fushën e studimit monografik historiko-letrar dhe në atë të studimit metrik.

Në këtë rrugë, hetohen edhe disa elemente të tjera të kësaj kritike, siç është shqyrtimi i ndonjë problemi letrar dhe mendimi i disa shkrimtarëve që paraqitet në parathënien që ua bëjnë librave të vet, si De Rada, Gavril Dara i Riu, Asdreni, Çajupi.

Shkolla kulturore e Rilindjes, përfshirë kritikën letrare, realizohet në raportin: letërsia-kombi, praktika kombëtare. Rugova dallon insistimin e letërsisë që të vlerësoj sipas artit në funksion; çështjesh preokupimit të realizimit të gjuhës në vepër; korrespondimin e bazave teorike të kësaj kritike me klasiken, me elemente të klasicizmit dhe të teorisë së romantizmit. Prandaj, ai mendon se shkrimtarët dhe kritikët e Rilindjes e zbatuan këtë platformë teorike në bazë të kërkesave të kohës, për të kërkuar një art me theks humanist e etik për forcimin e qenies kombëtare.

Por, orientimet e pikëpamjet e kritikës së Rilindjes, vështruar nga Rugova, do të ndryshojnë në kohë, duke theksuar kështu kërkesën për diferencimin midis praktikës patriotike kombëtare-shoqërore dhe asaj artistike. Kjo vlen së pari për Konicën, me shembullin e tij për Naimin, shkrimtarin më të njohur të asaj kohe. Rugova, ndërkaq, vëren se edhe pse në shumë konstatime dhe vlerësime në këtë çështje Konicë nuk

---

<sup>81</sup> Shih edhe Albanë Mehmetaj: "De Rada estet", AIKD, Prishtinë, 2010.

kishte argumente të mjaftueshme e bindëse, insistimi i tij është moment i rëndësishëm në planin teorik. Kështu që, Rugova jep vlerësimin se në fundet e Rilindjes insistohet edhe në anën artistike të letërsisë.

Ky përceptim i Rugovës, shkon kah mendimi se me letërsinë e Rilindjes vërehen dhe nisin elemente të letërsisë së re apo moderne. Mendimin e përforcon edhe kur vëren se kritika e asaj kohe i lanson disa elemente të mendimit modern, p.sh. kritika impresioniste, me të cilën mendon se edhe do të zhvillohet mendimi ynë kritik e teorik më vonë. Duke i pasur parasysh këto elemente e orientime të kritikës romantike, Rugova vlerëson se do të forcohet shkolla e kërkimeve historiko-letrare, e çështjeve estetike e teorike të letërsisë dhe e kritikës letrare.

Më pas, Rugova pasi thekson vetitë dhe orientimet e kritikës romantike, përpiqet të vlerësojë në këtë kuptim kritikën e periudhës prej vitit 1912 deri në vitin 1944. Në rradhë të parë dallon se kjo periudhë dimensionin kritik e kishte përfituar shumë nga shtypi, nga shkrimet e kritikës recensionale, publicistike, nga shkrimet analitike për fenomene të ndryshme historiko-letrare dhe për ato teorike e estetike. Ndërkaq, si frymë të orientimit e të hulumtimit dallon studimin e traditës letrare. Pra, te të gjithë shkrimtarët, publicistët dhe kritikët letarë vëren një interesimi për kritikën letrare, duke hetuar kështu më shumë kritikë se sa produksion letrar.

Gjithashtu, te kjo periudhë Rugova thekson edhe një hapësirë tjetër të kritikës, siç është libri. Pra, flet për botimin e teksteve shkollore të letërsisë dhe librave të kritikës letrare, antologji të letërsisë me shënime e komente, si dhe tekste historiko-letrare. Evidenton këtu librat duke filluar nga teksti i Xanonit, që doli si libër në vitin 1920, pastaj ai J. Rrotës, Xhuvanit e Cipos dhe tekstin *Shkrimtarët shqiptarë I, II*.

Për Rugovën kritika më aktive e kësaj kohe nis me me kritikët që fillojnë nga mesi i viteve '20, si Krist Maloki, E. Çabej, M. Kuteli, Vangjel Koça, Dh. Shuteriqi dhe në vitet '40 A. Pipa. Fillimisht këtu përmend edhe Nolin, i cili kishte filluar veprimtarinë e vet kritike nga fundi i Rilindjes, po që e vazhdonte në këtë periudhë me pikëpamje të reja në rrethana të reja. Për kritikën publicistike vëren kritikët më aktivë Stefan Shundi e Kudert Kokoshi në vitet '30, Ndërsa, në vitet '40 përmend kritikët e rinj: V. Kokona, N. Hakiu, Kolë Ashta, Pashko Gjeçi etj. Kritikën më të perfeksionuar e gjen edhe të shumë shkrimtarë, si të Gjergj Fishta, Etëhem Haxhiademi, Ernest Koliqi, Sterjo Spasse, Andrea Varfi etj. Më këtë rast vëren edhe që mendimi i letërsisë aktivizohet, që përfaqësohej me L. Poradecin, P. Marko, N. Bulka etj. Pas kësaj, Rugova arrinte të konkluzo se me kritikën e kësaj periudhe merreshin njerëz të profileve dhe të orientimeve të ndryshme.

Hulumtimi i Rugovës drejt definimit të shkollave kritike do të ndalet në vijim te *Kritika në Shqipëri*. Metodë të parë të shkrimit të letërsisë konsideron aplikimin e realizimit socialist. Punën kritike e konsideron të zhvilluar nga shkrimtarët dhe kritikët e viteve '30, si: Andrea Varfi, Aleks Caci dhe Dhimitër S. Shuteriqi. Pra, janë këtë shkrimtarët e parë që kishin pranuar idetë sociale të rolit shoqëror të letërsisë.

Në këtë vështrim, Rugova mendon se deri në vitet 60' kishte një aktivitet të vogël të kritikës. Një më shumë fushën e studimeve historiko-letrare më Ziaudin

Kodrën, Dh. S. Shuteriqin, Mahir Domin, V. Balën etj. Duhet të thuhet se në fushën e kritikës, Rugova mendon se botoheshin kryesisht tekste të huaja për realizimin socialist dhe më pak të autorëve shqiptarë. Por, kthesë të madhe në këtë aspekt konsideron shfaqjen dhe forcimin e një brezi të kritikëve të rinj, në fillim të viteve '60, me autorë si Razi Brahimi, Kudret Velça, Dalan Shaplo, më vonë Jorgo Bullo, Gjergj Zheji, Alfred Uçi etj.

Mbasi Rugova flet edhe për zhvillimin e mirë të vet letërsisë, përmend edhe tekstet e para historiko-letrare të pasluftë. Është fjala për *Historia e letërsisë shqipe I, II* (1957), pastaj *Historia e letërsisë shqiptare* që nga fillimet e deri të Lufta Nacionalçlirimtare, 1, 2 dhe 3, dhe *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist* (1987).

Kjo paraqitje e Rugovës bën kalsifikimin e çështjeve të përgjithshme për të konstatuar teorinë socialiste. Pastaj, thekson se vëmendje më të madhe i kushton vështrimit të problemeve të novatorizmit dhe të konceptit të traditës që lidhet me të, duke i konsideruar si orientimet dhe interesime të përbashkëta të kritikëve të kësaj periudhe.

Vështrimi i Rugovës shtrihet drejt orientimeve dhe metodave të kritikës letrare në Kosovë. Kërkimi i tij në këtë pjesë bëhet më i ndërlikuar, pasi që kritikët dhe autorët e saj i sheh në proces të vazhdueshëm të evoluimit. Prandaj, për t'i parë më mirë orientimet e përbashkëta të shkrimtarëve dhe kritikëve të kësaj periudhe, do të fokusohet te roli i paraqitjes së autorëve dhe të pikëpamjeve që mund t'i afronte. Kështu që bën një klasifikim orientues, në tri orientime ku si orientim të parë, e konsideron një pjesë të kritikës, e cila në qendër të vëmendjes kishte rolin shoqëror të letërsisë dhe funksionin më të theksuar të stimulimit të krijmtarisë letrare. Autorë ilustrativë i konsideron Vehap Shitën dhe Hasan Mekulin. Orientim të dytë konstaton kritikën që ka kërkuar angazhimin e letërsisë në planin social, po më shumë në atë të përgjithshëm jetësor, njerëzor e artistik. E ilustron këtë metodë me praktikën kritike të këtyre autorëve si, Ali Aliu, Rexhep Qosja, Hysni Hoxha dhe Ali Jasiqi. Ndërsa, në orientimin e tretë ai flet për kërkesat që shfaqeshin për një diferencim të këndvështrimeve për kuptimin dhe interpretimin e letërsisë. Te ky orientim Rugova konstaton kërkimin e forcimit metodologjik e teorik të kritikës, vëren në përgjithësi më shumë forma të vështrimit të letërsisë në bazë të metodologjive bashkëkohore dhe e ilustron me kritikën e Mensur Raifit, Rexhep Ismajlit dhe të Sabri Hamitit.

Këto orientime kritike Rugova i karakterizon dhe i vlerëson në bazë të rendit kohor se si janë shfaqur. Në dallim nga orientimet të lartpërmendura, këtë të fundit e vëren të dalë si reagim të atij pararendës, duke konsideruar se ka sjellë një vetëdije letrare dhe kulturore tjetër. Autorët që kanë jetuar dhe vepruar në të njëjtën kohë, përkundër reflektimit të ideve të përbashkëta, i përmbahen asaj fryme në të cilën janë formuar. Pas këtij vështrimi, e rëndësishme del se këto tri orientime, sipas Rugovës, kanë ndikuar në përdegëzimin e formave të vështrimit.

Sado shkurtimisht, vlen të veçohen se në vështrimin e Rugovës për *Kritikën e Arbëreshëve të Italisë* dominon ideja se vazhdon tradita e hulumtimit dhe e ribotimit të autorëve të njohur arbëreshë, por vërehet edhe përpilimi i historive dhe i teksteve të tjera me karakter historiko-letrar. Përmend këtu në vitet '50 Zef Skiroin e Ri dhe botimin e historisë së letërsisë shqiptare, pastaj një vëllim me studime nga Xhuzepe Gradilone. Punë të vlefshme mendon se bën edhe Françesko Solano në botimin dhe komentimin e veprave më pak të njohura të Santorit, pastaj Zef Ferrari, që bën një histori të letërsisë shqiptare me pjesë të zgjedhura.

Punë më të harmonizuar në kritikë Rugova konsideron se kanë bërë studiuesit e brezit të ri arbëresh, si Italo K. Fortino, Fran Altimari, Z. Farko, E. Mirako e të tjerë. Veçon këtu Fortinon dhe Altimarin me shkrimet e veta në shqip e sidomos këtë të fundit, i cili sjell të dhëna dhe ide më studioze për autorët e letërsisë arbëreshe të Rilindjes kombëtare. Më të rëndësishmin e konsideron vëllimin e studimit të tij në shqip dhe italisht *Mbi figurën e Skënderbeut në një Rapsodi të De Radës dhe letërisë gojore arbëreshe dhe Rapsoditë e De Radës në letërisë romantike evropiane*.

Përfundimisht, Rugova mendon se arbëreshët e Italisë, edhe në kritikën bashkëkohore, po japin ndihmesë të rëndësishme.

### **Premisa (rezultate)**

Pasi i diskuton kontaktet sociokulturore dhe heton kahet e tyre, pra orientimet, shkollat nëpër të cilat kanë ecur, Rugova do të merret më sistematikisht me bazat e tyre teorike. Pra, tash vështrimi i tij do të fokusohet në rezultatet e autorëve përfaqësues të epokave, pasi ka përcaktuar zhvillimin e kritikës letrare dhe orientimet. Rrjedha e vështrimit do t'i ngjajë analizave të mësipërme, duke fillur nga letërisa e traditës.

*Fillimet e mendimit kritik* do t'i përcaktojë më së miri duke trajtuar tekstet e Marin Barletit, Pjetër Bogdanit dhe Nezmit, si premisa të kësaj periudhe.

Te Barleti do të analizojë problemet teorike e letrare që kishte shtruar, i mbështetur në poetikën e Horacit mbi të dobishmen dhe të këndshmen. Te ky autor vlerëson kërkesën për harmoninë dhe ulitaritetin e artit, të cilën edhe e sheh si temë në gjithë historinë e mëvonshme të prolemeve estetike e letrare-torike. Me një fjalë, e vlerëson stilin e tij, si dhe trajtimin e çështjeve të poetikës, estetikës dhe të aktit të krijimit, që do të thotë mendimi i tij kritik shfaqet në poetikë dhe teori.

Pjetër Bogdani del si autori më i rëndësishëm i shkrimit të vjetër shqip. Çështje esenciale në praktikën e tij e konsideron raportin estetik, problemet e poetikës dhe të retorikës. Si te të gjithë autorët e Mesjetës, studiuesi vëren se edhe Bogdani kur trajton çështjen e klasifikimit të tipeve të shkrimit e bën këtë zgjedhjen e zakoshme. Duke kuptuar se Bogdani mbështetej në poetikën dhe retorikën e Mesjetës, poezinë dhe historinë e barazonte, e në krye të këtij kalifikimi vinte shkrimin e përsipirtshëm, duke i dhëna atribucionet që ia jepte poezisë Aristoteli. Në fund te ky

autor vlerëson çështjen e retorikës, pra problemin e kuptimit figurativ të Shkrimit të shenjtë, të përsëritshëm. Mendon se krejt këtë kuptim ai e përfshin me nocionin e profecisë dhe të metaforave në vështrimin retorik, duke gjykuar barazimin midis metaforës dhe profecisë. Pra, sheh që autori ynë i vjetër, duke u mbështetur në teorinë e Aristotelit, flet për metaforën si mbretëreshë të tropeve. Mendon se ai zbaton një praktikë retorike në gjuhën shqipe mbështetur te Aristoteli dhe te Toma Akuini. Kuptimi figurativ që i jep Bogdani retorikës së tij sipas Rugovës merr vlerë ontologjike, sepse vetë Shkrimi i shenjtë është produkt ontologjik. I gjithë mendimi kritik i Bogdanit inkuadrohet në problemet e përmendura, të konsideruara gjitha si pjesë e sistemit filozofik e teologjik.

Nezimi sipas Rugovës është autori më përfaqësues i *Letërsisë së Bejtexhinjve*, i cili dallohet për format poetike. Nënvizon se ai solli termat *shiri*, *kasideja*, *gazeli*, *rubaira*, *bejan*, duke inkuadruar kështu poetikën orientale.

Më shkurt, fillimet e mendimit tonë kritik Rugova i vëren të bazuara në teoritë mesjetare dhe klasike për shkrimin. Autorin më përfaqësues e konsideron Bogdanin, duke parë tek ai një vetëdije më të formuar për traditën dhe pikëpamje më të formuar për historinë.

*Kritikën romantike* në këtë logjikë të shqyrtimit Rugova e karakterizon me premisave të koloritit lokal, e kryesisht premisë së “frymës kombëtare”. Premisë tjetër të rëndësishme të kritikëve romantikë e konsideron aspektin artistik të krijimtarisë së tyre dhe çështjen e gjuhës, si gjuhë në funksion të artit. Jep këto konstatime, duke i analizuar dhe vlerësuar veprat e autorëve më të njohur të kësaj periudhe, si: Jeronim de Rada (konsideron si bazë teorike intencën e tij për një teori estetike), Stratikoi (duke e vlerësuar veprën e tij si bazë e historisë sonë letrare), Faik Konica (duke e shquar veprën e tij si vetëdije për nevojën e kritikës), Markionoi (nënvizon studimin monografik dhe premisën teorike që t’i veçojë çështjet e artit dhe të veprimtarisë praktike), Gurakuqi (veprën e të cilit e konsideron si bazë të teorisë tradicionale metrike në kritikën tonë); pastaj Rugova vështron edhe pikëpamjet e atyre shkrimtarëve që dhanë kontribut në vështrimin e rrjedhës së mendimit letrar dhe e ka fjalën këtu për Naim Frashërin (flet për mendimet e tij për përgjithësimet poetike, duke i parë të dala nga historia e poezisë), Asdreni (diskuton problemin e raportit që shtrihet ai letërsia-politika, dhe kërkesën e tij për kultivimin e rregullave të poetikës në frymë të prozodisë së gjuhës amtare, pra ishte kundër klasicizmit të Gurakuqit, mendimi ky që pëlqehet nga Rugova), Mjeda (shënon bazën e tij teorike me interesimin, idealin që kishte për teorinë klasike, që përputhet në shumë pika me atë klasiciste dhe shkrimi e tij me karakter shpjegues e interpretues me vlerë të bindjes), Çajupi (vlerëson premisën e tij estetike për rolin argëtues të letërisë, me të cilën konsideron se e pasuron mendimin kritik dhe teorik shqiptar).

Bazat më të forcuara teorike të kritikës e Rilindjes i konsideron te Jeronim de Rada, me intencën e tij për një teori estetike, në veprën *Parime të estetikës*. Do të thotë problemet e artit te ky autor shqyrtohen në kuadër të interesimeve estetike. Për Rugovën teoria estetike e De Radës nisët nga kategoria e së bukurës, e të cilën e

nxjerrë nga *parimi moral*. Mendon se kategoria e së ndershmes mirret si parim qendror, nga e cila edhe i nxjerr kategoritë e tjera estetike.

Në këtë vështrim Rugova mendon se De Rada e aplikon filozofinë klasike për të bukurën, të klasicizmit, dhe argumentimit teologjik, me orintime romantike dhe iluministe.

Artikullin e Konicës *Kohëtore e Letrave Shqipe* e shquan si ide për themelimin e kritikës letrare shqiptare, si vetëdije për kritikën letrare, duke vlerësuar teorinë dhe praktikën e tij kritike. Krijimtarinë kritike të Konicës para së gjithash Rugova e vlerëson si nevojë të kohës.

Në lidhje me kritikën e Konicës, Rugova merret kryesisht me shpjegimin dhe përkufizimin e kritikës, që sipas Konicës del si një gjykim i vlerës së librave dhe merret me shqyrtimin e një çështje shumë të rëndësishme, e cila edhe sot dikutohet, kritika art apo shkencë. Pastaj, Rugova analizon metodën dhe vjen te konstatimi se për Konicën kritika nuk është shkencë, por ka metodën e vet, e cila është krahasimi.

Kështu në teorinë e kritikës së Konicës Rugova nënvizon edhe një çështje tjetër të rëndësishme, që shtrohet për herë të parë në letërisë tonë, dallimi në mes të ideologjisë dhe letërisë, teori të cilën do ta pranojnë shumë autorë më vonë. Shquan edhe mendimin për pavarësinë e kritikës dhe të autorit. Tezën se letërsia nuk mund të rritet pa një kritikë, e konsideron si ndër rëndësitë më të mëdha të programit kulturor të Rilindjes.

Përveç karakterizimit të teorisë së kritikës, të cilën edhe e përcakton si inaugurim të kritikës moderne në letërsinë dhe kulturën tonë, Rugova e shqyrton edhe kritikën letrare të Konicës, tekstet e të cilit i veçon si fillim i kritikës së interpretimit të veprave shqiptare. Konkretisht, praktikën e tij kritike e shquan për karakterin afirmativ të kritikës së shkruar, duke analizuar kështu tekstin e tij për Naimin, De Radën, Çajupin, Asdrenin etj. Por, në praktikën e tij kritike Rugova dallon edhe disa mendime që i bien ndesh praktikës teorike të tij, p.sh. thotë se Konica çmonte në radhë të parë temën patriotike, pastaj gjuhën artistike. Rugova mendon se praktika kritike e Konicës i largon dhe i hedh disa mendime të gabuara që u dhanë të formuluar në formë teorike të *Kohëtorja*.

Rugova duke synuar të interpretojë në këtë tekst bazat teorike të autorëve të Rilindjes, për Konicën mendon se nisej nga premiset e kritikës impresionale, të cilën e përfaqësonte Zhyl Lemetri. Kur Konica e përkufizon kritikën si përshtypje, impresion e krahason me një nga premiset e para të kritikës impresioniste të Lemetrit. Por, me impresionizim Rugova mendon se fillojnë disa aspekte të kritikës moderne në përgjithësi. Përfundimisht, Konica vlerësohet nga Rugova si themelues i kritikës si disiplinë dhe shquhet për problemet fundamentale që shtroi, duke i parë si forma e nivele të ndryshme me kontekstet e kohës, do të rishqyrtohen dhe aktualizohen kohëpaskohe.

Shkurtimisht, kritika e Rilindjes për Rugovën paraqet një ngritje cilësore. E vlerëson si kritikë romantike, pasi që premiset e saj mbështeten në teorinë romantike për letërsinë dhe shoqërinë. Por, premisë tjetër të rëndësishme për këtë



periudhë e konsideron edhe mbështetjen në teorinë klasiciste e klasike për artin. Mendon kështu, pasi që rilindësit kërkonin një mbështetje të verifikuar për idealet e tyre kombëtare.

Rezultatet tjera të kritikës shqiptare Rugova do t'i kërkojë në vijim te *Kritika e periudhës 1912-1944*. Kjo epokë, pra është objekti për të cilën ai do të hetojë bazat teorike, duke i parë të nisura përveç nga vlerësimi i veprave letrare, edhe nga disa kritere në bazë të premisave jashtëletrare. Kjo kritikë në gjykim të autorit tonë, përkundër disa vërejtjeve del mjaft aktive në vlerësime dhe analiza. Prandaj, Rugova e konsideron të rrugës të mos ndalet në bazat teorike të saj, por t'i vështrojë disa kritikë më të afirmuar të kësaj kohe. Kritikët të cilët Rugova do t'i zgjedhë për t'i analizuar në këtë epokë:

Te F. S. Noli konsideron si vlerë kritikën introduktore të tij për nga esencat dhe qëllimet dhe për nga orientimi sociologjik e psikologjik, të cilat do t'i konsiderojë edhe si premisa teorike. Po ashtu, te ky autor do të shquajë edhe metodën kritike shkencore.

Tekstet e Krist Malokit *Naim Frashëri* dhe *A është Poet Lasgush Poradeci?*, i konsideron të realizuara nga premisa teorike të psikanalizës dhe shkollës kulturohistorike. Sipas Rugovës, Maloki zgjedh premisat psikanalitike si metodë për të vlerësuar dhe gjykuar më shumë objektivitetin në kritikë motiv konsideron aktualitetin e kritikës së kohës.

Në nivel të teorisë Rugova çmonte nisjen e kritikës së kritikës në kritikën tonë që solli Maloki, duke e konsideruar si të dobishme për vetëdijen dhe përgjithësinë më të madhe ndaj fjalës kritike. Pra, çmon vështimin psikanalitik, e psikobiografik tradicional dhe atë kulturohistorik të Malokit.

Kërkimi i Rugovës për t'i hetuar premisat teorike të periudhës së Rilindjes, në vijim ndalet te Eqrem Çabej, duke e vlerësuar metodën e tij për induktivitetin e studimit filologjik dhe kulturohistorik në kritikën tonë letrare. Te Çabej Rugova njeh dy premisa, atë historike-estetike dhe kulturohistorike.

Rugova çmon Çabejn për mënyrën e studimit të letërisë shqipe, pra filologjike dhe kulturore, prandaj edhe e analizon këtë metodë duke e parë të aplikuar në vështrime të ndryshme. Për shembull vëren kërkesën filologjike kur ky kritik vështron pozinë e Lasgushit, Asdrenit, më pas De Radës, Naimit, Fishtës etj. Pra, Çabej bën vlerësimin nga rëndësia e poetit, pastaj heton çështjet në kuptimin e poezisë. Një çështje tjetër të rëndësishme e konsideron edhe kërkesën e Çabejt për të vështrimin e brendshëm të veprës. Kështu metodën sinkronike dhe diakronike të tij, e vlerëson si një bazë të një terminologjie, që sot në studimet gjuhësore e letrare e gjen të përdoret duke filluar nga strukturalizmi e këndeje. Prandaj, Rugova në veprën e Çabejt vëren bazat teorike dhe shenjat e modernitetit.

Kritiku tjetër që jep shenja të rëndësishme në kritikën tonë letrare dhe që shquhet në vlerësimet e Rugovës është Mitrush Kuteli. Para së gjithash, ai njihet si kritiku i parë që arriti t'i përmbledhë kritikën e veta me një titull të veçantë "Shënimet letrare".

Të Kulteli shquan përpjekjen e tij që të bëjë një analizë imanente të poezisë, duke shqyrtuar formën dhe përmbajtjen e poezisë. Po ashtu, Rugova ndalet edhe te gjykimet impresioniste të tij, duke menduar se ato nuk ia humbin vlerën analitike kritikës së Kutelit. Në aspektin e ligjërimit kritik, vëren një gjuhë poetike, të cilën e sheh më shumë si ligjërimit identifikimi se vlerësimi e analizimi, por për të cilën mendon se edhe vetë angazhohej. Ky element mendon që bëri njëfarë rrafshimi të terminologjisë, duke e parë mjaft moderne e funksionale për kohën dhe kritikën e tij si kontribut i analizës në përgjithësi;

Dhimitër S. Shuteriqi është kritik i radhës së listës së Rugovës, tek i cili do të veçojë kërkesën për literaturën shoqërore e realiste. Vëren kështu pasi që thekson se ky kritik nisej nga premiset për karakterin social të artit, duke menduar se arti është prodhim shoqëror dhe shoqëria e bën për nevojat e veta. Më konkretisht metodën e analizës së tij e quan metodë socialiste e letërsisë shqipe, e dalë si radikalizëm e formë agresive.

Premisë tjetër interesante dhe e rëndësishme për kritikën shqiptare, në gjykimin e Rugovës del edhe kritika e Arshi Pipës. Te ky kritik vlerëson bazën teorike të tij, në të cilën kritika del estetike dhe historike. Pra, sipas Rugovës Pipa në plan teorik e konsideron kritikën si logjikë dhe diçka tjetër, duke pasur në qendër *intuitën*, për të cilin sjell lëndën e gjallë, rikrijimin, si letërsi për letërsinë. Më konkretisht ai e përkufizon kritikën si rikrijim të veprës artistike, por të ketë objektivitetin si kusht të parë. Për një kritikë të vlefshme, te ky kritik Rugova nënvizon edhe kërkesën për kritikë të specializuar.

Kështu, Rugova duke analizuar veç e veç disa nga kritikët të cilët ai i konsideron si më përfaqësuesit për paraqitjen e epokës dhe duke i konsideruar veprat e tyre si rezultate bazë, thekson një kohë individuale të krijimit, një larushi dhe një debat të hapur kritik. Pra, të gjitha premiset e autorëve përbëjnë edhe veçantinë e periudhës. Në këtë rend Rugova përmend edhe Vangjel Koçën me kritikën e romanit, pastaj edhe disa veti dhe autorë të fillimit të interpretimit, mendime kritike të shkrimtarëve, tekstet e mësimin të letërsisë, me përfaqësues Xanonon. J. Rrotën dhe Xhuvani-Cipon.

Shkurtimisht, kur flet për këtë periudhë, Rugova i thekson premiset teorike që bazohen në dijet e kohës, që cilësohen si dije moderne, të inicuar nga Frojdi, Marksi, Niçe etj.

Kur ndalet te Kritika në Shqipëri, vështimi kritik i Rugovës ndryshon qasjen dhe ai, kur heton premiset teorike dhe bazën e përgjithëshme teorike të kritikës, nuk ndalet të analizojë e të vlerësojë autorë dhe tekste të veçanta, por i vështron problemet që e preokupuan kritikën, duke parë kështu orientimin dhe interesimin e autorëve. Kështu, çështjet që do t'i trajtojë fillimisht lidhen me aprovimin dhe aplikimin e realizmit socialist si teori. Vëmendje Rugova do t'i kushtojë problemeve të novatorizmit dhe koncepteve të traditës që lidhen me të. Pra, Rugova synon t'i përkufizojë disa premisa teorike të kritikës simbas autorëve, duke menduar se çështjet e tilla zhvillohen mbi një bazë të përbashkët të realizmit socialist.

Ky lloj i kërkimit të Rugovës çon te përfundimi se metoda e cila aplikohet në këtë kohë ishte metoda e realizmit socialist, e cila lidhet me ideologjinë shoqërore që zbatohet në kulturë e sidomos në letërsi. Duke synuar t'i interpretojë të gjitha fenomenet dhe interesimet e kësaj kritike, Rugova analizon të gjitha aspektet teorike, të cilat mendon se kërkoheshin në analizën letrare. Funkcioni social është parimi i parë në bazë, të cilit letërsia merret si mjet edukimi i masave. Rugova vëren një identifikim të plotë midis subjektit të kritikës, subjektit të letërsisë dhe subjektit social.

Në këtë ideologji të medimit dhe metodë, si kthesë të rëndësishme Rugova e konsideron procesin e novatorizmit që fillon të zhvillohet. Kjo teori del fillimisht nga veprimtaria letrare e disa poetëve dhe Rugova e shikon si rrugë, formë për kërkimin e elementeve të reja, duke u bërë një vlerësim dhe rivlerësim i traditës, por në kuadër të metodës dhe të realizmit socialist. Prandaj, në përgjithësi procesin e novatorizmit e konsideron si zgjerim të koncepteve dhe të teorisë ekzistuese. Poetët më të shquar të kësaj rryme i konsidron Ismail Kadarenë, Dritëro Agollin, Fatos Arapin, ndërsa si kritikun më të dalluar Drago Siliqin.

Premisa teorike të Kritikës shqiptare në Kosovë Rugova do t'i kërkojë në bazë të tri orientimeve të autorëve përfaqësues të epokës. Orientim të parë të kritikëve bashkëkohorë në Kosovë e konsideron kërkesën për rolin shoqëror të letërsisë. Në këtë tip të kritikës Rugova shquante problemin e "modernes" dhe "modernizmit". Bazat teorike të këtyre kërkesave i sheh të ngritura më shumë në botëkuptimin tradicional dhe social për letërsinë. Problem të parë të kësaj teorie sheh raportin midis tradicionales dhe modernes. Ndërsa, në aspektin e vlerësimit kjo kritikë kryente rol stimulatív, sepse çdo vepër e çmonte dhe e përkrahte si kontribut për letërsisë.

Këtë kritikë, e cila u shkrua pas Luftës së Dytë Botërore, deri nga mesi i viteve '60, me këtë orientim dhe premisë të lartpërmendur Rugova e ilustron me Vehap Shitën dhe Hasan Mekulin. Vështimi i studiuesit tonë për Shitën ka rëndësi për të hetuar premisat e para të kësaj kritike. Pikëpamjet e tilla i veçon më shumë nga praktika kritike, se sa që i gjen të theksuara në formë të shqyrtimit teorik. Sipas Rugovës, Hasan Mekuli nisat nga premisa sociologjike, që i modifikonte nga teoria sociale e realizmit dhe angazhimit ideologjik të letërsisë. Do të thotë, vëren një modifikim dhe modernizim të teorisë sociale të letërsisë, duke mos pranuar premisën kryesore të realizmit socialist se letërsia është pasqyrim objektiv dhe besnik i realitetit.

Orientimi i dytë i hetuar nga Rugova, në të cilin bëhet fjalë për fundin e viteve '60 dhe fillimin e viteve '70, është kritika e angazhimit letrar. Rëndësia e kësaj qëndron në faktin se pas angazhimit social që ishte primar më parë, tash kërkohet një angazhim më i përgjithshëm, si angazhim artistik e human i shkrimtarit dhe i veprës së tij. Do të thotë, për Rugovën, ky aspekt kritik i angazhimit del si kategori vlerësuese. Ky problem në aspektin teorik po ashtu nxjerr në shesh edhe mbështetjen në teorinë e Sartrit, në studimin e tij *Letërsia e angazhuar*.

Premisë tjetër interesante për këtë kritikë në vështrimet e Rugovës del edhe hetimi i problemit të çlirimit nga shtrëngesat e ndryshme jashtëletrare, që ishte inicuar, por ende nuk kishte marrë formë. Rugova e vlerëson vetëdijen për letërsinë, për funksion e saj si art, por ende në kontekst të angazhimit. Autorë ilustrativë të kësaj kritike janë Ali Aliu, Ali Jasiqi, Hysni Hoxha dhe Rexhep Qosja.

Në pikëvështrimin e Rugovës Aliu nisat nga premisa teorike e angazhimit, e cila lidhet me kërkesën e kohës për zhvillimin e letërsisë. Konkretisht Aliu, sipas tij, kërkon “një angazhim total njerëzor”, kategori e cila merr shpesh edhe vlerë aksiologjike në shqyrtimin e veprave konkrete. Te ky kritik Rugova e thekson edhe mënyrën e qasjes ndaj veprës letare, duke e parë të nisur nga premisa e intuicionit, duke ia krijuar kështu autorit një refleksion të vetin për letërsinë.

Çështja e angazhimit si qendër e kritikës do të dalë edhe në vështrimin për Jasiqin, ndërsa baza teorike e Hoxhës del nga premisa të teorisë sociale për artin.

Rexhep Qosja, si kritikët e brezit të tij, premisë kryesore për vështrimin e letërsisë do të ketë çështjen e angazhimit si interesim kritik. Tekstet e tij për E. Mekulin, Mjeden, Asdrenin, Rugova i shikon esencialisht të prekopuara me këtë problemin e angazhimit, që edhe vetë kritiku i thekson me termat “akt i angazhimit”, “angazhim moral e artistik”, “angazhim patriotik, social dhe politik”, ndërsa kur shkruan për shkrimtarë bashkëkohës kërkon “angazhimin modern”. Më tej në vlerësime Rugova e thekson edhe premisën tjetër teorike të këtij autori, e që është premisa sociologjike dhe etike e letërsisë. Në këtë aspekt dallon insistimin për ta vënë letërsinë në raport me çështjet morale. Por, Rugova mendonte se Qosja, duke u nisur nga koncepti i intergralitetit dhe i totalitetit, merret edhe me problemet e aspektit artistik, të stilit të poetikës së ndonjë autori.

Duke e analizuar kritikën e tij, madje duke e hetuar çdo interesim të tij, në plane të ndryshme, Rugova shenjon edhe përpjekjen e tij për inkuadrimin e argumentit. Edhe pse në shumicën e rasteve e vëren të aplikuar argumentin, mendon se e sjell në kaudër të diversitetit nga aspekte të ndryshme teorike, që nuk përkojnë me problemin që e shqyrton. Përfundimisht, mendon se Qosja në vlerësimet e ndryshme nuk mund të çlirohet plotësisht nga vlerësimi dualist.

Duke e mbyllur tekstin për këtë pjesë të kritikës së angazhimit letrar, që e konsideronte orientim të kritikës në Kosovë, Rugova kritikët përfaqësues të saj, di t'i vlerësojë për inkuadrimin e pikëpamjeve të çliuara për letërsinë.

Orientimi i tretë i kritikës bashkëkohore në Kosovë, sipas Rugovës, është *diferencimi i tipave të kritikës*. Në këtë pjesë të tekstit Rugova dëshmon tendencat dhe kërkesat e reja për zhvillimin e kritikës. Në këtë plan nënvizon se kritika forcohet, pasurohet me teori dhe merr një orientim metodologjik. Këtu gjen hapat e parë të kritikës për kritikën, apo të torisë së kritikës.

Rugovës si kërkues i kritikës së hapur, i kritikës moderne, pëlqimi i realizohet në këtë tip kritike. Pikëpamja që letërisa është polivalente, polifonike, shumështrësore, gjykon se i mundëson kritikës t'i shtrohet një plurariteti analizash dhe interpretimesh.

Prandaj, në këtë kritikë, Rugova evidencon rezultate dhe disiplina të ndryshme, duke filluar nga strukturalizmi, (nga semiologjia, teoria moderne letrare, nga estetika, si dhe vëren edhe disa disiplina nga antropologjia, marksizmi bashkëkohor, mitologjia e psikanaliza.

Pra, mund të theksohet se Rugova flet për metoda që aplikohen në studimet letrare. Autorët kryesorë që shquan në këtë kritikë, tërësisht të pastruar nga ideologjia, por të bazuar në individualite, për Rugovën janë: Mensur Raifi, Rexhep Ismajli dhe Sabri Hamiti.

Rugova synon ta argumentojë kritikën e Raifit si kritikë moderne, kështu që fillimisht flet për nisjen e tij nga premiset artistike të veprës dhe kërkesa që t'i afirmojë ato. Tash e dimë se Rugova, veprat ose ngjarjet e rëndësishme i quan *momente*, kështu moment me rëndësi në veprimtarinë e Raifit e konsideron veprën *Fan S. Noli dhe Migjeni*. Si e veçantë këtu theksohet nisja për të analizuar veprat nga premisa të psikanalizës dhe analizës moderne të mitit. Problemin e analizës mitologjike Rugova e konsideron si problem të jashtëm, si mekanizëm të jashtëm, kështu që më pas e heton mekanizmin e brendshëm të analizës së Raifit, që është psikanaliza, e për të cilin mendon se është instrumenti më i përshtatshëm i demistifikimit. Po kështu, në këtë nivel të vështrimit, analizën e brendshme të Raifit për Nolin Rugova e shquan për qartësimin që i bën këtij autori. Dhe, njësoj si Raifi, mendon se Noli me veprat *Historia e Skënderbeut e Bethoveni dhe revolucioni francez* paralajmëron shkencën e re shqiptare. Kështu, për Rugovën, Raifi solli një lloj vetëdije në kritikën dhe kulturën shqipe me metodën dhe premiset teorike të tij.

Rexhep Ismajli është një autor tjetër shumë i rëndësishëm që mbush pikëpamjet teorike të Rugovës për kritikën moderne bashkëkohore. Rugova e njihte Ismajlin me formim linguisti, por thekson edhe interesimin e tij në çështjet letrare, në kuadër të gjuhësisë bashkëkohore. Orientimet e tij i vëren të përqendruara në gjuhësi, strukturalizëm dhe semiologji. Rëndësi të posaçme të punës së këtij studiuesi Rugova e konsideron përkthimin që ia bën veprës së F. Sosyrit dhe prezantimin e rezultateve të tij në këtë fushë. Për drejtimet moderne në të cilat u orientua Sosyri Rugova mendon se i kontribuoi problemit të terminologjisë. Më tej, inkuadrimi i rezultateve të gjuhësisë strukturale, asaj gjenerative, transformacionale, pastaj problemet e semiologjisë dhe të tekstit gjuhësor artistik, shqyrtuar e trajtuar nga Ismajli, e bëjnë Rugovën që të shkruante për Ismajlin si për njërin ndër autorët kryesorë që studimi i letërsisë të modernizohet dhe të japë rezultate të reja.

Rugova, përderisa i analizon teoritë letrare moderne, me të cilat merrej Ismajli, kalon edhe te disa aspekte të poezisë që trajton ai. Në këtë rast interpretimin dhe komentimin e Ismajlit e sheh të nisur nga premiset e teorisë së tekstit, me insistimin që vepra letrare të merret si korpus i tekstit, si njësi dhe si tërësi, ndërsa, metodë të tij analizën e tekstit apo analizën tekstore.

Kritika letrare e Sabri Hamitit sipas Rugovës shënon kritikën më aktive të kohës. Fillimisht e njuh si shkrimtarin e parë që paralelisht merret me krijimtari dhe kritikë. Atë që e veçon Rugova te Hamiti është përpjekja për definimin e poetikës së vet në

*Sprova për një Poetikë*, që përbëhet nga përmbledhjet e kritikave dhe vështrimeve të veçanta. Këtu e vëren pikëpamjen e tij se leximi jep mundësi të ndryshme, e të cilën mendon se ai do ta ngrisë në nivel të poetikës, të teorisë së leximit. Do të thotë, mundësitë e ndryshme të leximit dhe të interpretimit, Hamiti i lidh me teorinë moderne të letërsisë dhe, mbi këtë pikëpamje, thekson premisën teorike të tij, që “kritika në një mënyrë është bijë e veprës së letërsisë”.<sup>82</sup> Është fjala pra për variante të leximeve, për variaretet e kritikës.

Pikëpamje tjetër e Hamiti, të cilën Rugova do ta vlerësojë si premisë të kritikës moderne, është “qëllimi i leximit subjektiv”, që origjinarisht e gjen në premisat frënge e sidomos nga Barti, i cili e lansoi çështjen e kritikës si lexim subjektiv. Pikëpamje e Sabri Hamitit për leximin e kritikës, të cilën ai e përkufizon “art të leximit”, Rugova e sheh të lidhur me teorinë gjermane të “artit të interpretimit”.

Në vazhden e analizës së veprës kritike të Hamitit, Rugova konstaton se ai kritikën e konsideron si akt krijues, por të pasuruar me argumentin teorik kur e do nevoja, në bazë të informacionit të sotëm.

Është e rëndësishme të përmendet se për këtë periudhë kritike Rugova ka parasyh që ajo ishte në fazë të interesimit dhe të zhvillimit. Pra, ai gjërat i shikonte në proces e sipër, në proces të interaksionit veprues. Do të thotë, Rugova kupton dhe e vëren se në këtë epokë vazhdimisht shtrohen probleme të pasurimit të saj në planin teorik, praktik dhe orientues. Por, prapë se prapë, në vështrimin e tij, kjo kritikë, bashkë me letërsinë, e ka forcuar stabilitetin dhe perspektivën e zhvillimit të vet normal.

Në përfundim të këtij studimi për kritikën shqiptare, shikojmë se Rugova ka bërë një punë të jashtëzakonshme në aspektin e hetimit dhe të vlerësimit të kaheve dhe të premisave të saj. Rugova ka klasifikuar, ka karakterizuar dhe vlerësuar të gjitha interesimet, kahet dhe premisat kryesore kritike, probleme këto që gjer atëherë nuk janë vështruar në mënyrë të tërësishme dhe nuk janë verifikuar në fushën e informacionit historik. Dhe, në këtë aspekt Rugova ka dhënë rezultatet më të mira në interpretimet metakritike shqiptare deri më sot.

Kur e trajton këtë problem të madh kritik, Rugova udhëhiqet nga mendimi i Montenjit se “Më vështirë është t’i interpretosh interpretimet se t’i interpretosh gjërat”. Këtë mendim Rugova e ka vë edhe në krye të librit, duke e parë si problem intim dhe profesional. Duke e ndier vështirësinë e problemit, Rugova bëhet shumë sistematik në hetim. Do të thotë, ai ka shqyrtuar çdo gjë deri në imtësi, për të nxjerrë rezultate.

Monografia e Rugovës *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, me objekt vështrimi analizën dhe vlerësimin e kritikës shqiptare, përveç problemeve që lidhen me kritikën, e tajton edhe problemin e letërsisë shqiptare. Duke interpretuar interpretimet, duke hetuar shkollat dhe rezultatet, Rugova ndeshet me vetë letërsinë, duke e parë si objekt të kritikës. Do të thotë, brenda kritikës letrare

---

<sup>82</sup> Ibrahim Rugova, po aty, f. 295.

në studimin e Rugovës hetohet edhe zhvillimi i letërsisë shqiptare që në nisje të saj. Në çdo periudhë Rugova heton dhe komenton edhe poetikën e saj. Prandaj, ai e ndjek rrugën e rendit të epistemologjisë dhe të gnoseologjisë letrare shqiptare.

## Bibliografia

Rugova, pasi të ketë kaluar nëpër kritikën letrare shqiptare që nga viti 1504 deri më 1983, pasi të ketë studiuar dhe hulumtuar mirë rrugën e zhvillimit të saj, duke kërkuar kahet dhe premisat, një pjesë të rëndësishme të këtij kërkimi do t'ia kushtojë Bibliografisë së kritikës. Në radhë të parë dy tekstet e tij për teorinë e kritikës dhe bibliografinë e saj do t'i bashkojë interesimi dhe dëshira për të hetuar probleme jo të trajtuara më parë. Kështu, përballë këtij problemi diskursi i Rugovës është shumë i hapur, i qartë e shumë shpjegues. Se Rugova merret intensivisht e sistematikisht me këto dy probleme del qartë, sepse, kur diskuton për kritikën shpeshherë komenton si bibliograf, duke hetuar çdo detaj, ndërsa, kur diskuton për bibliografinë, merr përsëri rolin e kritikut, duke vlerësuar e komentuar tekste të ndryshme. Në këtë mënyrë, kjo metodë ose mënyrë e leximit të Rugovës i bën më complete dhe më me peshë të dy llojet e studimit.

Bibliografia e Rugovës është sistemuar në tri pjesë: *Bibliografia përshkruese e librit 1861-1944*; *Bibliografia komentuese e kritikës më shtypin shqiptar 1848-1944*; dhe *Lista e organeve të shtypit shqiptar 1848-1944*. Në pjesën e parë Rugova është më shumë informues dhe përshkrues. Në këtë pjesë shenjon qartë dhe sqaron interesimin që ka për të parë përmbajtjen e drejtpërdrejtë të këtyre veprave. Duke shpresuar së këto vepra në të ardhmen do të njihen më shumë në opinion, paraqet informativisht strukturën përmbajtjesore të tyre dhe mënyrën e konceptimit klasifikues të problemeve.

Pjesa e dytë e bibliografisë merr vlerë më të madhe pasi që Rugova, përveç që informon për tekstet kritike, edhe i vlerëson idetë e tyre. Do të thotë, Rugova edhe në këtë drejtim hulumton *kahet* dhe *premisat* e shtypit kritik shqiptar që nga "Fiamuri i Arbërit" (1883) e deri te "Revista letrare" (1944). Këtë qasje e bën edhe me të qartë kur radhitjen e njësive bibliografike nuk e jep sipas rendit bibliografik, por sipas autorëve në revista. Po ashtu, Rugova në këtë tërësi bibliografike, përveç komentimit të teksteve kritike, lë të hapur mundësinë që lexuesit t'i shohin idetë e kritikëve në mënyra të ndryshme duke nxjerrë fragmente të shumta.

Në pjesën e tretë Rugova shqyrton listën e organeve të shtypit nga viti 1848 deri në vitin 1944. Këtë listë autori njofton se e mori nga gjuhëtari dhe bibliografi Palok Doda te *Kontribut për bibliografinë e gjuhësisë shqipe në Studimet filologjike 2/1964 - 1/1968*. Në këtë bibliografi Rugova përmbledh 2.890 njësi, përfshirë të gjithë ata që shkruan brenda kësaj periudhe kohore.

Në fund të kësaj paraqitjeje, mund të theksohet se rëndësia e pikëpamjes dhe e qëllimit të Rugovës është e veçantë dhe synon plotësimin e informacionit shkencor

për traditën e kritikës letrare shqiptare, të cilën edhe e dëshiron autori. Me një fjalë, me këtë bibliografi, Rugova shtron kërkesën për një bibliografi të plotë të kritikës në shtypin e traditës.



## PËRFUNDIM

Metoda e studimit të veprës studimore të Ibrahim Rugovës në punimin tonë ka patur parësor shenjimin dhe theksimin e pikëpamjeve kyçe të saj. Po ashtu, ne kemi synuar që përmjes studimit të kësaj vepre të hetohen edhe disa orientime të reja në studimet letrare shqiptare, probleme estetike, filozofike dhe semiotike. Në këtë plan, Rugova, me rezultatet e tij, është një shembull përfaqësues i studimeve letrare shqiptare moderne.

E kemi theksuar gjatë tërë punimit se, duke e lexuar veprën e Rugovës, hasim probleme kritike e teorike, letrare, semiotike, filozofike, estetike, strukturaliste, poststrukturaliste etj. Të gjitha këto probleme që nga fillimi e deri në fund kanë një objekt të veçantë interesimi: elementin artistik dhe estetik të veprës letrare. Kjo metodë aplikohet që nga tekstet estetike, ato recensioniste, monografitë e deri te teoria e poezisë. Të gjitha tekstet analizohen përmes koncepteve të semiologjisë, duke kaluar nëpër shenjat dhe idetë e letërsisë shqipe. Në këtë mënyrë, fusha e studimeve të Rugovës del mjaft e zgjeruar, duke dëshmuar vazhdimisht interesimin për teorinë letrare moderne.

Rëndësia themelore e Rugovës si kritik letrar dhe studiues i letërsisë qëndron në mbështetjen e metodës strukturaliste dhe të semiologjisë, duke bërë që kërkimi i tij letrar të formojë një sistem të *shenjave studimore*. Kështu, kjo metodë e tij ka bërë që ta dallojë dhe të ndërtojë personalitetin e Rugovës intelektual, të dallojë konceptet dhe problemet me të cilat merret ai. Me një fjalë, Rugova, edhe pse kërkon dhe provon probleme të ndryshme teorike, në të gjitha aspektet bëhet i veçantë me mënyrën e veçantë të konceptimit të artit dhe të letërsisë.

Ky kënd i shikimit vërehet që në veprat e hershme të tij, kur ai e propozonte tekstin e hapur dhe artin e hapur, letërsinë si *differentia specifica*. Kështu, mendimi teorik i tij del prej letërsisë moderne duke folur për *apertativitetin* e artit, në të cilën vepra është e bazuar në *posiblen*, në të mundshmen. Dominon pra mendimi për veprën letrare si *qenie e objektivuar e polisemantike*, e cila kërkon interpretim të hapur, pra Rugova kërkon kuptimin atributiv të veprës letrare, duke e konsideruar edhe si objekt të kritikës bashkëkohëse, pyetja e të cilës është “Ç’mund të thotë vepra?” dhe jo “Çka thotë vepra?”.

Sa i përket mënyrës së vështrimit të veprës nga ana e Rugovës, duhet të theksohet se për këtë autor e rëndësishme është që në interpretimin e veprës letrare të nisemi nga një teori e caktuar, ndërsa interpretimi i artit më së miri del nga

teoritë estetike, e konkretisht nga estetika e objektivizmit ontologjik, nga buron edhe efekti estetik.

Interesim parësor i Rugovës në çështjet teorike të letërsisë është letërsia si *differentia specifica*, e cila e ka objekt letërsinë si aktivitet të veçantë funksional (artistik), me efekte estetike dhe strukturë autonome dhe, në këtë plan, metoda estetike-teorike si pjesë përbërëse dhe element kryesor i veprës artistike, në të cilën Rugova pozicionohet, rrjedh nga estetika objektive ontologjike, pasardhëse e mendimit filozofik të Aristotelit.

Ibrahim Rugova qysh në veprat e para arriti ta krijojë këtë mënyrë vështrimi, duke u lidhur pazgjidhshëm me të dhe duke e pasuruar në vijimësi. Duke ecur në këtë parim, Rugova mbërrin edhe te një çështje tjetër thelbësore, te *funkzioni metafizik* i veprës dhe për studimin e veprës kërkon qasje epistemologjike. Në këtë vështrim, vërejmë qartësisht se teoria e Rugovës mbështetet në filozofinë ontologjike, duke u nisur nga pikëpamja se në vepër objektivohet personaliteti, kurse në personalitet objektivohet vepra.

Në fakt, ky përkufizim i autorit ka në shenjestër ekzistimin e veprave artistike si rezultat të kohëve të ndryshme. Mendimin e tillë e konkretizon me shpjegimin e vlerës së procesit të objektivizmit artistik, duke vlerësuar se qenia njerëzore i krijon këto qenie artistike, shuhet apo nuk ekziston më (subjekti), por këto ekzistojnë në kohë të ndryshme, të cilat flasin në kuptimin kozmik. Këtu ndeshim mendimin estetik të Rugovës, për të cilin qenia artistike ekziston si *fizis*, si vepër, i cili objekt me vete përmban botën prej idesh, emocioneve të cilat hyjnë në *meta-fizisin* e saj. Shkurtime, te ky autor termi *metafizikja* konceptohet si kualitet estetiko-metafizik. Nga ky koncept filozofik e që është karakteristikë e veprave moderne, Rugova analizon veprat letrare, duke e kërkuar poetikën e tyre. Kjo do të thotë se studiuesi Ibrahim Rugova e kalon dihotominë formë - përmbajtje, duke pasur kërkesë kënaqësinë njohëse dhe artistike, vetë artin.

Kur kemi parasysh teorinë e Rugovës për veprën artistike si qenie shpirtërore e produkt intelektual, është e rëndësishme të theksohet se kusht për këtë prodhim bëhet strategjia e kuptimit dhe refuzimi estetik. Çfarë do të thotë kjo? Vepra artistike, sipas Rugovës, krijohet nga kuptimi (në aspektin fenomenologjik), i cili del si qëllim i fundit i veprës artistike. Pra nga kjo del se idetë duhet të interpretohen përmes kuptimit, që është objekt i semantikës. Këtë shkencë Rugova e shikon të lidhur ngushtë me semiologjinë, e cila procesin e kuptimit e shpjegon përmes shenjëzimit, si proces të prodhimit. Në këtë plan, përfundimisht kuptimin e konsideron si rezultat të relacionit të objekteve, fjalëve dhe shenjëzimeve të veprës letrare artistike, e cila ka objekt semantikën e kritikës.

Kërkesa sistematike e Rugovës për krijimin artistik të veprës argumentohet edhe më qartë me konceptin tjetër të tij, *refuzimin estetik*. Në kuptimin rugovian, *refuzimi estetik* e kërkon letërsinë si vlerë dhe funksionin e saj si qenësi, jo si letërsi në funksion.

Refuzimi estetik del si një nga nocionet kryesore të teorisë estetike të Rugovës, i cili edhe e ilustron më së miri kërkesën e tij për liri në letërsi, e cila e nënkupton, jo imponimin, por ofrimin e përfaqësueses dhe ekzistueses, procese këto që ofrojnë lindjen e zgjidhjes së lirë, përcaktimin e individit në formë të lirë midis të asaj që imponohet dhe të refuzimit, që, sipas Rugovës, arrihet përmes formës së *plebishitit* individual, *referendumit* individual dhe kolektiv.

Refuzimi estetik e shenjon në njëfarë mënyre më qartë pikën qendrore të diskutimeve të Rugovës, duke dalë si udhërrëfyes i kërkimit. Është pra elementi estetik në art dhe në letërsi, i cili edhe e orienton hulumtimin tonë teorik (dhe zgjon interesimet tona), duke bërë që të fokusohemi më shumë te ky aspekt, duke e parë se si është teorizuar, dhe si është kërkuar te veprat e poetëve dhe kritikëve konkretë, pasi që mbi këtë princip Rugova i analizon shenjat e tyre. Rezultatet që mbeten me vlerë te Rugova gjenden në tekstet bashkëkohore, pasi që në to ndihet i lirë të nxjerrë kuptime të ndryshme. I quan tekste të *shkrueshme*, sikurse Barti, sepse aktivizojnë lexusin gjatë leximit dhe mundësojnë lexime të hapura.

Rugova mendon se natyra e kritikës letrare është e hapur dhe, për më tepër, si eseist që është, do lirinë e tekstit. Prandaj, ai edhe kur bën kritikë recensioniste, për dallim nga kritika eseistike, prapë bën një kritikë më të hapur, dialoguese, kritikë e cila dallon nga kritikata e rëndomta recensioniste. Kështu, mund të themi se tek autori yni kemi kritikë estetike e kritikë semantike. Rugova, në tërë veprën studimore, pasi lexon, interpreton dhe e vlerëson, mbështetur në teoritë letrare moderne, prapë e lë çështjen e hapur, për të vërejtur jo vetëm ç’thotë vepra, por edhe ç’thotë dhe si e thotë kritiku, duke bërë kështu kritikë dialogjike.

Duke theksuar veçantitë që e përbëjnë profilin e Rugovën dijetar, është e rëndësishme të nënvizohet që ajo që e definojnë punën e këtij autori drejt këtij boshti të kërkimit është monografia për autorin më të shquar të letërsisë së vjetër shqipe, Pjetër Bogdanit. Rugova e lexon tekstin e Bogdanit si sistem shenjash, duke nxjerrë kuptime, duke operuar kështu mjete semiologjike. Rugova arrin ta lexojë veprën e Bogdanit si një vepër të kohës së studiuesit, duke e parë si *Univers modern*. Në këtë pikë dëshmohej më së fortë veçantia dhe rëndësia e Rugovës semiolog dhe estet. Gjithashtu, Rugova si njëri ndër dijetarët themelorë të modernitetit shqiptar, nëpërmjet shenjave të leximit, e gjen modernitetin te vepra e Bogdanit dhe jo vetëm në problemet fundamentale filozofike dhe shkencore, por dhe te problemet teoriko-letrare, të krijimit artistik, stilit etj.

Kritika letrare e Ibrahim Rugovës, para së gjithash, për nga mënyra e vështrimit, na shtyn që mendimin teorik dhe kritik ta shohim në një rend, ta lexojmë sistematikisht.

Lexojmë kështu, pasi që, para së gjithash, kërkimi i autorit, botëkuptimi dhe botëvështrimi i tij ndjekin parimin që të refuzojnë estetikisht hyrjen e letërsisë në funksion, duke i lënë shteg asaj të jetojë si qenësi. Një cilësi e tillë, sipas Rugovës, arrihet kur letërsia lexohet si një model i botës dhe i shoqërisë. Përfundimisht, këtu do theksuar se, për Rugovën, letërsia është model i botës, i jetës, i vet ekzistimit.

## BIBLIOGRAFI

I  
POEZI, PROZË, INTERVISTA, SHKRIME, ESE  
DHE STUDIME TË BOTUARA  
NË GAZETA DHE REVISTA

1. Rugova, Ibrahim: Erdhi vjeshta (poezi). "Rilindja" ("Rilindja për fëmij"), Prishtinë, 1961, 3 tetor, f. 9.
2. R(ugova), I(brahim): Në katundin Cërce filloi me punue kuzhina e nxanësve, "Rilindja" ("Rilindja për fëmij"), Prishtinë, 1961, 14 nandor, f. 11.
3. Rugova, Ibrahim: I ikuni (prozë). "Rilindja" ("Rilindja për fëmij"), Prishtinë, 1962, 20 nandor, f. 10.
4. Rugova, Ibrahim: Andrej Voznesenski: Pse e dua Lorkën. (Rubrika: Zenite letrare). "Fjala", Prishtinë, 1969, shkurt, nr. 2, f. 7.
5. Rugova, Ibrahim: Të lindet njeriu (Me rastin e 60-vjetorit të lindjes së shkrimtarit tonë të shquar Millosh Gjergj Nikolla - Migjeni). "Nëndori", Tiranë, 1971, nr. 10, f. 93-99.
6. Rugova, Ibrahim: Pol Valeri dhe veprat e tij. I papajtueshëm me bashkëkohësit e vet; Prirja kah gjakftohtësia. "Rilindja", Prishtinë, 1972, 5 shkurt, f. 12.
7. Rugova, Ibrahim: Elemente estetike e poetike të qenjes letrare. 2. Struktura e qenjes letrare; 4. Përfundime [Ky fragment u nxor nga kumtesa "Pikëpamje estetike e poetike të letërsisë shqipe të Kosovës", që u lexua më 8 maj në Sesionin shkencor kushtuar periodizimit të letërsisë shqipe]. "Rilindja", Prishtinë, 1973, 26 maj, f. 13.
8. Rugova, Ibrahim: Letërsia si diferentia specifica. 1. Koncepti i problemit; 2. Transformimi i nevojave shpirtërore; 3. Tri fytyra të mitit; 4. Procesi i filluar; Shënim plotësues. (Skicë për hulumtim). "Fjala", Prishtinë, 1973, nëntor, nr. 11, f. 7, 9.
9. Rugova, Ibrahim: Një korrektiv estetikoteorik. 1. Mbi metodën; 2. Estetika ideologjike; 3. Estetika marksiste, apo jo; 4. Estetika ontologjike; 5. Estetika e shkatërrimit ; 6. Mbi rezultatet, "Fjala", Prishtinë, 1973, dhjetor, nr. 12, f. 11.
10. Rugova, Ibrahim: Moment i rëndësishëm në prozën shqipe (Rexhep Qosja: "Vdekja më vjen prej syve të tillë"). 1. Si hyrje (f. 208); 2. Çështje të zhanrit (f. 208, 209); 3. Çështje etike-filozofike (f. 209-212); 4. Çështje poetike e estetike f. 212-214); 5. Si përfundim (f. 214-215). "Jeta e re", Prishtinë, 1974, nr. 2, f. 208-215.
11. Rugova, Ibrahim: Interpretime metodologjike e teorike të kritikës letrare (f. 1096). 1. Aksepte hyrëse (f. 1096); 2. Mbi konceptin dhe mbi metodat e kritikës (f.

- 1096-1101); 3. Çështja e trajtuar në kritikën tonë (f. 1101-1103); 4. Akseptime përfundimtare (f. 1103). "Jeta e re", Prishtinë, 1974, nr. 6, f. 1096-1103.
12. Rugova, Ibrahim: Fetishizimi i metodave në studimin e letërsisë. 1. Sinjalizim; 2. Letërsia dhe studimi i saj; 3. Krijimtaria dhe kritika e jonë; 4. Logjika ahistorike; 5. Po përfundojmë. "Rilindja", Prishtinë, 1975, 10 maj, f. 13.
13. Rugova, Ibrahim: Kualitetet estetike të poezisë së Nolit (f. 508). 1. Teza. Argumentimi teorik (f. 508-509); 2. Literatura (f. 509-511); 3. Fakti real-historik (f. 511-512); 4. Konkretizimi (f. 512-513); 5. Sekuencat (f. 513-514); 6. Struktura poetike (f. 514-516); 7. Kualitetet estetike (f. 516-519); 8. Përfundimi (f. 519). "Jeta e re", Prishtinë, 1975, nr. 3, f. 508-519.
14. Rugova, Ibrahim: Teza rreth elementeve estetikopoetike (f. 163). Njoftime hyrëse (f. 163-164); I. Faktorët jashtë letrarë (f. 164); II. Strukturat e qenjes letrare (f. 164-165); II.1. Elementet estetikopoetike në poezi (f. 165-167); II.2. Elementet estetikopoetike në prozë (f. 167-168); II.3. Elementet estetikopoetike në dramë (f. 168); III. Strukturat e mendimit mbi letërsinë (f. 169-170); Njoftime përfunduese (f. 170-171); Résumé : Des theses concernant les elements esthetiques-poetiques (f.171)."Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave filologjike", Prishtinë, 1975, nr. III-1973, f. 163-171.
15. Rugova, Ibrahim: Ndërmarrje serioze dhe e vlefshme. Bisedë me Ibrahim Rugovën, që, bashkë me Isak Shemën, e ka përgatitur "Bibliografinë e kritikës letrare shqiptare 1944- 1974). Intervistoi J. Buxhovi. "Rilindja", Prishtinë, 1975, 22 nëntor, f. 12.
16. Rugova, Ibrahim: Poezia e Rilindjes dhe poezia bashkëkohëse (f. 127). 1. Përkufizime (f. 127-128); 2. Poezia e Rilindjes (f. 128-130); 3. Vazhdimësi tematike dhe ndryshime poetike (f. 130-136); 4. Përfundime (f. 136-137); Résumé : La poesie de la Renaissance et la poesie contemporaine (f. 137- 138). "Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave filologjike", Prishtinë, 1976, nr. V-1975, f. 127-138.
17. Rugova, Ibrahim: Pak dije, pak urti dhe sa më shumë shije. Semiologjia artistike e filozofit dhe kritikut të njohur bashkëkohës francez Roland Bartit. 1. Tjetërsimi (alienacioni) i gjuhës; 2. Letërsia dhe shija e dijes; 3. "Joker-i" i dijes. Nga një punim më i gjatë. "Rilindja", Prishtinë, 1977, 3 dhjetor, f. 13.
18. Rugova, Ibrahim: Kritika integrale është një monizëm heterogjen (Bisedë me kritikun letrar Ibrahim Rugova, me rastin e botimit të vëllimit me tekste teoriko-kritike "Kah teoria"). "Rilindja", Prishtinë, 1978, 9 shtator, f. 12;
19. Rugova, Ibrahim: Libër mbi prosedeun krijues të Kadaresë (Bisedën e zhvilloi: Shaip Beqiri). "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1978, 1 janar, nr. 1, f. 18.
20. Rugova, Ibrahim: Semantika e figurës dhe e ngjyrës. 1. Apelacion për një piktor; 2. Në atelie dhe jashtë saj; 3. Saktësia figurative dhe moderniteti kuptimor. (Me rastin e ekspozitës së Daut Berishës në Myro - Paris). "Rilindja", Prishtinë, 1977, 10 dhjetor, f. 15.

21. Rugova, Ibrahim: Shenjat e të folurit poetik. Thënia poetike; 2. Raportet e shenjzimit; 3. Përfundimi. (Poezia e Ali Podrimjes). "Rilindja", Prishtinë, 1978, 20 maj, f. 13.
22. Rugova, Ibrahim: Teksti simbolik. 1. Çështje paraprake; 2. Teksti simbolik (Ky tekst kritik u shkrua si pasthënie për librin e poezive të Rahman Dedajt "Poezi" që këto ditë doli nga shtypi në botim të Rilindjes). "Bota e re", Prishtinë, 1978, 15 qershor, nr. 11-12, f. 23.
23. Rugova, Ibrahim: Konceptet e Konitzës mbi kritikën. "Rilindja", Prishtinë, 1978, 12 gusht, f. 13;
24. Rugova, Ibrahim: Mikrobotë që ekziston dhe flet (Fragment nga pasthënia e librit të ribotuar "Torzo" të Ali Podrimjes). 2. Standardizimi poetik; 3. Torzoja dhe torzioni. "Rilindja", Prishtinë, 1979, 4 mars, f. 11.
25. Rugova, Ibrahim: Kuptimi poetik i torzos. Në librin: Ali Podrimja "Torzo", botim i dytë, "Rilindja", Prishtinë, 1979, f. 73-79.
26. Rugova, Ibrahim: Realist i kulluar i realizmit të madh: Filozofia jetësore e Lumit të vdekur. "Fjala", Prishtinë, 1979, 15 mars, nr. 6, f. 7.
27. Rugova, Ibrahim: Fakt i vetëdijes dhe i pjekurisë sonë intelektuale [Me rastin e botimit të veprave të zgjedhura: Naim Frashëri - Vepra - 5 vëllime; Sami Frashëri - Vepra - 4 vëllime; Lasgush Poradeci "Vdekja e Nositit", botoi "Rilindja", Prishtinë, 1978]. 1. Rëndësia e ndërmarrjes; 2. Mbi zgjedhjen dhe përgatitjen. "Rilindja", Prishtinë, 1979, 24 mars, f. 14.
28. Rugova, Ibrahim: Nga teoria e tipologjisë. 1. Projektimi; 2. Semantika e terminologjisë; 3. Koncepti i tipologjisë "Fjala", Prishtinë, 1979, 1 nëntor, nr. 19, f. 8-9.
29. Rugova, Ibrahim: Nevojë imanente e poezisë shqipe (Lasgush Poradeci). 1. Një çështje teoriko-historike; 2. Në nivelin simbolist; 3. Përfundim. "Fjala", Prishtinë, 1979, 15 dhjetor, nr. 22, f. 6.
30. Rugova, Ibrahim: Ideja e tjetërsimit [Abdullah Konushevci: "Pasqyrë dhe diell", botoi "Rilindja", Prishtinë, 1979]. Nëntitujt: 1. Momenti poetik; 2. Në fushën e dy simboleve. "Rilindja", Prishtinë, 1980, 8 mars, f. 15.
31. Rugova, Ibrahim: Eidoritmia poetike (Eqrem Basha "Polip-ptikon"). 1. Eidos e rythmos; 2. Polipët-Deti-Bota; 3. Parodizimi si riafirmim; 4. Elemente të tjera; 5. Mesazhi i paimponuar. "Fjala", Prishtinë, 1980, 1 prill, f. 9.
32. Rugova, Ibrahim: Arti i dhembjes universale i Kadaresë. 1. Sugjerime; 2. Zgjidhje artistike; 3. Universi kadarejan (f. 9); 4. Përfundime (f. 10). "Fjala", Prishtinë, 1980, 1-15 korrik, nr. 13, f. 9-10.
33. Rugova, Ibrahim: Strategjia e kuptimit. Nëntitujt: 1. Strategjia; 2. Kuptimi. "Fjala", Prishtinë, 1980, 1-15 gusht, nr. 14, f. 9.
34. Rugova, Ibrahim: Një kryevepër e letërsisë shqiptare ose Çeta e Profetëve - Pjetër Bogdanit. I. Hyrje; 2. Pak biografi; 3. Informacione hitoriografike (f. 1); 4. Tradita hasjane; 5. Përshkrimi dhe përmbajtja; II. Interpretimi; 1. Pikëpamjet filozofike; 2. Pikëpamjet shkencore; 3. Çështje të retorikës (f. 7); 4. Idetë estetike; 5. Poezia - sibilat; 6. Veçori etnopsikologjike; 7. Stili - gjuha; 8. Terminologjia,

metodologjia; 9. Përfundime: racionalisti, humanisti (f. 8). "Fjala", Prishtinë, 1981, 1 shkurt, nr. 3, f. 1, 7-8.

35. Rugova, Ibrahim: Pikëpamjet estetikoletrare të E. Mekulit. 1. Estetika e shkrimtarëve (f. 742-743); 2. Ç'është letërsia (f. 743-747); 3. Gjuha e letërsisë (f. 747-748); 4. Subjektivja, Objektivja (f. 748-749); 5. Vetëdija historike (f. 749); 6. Pasurimi i pikëpamjeve (f. 750-751); 7. Përfundime (f.

751). "Jeta e re", Prishtinë, 1981, nr. 5, f. 742-751.

36. Rugova, Ibrahim: Praktika teoriko - letrare e Pjetër Bogdanit (f. 81-84). 1. Raporti estetik (f. 85, 86); 2. Poetikë (f. 86-88); 3. Retorikë (f. 88-93); 4. Semiotikë (f. 93-96); 5. Semantikë (f. 96-99); Shënimet (f. 99-100). "Dituria", Prishtinë, 1981, nr. 1- 2, f. 81-100.

37. Rugova, Ibrahim: Miti i jetës (Mbi syzheun, konfliktin dramatik e mbi disa aspekte letraro-artistike të dramës "Nita" të Josip V. Relës). 1. Ligjërimi - diaspora (f. 14); 2. Miti i jetës dhe i ekzistencës (f. 14-15); 3. Teksti dramatik (f. 15). "Rilindja", Prishtinë, 1981, 26 dhjetor, f. 14-15.

38. Rugova, Ibrahim: Poezia e gjuhës poetike (Mbi poezinë më të re shqipe të Kosovës I, II). 1. Përcaktime; 2. Gjuha poetike; 3. Konkretisht. "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1982, 2 janar, nr. 53-1, f. 24-25; 16 janar, nr. 2, f. 22-23.

39. Rugova, Ibrahim: Praktika poetike e Pjetër Bogdanit (I, II). 1. Kozmogonia; 2. Sibilat - akti i një jete; Semantika e prozodisë; 4. Figuracioni; 5. Përkthimi i poezisë; 6.

Duel në Gurit bukuria. Fragment nga libri Vepra e Bogdanit 1675- 1685 që këto ditë del nga shtypi. "Fjala", Prishtinë, 1982, 1-15 gusht, nr. 14, f. 6; 1 shtator, nr. 15, f. 7.

40. Rugova, Ibrahim: Paradoksi heretik. Për romanin "Herezia e Dervish Mallutës" të Teki Dërvishit. 1. Me autorin; 2. Etimologji; 3. Mjeti dhe qëllimi; 4. Askeza - spastrimi, dogma; 5. Invencion. "Rilindja", Prishtinë, 1982, 18 shtator, f. 14-15.

41. Rugova, Ibrahim: Reminishencat psikohistorike. Për romanin "Moti i madh" të Mehmet Krajës. 1. Çelësi i rrëfimit - leximit; 2. Fuqia reminisente; 3. Relativizimi kohor; 4. Relativizimi shpirtëror - intelektual; 5. Ironia; Tri romane, Pse? "Rilindja", Prishtinë, 1982, 2 tetor, f. 14-15.

42. Rugova, Ibrahim: Burimësia e një poezie. Poezia e Din Mehmetit). 1. Si realizohet ambienti; 2. Elemente konkrete; 3. Koncepti kohor; 4. Ironia lirike; 5. Indiferenca; 6. Thënia poetike (f. 7). "Fjala", Prishtinë, 1982, 1 tetor, nr. 17, f. 7.

43. Rugova, Ibrahim: Kuptimi i "rënies" (Abdullah Konushevcu "Rënia e mollës"). 1. Imazhi poetik i rënies; 2. Me gjërat ekzistuese. "Fjala", Prishtinë, 1983, 1-15 shkurt, nr. 3-4, f. 19.

44. Rugova, Ibrahim: Realizimi i vazhdimësisë (Për romanin *Kroi i ilaçit* të Ibrahim Kadriut). 1. Legjenda - miti - realja; 2. Miti i vazhdimësisë; 3. Logjika e jetës, logjika artistike; 4. Viktimë e statusit social; 5. Hapësirat romanësore. "Rilindja", Prishtinë, 1983, 9 prill, f. 14-15.

45. Rugova, Ibrahim: Sistemi poetik i Sabri Hamitit. Vështrim monografik. 1. Kritika për poetin; 2. Ideja e sistemit poetik; 3. Libri, cikli, subjekti poetik; 4. Njeriu vdes i ri;



5. Faqe e fund; 6. Thikë harrimi; 7. Trungu ilir; 8. Fenomenet poetike (klasematikë); a) - restrukturacione; b). - miti i nanës; c). - kujtimi; ç). - kuptimi; d). - sublimacioni antik; e). - dielli i zi i ligjërimit; f). - topoit e ligjërimit popullor; g). - formulacione poetike; 9. Vlera prozodike; 10. Përfundim: Midis klasicitetit dhe modernitetit. "Fjala", Prishtinë, 1983, 1 tetor, nr. 17, f. 1, 8-9; 15 tetor, nr. 18, f. 8-9.
46. Rugova, Ibrahim: Perceptimi nokturnian i botës. Nëntitujt: 1. Momente të veprimtarisë; 2. Teksti me errësirë. (Qerim Arifi, Nokturno, Rilindja, Prishtinë, 1983). "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1983, tetor, nr. 40, f. 23.
47. Rugova, Ibrahim: Shënim. (Musine Kokolari *Siç më thotë nënua plakë*). "Jeta e re", Prishtinë, 1983, nr. 2, f. 398-399.
48. Rugova, Ibrahim: Perceptimi i historisë në një korpus romanesh. 1. Tema e historisë; 2. Procedimi modern i historisë; 3. Rekapitulime. (Ky tekst u lexua në Tribunën e Institutit Albanologjik të Prishtinës më 8.5.1984). "Rilindja", Prishtinë, 1984, 12 maj, f. 14.
49. Rugova, Ibrahim: Sensibiliteti poetik i trupit. Ramadan Musliu, Shqisa e gjashtë, "Rilindja", Prishtinë, 1983. "Kosovarja", Prishtinë, 1984, maj, nr. 5, f. 25.
50. Rugova, Ibrahim: Liria e krijimtarisë (Replikë distancuese). Fjalë e mbajtur në Kongresin e Nëntë të Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë). "Fjala", Prishtinë, 1985, 1 maj, nr. 9, f. 6.
51. Rugova, Ibrahim: Opsi poetik i Beqir Musliut (I, II). Nga distanca e aktualitetit; 1. Rima të shqetësuar (ambienti i brendshëm); 2. Lulëkuqet e gjakut/vetëdija krijuese; 3. Bukurija e zezë/metafora estetike; 4. Kurorë sonetesh/personazhi historik; 5. Sezamet/imagjinarieteti, koceptualiteti poetik; 6. Parabola/absurdi. Darka e magjisë/metafizike e ekzistimit; 7. Përfundime. "Fjala", Prishtinë, 1985, 15 maj, nr. 10, f. 4; 1 qershor, nr. 11, f. 4-5.
52. Rugova, Ibrahim: Xhojsi, shqipja, Aristoteli. 1. Rasti i kërkimit: Hodgarti; 2. Xhojsi, Irlanda, mërgimi; 3. Fenegen Ueik; 4. Fjalë e shprehje shqipe; 5. Aristoteli përmes shqipes; 6. Malësia te një libër para 1500-shit; 7. Një tablllo antike shqiptare; Në fund. "Rilindja", Prishtinë, 1985, 7 shtator, f. 14.
53. Rugova, Ibrahim: Kritika bashkëkohore shqiptare dhe kritika evropiane. (Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor me temë "Gjendja e studimeve albanologjike - rezultate dhe probleme", që u mbajt në dhjetor të vitit të kaluar në organizim të Institutit Albanologjik të Prishtinës). "Jehona", Shkup, 1986, nr. 2, f. 17-23.
54. Rugova, Ibrahim: Poezi e refuzimit estetik. Fjalë e mbajtur në Tryezën e "Fjalës" për vëllimin e poezive të Azem Shkrelit "Kënga e hutinit". 1. Hyrje; 2. Parantezë; 3. Shqetësimi intelektual i subjektit poetik; 4. Tema historike; 5. Sociopatia jetësore; 6. Estetika negative dhe ideomatika autoktone; 7. Përmbyllje."Fjala", Prishtinë, 1986, 15 maj, nr. 10, f. 6-7.
55. Rugova, Ibrahim: Kritika letrare e Rilindjes Kombëtare (f. 35). I. Konteksti sociokulturor (f. 35-37); II. Kritika romantike (f. 37); 1. Letërsia e traditës - letërsia gojore (f. 37-38); 2. Konstituimi i kritikës (f. 38-39); IV. A. Stratikoi: Bazat e historisë së letërsisë (f. 40-41); V. Konica: Vetëdija për nevojën e kritikës (f. 41-43); 1. Ç'është

kritika (f. 43-44); 2. Modeli si metodë (f. 44-45); 3. Natyrë dhe logjikë (f. 45-46); 4. Atëdhësië dhe letrëtyrë (ideologjia dhe letërsia), f. 46-48; 5. Raporti shkrimtarët - kritika (f. 48-49); 6. Praktika kritike (f. 49-53); VI. M. Markiano: Studimi monografik (f. 53-55); Résumé: La critique littéraire de la Renaissance nationale (f. 55). "Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave filologjike", Prishtinë, 1986, nr. 15-1985, f. 35-55.

56. Rugova, Ibrahim: Sublimimi i thënies eugjenike. 1. Në të parë; 2. Ideja e ndërlidhur; 3. Fenomenologjia e leximit; 4. Mitologjia - Autoktonja - Historia; 5. Në fund. Tryeza e "Fjalës", vëllimi me poezi i Musa Ramadanit "Eugjenika e tri detëve" që e botoi redaksia e botimeve "Rilindja", Prishtinë, 1986. "Fjala", Prishtinë, 1986, 1 shtator, nr. 15, f. 4-5.

57. Rugova, Ibrahim: Refuzimi estetik. 1. Përkufizimi; 2. Karakteri, natyra e letërsisë; 3. Estetika dhe politika; 4. Kontrollimi i veprave; 5. Shkrimtarët e oborrit; 6. Prijës i popullit; 7. Shkrimtari i angazhuar - letërsia e angazhuar; 8. Qenësia estetike; 9. Përfundime "Fjala", Prishtinë, 1987, 15 maj - 15 qershor, nr. 10-12, f. 1, 18.

58. Rugova, Ibrahim: Metoda kulturohistorike në punimet letrare të Çabejt. "Jeta e re", Prishtinë, 1987, nr. 6, f. 430-436. 59. Rugova, Ibrahim: Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare (Nga vepra Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptarer 1504 -1983. Botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1986). Kritika e periudhës 1912 - 1944 (f. 12); Teza e Branko Merxhanit (f. 12); Programi i revistës "Bota e re" (f. 12); Konsolidimi i kritikës (f. 12-13); Disa probleme të kritikës (f. 13); Kritikizmi dhe mostoleranca (f. 13). "Rilindja", Prishtinë, 1987, 8 gusht, f. 12-13.

60. Rugova, Ibrahim: Një varg - një poezi. ("Melankolia" poezi nga libri më i ri i Sabri Hamitit "Leja e njohtimit 1985", Prishtinë, 1985). 1. Meditimi; 2. Ndërtimi; 3. Dhe meditimi përsëri. "Rilindja", Prishtinë, 1987, 22 gusht, f. 12.

61. Rugova, Ibrahim: Dialogu poetik i Gurakuqit. 1. Parantezë: personaliteti, individualiteti (f. 12); 2. Dialogu poetik (f. 12); 3. Parabola aktualiteti - historia (f. 13); 4. Nostalgjia (f. 13); 5. Mbi artin dhe artin e tij (f. 13). "Rilindja", Prishtinë, 1987, 12 shtator, f. 12-13.

62. Rugova, Ibrahim: Katër urata origjinale të Buzukut. 1. Buzuku i Çabejt; 2. Katër uratat origjinale; 3. Idetë kombëtare dhe kulturore. "Rilindja", Prishtinë, 1987, 24 tetor, f. 12; 25 tetor, f. 12;

63. Rugova, Ibrahim: Një poemë e Pjetër Budit. 1. Opusi poetik i Budit; 2. Nga zhanret dhe format letrare; 3. Çështje të tjera. "Rilindja", Prishtinë, 1987, 31 tetor, f. 10.

64. Rugova, Ibrahim: Terminologjia letrare te shkrimtarët e vjetër shqiptarë. 1. Terma të përgjithshëm; 2. Terma zhanrorë; 3. Terma të teorisë e të poetikës; 4. Terma të poetikës orientale. "Rilindja", Prishtinë, 1988, 6 shkurt, f. 13.

65. Rugova, Ibrahim: Studime me relevancë shkencore. 1. Teksti, përkujtimi; 2. Një interpretim; 3. Metodologjia, rezultati. (Rexhep Munishi: "Këngët malësorçe shqiptare). "Fjala", Prishtinë, 1988, 1-15 shkurt, nr. 3-4, f. 27-28.

66. Rugova, Ibrahim: Aspekte të një strategjie të fshehur negative (Fjala në Beograd në temën: Serbet dhe Shqiptarët sot në Jugosllavi me 26 prill 1988). "Rilindja", Prishtinë, 1988, 27 prill, f. 12.
67. Rugova, Dr. Ibrahim: Kur mbaron gjuha, mbaron edhe qenia kombëtare (Fjalë nga debati i zhvilluar në tribunën "Perspektiva - në barazinë e gjuhëve" organizuar nga Bashkësia Kulturore-Arsimore e Kosovës). "Rilindja", Prishtinë, 1988, 8 dhjetor, f. 10.
68. Rugova, Ibrahim: Imuniteti autokton. 1. Gjendja epidemike; 2. Intelektuali dhe roli i tij; 3. Empiria popullore; 4. Dokumenti-fakti (Romani i Isuf Buxhovit "Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit"). "Drita", Tiranë, 1989, 26 mars, nr. 13, f. 10, 11.
69. Rugova, Ibrahim: Poezia e Bogdanit dhe tipare të stilit të veprës së tij. "Studime filologjike", Tiranë, 1989, nr. 2, f. 99-118.
70. Rugova, Ibrahim: Historia shqiptare në veprën e Pjetër Bogdanit. 1. Parahistoria dhe antika ilire; 2. Mesjeta shqiptare - Skënderbeu; 3. Nga koha e tij "Drita", Tiranë 1989, 5 nëntor, f. 10-11.
71. Rugova, Ibrahim: "Një përkushtim filozofik i së vërtetës te Bogdani". Fjalë në Tribunën Shkencore të Institutit Albanologjik të Prishtinës kushtuar Pjetër Bogdanit me rastin e 300-vjetorit të vdekjes së tij. "Rilindja", Prishtinë, 1989, 15 dhjetor, f. 10.
72. Rugova, Ibrahim: Elemente të hiperteatrit. Mendime për dramën "Ora e Kukurajës" të Beqir Musliut, në regjinë e Fadil Hysajt, Tribuna publike të organizuar në Teatrin Popullor të Gjakovës, menjëherë pas shfaqjes së premierës. "Rilindja", Prishtinë, 1989, 19 janar, f. 12.
73. Rugova, Ibrahim: Vepra me botë shqiptare. Fjalë e mbajtur me rastin e pritjes dhe shpalljes anëtar nderi të Martin Camajt në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës. "Fjala", Prishtinë, 1990, shtator, nr. 17, f. 5.
74. Rugova, Ibrahim: Konteksti kohor dhe stili në disa vepra të Ramiz Kelmendit (Fjalë në tribunën e Shoqatës së Shkrimtarëve me rastin e promovimit të veprave të Ramiz Kelmendit). "Bujku", Prishtinë, 1991, 26 prill, f. 13.
75. Rugova, Ibrahim: Konica: Dija dhe liria. "Bujku", Prishtinë, 1995, 4 maj, f. 1.
76. Rugova, Ibrahim: Vetëdija për format e kritikës [Mitrush Kuteli]. "Jeta e re", Prishtinë, 1995, nr. 5, f. 599-606.
77. Rugova, Ibrahim: Xhojsi i letërsisë shqiptare (Anton Pashku). "Bujku", Prishtinë, 1995, 2 nëntor, f. 8.
78. Rugova, Ibrahim: Aspekte kreative të vrojtimit kritik [Hasan Mekuli]. "Jeta e re", Prishtinë, 1996, nr. 5, f. 695-698.
79. Rugova, Dr.: Vepra e Sabri Hamitit një pasuri kapitale e kombit shqiptar. Në Bibliotekën Kombëtare Universitare të Kosovës u përurua vepra complete e Sabri Hamitit. "Bota sot", Prishtinë, 2002, 23 nëntor, f. 16.
80. Rugova, Dr.: Veprimtaria letrare, shkencore dhe politike e prof. Krasniqit është kombëtare dhe njerëzore. "Bota sot", Prishtinë, 2003, 11 shtator, f. 19.

//  
*INTERVISTA, BISEDA, ANKETA*

81. Rugova, Ibrahim: Lirika, Zenitet (Rubrika: Intervistë e vogë). Intervistoi: I.(brahim) K. (adriu). - "Rilindja", Prishtinë, 1969, 15 shtator, f. 7.
82. Rugova, Ibrahim: Hovin e pasurimit tonë letrar po e ndërprejnë disa dobësi tona. Bisedoi Gani Bobi. "Rilindja", Prishtinë, 31 dhjetor 1969, 1 e 2 janar, 1970, f. 17.
83. Rugova, Ibrahim: E reja në letërsi dhe kritika jonë letrare (Në pyetjet tona përgjigjet Ibrahim Rugova). Anketën e udhëhoqi: Jusuf Buxhovi. "Rilindja", Prishtinë, 1970, 19 dhjetor, f. 11
84. Rugova, Ibrahim: Është koha e punës. Bisedë me poetin dhe kritikun e ri Ibrahim Rugovën. Bisedoi: Nexhmedin Soba. "Flaka e vëllazërimit", Shkup, 1971, 21 nëndor, f. 14;
85. Rugova, Ibrahim: Ndërmarrje serioze dhe e vlefshme. Bisedë me Ibrahim Rugovën, që, bashkë me Isak Shemën, e ka përgatitur "Bibliografinë e kritikës letrare shqiptare 1944-1974". Intervistoi J. Buxhovi. "Rilindja", Prishtinë, 1975, 22 nëntor, f. 12.
86. Rugova, Ibrahim: Kam një mendim tjetër (Anketoi Hasan Hasani). "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1976, 6 mars, nr.9, f. 8.
87. Rugova, Ibrahim: Klasifikimi i gjeneratave zhduk epigonizmin dhe ndihmon progresin letrar Anketat e "Botës së re" - Brezi ynë letrar (Anketën e udhëhoqi Sh. Beqiri). "Bota e re", Prishtinë, 1976, 1 nëntor, nr. 13, f. 11.
88. Rugova, Ibrahim: Hapësirë e lirisë së realizueshme të punës (Anketoi: Xhemail Mustafa). "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1978, 4 mars, nr. 10. f. 12-13.
89. Rugova, Ibrahim: Kritika integrale është një monizëm heterogjen. Bisedë me kritikun letrar Ibrahim Rugova, me rastin e botimit të vëllimit me tekste teoriko-kritike "Kah teoria". Intervistoi: Xhemail Mustafa. "Rilindja", Prishtinë, 1978, 9 shtator, f. 12.
90. Rugova, Ibrahim: Kompleti i Kadaresë - ngjarje letrare e vitit (Shkrimtarët në prag të ndërrimit të moteve). Anketoi: Qerim Arifi . "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1981, 1 janar, nr. 54-1, f. 18.
91. Rugova, Ibrahim: Të shtrohen më shumë çështje me interes të drejtpërdrejtë për shkrimtarët (Xh. Mustafa: Pyetjeve të anketës sonë u përgjigjet Ibrahim Rugova kritik letrar). "Rilindja", Prishtinë, 1982, 16 gusht, f. 9.

92. Rugova, Ibrahim: Vepër bazë e humanistikës shqiptare. Bisedë me Ibrahim Rugovën, kritik dhe teoricien letrar. Bisedoi Abdullah Konushevc. "Rilindja", Prishtinë, 1982, 11 shtator, f. 12.
93. Rugova, Ibrahim: Më interesojnë fenomenet e letërsisë. Bisedë me Ibrahim Rugovën, kritik letrar, të cilit për studimin "Vepra e Bogdanit 1675-1685" iu dha shpërblimi i Dhjetorit për vitin e kaluar. Bisedoi: Xh. Mustafa. "Rilindja", Prishtinë, 1983, 29 janar, f. 12.
94. Rugova, Ibrahim: Gjeneratë poetësh nga e cila presim shumë (R. Musliu, M. Xhemajli, M. Krasniqi, B. Çapriqi, A. Konushevc etj.). Anketë në ndërrim motesh. Anketoi "Bota e re", Prishtinë, 1983, 1 janar, nr. 1, f. 18.
95. Rugova, Ibrahim: Presim një dialog të barabartë e konstruktiv (Biseda e "Fjalës" - Bisedë me Ibrahim Rugovën, kryetar i Kryesisë së SHSHK). Nëntitujt: Për forma më krijuese komunikimi e bashkëpunimi; Etiketa e heshtjes - për qëllim manipulimi e mashtrimi. "Fjala", Prishtinë, 1988, 15 mars, nr. 6, f. 1.
96. Rugova, Ibrahim: Repriza e një krize. Nëntitujt: Paralajmërimi i një dorëheqjeje kolektive; Kur çështjet mbeten në gjysmë të udhës; Shkrimtari në rolin e tjetërkujt; Dëmi nga sforcimi i mitologjisë; Bashkëpunimi dhe barabarësia; Gjakftohtësia, para së gjithash. Bisedën e zhvilluan: Shaip Beqiri dhe Blerim Shala. "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1988, 22 tetor, nr. 1209, f. 20-22.
97. Ibrahim Rugova: Libri "Refuzimi estetik" ishte libri i fundit që botova nga lëmi i kritikës dhe studimeve (Titulli u nxor nga intervista). Me rastin e promovimit të veprave të tij. Intervistoi Fatmire Rrahmani, Radio Kosova, 29 tetor 2005.

III  
PËRKTHIME

98. Sergej Jesenin: Poeti (poezi) - nga rusishtja. "Zani i rinisë", Prishtinë, 1968, 27 prill, nr. 17-18, f. 6. 99. Xhorxh Oruel. Totalitarizmi dhe letërsia. "Fjala", Prishtinë, 1969, prill, nr. 4, f. 12.
100. Kujtime për Kafkën (Pjesë fejttoni). "Zani i rinisë", Prishtinë, 1969, 18 janar, nr. 2, f. 15.
101. Ana Ahmatova: Epitaf (poezi). "Zani i rinisë", Prishtinë, 1969, 29 mars, nr. 12, f. 14.
102. Eugjen Jeftushenko: Monologu i tinejxherit (poezi). "Zani i rinisë", Prishtinë, 1969, 29 mars, nr. 12, f. 14.
103. Maja Borisova: Fytyra jote (poezi). "Zani i rinisë", Prishtinë, 1969, 29 mars, nr. 12, f. 14.
104. Andrej Voznesenski: Kaprojt (poezi). "Zani i rinisë", Prishtinë, 1969, 29 mars, nr. 12, f. 14.
105. Mihail J. Lermontov: Retë (Poezi). "Rilindja", Prishtinë, 1968, 31 dhjetor; 1969, 1, 2 kallnor, f. 6.
106. Dostojevski - frymëzim i Ajnshtajnit. Fejton. [Tendenca dhe poetika (1). Përgatiti: Ibrahim Rugova]. "Rilindja", Prishtinë, 1971, 19 dhjetor, f. 12.
107. Stojan Vuçiqeviq. Filozofia e një poezie (Lao Ce: "Libri i Taos dhe Tesë". Përgatiti Ibrahim Rugova. "Fjala", Prishtinë, 1971, dhjetor, nr. 12, f. 12-13.
108. Vesna Parun. Ishte verë. Poezi. "Fjala", Prishtinë, 1972, shkurt, nr. 2, f. 10.
109. Done Zajc. I huaji. Poezi. "Fjala", Prishtinë, 1972, prill, nr. 4, f. 9.
110. Aleksandar Blllok. Të dymbëdhjetët (poemë). Përgatiti: I. Rugova. "Fjala", Prishtinë, 1972, shtator, nr. 9, f. 17.
111. Përse e vrau vetën Heminguej? Nëntitujt: Një udhëtim, një ngatërresë; Indjekur, i prekur; Mëdyshje, amulli; I sëmurë, pa shërim; I pafat kundër vetes. (Përgatiti: Ibrahim Rugova). "Rilindja", Prishtinë, 1972, 16 shtator, f. 13.
112. Gilbert Hajet: Rendjet e mendjes njerëzore (Ese i përkthyer). Nëntitujt: Mjekët e shpirtit; Më shumë të shkolluar në vitin 150 se në atë 1850; Kurrfarë hapësire. "Rilindja", Prishtinë, 1972, 16 dhjetor, f. 12.
113. H. L. Borhes: Filozofia e ndihmon jetën. "Jeta e re", Prishtinë, 1973, nr. 2, f. 339-347.
114. Tomas Man. Arti i romanit. "Jeta e re", Prishtinë, 1973, nr. 5, f. 802-814.

115. Vinsten Hju Odin: Enigma e gjuhës poetike. "Jeta e re", Prishtinë, 1974, nr. 1, f. 147-165.
116. Sesil M. Baura: Simbolizmi dhe trashëgimia e tij. "Jeta e re", Prishtinë, 1974, nr. 2, f. 318-331.
117. Abraham Mol: Gjenezja e kësaj (f. 528). 1. Zhvillimi historik (f. 528-531); 2. Jeta dhe letërsia e kësaj (f. 531-537); 3. Përfundim 9 f. 537-542). "Jeta e re", Prishtinë, 1974, nr. 3, f. 528-542.
118. Ivan Foht: Kufijtë e ontologjisë së artit në hulumtimin e veprës letrare. "Jeta e re", Prishtinë, 1975, nr. 3, f. 639-649.
119. Jan Mukarzhovski: Rëndësia e estetikës. Përktheu Ibrahim Rugova. "Jeta e re", Prishtinë, 1975, nr. 1, f. 23-33.
120. Ulyse Renaud: Ishin ato ditë (Daut Berishës). Poezi "Rilindja", Prishtinë, 1978, 1 qershor, f. 10.
121. Katalina Vatashesku: Parafraza të shkëlqyeshme afër origjinalit (për përkthimin e librit me poezi: Mihail Eminescu "Ylli i dritës" nga Rexhep Ismajli). Artikulli i shkruar në frëngjisht është marrë nga revista Synthesis, Akademia e Shkencave Sociale e Politike e Republikës Socialiste të Rumanisë, 1977, nr. IV, f. 262-264. "Rilindja", Prishtinë, 1978, 29 korrik, f. 12.
122. Zhak Menje: Cvetan Todorovi në gjurmë të Konkuistatorëve. "Rilindja", Prishtinë, 1982, 4 dhjetor, f. 12.
123. Charl Lalo: Objektet dhe metodat e estetikës. I. - Objektet e estetikës (f. 15). I. - Problemet e shtrura keq. - Polemikë të shkollave; II. - Problemi i vërtetë: e bukura natyrore dhe e bukura artistike; III. - Estetika është filozofi i artit, apo e kritikës dhe historisë së artit. II. - Metodat e estetikës. Nëntitujt: I. Çështje paraprake - Mungesa metodike e metodës; II. Estetika eksperimentale; Objektet dhe metodat e estetikës. "Fjala", Prishtinë, 1978, 1 qershor, nr. 11, f. 12.
124. Faik Konica: Letërsia shqiptare (Albania, Bruxelles, 1897, vj. I, nr. 1, f. 7-8. Nga frëngjishtja). Në librin: I. Rugova & S. Hamiti "Kritika letrare", Prishtinë, 1979, f. 45-48.
125. Skënder Luarasi: Letërsia moderne në Shqipëri (Nga frëngjishtja. Nga Revue internationale des etudes Balkaniques, Beograd, 1936, II eme annee, tome I-II (3-4). F. 524-527; 551-5540. Librin: I. Rugova & S. Hamiti "Kritika letrare", Prishtinë, 1979, f. 321-328.
126. Horhe Luis Borhes (1899-1986): "Vdekja për të pavdekshmin është e kotë"; Libri i rërës; Librat e mi (poezi); "Kush jam unë..." Shkruaj nga një urdhër i brendshëm... Përgatiti: Ibrahim Rugova. "Fjala", Prishtinë, 1986, korrik, nr. 13, f. 4.

IV  
TË TJERËT PËR IBRAHIM RUGOVËN  
DHE VEPRËN E TIJ

127. Aliu, Ali: Studim monografik i kritikës letrare [Ibrahim Rugova, "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983", Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1986]. "Bota e re", Prishtinë, 1987, 15 mars, nr. 6, f. 16.
128. Aliu, Ali: Një vështrim mbi perceptimin estetik të veprës së Ibrahim Rugovës (Kumtesë e mbajtur në simpoziumin "Rugova dhe vepra e tij", me 29 shtator në Tiranë). Gazeta "55", Tiranë, 2006, 5 tetor, f. 8.
129. Bajra, Y.(mer): Poet i vogël (Ju prezentojmë - Ibrahim Rugovën). "Rilindja", Prishtinë, 1962, 27 fror, f. 9.
130. Baku, Pasho: Rugova, Ibrahim (1944-2006). Në: Pasho Baku "Enciklopedia universale e ilustruar". Botoi Shtëpia Botuese Bacchus, Tiranë, 2011, f. 810-811.
131. Balliu, Fahri: Monografia e Sabri Hamitit një akt i madh qytetar (Fjala në promovimin e librit të Sabri Hamitit "Presidenti Rugova: Memento për Rugovën" mbajtur në Tiranë). "55", Tiranë, 2007, 3 korrik, f. 7.
132. Bashota, Sali: Vetëdijesimi dhe funksionaliteti i shkrimit kritik (f. 195). Venerime hyrëse (f. 195-196); Eseja, studimi vështrimi (f. 196-198); Bibliografia e romanit bashkëkohor (f. 198-199); Teoria e kritikës (199-201); Për fund (f. 201). Në librin: Sali Bashota "Shqipshkrimi kritik". Botoi Ndërmarrja Botuese "Rilindja", Prishtinë, 1997, f. 195-201.
133. Bejko, Sadik: Homo civitatis (Filozofia e Rugovës). "Iliria Post", Prishtinë, 2006, 3 shkurt, f. 18.
134. Belaj, Ismail: Përafrime dhe interpretime letrare (Ibrahim Rugova: "Strategjia e kuptimit". Botoi "Rilindja", Prishtinë, 1980). "Fjala", Prishtinë, 1981, 1 maj, Nr. 9, f. 15.
135. Berisha, Anton: Qenësi teorike dhe thellësi mendimi (Ibrahim Rugova "Kah teoria", "Rilindja", Prishtinë, 1978). 1. Domosdoja e parë: njohja teorike; 2. Domosdoja e dytë: kryesorja e veprës letrare - artistikja; 3. Domosdoja jo e fundit: sistemi nacional. "Rilindja", Prishtinë, 1978, 5 gusht, f. 15.
134. Berisha, Anton: Dëshmi e vetëdijësimit të mendimit tonë teoriko - kritik. Ibrahim Rugova "Strategjia e kuptimit", botoi "Rilindja", Prishtinë, 1980; Qenësia e kuptimit të krijimit artistik; thellësia e aplikimit dhe ekonomia e stilit. "Rilindja", Prishtinë, 1980, 27 dhjetor, f. 12.
135. Berisha, Dr. Anton: Interpretim modern i veprës së Bogdanit (Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit 1675-1685, botoi "Rilindja", Prishtinë, 1982). Vijimësi krijuese;



- Qasje pa kompleks; Moderniteti i veprës dhe moderniteti i shkrimit; Thellësia vrojtuese dhe aftësia interpretuese. "Rilindja", Prishtinë, 1982, 16 tetor, f. 14.
136. Bullo, Jorgo: Ibrahim Rugova la një trashëgimi të çmuar shkencore. (Personalitete të letrave shqipe vlerësojnë rolin e Dr. Rugovës). "Bota sot", Prishtinë, 2006, 31 janar, f. 22.
137. Canolli, Arsim: Kultura dhe refuzimi estetik. Në librin: Arsim Canolli "Kultura K". Botoi AIKD, Prishtinë, 2009, f. 196-204.
138. Çiraku, Ymer: Profil studiuesi (Mbi studimet letrare të I. Rugovës). Në librin: Ymer Çiraku "Në zbërthim të kodeve letrare" (Studime - ese), Tiranë, 1998, f. 68-76.
139. Çobani, Tonin: Vepra e Bogdanit - dy herë e humbur. (Ibrahim Rugova: Vepra e Bogdanit 1675-1685), Tiranë, 1989. "Rilindja demokratike", Tiranë, 1991, 13 shkurt, f. 4.
140. Dado, Floresha: Akademik i lartë që shfaqet si një faktor i jashtëzakonshëm kritik. "Bota sot", Prishtinë, 2006, 23 janar, f. 24.
141. Dërvishi, Teki: Prekja si impresion [Ibrahim Rugova: "Prekje lirike" (Vështrime letrare. "Rilindja", Prishtinë, 1971)]. "Flaka e vëllazërimit", Shkup, 1971, 8 gusht, f. 16.
142. Dërvishi, Teki: Ibrahim Rugova është i pari që qysh si student ka mohuar realizmin socialist ose dogmat letrare (Deklaratë e njerëzve të letrave shqipe për veprën letrare të presidentit të ndjerë, dr. Ibrahim Rugova). "Koha ditore", Prishtinë, 2006, 23 janar, f. 20.
143. Gjoka, Behar: Rugova, formulues i shkencës letrare. "Metropol", Tiranë, 2006, 25 janar, f. 16.
144. Hamiti, Sabri: Ligjërime estetiko-poetike (I. Rugova dhe rubrika "Zenite letrare"). *Fjala*, Prishtinë, 1970, prill, nr. 4, f. 15.
145. Hamiti, Sabri: Ibrahim Rugova: Kërkimi i kuptimit (f. 153). I. Shkrimi kritik i argumentuar (f. 155). 1. Teorizime e likuidime (f. 155-156); 2. Letërsia dhe detyrat (f. 156-158); 3. Arti i interpretimit (f. 158-159); 4. Vlerësia e metodave (f. 159-160); 5. Tekstet shqipe (f. 160-161); 6. Vetëdija kritike dhe qëndrimi (f. 161-162). II. Teoria e poezisë (f. 163). 1. Eseu, kritika (f. 163-164); 2. Teoria e poezisë (f. 164-165); 3. Tri tipe të poezisë (f. 165-167); 4. Vlerësimet (f. 168-169). III. Kërkimi i kuptimit (f. 170); 1. Karakteri i veprës (f. 170-173); 2. Kërkimi, metoda, rezultati (f. 173-179). IV. Njohja e letërsisë (f. 180-182). Në librin: Sabri Hamiti "Arti i leximit" (Sprova për një poetikë 3), Rilindja, Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1983, f. 155-182.
146. Hamiti, Sabri: Memento për Rugovën. I. Biografia (f. 13). Ka botuar këto vepra (f. 13-14); Çmimet dhe titujt ndërkombëtar të Ibrahim Rugovës (f. 15). II. Kritika (f. 16). 1. Qarku i Prishtinës (f. 16); 2. Profili i kritikut (f. 17-18). III. Politika (f. 19). 1. Presidenti/Kryetari (f. 19); 2. Shqiptari (f. 20); 3. Politika (f. 21); 4. Besimi (f. 22); 5. Elipsat (f. 22-23); 6. Shenjat (f. 23-24); 7. Pamja (f. 24); 8. Miku (f. 25-26); 9. Ikona (f. 26); 10. Trashëgimia (f. 26-28). IV. Kujtesa (f. 29-32). Në librin: "Presidenti Rugova", Prishtinë, 2007, f. 13-32.

147. Hasani, Hasan: Rugova, Ibrahim (1945). Në librin: Hasan Hasani "Leksikon i shkrimtarëve shqiptarë 1501 - 1990", Prishtinë, 1994, f. 254.
148. Ismajli, Rexhep: Ndërthurje e njohjeve albanistike me dijet bashkëkohore. (Fjalë e mbajtur me rastin e përrimit të kompletit të veprave të Ibrahim Rugovës në Tiranë). "Koha ditore" (Koha për kulturë, nr. 279, 12 nëntor 2005), Prishtinë, 2005, 12 nëntor, f. 26.
149. Jasiqi, Ali D: Kultivuesi i modernitetit. Në librin: Ali D. Jasiqi "Tridhjetë e një shkrime për poezinë dhe studimet e tjera", Prishtinë, 2007, f. 80-83.
150. Kadare, Ismail: Parathënie. Në librin: Ibrahim Rugova, "Çështja e Kosovës". Biseda me Marie - Françoise Allain dhe Xavier Galmiche. Botoi "Dukagjini", Pejë, 1994, f. 13-37.
151. Kikaj, Vehbi: Shprehja e sinqertë e fëmijve në vargjet e tyre (Shembuj: Myrvete Myha, Agim Byci dhe Ibrahim Rugova). "Rilindja", Prishtinë, 1965, 1, 2 e 3 maj, f. 15.
152. Konushevc, Abdullah: Dëshmi për vlerën e qëndrueshme të mendimit tonë kritik, teorik dhe estetik (I. Rugova, S. Hamiti: "Kritika letrare", botoi "Rilindja", Prishtinë, 1979). "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1981, 17 janar, nr. 3, f. 20.
153. Kraja, Mehmet: Rugova, portret i shkrimtarit. Në librin: Mehmet Kraja "E shtuna ime". Botues Pen-Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2009, f. 189-191.
154. Krasniqi, Nysret: Lufta ndaj harresës (f. 181). Presidenti Ibrahim Rugova-Memento për Rugovën (f. 181-184); Rugova meditant - kritika letrare e Ibrahim Rugovës (f. 184-185); Rugova: vizioni nacional (f. 185-186). "Verbi", Prishtinë, 2009, nr. 4, f. 181-186.
155. Kullashi, Muhamedin: Rugova dhe libraritë e Parisit. Ese. Nëntitujt: Leximi: Bisedë për kërkim; Leximi që paralizon. "Shekulli", Tiranë, 2006, 24 janar, f. 1, 15.
156. Kulla, Ndriçim: Rugova, një autoritet postmortum, po kaq i madh sa në gjallje. (Kumtesë e mbajtur në simpoziumin "Rugova dhe vepra e tij", më 29 shtator në Tiranë). "Gazeta 55", Tiranë, 2006, 30 shtator, f. 8.
157. Kumtesë: Antologjia "Lulet në ballkon" (Botim i vitit 1982). - Tërhiqet nga shitja. (Kryesia e KK të LRS të Kosovës). "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1987, 14 mars, nr. 1197, f. 5.
158. Maloku, Enver: Refuzimi i strategjisë negative (Dy ese të Dr. Ibrahim Rugovës: "Strategjia negative", 1980 dhe "Refuzimi estetik", 1987). "Rilindja", Prishtinë, 1990, 29, 30 prill dhe 1 e 2 maj, f. 13.
159. Marku, Mark: Filozofia e refuzimit (Vështrim krahasues). "Shekulli", Tiranë, 2005, 5 nëntor, f. 19.
160. Mehmetaj, Albanë: De Rada i lexuar (Estetika e De Radës në optikën e studiuesve), f. 180. 2. Ibrahim Rugova. Në librin: Albanë Mehmetaj "De Rada estet". Botoi AIKD-99, Prishtinë, 2010, f. 86-71.
161. Miftari, Vehbi: Kritika e qenësisë (Ibrahim Rugova: "Refuzimi estetik", Rilindja, Prishtinë, 1987) 1. Njësia artistike: Esetja kritike (f. 91-92); 2. Kërkimi letrar: qenësia e veprës (f. 93-94); 3. Veçantitë krijuese: kohësia e librit dhe vetëdija letrare (f. 94-95);

4. Kritika letrare shqipe dhe teoria e kritikës (f. 96-98); 5. Përfundim (f. 98-99). Në librin: Vehbi Miftari "Teoria e objektit". Botoi: AIKD, Prishtinë, 2001, f. 89-99.
162. Morina, Enver S: Mesi i artë, madhështia në mes të Rugovës dhe Kadaresë. Zëri i ndërgjegjës së shkrimtarit dhe akti intelektual; Kadare: Ibrahim Rugova, president; Dr. Rugova: Universumi letrar kadarean...; Dr. Rugova: Kërkesa e Kadaresë "sui generis"; Kadare: Kemi qenë miq edhe kur kemi pasur mendime të njëjta dhe kemi mbetur miq edhe kur kemi pasur mendime të kundërta. "Bota sot", Prishtinë, 2006, 1 shkurt, f. 27.
163. Musliu, Ramadan: Riaktivizimi i memories letrare (Monografia "Vepra e Bogdanit 1675-1685" e Dr. Ibrahim Rugovës). Nëntitujt: Poetika e letërsisë sonë të vjetër (f. 163-164); Koncepti i letërsisë së vjetër (f. 165-166); Koncepti mesjetar i shkrimit (f. 166-168); Statusi i veprës së Bogdanit (f. 168); Aspekti zhanror (f. 168-169); Fusha e problematizimit (f. 169-171); Plotënia e imazhit (f. 171-172). Në librin: Ramadan Musliu "Estetikë e dallueshme", Prishtinë, 2003, f. 163-172.
164. Musliu, Ramadan: Morfologji e mendimit kritikoteorik shqiptar. (f. I). Nëntitujt: Konteksti i sotëm socio-kulturor (f. I); Kontinuiteti dhe diskontinuiteti kulturor (f. II-III); Paradigmë e studimeve të sotme (f. III); Karakterizimi i problemeve dhe koncepteve të kritikës (f. IV); Nocioni kritikë (f. IV-V); Kontekstualizimi i orientimeve kritike (f. V-VII); Fiksimi i kodit kritik (f. VII); Ideja e kulturofikimit (f. VII/VIII); Në vend të përfundimit (f. VIII-IX). Në librin: Ibrahim Rugova "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504- 1983", Botim i dytë. Botoi Euerorilindja, Tiranë, 1996, f. I-IX.
165. Mustafa, Xhemal: Vetëdija mbi tërësinë (Ibrahim Rugova "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983". Botim i dytë i "Eurorilindjes", Tiranë, 1996). "Bujku", Prishtinë, 1997, 13 shtator, f. 12.
166. Mustafaj, Besnik: Redaksia e "Dritës" më hoqi një poezi kushtuar I. Rugovës, më 1988. Në librin: Besnik Mustafaj "Midis krimeve dhe mirazheve". Ese. Botoi "Onufri", Tiranë, 1999, f. 40-41.
167. Plasari, Aurel: Botimi, një qasje e mirëfilltë filologjike (Sabri Hamiti: "Presidenti Ibrahim Rugova - Memento për Rugovën). "Gazeta 55", Tiranë, 2007, 3 korrik, f. 14.
168. Podrimja, A.(li): Studimi i Rugovës (Vepra e Bogdanit 1676-1685). "Zëri i rinisë", Prishtinë, 1983, 12 mars, nr. 11, f. 32.
169. Pllumi, Zef Át: Ibrahim Rugova. "Panorama", Tiranë, 2011, 27 tetor, f. 19.
170. Raifi, Mensur: Trajtesë mbi vazhdimësinë e mendimit kritik shqiptar. Ibrahim Rugova: "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983", botoi Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1986. "Fjala", Prishtinë, 1987, 15 janar / 1 shkurt, nr. 2-3, f. 19.
171. Rrahmani, Zejnullah: Kritiku me prirje drejt racionalizmit dhe filozofisë. "Bota sot", Prishtinë, 2006, 23 janar, f. 24.
172. Sedaj, Engjëll: Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit (1675-1685), Rilindja, Prishtinë, 1982. "Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave filologjike", Prishtinë, 1984, nr. XIII-1983, F. 314-319.

173. Sinani, Shaban: Midis dy Rilindjeve (Pjetër Bogdani dhe vepra e tij “Cuneus prophetarum” në studimin monografik të Dr. Ibrahim Rugovës dhe në disa studime tjera - Sprovë për një vëzhgim krahasimtar). “Nëntori”, Tiranë, 1991, nr. 1, f. 116-133.
174. Spahiu, Nexhmedin: Monument i rebelimit intelektual. “Fjala”, Prishtinë, 1991, shkurt, nr. 5, f. 7.
175. Sylaj, Sylejman: Kritika si teori [Ibrahim Rugova “Strategjia e kuptimit”]. “Jeta e re”, Prishtinë, 1981, nr. 4, f. 592-599.
176. Shabani, Resul: Pikëpamjet e Rugovës mbi intelektualin. (Kumtesë e mbajtur në simpoziumin “Rugova dhe vepra e tij”, me 29 shtator në Tiranë). “55”, Tiranë, 2006, 1 tetor, f. 6.
177. Shala, Kujtim M.: Rugova meditans (Kritika letrare e Ibrahim Rugovës), f. 273. Nëntitujt: 1. Rugova meditans (f. 273-275); 2. Teoria: Letërsia/Kërkimet (f. 276-278); 3. Kritika/Metakritika (f. 278-280); 4. Estetikë dhe Ideologji (f. 281- 282); 5. Shekulli i Ibrahim Rugovës (f. 282-284). Në librin: Kujtim M. Shala “Shekulli i letërsisë shqipe”, Ndërmarrja Botuese “Gjon Buzuku”, Prishtinë, 2006, f. 273-284.
178. Shala, Kujtim M.: Rugova: Qarku i Prishtinës dhe rugovizmi (Rikujtesë). I. Qarku letrar i Prishtinës (f. 115); II. Ibrahim Rugova (f. 116-117); III. Acta Albanica (Veprimi nacional / rugovizmi), f. 118. Në librin: Kujtim M. Shala: Prishtina letrare (Acta Albanica: Qarku letrar i Prishtinës). Botoi Albas, Tiranë, 2011.
179. Sherifi, (Skënder): Dy përmbledhjet e mia janë përkthyer nga Ibrahim Rugova. “Zëri”, Prishtinë, 2008, 25 korrik, f. 27.
180. Shita, Vehap: Ibrahim Rugova. Rubrika: Leksikon i vogël i shkrimtarëve. “Rilindja”, Prishtinë, 1986, 27 shtator, f. 13.
181. Tufa, Agron: Profeti dhe testamenti. “Tema”, Tiranë, 2006, 25 janar, f. 10.
182. Xhemali, Mustafë: Ibrahim Rugova - studiues i guximshëm në fushën e kritikës letrare. “Haemus”, Bukuresht, 2006, 30 janar, f. 89-90.
183. Xholi, Zija: Pjetër Bogdani (1630-1689), Ibrahim Rugova “Vepra e Bogdanit 1675-1685”. Në librin: Zija Xholi “Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare”, Tiranë, 2003, f. 197-198.
184. Zeqo, Mojkom: Rugova shekuj më vonë e ka veshur petkun e heroit të tij, Bogdanit. “Bota sot”, Prishtinë, 2006, 5 shkurt, f. 21.
185. Zheji, Gjergj: Ibrahim Rugova: mendimtar dhe letrar i shquar. “Drita”, Tiranë, 2005, 13 nëntor, f. 3.<sup>83</sup>

---

<sup>83</sup> Sipas Kujtim M. Shala, Dhurata Shehri, Munish Hyseni, Albanë Mehmetaj: “Rugova i letërsisë”, Fondacioni “Ibrahim Rugova”, Prishtinë, 2012, ff. 279-299.

## LITERATURA

### ***Korpusi teorik***

1. "Aesthetics and the Philosophy of Art", edited by Peter Lamarque and Sten Haugon, Blackwell Publishers, Oxford, 2004.
2. ARISTOTELI: "Poetika", Rilindja, Prishtinë, 1984.
3. BART, Rolan: "Aventura semiologjike", Rilindja, Prishtinë, 1986.
4. CALINESCU, Matei: "Pesë fytyrat e modernitetit", Dituria, Tiranë, 2012.
5. "Critical Terms for Literary Study", edited by Frank Lentricchio and Thomas G. McLonghlin, The University of Chicago Press, Chicago and London, 1995.
6. CULLER, Jonathan: "Criticism after Structuralism", Routledge & Kegan Paul, London and Melburn, 1983.
7. DERRIDA, Jacques: "Of Grammatology", The John Hopkins University Press, Baltimore and London, 1997.
8. ECO, Umberto: "Otvoreno djelo", Veselin Masleša, Sarajevo, 1965.
9. HAJDEGGER, Martin: "Poetry, Language, Thought", Hague & Roë Publishers, New York, 1971.
10. FRAJ, Northrop: "Anatomia e kritikës", Rilindja, Prishtinë, 1990.
11. GADAMER, Hans-George: "Historia e filozofisë", Plejad, Tiranë, 2008.
12. "Literary Aesthetics" edited by Alan Singer and Allen Dunn, Blackwell Publishers, Oxford, 2000.
13. PLATONI: "Shteti", Rilindja, Prishtinë, 1980.

14. "Teori dhe kritikë moderne" (zgjedhi dhe përktheu Nysret Krasniqi), Rozafa, Prishtinë, 2008.
15. TODOROV, Cvetan dhe DYKRO, Olivier: "Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërit", Rilindja, Prishtinë, 1984.
16. VELEK, Rene dhe VOREN, Ostin: "Teoria e letërsisë", Rilindja, Prishtinë, 1982.
17. ZHENET, Zherar: "Figura", Rilindja, Prishtinë, 1985.
18. "20<sup>th</sup> Century Literary Criticism", edited by David Lodge, Londgman, London, 1972.

### ***Korpusi studimor***

19. ALIU, Ali: Studim monografik i kritikës letrare [Ibrahim Rugova, "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983", Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1986]. "Bota e re", Prishtinë, 1987, 15 mars, nr. 6, f. 16.
20. ALIU, Ali: Një vështrim mbi perceptimin estetik të veprës së Ibrahim Rugovës (Kumtesë e mbajtur në simpoziumin "Rugova dhe vepra e tij", me 29 shtator në Tiranë). Gazeta "55", Tiranë, 2006, 5 tetor, f. 8.
21. BEJKO, Sadik: Homo civitatis (Filozofia e Rugovës). "Iliria Post", Prishtinë, 2006, 3 shkurt, f. 18.
22. BERISHA, Anton: Qenësi teorike dhe thellësi mendimi (Ibrahim Rugova "Kah teoria", "Rilindja", Prishtinë, 1978). "Rilindja", Prishtinë, 1978, 5 gusht, f. 15.
23. BERISHA, Anton: Dëshmi e vetëdijësimit të mendimit tonë teoriko - kritik. Ibrahim Rugova "Strategjia e kuptimit", botoi "Rilindja", Prishtinë, 1980; Qenësia e kuptimit të krijimit artistik; thellësia e aplikimit dhe ekonomia e stilit. "Rilindja", Prishtinë, 1980, 27 dhjetor, f. 12.
24. BERISHA, Dr. Anton: Interpretim modern i veprës së Bogdanit (Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit 1675-1685, botoi "Rilindja", Prishtinë, 1982). "Rilindja", Prishtinë, 1982, 16 tetor, f. 14.

25. ÇIRAKU, Ymer: Profil studiuesi (Mbi studimet letrare të I. Rugovës). Në librin: Ymer Çiraku "Në zbërthim të kodeve letrare" (Studime - ese), Tiranë, 1998, ff. 68-76.
26. DADO, Floresha: Akademik i lartë që shfaqet si një faktor i jashtëzakonshëm kritik. "Bota sot", Prishtinë, 2006, 23 janar, f. 24.
27. HAMITI, Sabri: Ligjërime estetiko-poetike (I. Rugova dhe rubrika "Zenite letrare"). *Fjala*, Prishtinë, 1970, prill, nr. 4, f. 15.
28. HAMITI, Sabri: Ibrahim Rugova: Kërkimi i kuptimit (f. 153). Në librin: Sabri Hamiti "Arti i leximit" (Sprova për një poetikë 3), Rilindja, Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1983, ff. 155-182.
29. HAMITI, Sabri: Memento për Rugovën, Tiranë, "55", 2007.
30. ISMAJLI, Rexhep: Ndërthurje e njohjeve albanistike me dijet bashkëkohore. "Koha ditore" (Koha për kulturë, nr. 279, 12 nëntor 2005), Prishtinë, 2005, 12 nëntor, f. 26.
31. KADARE, Ismail: Parathënie. Në librin: Ibrahim Rugova, "Çështja e Kosovës". Biseda me Marie-Françoise Allain dhe Xavier Galmiche. Botoi "Dukagjini", Pejë, 1994, f. 13-37.
32. KRASNIQI, Nysret: Lufta ndaj harresës, "Verbi", Prishtinë, 2009, nr. 4, ff. 181-186.
33. KULLASHI, Muhamedin: Rugova dhe libraritë e Parisit. "Shekulli", Tiranë, 2006, 24 janar, f. 1, 15.
34. MARKU, Mark: Filozofia e refuzimit (Vështrim krahasues). "Shekulli", Tiranë, 2005, 5 nëntor, f. 19.
35. MEHMETAJ, Albanë: De Rada i lexuar, në librin: Albanë Mehmetaj "De Rada estet". Botoi AIKD-99, Prishtinë, 2010, ff. 86-71.
36. MEHMETAJ, Albanë: Semiologjia ime, Ndërmarrja Botuse "Buzuku", Prishtinë, 2013.
37. MUSLIU, Ramadan: Riaktivizimi i memories letrare (Monografia "Vepra e Bogdanit 1675-1685" e Dr. Ibrahim Rugovës), në librin "Estetikë e dallueshme", Prishtinë, 2003, ff. 163-172.



38. MUSLIU, Ramadan: Morfologji e mendimit kritikoteorik shqiptar, në Ibrahim Rugova "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983", Botim i dytë. Botoi "Eurorilindja", Tiranë, 1996, f. I-IX.
39. MUSTAFA, Xhemail: Vetëdija mbi tërësinë (Ibrahim Rugova "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504- 1983". Botim i dytë i Eurorilindjes", Tiranë, 1996). "Bujku", Prishtinë, 1997, 13 shtator, f. 12.
40. PLASARI, Aurel: Botimi, një qasje e mirëfilltë filologjike (Sabri Hamiti: "Presidenti Ibrahim Rugova - Memento për Rugovën). "Gazeta 55", Tiranë, 2007, 3 korrik, f. 14.
41. PLLUMI, Zef Át: Ibrahim Rugova. "Panorama", Tiranë, 2011, 27 tetor, f. 19.
42. RAIFI, Mensur: Trajtesë mbi vazhdimësinë e mendimit kritik shqiptar. Ibrahim Rugova: "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983", botoi Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1986. "Fjala", Prishtinë, 1987, 15 janar / 1 shkurt, nr. 2-3, ff. 19.
43. RRAHMANI, Zejnullah: Kritiku me prirje drejt racionalizmit dhe filozofisë. "Bota sot", Prishtinë, 2006, 23 janar, f. 24.
44. SEDAJ, Engjëll: Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit (1675-1685), Rilindja, Prishtinë, 1982. "Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave filologjike", Prishtinë, 1984, nr. XIII-1983, ff. 314-319.
45. SINANI, Shaban: Midis dy Rilindjeve (Pjetër Bogdani dhe vepra e tij "Cuneus prophetarum" në studimin monografik të Dr. Ibrahim Rugovës dhe në disa studime tjera - Sprovë për një vëzhgim krahasimtar). "Nëntori", Tiranë, 1991, nr. 1, ff. 116-133.
46. SHALA, Kujtim M.: Rugova meditants, në Kujtim M. Shala "Shekulli i letërsisë shqipe", Ndërmarrja Botuese "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2006, ff. 273-284.
47. SHALA, Kujtim M.: Rugova meditants, Ndërmarrja Botuese "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2008.
48. SHALA, Kujtim M.: Rugova: Qarku i Prishtinës dhe rugovizmi, në librin: Kujtim M. Shala: Prishtina letrare (Acta Albanica: Qarku letrar i Prishtinës), Albas, Tiranë, 2011.
49. SHALA, Kujtim M., SHEHRI Dhurata, HYSENI Munish, MEHMETAJ Albanë: Rugova i letërsisë, Fondacioni "Ibrahim Rugova", Prishtinë, 2012, ff. 279-299.

50. SHALA, Kujtim M.: Rugova dhe zbulimi i Bogdanit, "Drita", Prishtinë, 2013, ff. 14-15.
51. SHALA, Kujtim M.: Zbulesa e Rugovës, në Kujtim M. Shala: Prishtina letare: petit Paris, Ndërmarrja Botuese "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2014, ff. 139-150.
52. SHEHRI, Dhurata: Statusi i kritikës, Albas, Tiranë, 2013.
53. TUFA, Agron: Profeti dhe testamenti. "Tema", Tiranë, 2006, 25 janar, f. 10.
54. ZHEJI, Gjergj: Ibrahim Rugova: mendimtar dhe letrar i shquar. "Drita", Tiranë, 2005, 13 nëntor, f. 3.

## Abstrakti

Në punimin tonë të doktoraturës, metoda e studimit të veprës së Ibrahim Rugovës në ka qëllim parësor shenjimin dhe theksimin e pikëpamjeve kyçe të dijetarit tonë të njohur. Ne kemi synuar që përmes studimit të kësaj vepre të hetohen edhe disa orientime të reja në studimet letrare shqiptare, probleme estetike, filozofike dhe semiotike. Kështu që, në këtë plan, Rugova, me rezultatet e tij, është një shembull përfaqësues i studimeve letrare shqiptare moderne.

Duke e studiuar veprën diskurseve të Rugovës, hasim probleme kritike dhe teorike, letrare, semiotike, filozofike, estetike, strukturaliste, poststrukturaliste etj., që kanë një objekt të veçantë interesimi: elementin artistik dhe estetik të veprës letrare.

Rëndësia parësore e Rugovës si kritik letrar dhe studiues i letërsisë qëndron në mbështetjen e metodës strukturaliste dhe të semiologjisë, duke bërë që kërkimi i tij letrar të formojë një sistem të *shenjave studimore*. Ndërsa, interesimi parësor i Rugovës në çështjet teorike të letërsisë është letërsia si *differentia specifica*, e cila e ka objekt letërsinë si aktivitet të veçantë funksional (artistik), me efekte estetike dhe strukturë autonome.

Kërkesa sistematike e Rugovës për krijimin artistik të veprës argumentohet edhe më qartë me konceptin tjetër të tij, *refuzimin estetik*. Në kuptimin rugovian, *refuzimi estetik* e kërkon letërsinë si vlerë dhe funksionin e saj si qenësi, jo si letërsi në funksion.

Duke theksuar veçantitë që e përbëjnë profilin e Rugovën dijetar, është e rëndësishme të nënvizohet që ajo që e definon punën e këtij autori drejt këtij boshti të kërkimit është monografia për autorin më të shquar të letërsisë së vjetër shqipe, Pjetër Bogdanit. Rugova e lexon tekstin e Bogdanit si sistem shenjash, duke nxjerrë kuptime, duke operuar kështu mjete semiologjike.

Metoda e studimit të veprës studimore të Ibrahim Rugovës në punimin tonë ka patur parësor shenjimin dhe theksimin e pikëpamjeve kyçe të saj. Po ashtu, ne kemi synuar që përmes studimit të kësaj vepre të hetohen edhe disa orientime të reja në studimet letrare shqiptare, probleme estetike, filozofike dhe semiotike. Në këtë plan, Rugova, me rezultatet e tij, është një shembull përfaqësues i studimeve letrare shqiptare moderne.

Rëndësia themelore e Rugovës si kritik letrar dhe studiues i letërsisë qëndron në mbështetjen e metodës strukturaliste dhe të semiologjisë, duke bërë që kërkimi i tij letrar të formojë një sistem të *shenjave studimore*. Kështu, kjo metodë e tij ka bërë që ta dallojë dhe të ndërtojë personalitetin e Rugovës intelektual, të dallojë konceptet dhe problemet me të cilat merret ai. Ndërsa, interesim parësor i Rugovës në çështjet teorike të letërsisë është letërsia si *differentia specifica*, e cila e ka objekt letërsinë si aktivitet të veçantë funksional (artistik), me efekte estetike dhe strukturë autonome.

Refuzimi estetik e shenjon në njëfarë mënyre më qartë pikën qendrore të diskutimeve të Rugovës, duke dalë si udhërrëfyes i kërkimit. Është pra elementi estetik në art dhe në letërsi, i cili edhe e orienton hulumtimin tonë teorik (dhe zgjon interesimet tona), duke bërë që të fokusohemi më shumë te ky aspekt, duke e parë se si

është teorizuar, dhe si është kërkuar te veprat e poetëve dhe kritikëve konkretë, pasi që mbi këtë princip Rugova i analizon shenjat e tyre. Rezultatet që mbeten me vlerë te Rugova gjenden në tekstet bashkëkohore, pasi që në to ndihet i lirë të nxjerrë kuptime të ndryshme. I quan tekste të *shkrueshme*, sikurse Barti, sepse aktivizojnë lexuesin gjatë leximit dhe mundësojnë lexime të hapura.

Duke theksuar veçantitë që e përbëjnë profilin e Rugovën dijetar, është e rëndësishme të nënvizohet që ajo që e definon punën e këtij autori drejt këtij boshti të kërkimit është monografia për autorin më të shquar të letërsisë së vjetër shqipe, Pjetër Bogdanit. Rugova e lexon tekstin e Bogdanit si sistem shenjash, duke nxjerrë kuptime, duke operuar kështu mjete semiologjike.

Kritika letrare e Ibrahim Rugovës, para së gjithash, për nga mënyra e vështrimit, na shtyn që mendimin teorik dhe kritik ta shohim në një rend, ta lexojmë sistematikisht.

Fjalët çelës: kritikë letrare, estetikë, semiologji letrare, gjenetikë e veprës, analitikë, refuzim estetik, studim, eseistikë.

## Abstract

By studying the work discourses Rugova, facing critical problems and theoretical, literary, semiotic, philosophical, aesthetics, structuralism, post-structuralism etc., That have a particular item of interest: artistic and aesthetic element of the literary work. Rugova primary importance as a literary critic and scholar of literature lies in the support of structural method and semiotics, making his search literary form a system of signs study. While the primary focus of Rugova on theoretical issues of literature is literature as *differentia specifica*, which has the object of literature as separate functional activity (artistic), aesthetic effects and autonomous structure.

Rugova systematic request for artwork to work even more clearly argued with his other concept, rejecting aesthetic. In Rugovas terms, refusing requests literature as aesthetic value and its function as an essence, not as literature in function.

Stressing the peculiarities that make Rugova scholar profile, it is important to emphasize that what defines the work of the author towards the axis of research is monograph most prominent author Old Albanian literature, Peter Bogdani. Rugova Bogdani text reads as a system of signs, putting meanings, operating so semiotics tools.

The method of studying the work of Ibrahim Rugova study in our paper had primary marking and highlighting its key views. Also, we intended to study throw this work investigated several new orientations Albanian literary studies, problems aesthetic, philosophical and semiotic. In this plan, Rugova, with its results, is a representative example of modern Albanian literary studies.

Rugova's fundamental importance as a literary critic and scholar of literature lies in the support of structural method and semiotics, making his research literature to form a system of signs study. Thus, this method has made it to recognize and build

intellectual Rugova's personality, distinguish concepts and problems with which he deals. While Rugova's primary interest in theoretical issues of literature is literature as *differentia specifica*, which has the object of literature as separate functional activity (artistic), aesthetic effects and autonomous structure.

Rugova systematic request for artwork to work even more clearly argued with his other concept, rejecting aesthetic.

Refusal esthetically somehow mark clearly the focal point of discussions Rugova, emerging as research guide. It is thus the aesthetic element in art and literature, who also directs our theoretical research (and awakens our interests), doing to focus more on this aspect, seeing how theorizing, and is looking to deeds concrete poets and critics, since on this principle Rugova analyzes their signs. Results remaining value of Rugova found in contemporary texts, since in them feels free to draw different meanings. The text calls writeable, as Barthes, because activate the reader enable reading and open readings.

Stressing the peculiarities that make Rugova scholar profile, it is important to emphasize that what defines the work of the author towards the axis of research is monograph most prominent author Old Albanian literature, Peter Bogdani. Rugova, the Bogdani text reads as a system of signs and putting meanings.

Literary criticism of Ibrahim Rugova, first of all, by way of observation, pushes us theoretical and critical thinking to look at a sequence, to read systematically.

Keywords: literary criticism, aesthetics, literary semiotics, genetics work, analytical, aesthetic rejection, study, essayistic.